



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 DHE 17 PRILL 2019 - VAZHDIM**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. I 17. APRILA 2019. GODINE - NASTAVAK**

**PRILL - APRIL
2019**

Rendi i ditës

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 janar 2019:

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Protokollin Shtesë 5 të Marrëveshjes për Amendimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore,
2. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore,
3. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
4. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018, për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor,
5. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 28 shkurt 2019:

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale,
3. Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
5. Votimi në rundin e dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019,
7. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për pesë (5) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 7 mars 2019:

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale,
2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave,
3. Votimi i Raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017,
4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
6. Votimi i raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017,
7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017,
8. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,

9. Votimi për shkarkimin e një (1) anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.
10. Votimi i Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.
12. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë,
13. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.
14. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës,
15. Votimi në parim i Projektligjit për peticione,
16. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
17. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
18. Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar,
19. Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve.
20. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës.
21. Miratimi i Deklaratës në lidhje me vëllezërit Bytyqi,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
23. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për Kinematografinë,
24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat,
26. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim-ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës,
27. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit,
28. Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit të Procedurës Penale,
29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
31. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Diasporën,
32. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës,

33. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pronën publike,
34. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike,
35. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247,
36. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, në lidhje me mos-caktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës,
37. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluca, sipas kërkesës së kryetarit të GP Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a./NKEC.

IV. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 12 mars 2019:

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e mjeteve financiare nga shpenzimet e paparashikuara.

V. Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e mbajtur më 13 mars 2019:

1. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me bllokimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Presidenti.

Dnevni red

I. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 30 januara 2019. god:

1. Glasanje N/zakona o ratifikaciji za Dodatni Protokol 5 uz Sporazum o izmjeni i pristupanju Centralno Evropskom Sporazumu o slobodnoj trgovini,
2. Glasanje u načelu Nacrta zakona za izmene i dopune zakona br.02/L-88 o kulturno nasleđe,
3. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
4. Zahtev parlamentarne istražne Komisije u vezi rasvetljavanju slučaja poterivanja 6 turskih državljana, dana 29 mart 2018 za produžetak mandata za rok od 30 dana,
5. Glasanje u načelu N/zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova.

II. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 28 Februar 2019. god:

1. Drugo glasanje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-132 o vozilima,
2. Drugo glasanje Nacrta zakona o rudnicima i mineralima,
3. Drugo glasanje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Glasanje u drugoj rundi za izbor šest (6) članova Saveta za besplatnu pravnu pomoć,

6. Razmatranje zahteva Fonda penzijske štednje Kosova za usvajanje godišnje takse za 2019. god,
7. Formiranje komisije ad hoc za izbor kandidata za pet (5) članova Odbora Radiotelevizije Kosova.

III. Nedovršene tačke sa plenarne sednicu održane 7 mart 2019. god:

1. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na lične dohotke,
2. Drugo glasanje Nacrt zakona o porezu na prihode korporacija,
3. Glasanje Godišnjeg izveštaja Agencije za menadžiranje memorijalnih kompleksa Kosova za 2017.godinu.,
4. Glasanje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
5. Glasanje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
6. Glasanje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Ministarstva kulture, omladine i sporta za 2017. godinu,
7. Glasanje Izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2017. godine,
8. Glasanje za Imenovanje 7 (sedam) članova u Kosovskom savetu za kulturno nasleđe,
9. Glasanje za Razrešenje jednog (1) člana Borda Regulatornog autoriteta elektronskih i poštanskih komuniciranja,
10. Glasanje odluke Predsednika Republike Kosova o vraćanju Zakona br. 06/L-043 o slobodi udruživanja u nevladinim organizacijama,
11. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi neuspeha i skandala spoljne politike Republike Kosovo,
12. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi angažovanja Predsednika Kosova u uključivanju “razmene teritorija” ili “korigovanja granica” u dijalogu između Kosova i Srbije,
13. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog ne liberalizacije viza,
14. Glasanje u načelu Nacrta zakona o javnom prenosniku Kosova,
15. Glasanje u načelu Nacrta zakona o peticijama,
16. Glasanje u načelu Nacrta zakona za zaštitu od buke,
17. Glasanje u načelu Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za upoređivanje i verifikaciju imovine,
18. Glasanje u načelu Nacrta zakona o porezu na dodatu vrednost,
19. Glasanje u načelu N/zakona o lustraciji figura visokih službenika u Javnim Institucijama i izabranih,
20. Glasanje o preporukama od parlamentarne debate o slučaju seksualnog uznemiravanja i silovanja, nezakonitog abortusa maloletnice i institucionalnoj odgovornosti Vlade Kosova,
21. Usvajanje preporukama u vezi sa braćom Bytyqi,

22. Drugo razmatranje N/zakona o Specijalizovanom veću Vrhovnog suda u vezi pitanja Kosovke agencije za privatizaciju,
23. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.2004/22 o kinematografiji,
24. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.04/L-065 o autorskim pravima i srodnim pravima,
25. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.04/L-097 o bibliotekama,
26. Drugo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakonika o krivičnom postupku Republike Kosova,
27. Drugo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-042 o regulisanju usluga vode,
28. Prvo razmatranje N/ zakonika o krivičnom postupku,
29. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona o ličnoj karti,
30. Prvo razmatranje N/zakona o izvršenju krivičnih sankcija,
31. Prvo razmatranje N/zakona o dijaspori,
32. Prvo razmatranje N/zakona o rada,
33. Prvo razmatranje N/zakona o javnoj svojini,
34. Prvo razmatranje N/zakona o jakim alkoholnim pićima,
35. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama zakona br.04/L-061 o prodaji stanova za koje postoji stanarsko pravo, izmenjen i dopunjen zakonom br.04/L-247,
36. Interpelacija premijera Republike Kosovo, Ramush Haradinaj, na zahtev PG PSD, u vezi ne utvrđivanja i povećanja minimalne plate u Republici Kosovo,
37. Interpelacija ministra za ekonomski razvoj g. Valdrin Lluka, na zahtev predsednika PG- PSD g. Dardan Sejdiu, uz podršku 11 poslanika, u vezi osnivanja Novog energetskeg preduzeća Kosova A.D./NKEC.

IV. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 12 marta 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata o odluci Vlade Republike Kosovo za izdvajanje finansijskih sredstava iz nepredviđenih troškova.

V. Nedovršena tačka sa vanredne sednice održane 13 marta 2019. godine:

1. Glasanje Predlog-rezolucije sa parlamentarne debata u vezi sa blokiranjem Centralne izborne komisije od strane Predsednika.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Bilall, po presim, 60 deputetë janë ndërkohë, Bilall Sherifi ka një propozim për seancë, e cila është shumë e rëndësishme. Kisha pasur dëshirë, kolegë deputetë, për vëmendjen. Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

KRYETARI: A ka mundësi, ju lutem, është e rëndësishme, për vëmendje.

BILALL SHERIFI: Duke pasur parasysh deklaratimet publike të të gjitha partive politike, sidomos kohëve të fundit lidhur me sanksionimin e krimit të gjenocidit në Kosovë nga Republika e Serbisë nga shteti, nga ushtria, nga policia, nga të gjitha segmentet e aparatit shtetëror represiv të Serbisë në Kosovë, mendoj që tani është koha të krijojmë një komision ad hoc nga Kuvendi i Kosovës dhe të gjitha deklaratimet publike të partive politike t'i shkrijmë në një rezolutë të përbashkët.

Unë deri më tani u konsultova me kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli, para se të konsultohem me kryetarin, nga e premtja dhe në vazhdimësi kam pasur kontakte do të kisha thënë jo takime, me parti politike, përfaqësues të partive politike, të cilët në parim kanë thënë se po, jemi dakord që të fillojë një proces i tillë dhe mendoj që në mbështetje edhe të kryetarit, i cili ka treguar gatishmëri edhe në të kaluarën, sidomos ditëve të fundit, po edhe sot, që të fillojë ky proces.

Pastaj në komision të gjitha partitë do të dërgojnë përfaqësues të tyre dhe së bashku do të ulemi të hartojmë një rezolutë.

Unë kam një propozim në rezolutë, do ta shtroj në komision, pastaj jemi të hapur për të plotësuar apo për të hequr, sido që ne ta shohim të arsyeshme si komision, pastaj ta sjellim në Kuvend për ta miratuar në seancën e ardhshme, shpresoj javën e ardhshme kur ajo do të mbahet.

Kërkoj mirëkuptim edhe mbështetje që sot, në këtë seancë, grupet parlamentare të dërgojnë nga një përfaqësues në komision dhe të krijohet komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sherifi!

Po, është një propozim konkret, i cili merr kohë, ne mund ta bëjmë edhe si lloj mocioni procedural, ta futim sot vetëm krijimin e komisionit për vetë faktin se tani është pikërisht përvjetori i masakrave të mëdha, 186 masakra deri me qindra vetë, fëmijë, nga të porsalindur deri

në pleq të palëvizshëm. Për besë, gjithë më tepër se politikanë, jemi qeneje njerëzore, kur shkojmë t'i përkujtojmë, ende Kuvendi të mos marrë asnjë hap nuk është e nderhme.

Të keni parasysh, më 3 gusht 2015 Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka arritur ta bëjë këtë, 102 deputetë kanë votuar, 55 kundër, ta keni parasysh.

Atëherë kështu, kryetarët e grupeve parlamentare, në rend të parë shkojmë në mocion procedural, pastaj do të shkojmë te secili kryetar, pastaj në qoftë se e pranojnë, a ka mundësi që ata propozojnë nga një anëtar të komisionit ad hoc. Urdhëro, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ne sigurisht që e mbështesim këtë iniciativë, në fakt e përshëndesim. Po Kuvendi i Kosovës edhe në të kaluarën ka pasur, unë jam informuar sot që së paku tri rezoluta kanë kaluar për këtë çështje, po pavarësisht kësaj ne e mbështesim plotësisht. Ne do ta delegojmë deputetin Armend Zemaj, që është zëvendëskryetar i grupit parlamentar dhe shpresoj që në konsultim me të gjitha grupet parlamentare të nxjerrët një rezolutë në frymën edhe të rezolutave të Parlamentit Evropian, i cili ka dënuar masakrën Srebrenicë e në plot vende të tjera, shpresoj që do të nxjerrim një rezolutë që është e pranueshme për të gjithë deputetë e Kuvendit të Kosovës, e cila mund të përcillet pastaj edhe në Parlamentin Evropian dhe në institucione të tjera të BE-së. Faleminderit!

KRYETARI: Memli Krasniqi, para se ta marrësh fjalën, ideja nuk është vetëm të bëjmë rezolutë, ideja përmes kësaj rezolute pastaj të bëhen hapa, biseduam edhe me Bilallin, duhet të shkojmë në Këshillë të Evropës, në Parlament Evropian, ky komision duhet të krijohet një tribunal ndërkombëtar për krime serbe. Kjo duhet gjithsesi, është në nderin, dinjitetin e këtij vendi. E kemi mohimin e masakrave, e cila po ndodh sot, kështu do t'i mohojnë pas pesë vjetësh të gjitha. Kjo është çka ka ndodhur, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë kolegët,

Pa dyshim që për shkak të sjelljeve absolutisht të dënueshme nga disa prej zyrtarëve serbë të Kosovës, më vjen mirë që është aktualizuar kjo temë dhe është pa dyshim e nevojshme që Kuvendi i Kosovës ta thotë fjalën e vet, por jo vetëm deklarativisht, por që të nxisë përmes një rezolute edhe marrjen e veprimeve konkrete për dhënien e obligimeve ndaj Qeverisë dhe institucioneve të tjera në lidhje me këto çështje, veçanërisht duke e bërë të dënueshëm edhe mohimin e krimeve dhe gjenocidit që ka ndodhur në Kosovë.

Andaj, si Grup Parlamentar i PDK-së e mbështesim plotësisht këtë iniciativë, të cilin e kemi diskutuar edhe javën e kaluar dhe është përmendur edhe në këtë Kuvend.

Kështu që ne do ta kemi përfaqësuesin tonë në komisionin që do të themelohet dhe propozojmë që përfaqësues në këtë komision të jetë deputeti Mërgim Lushtaku.

KRYETARI: Faleminderit! Albulena Haxhiu, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Pa dyshim që kjo është e rëndësishme dhe sigurisht që Vetëvendosje do të kontribuojë në këtë. Ne propozojmë deputeten Saranda Bogujevci që të jetë në këtë komision.

Megjithatë, përfaqësuesja jonë në këtë komision do të japë të gjitha qëndrimet e Vetëvendosjes të shkruara, propozime tona.

Pra, nga kjo seancë sot nuk mund të paragjykojmë se cili do të jetë qëndrimi i këtij komisioni ad hoc, sepse u përmend nga ju një tribunal për krimet e Serbisë, në fakt ne është dashur qysh moti ta kemi një gjykatë të veçantë që do t'i trajtonte të gjitha krimet që kanë ndodhur në Kosovë, siç kanë bërë të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë, sepse ne jemi dëshmitarë që as UNMIK-u dhe as EULEX-si, por as institucionet vendase nuk e kanë pasur as minimumin e vullnetit për të adresuar krimet e kryera nga Serbia.

Prandaj, ndoshta do të duhej të përmendej këtu që të gjithë deputetët e Kuvendit e kanë pasur në i melat e tyre zyrtare një kërkesë nga Bardhyl Mahmuti, pra ai na ka dërguar madje edhe një rezolutë se si do të mund të adresonim këtë, por megjithatë ne kërkojmë që t'i lihet këtij komisioni, siç po quhet, ad hoc, që do të dalë me propozime konkrete.

Vetëvendosje e mbështetë gjykatën vendase, ashtu siç kemi kërkuar para votimit të amendamentimit për Gjykatën Speciale, e cila në fakt është një gjykatë etnike, e padrejtë dhe do ta paraqesë një pasqyrë të shtrembëruar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, ne insistojmë që të ketë një gjykatë vendase dhe po ashtu përqendrimet e tjera ne do t'i adresojmë në këtë komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ta kemi parasysh, e kemi edhe publikun. Për hir të kursimit të kohës jemi duke shkuar në dy procedurat, se një herë do ta kalojmë mocionin procedural, pastaj do të paraqesim edhe këto propozimet për komisionin ad hoc.

Tash kalojmë tek Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Po Aleanca pajtohet me ngritjen e një mocioni, pra është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Republikës së Kosovës të flasë me një zë përmes një rezolute dhe ne si grup parlamentar do të na përfaqësojë zotëri Muharrem Nitaj.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Pa i përsëritur ato që i thanë kolegët më herët, edhe për të kursye pak kohë, se kemi plot ligje që ndoshta duhet t'i diskutojmë e t'i votojmë, ne e përkrahim iniciativën dhe propozojmë nënkryetaren e Kuvendit, Aida Dërguti, që të jetë përfaqësuese e PSD-së në këtë komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sherifi, fjala për ju!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Nëse më lejoni t'i them edhe disa fjalë më shumë se sa të jap propozimin se cili nga deputetët do të jetë i Nismës në komision.

Mendoj që po i referohem fjalës së koleges Haxhiu, çështja e propozim-rezolutës nga ish-zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për jashtë, zoti Bardhyl Mahmuti, është çështje që u është drejtuar të gjithë deputetëve edhe publikisht, por edhe, siç më ka informuar, ua ka dërguar edhe personalisht secilit.

Pra, po ajo është për mua një nga bazat si iniciues apo si propozues i komisionit, një nga bazat apo një nga propozimet që do të merret bazë në punën e komisionit, por natyrisht nuk do të paragjykojmë, nuk dua të paragjykoj apo nuk dua as të kushtëzoj që rezoluta do të jetë në tërësi siç e ka propozuar ai. Mund të ketë propozime nga deputetët për të shtuar apo për të hequr. Mirëpo sidoqoftë, më lejoni të them që për model është marrë rezoluta e Parlamentit Evropian që ka miratuar për Srebrenicën, pra model për dënimin e gjenocidit në Kosovë është marrë rezoluta e Parlamentit Evropian.

Unë mendoj dhe besoj që edhe në Kuvendin tonë dhe jashtë Kuvendit mund të kemi ekspertë që mund të na ndihmojnë në këtë drejtim, por modeli i Parlamentit Evropian besoj që duhet të jetë i mjaftueshëm.

Dhe, pse është e nevojshme rezoluta, besoj të gjithë e dimë që rezoluta do të përdoret pastaj si një bazë nga cila do të derivojnë të gjitha aktet e tjera, siç u tha edhe nga kryetari, të kërkohet një tribunal për të dënuar këtë krim të gjenocidit, për të miratuar ligje, të cilat pastaj do të trajtonin tema që i ngrit apo i sanksionin rezoluta, e kështu me radhë. Prandaj, unë për fund propozimet e mia do t'i jap në mbledhjen e parë të komisionit dhe në atë komision do të jem unë vetë anëtar, pra Bilall Sherifi, anëtar nga Nisma. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Albert Kinolli nga 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Tashmë 20 vjet pas luftës mendoj se kjo iniciativë, ky hap që po e ndërmarrim sot së bashku mendoj se është i qëlluar, edhe pse pak i vonuar dhe është dashur të merret shumë kohë më parë.

Ne si Grup Parlamentar 6+ e përkrahim këtë iniciativë, ndërsa kontributin tonë do ta japim në komisionin, i cili do të formohet, gjegjësisht komisionin ad hoc përmes anëtarit tonë, deputetit Danush Ademi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më, grupet parlamentare i dhanë propozimet e veta. Në rend të parë do të shkojmë mocion procedural, për hir të publikut edhe diçka, për arsye se kemi shumë shoqata, të cilat merren me të pagjeturit, do të inkorporohen në proces të vendimmarrjes dhe të hapave të mëtejme edhe të gjitha shoqatat, asociacionet, organizatat joqeveritare, mediat, të cilat kanë të bëjnë me kontributin në këtë drejtim, derisa të krijohet tribunali ndërkombëtar për krimet serbe dhe gjenocidin në Kosovë.

Unë në rend të parë do të fus në rend dite formimin e komisionit, do ta quaja të veçantë, për të gjykuar gjenocidin e ushtruar nga regjimi serb. Sa deputetë i kemi në sallë?

63 deputetë janë në sallë, vendimmarrja do të jetë në mënyrë elektronike.

Votojmë tash! Urdhëro, e ndalim votimin, urdhëro zonja Bogujevci, a e dëshiron fjalën? Urdhëroni! Ndërpritet procesi i votimit, zonja Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Më fal, duhet të specifikohen si krime të luftës, se gjenocidi është një aspekt i krimeve të luftës. Nuk mund të përcaktosh me një pjesë të krimeve të luftës. Kështu që propozimi është dënimi i krimeve të luftës, ku përfshihen të gjitha.

KRYETARI: Propozimi është Komision i veçantë për dënimin e krimeve të luftës dhe gjenocidit që shteti serb ka bërë mbi popullatën e pafajshme në Kosovë. Kështu, komisioni ad hoc pastaj e elaboron më tutje idenë edhe më mirë kur na e sjell rezolutën, një herë vetëm jemi në mocion procedural. Urdhëro, zoti Hoti! Po, po në fund pastaj zoti Sherifi, zoti Hoti një herë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Me sa u kuptuam, është komision i veçantë që dënon mohimin e krimeve të luftës. Krimet e luftës i kemi dënuar të gjithë, por ne duhet me këtë rezolutë ndoshta të shkojmë edhe tek ligji i veçantë, i cili parandalon këdo që të mohojë krimet e luftës të bëra në Kosovë.

KRYETARI: I nderuar zoti Hoti, ne patëm një debat me zotin Sherifi, e përgëzoj për iniciativën, por unë edhe publikisht kam premtuar në Masakrën e Lubishtës, nuk ka të bëjë vetëm me një

rezolutë, e cila do të mbetet rezolutë. Ky vend, ky shtet, ky komb duhet ta dërgojë Serbinë me tribunal ndërkombëtar, kjo është ideja për të shkuar deri në fund.

Po, po gjithsesi vetëm kini parasysh këtë, ne mund ta zbërthejmë, siç thotë populli, “ta hollojmë shumë derisa ta këpusim”, por është mirë të marrim hapat, për faktin se sot ne vetëm po fillojmë, e pastaj komisioni na e sjell, të mos bëjmë asnjë gabim, konsultohet, para meje e kemi edhe ish-Avokatin e Popullit, do të jenë edhe shumica e njerëzve, të cilët edhe kanë përvojën, legjitimitetin, por në të njëjtën kohë që ku e keni edhe zonjën deputete, zonjën Bogujevci, ka pësuar edhe vetë, por do të thotë keni mundësi t’i japë, por të fillojmë vetëm të futemi në proces. Vetëm një konsultim me zotin Kurteshi.

Zoti Sherifi, e pate fjalën, dhe shkojmë drejt votimit, po mundohem të formuloj, po ky formulimi aktual nuk ka peshën më shumë se sa kur ta marrim rezolutën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Me emërtimin “Rezolutë për gjenocidin serb” përfshihen të gjitha në të, integrohen krimet kundër luftës, krimet kundër njerëzimit, të gjitha, pra krimet e luftës janë vetëm një variant i veprimeve kundër ligjeve të luftës, ndërsa gjenocidi ka të bëjë me qëllimin, nuk ka rëndësi a janë vranë 10, a janë vranë 100 mijë, rëndësi ka që qëllimi ka qenë shfarosja e shqiptarëve si të tillë, jo sa shqiptarë. Unë këtu po jua sjell vetëm një shembull, sepse kam hulumtuar në këtë drejtim, që vetëm për 1 mijë e 700 romë që janë vranë ka rezolutë të nxjerrë për gjenocid, sepse qëllimi ka qenë shfarosja e tyre.

Pra, në vetvete gjenocidi nuk ka të bëjë me sa janë vranë, sa janë dëbuar, po a ka pasur për qëllim shfarosjen e tyre. Prandaj, mendoj që nuk duhet t’i ndërrohet emërtimi i rezolutës, por t’i lihet “Rezolutë për gjenocidin serb në Kosovë”. Nëse ne me një rezolutë e sanksionojmë një herë, pastaj nga kjo rezolutë derivojnë ligje të tjera për kushdo që e mohon, dënohet për të ndërtuar një tribunal, për të shkuar në instanca më të larta ndërkombëtare, pra ne kërkojmë nga të tjerët ta dënojnë gjenocidin serb, e ndërsa ende vetë nuk e kemi dënuar, ende vetë, me përjashtim nëpër tubime partiake, nëpër tubime përkujtimore ende nuk kemi asnjë dokument zyrtar ku Republika e Kosovës përmes institucioneve të saj e sanksionon si gjenocid tërë krimin në Kosovë që e ka ushtruar Serbia. Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë në votim, po votojmë formimin e komisionit të veçantë për të gjykuar krimet e luftës, gjenocidin, agresionin serb, krimet kundër njerëzimit të ushtruar nga regjimi serb, 186 masakra, 11 mijë e 840 civilë dhe 1 mijë e 396 fëmijë.

Votojmë në mënyrë elektronike tash! Faleminderit!

68 deputetë, të gjithë kanë votuar për. Edhe një me dorë, 69, për protokoll, Ismet Beqiri është deputeti që ka votuar me dorë.

Ky ishte mocioni procedural, tani do të votojmë për krijimin e komisionit, propozimet, të cilat u dhanë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash!

64 deputetë, plus Ismet Beqiri, 65, Arbeni me dorë, 66 deputetë për.

Formohet komisioni i veçantë, mundësia u jepet edhe grupeve të tjera parlamentare në qoftë se dëshirojnë të dërgojnë anëtarë të komisionit për aq sa e biseduam paraprakisht, komisioni do të konsultojë edhe shoqatat, asociacionet, organizatat joqeveritare, ekspertët, juristët, mediat, të gjithë ata, të cilët mund të japin kontributin në ndriçimin edhe të vërtetën e kombit tonë, luftës në Kosovë. Faleminderit!

Më lejoni tash pas kësaj teme shumë të ndjeshme, në emër të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë të veçantë ju dëshiroj mirëseardhje dhe t'i falënderoj për prezencën e tyre, e kemi një shkollë të mesme, e cila ka ardhur, janë nxënësit tanë nga Suedia, në fakt, mund të jenë edhe suedezë, i falënderoj, janë nën udhëheqjen e Xhevat Isufit, profesor, sigurisht. Faleminderit!

Tani, po vazhdojmë me votimin, pika e parë, po zoti Memli, edhe Milaimi pastaj. Po, Memli Krasniqi, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në seancën e kaluar ne diskutuam për një marrëveshje të përbashkët që e kemi arritur të gjitha grupet parlamentare për themelimin e komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor. Me mocion u pajtuam dhe kaluam që të futej në rend të ditës dhe të votohej, por përbërja e komisionit ngjalli disa debate, të cilat nuk rezultuan në fund me votim të suksesshëm.

Meqenëse në konsultim edhe me kolegun nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zotin Hoti, por edhe me të tjerët, tashmë besoj që jemi në linja të asaj që kemi diskutuar në fillim. Unë ju lus që ta procedoni një mocion procedural përsëri, për ta përfshirë si pikën e parë të rendit të ditës, para se të vazhdojmë me pjesën tjetër të seancës, themelimin e komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor dhe besoj që do të ishte e rëndësishme që ta kalojmë sot, meqenëse tashmë vetëm kemi një pajtueshmëri të plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Për hir të shpejtimit të procedurave, a e nxjerr drejt në votim, si doni ta kaloni si mocion procedural, pastaj futemi te tema?

Shkojmë në mocion procedural, propozimi është i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi, për futje të rendit të ditës të kësaj pike: Votimi i komisionit ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, votojmë tash!

67 deputetë janë në sallë, 67 kanë votuar për. U fut në rend të ditës.

Zoti Hoti tani, fjala për ju!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Me dakordim të deputetit Arben Gashi, ne propozojmë që në vend të deputetit Arben Gashi të jetë Lirije Kajtazi.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi propozimin konkret. Shkojmë në votim? Zoti Krasniqi, urdhëro! I keni emrat e tjerë, vetëm ky ndryshim.

MEMLI KRASNIQI: Ok! Mendova nëse duhet lexuar të tjerët, të tjerët i dini domethënë.

KRYETARI: Komisioni ad hoc është i njëjti, vetëm ndërrimi i Arben Gashit nga Grupi Parlamentar i LDK-së tërhiqet, vjen zonja Lirije Kajtazi. Votojmë tash!

71 deputetë janë në sallë. 70 për. 1 kundër. Urime! U krye ky votim. Do të thotë, Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor, emrat e tjerë janë ata të seancës së kaluar. Milaim Zeka, urdhëroni, e keni fjalën!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar! Jam i lumtur që kemi këtu fëmijë nga Suedia, se edhe ata mund të bëhen deputetë në të ardhmen. E di, zoti kryetar, që ne me një përpjekje të madhe kemi arritur të formojmë një komision hetimor, përpos Telekomit e Kosovës, meqenëse opozitës i takon kryetari, unë e kam një propozim për nënkryetarin që ka qenë iniciativa e Grupit tonë Nisma dhe imja personalisht, kështu që unë propozoj Milaim Zeka të jetë nënkryetar të zëvendësojë Visarin.

E mora mësimin nga kryetari i Grupit Parlamentar Nisma, kështu që “Mirë se keni ardhur në Parlament” (suedisht), dhe jam i lumtur që keni ardhur të na vizitoni.

KRYETARI: Faleminderit! E kemi këtë situatë, duhet të shkojmë në mocion procedural në fillim, pastaj të vijmë te procedimi.

E votojmë si mocion procedural ose e fusim rend dite, votojmë tash!

Nuk ka kuorum! Shkojmë edhe një herë në votim, ju kisha lutur, se ishin 61, po u tërhoq një, shkojmë edhe një herë në votim mocion procedural, votojmë tash! Jemi te mocioni procedural.

74 deputetë janë në sallë. Kaloi si pikë e rendit të ditës me 62 vota. Votojmë edhe ato ndryshime, të cilat i propozoi deputeti Milaim Zeka, ato të cilat i thanë si propozime janë për votim tek ju. Votojmë tash!

61 deputetë janë në sallë. 58 për, 3 abstenime. Kalon propozimi i Milaim Zekës.

Kuvendi emëroi Milaim Zekën zëvendëskryesues të Komisionit Hetimor dhe atë ndryshimin, anëtar i komisionit.

Tani jemi te pikat e papërfunduara nga seanca plenare më 30 janar 2019.

Më herët i lexova datat. Pikat 1, 2 dhe 3 nuk po i vë as formalisht në votim, për faktin se duhet të jenë 2/3 e deputetëve, nuk i përmbushin kushtet.

Zonja Haxhiu, fjala për ju!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Kërkoj falje që po ju ndërpres, por në seancën e fundit që kishim të premtën jemi dakorduar të gjithë deputetët sa kemi qenë, pas debatit parlamentarë për pensionistët kontributdhënës, jemi dakorduar që sot si pikë e parë të jetë rezoluta e propozuar në seancën e fundit. Prandaj ju kisha lutur që ta lexoj, ashtu jemi marrë veshë, është nënkryetari aty.

KRYETARI: Zonja deputete, nuk kemi tekst, se administrata, sekretarit përkatësisht i referohem, por më tregon se e keni bërë për seancën e parë që do të vijë, kjo ka qenë në vazhdim, por nuk kemi as tekst, se e kishim futur tani me mocion procedural.

TEUTA HAXHIU: Vetëm se të dakordohemi sot, tekstin besoj se e shpërndajnë menjëherë, ua dërgojnë deputetëve dhe të hyjë sot si pikë e rendit të ditës, meqë ka qenë një dakordim i seancës së fundit.

KRYETARI: Kur ta përgatitë Administrata dhe na e sjell unë e fus në mocion procedural, të mos vonohemi.

4. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018, për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 29 mars 2019 ka vendosur që në këtë seancë të radhitet edhe kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 shtetasve turq më 29 mars 2018, për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor. Ftoj kryetarin e Komisionit Hetimor, zotin Xhelal Sveçla, që ta arsyetojë kërkesën, pastaj shkojmë në votim.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit!

Komisioni Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 shtetasve turq është themeluar me vendim të këtij Kuvendi. Ne kemi pasur mandat 4-mujor, për shkak të volumit të punës, me kërkesë unanime të të gjithë anëtarëve të komisionit, ne kemi kërkuar që mandati të vazhdohet edhe për 30 ditë. Prandaj, lus deputetët që të votojnë këtë vazhdim të mandatit.

KRYETARI: Shkojmë në votim drejt! Deputetët të përgatiten për votim, jemi në zgjatjen e mandatit të Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të 6 shtetasve turq më datë 29 mars 2018, për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor, votojmë tash!

54 deputetë kanë votuar. Nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Të nderuar deputetë,

Sa për njoftim, ky komision është mirë të shkojë deri në fund, nuk është mirë Kosova të sanksionohet me ndonjë rezolutë ndërkombëtare, pa pasur nevojë, ose ndonjë raport, për diçka që duhet të kryhet.

Votojmë edhe një herë! Regjia, deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash! Prapë 54 deputetë.

Edhe një herë e nxjerr në votim, e mirë është kjo demokracia. A votojmë edhe një herë? Votojmë tash!

Po i nxitni të mos votohet, 56 deputetë.

Vazhdojmë tutje, kur të bëhen 61 deputetë, e votojmë prapë.

5. Votimi në parim i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës

Duhet 80 deputetë të votojnë. Nuk mund të votohet, se duhen të paktën 11 vota të komuniteteve joshumicë.

II. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 28 shkurt 2019

Diskutimet për pikat e rendit të ditës 1, 2, 3 dhe 5 kanë përfunduar në seancat e mëparshme.

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente. Procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes të paraqitura në raport nga Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik.

Amendamenti 1, me përkrahje të Komisionit Funkcional. Votojmë!

Kush është kundër? Me dorë.

A ka abstenim? Në mënyrë elektronike? Shkojmë në mënyrë elektronike.

Urdhëro, zoti Lushtaku, por jemi në proces të votimit.

MËRGIM LUSHTAKU: Kryetar, sa për sqarim, ne i kemi pasur disa herë disa takime edhe me deputetët e partive të ndryshme dhe jemi pajtuar që të bëjmë një propozim në seancë, në këtë pikë, pasi që nuk kemi gjetur deri tani një pajtueshmëri për çështjen e viteve.

Kështu që e kam një propozim, neni 44 i Ligjit bazik të fshihet nga paragrafi 2, në mënyrë që të mos ketë kufizime në vite për import të veturave në Kosovë. Fshihet paragrafi 2 i nenit 44, kështu që mbetet vetëm standardet e Euro 4 dizel për import të veturave në Kosovë.

KRYETARI: Atëherë shkojmë te amendamenti i parë, me përkrahje të Komisionit Funkcional, në mënyrë elektronike.

Ndërkohë, derisa të përgatitemi për këtë, po shkojmë të mos vonohemi te votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale.

Do të rikthehem në këto pika të cilat janë të hapura, keni parasysht të gjitha një për një.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Në seancën plenare të mbajtur 15 tetor, janë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Tani kemi për të miratuar tekstin e Projektligjit në tërësi. Votojmë tash!

38 deputetë kanë votuar, përderisa 74 janë në sallë.

Është mirë të votohet kundër, se ka mbetur qe sa kohë. Jo, jo, unë vendos edhe dhjetë herë, çështja është se këtu nuk po votohet kuorum. S'ke as kuorum. Nuk ka kuorum do të thotë.

Votojmë edhe një herë. Votojmë tash!

40 deputetë.

Edhe një herë zonja nënkryetare, edhe një herë votojmë tash!

36 deputetë. Nuk ka kuorum. Do ta provoj prapë.

Votim në lexim të dytë. Urdhëro, kush? Urdhëro ministër pastaj Glauk. Glauk, urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Jo desha një sqarim lidhur me këta numra që po dalin atje në tabelë. Kjo po ndodh për shkak të një vendimi që sapo e mori opozita që të mos votohet asnjëra prej këtyre pikave të rendit të ditës, për shkak të asaj që ndodhi pak më herët me komisionin për zbardhjen e atij rasti të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, për çka u pa qartë që mazhoranca qëllimisht po e bojkoton vazhdimin e punës së atij Komisioni. Pikërisht për këtë arsye.

KRYETARI: Unë, kështu... Kjo është dëshirë, vullnet i secilit, qysh të dojë voton. Imponim nuk ka. Ajo çka është kryesore, unë e sjell në votim. Unë mund ta fus prapë në votim, por..., urdhëro zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po e kuptoj deri diku atë çka e tha kolegu Konjufca. Unë këtë e kuptova si njëfarë kushtëzimi, që ne s'votojmë nëse ju s'votoni. Në rregull është. Është e drejtë e tyre. Meqenëse e kanë kaq shumë me rëndësi, atë Komision e kemi votuar të gjithë, atë komision e kemi mbështetur në punën e vet të gjithë. Paaftësia e atyre që e kanë udhëhequr Komisionin, nuk mund të jetë arsye tash të marrim përgjegjësinë edhe një herë ky Kuvend dhe kjo seancë për të mbuluar dështimet e udhëheqësve të atij Komisioni.

Sidoqoftë, përveç shkeljeve procedurale, shkeljet e mëdha që kanë ndodhur, janë që pa u miratuar raporti as në komision e as në seancë, nga së paku ato që kemi dëgjuar publikisht, krerët e atij komisioni kanë marrë veprime që janë të kundërligjshme, siç është procedimi i raportit pa qenë raport në organet e Prokurorisë, e kështu me radhë. Do të ishte e rrugës që të pritej fillimisht vazhdimi i mandatit, e pastaj të respektohej Ligji për hetim parlamentar dhe aktet e tjera, në mënyrë që të procedohet me hapat e mëtejme dhe të mos mundohet dikush të marrë flamurin për një proces për të cilin ka pasur pajtueshmëri edhe konsensus të plotë.

Sidoqoftë, unë po i them zotit Konjufca, edhe juve zoti kryetar, nëse mund ta kemi vëmendjen e të gjithëve. Rikthejeni në votim. Ne do ta japim votën për ta kaluar këtë Komision, në mënyrë që të shohim pastaj edhe vullnetin e opozitës për t'i votuar këto ligje, që ne konsiderojmë janë të rëndësishme po aq sa komisionet, e ndoshta edhe më të rëndësishme sesa ato, e sidomos Ligji për miniera dhe minerale, që ka mbetur duke u zvarritur me muaj të tërë në Kuvend, ndërsa po flasim për pasuritë ndoshta më të mëdha që i ka Kosova.

Kështu që ta rivendosim atë Komisionin edhe një herë, t'ia vazhdojmë mandatin dhe pastaj të shohim se si do të jetë sjellja e opozitës. A do të jetë konform asaj që vetëm sa e tha zoti Konjufca që s'do të votojnë derisa s'votohet ai, pra që do të votojnë kur të votohet ai, në mënyrë që të shkojmë tutje me normalizimin e punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Kështu-ashtu e pata ndërmend ta kthejë në votim edhe një herë.

4. Kërkesa e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më datë 29 mars 2018, për vazhdimin e mandatit edhe për një afat 30-ditor

Regjia, deputetët, përgatiten për votim. Votojmë tash! Regjia, përgatitemi për votim? Votojmë tash! Votoni tash!

65 deputetë kanë votuar, 60 për, 1 kundër, 4 abstenime. Kuvendi miratoi zgjatjen e mandatit të afatit edhe për një afat 30-ditor për Komisionin Hetimor Parlamentar lidhur me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq, më 29 mars 2018.

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Jemi te votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale. Votojmë tash!

Regjia! Te miniera e mineralet. Ju kisha lutur veç, se regjia edhe ata duhet teknikisht të përgatiten. Të presim pak. Kur jeni gati në ekran, pastaj shkojmë në votim.

Në qoftë se ka probleme regjia, na lajmëron a mund të vazhdojmë më tutje me të tjerat pika. Rikthehemi në vonë pastaj.

Shkojmë në lexim të dytë të Projektligjit për miniera dhe minerale. Votojmë tash!

Ky ligj është bukur gjatë, është esencial për investimet e huaja në Kosovë. Sido që të jetë, kjo është legjitimitet pozitiv-opozitë, veç vendi mbetet aty ku është.

III. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 29 shkurt 2019

Jemi te votimi në lexim të dytë. Urdhëro zoti Krasniqi, po kështu vetëm po vonohemi. Urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Meqenëse jam i bindur na përcjellin edhe qytetarët e Kosovës, drejtpërdrejt në këtë seancë, është e turpshme, po edhe për keqardhje në të njëjtën kohë, brenda dy minutave qysh zbulohet pabesia e kësaj opozite të lodhët. Para dy minutash, a kërkuan, hajde të votojmë se votojmë edhe ne. D.m.th. këta janë mashtrues të cilët nuk janë në gjendje dy minuta një marrëveshje ta mbajnë. Nuk e di qysh kanë fytyrë pastaj ta lypin edhe besimin e qytetarëve. Nuk mbetet keq ky Kuvend pse nuk votohet Ligji për miniera dhe minerale se nuk e kanë votuar edhe tre-katër muajt e fundit, por arsyeja pse, e mora fjalën edhe më herët, ishte sepse pikërisht Glauk Konjufca kërkoi që të votohet ajo, në mënyrë që këta të marrin pjesë në votim. A e patë dallimin, janë diku katër vota më shumë sesa ishin në të kaluarën.

Nuk është Ligji për miniera dhe minerale ligj as i GP të PDK-së, as i koalicionit. Është ligj për Kosovën dhe sektorin minerar që konsiderohet ndoshta pasuria më e madhe në Kosovë. Nëse edhe për këtë nuk janë në gjendje dy minuta ta mbajnë fjalën që e japin publikisht, unë realisht nuk e di çka mund të bëjmë ne bashkërisht për diçka më të madhe për këtë vend.

KRYETARI: Po se i është përmendur emri, po vazhdojmë pastaj në seancë. Replikë!

GLAUK KONJUFCA: Mund ta merrni aty tabelën e votave kush ka votuar. Unë votova. Por problemi është që grupi parlamentar s'po dëgjon. Kjo është punë, edhe autoriteti në fund të fundit. As opozita nuk po më dëgjon, askush nuk më dëgjo, kështu që çka kam faj unë.

KRYETARI: Glauk, të ka lëvizur pak autoriteti kohëve të fundit. Shëndosh!

A shkojmë në projektligjin e radhës?

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Zoti Zemaj e ka fjalën se e ka edhe një propozim më duket.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Jo, nuk kam propozim. Ka kohë që e kam kërkuar fjalën në emër të GP të LDK-së. Sa i përket pjesëmarrjes sonë në votime, apo mospjesëmarrjes është vendimi i joni politik dhe ne e deklarojmë. E deklarojmë edhe me votë. Sipas rendit të ditës të përcaktuar edhe të harmonizuar edhe me qëndrimet e shefit tonë të grupit parlamentar në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës.

z. Kryetar kjo porosi shkon për ju si shef i kësaj mazhorance. Që nga fillimi, ne duhet të presim me orë të tëra që ju ta siguron kuorumin në seancë plenare dhe kjo politika e kushtëzimeve, nuk gjen adresë te Lidhja Demokratike e Kosovës. Kjo vlen për grupin e apostrofuar dhe nëse flasim për turp ose paturpësi, turp është ta mbash pushtetin pa vullnetin e popullit me 40 deputetë, ashtu siç po del këtu në pasqyrë. Andaj duhet t'i dallojmë gjërat. Siguroni 61 deputetë, ashtu siç e keni siguruar udhëheqjen, ulësen në atë karrige ju edhe qeveria aktuale.

Mos kërkoni diçka prej opozitës, e cila nuk është në harmoni as me normat demokratike, as morale dhe as etike. Ne vendosim për çdo ligj sipas perceptimit tonë politik, edhe sipas programit tonë politik. Në fund të fundit, çka mendojmë për një ligj apo për një marrëveshje ndërkombëtare të caktuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E drejtë e secilit është si deputet këtu, nuk vijnë si grupe, po si deputetë. Kush do voton si të dojë. Ajo është më kryesore. Sa i përket kuorunit, 87 deputetë më duket kemi qenë mazhorancë e herës së kaluar, diku dhjetë herë e kemi ndërprerë s'kemi mundur t'i bëjmë 50. Njëjtë është, kjo është demokraci.

Por po shkojmë të votojmë atë që e kemi përpara. Sa të mundemi votojmë, kur s'mund të votojmë, qytetarët janë që gjykojnë.

Ky Projektligji për automjete që qenka i ka katër amendamente. E ka një amendament të cilin propozuesi e ka sjellë tani, por çështja është. Amendamenti 1: Nën një, në Kosovë nuk mund t'i përdorim veturat më të vjetra se 15 vjet, ka qenë përpara. Tash po do të hiqet, të jetë që mos të ketë vjetërsi hiç. Sa të duan të sjellin në kuptimin për vjetërsi. Kështu që, unë po e vë në votim.

Amendamenti është këtu, ndiqet, edhe pse me rregulla tamam të Kuvendit, veç edhe me pajtueshmëri edhe tuajën, për arsye se amendamenti nuk preket në seancë i propozuar. Por, sido që të jetë, unë po e bëj këtë se jeni vetë ju seanca që e vendosni.

Kështu, amendamenti 1, ka qenë: neni 2 ndryshohet si në vijim: neni 44 i ligjit bazik, paragrafi 2 ndryshohet si në vijim. Do të thotë esenca që ka qenë çdoherë si është propozuar, në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se 15 vjet. Tani paska një dakordancë që të fshihet kjo fare dhe të importohen pa vjetërsi, në kuptimin pa e përcaktuar fare, sado të vjetra mund të importohen, a është kështu? Shlyhet ajo krejt.

Përgatitemi për votim në mënyrë elektronike. Amendamenti 1 me këto ndryshime të cilat i thash unë i interpretova më duket shumë qartë. Votojmë tash!

Shkojmë te amendamenti i dytë. Nuk ka vendimmarrje. Po ndalemi këtu.

3. Votimi në lexim të dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës

Duhet ta dimë vetëm se duhet 80 vota për kur votohet në tërësi Rregullorja, po ne kemi disa amendamente, që janë 42. Ne do të votojmë amendamentet e propozuara sipas radhitjes së paraqitur.

Edhe këtë po e tejkalojmë se nuk jemi 80 veta.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë

Edhe këtu po ashtu duhen 11 vota të komuniteteve joshumicë.

5. Votimi në rundin e dytë për zgjedhjen e gjashtë (6) anëtarëve të Këshillit për Ndhimë Juridike Falas

Në seancën plenare të mbajtur me 28 shkurt, në rrethin e parë të votimeve për anëtarë të Këshillit për Ndhimë Juridike Falas është zgjedhur vetëm kandidatja Hidajete Vokshi, e propozuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Andaj, ne do të procedojmë me votimin në raundin e dytë me kandidatët që kanë votuar më së shumti vota në rrethin e parë të votimit, si në vijim:

Ministria e Drejtësisë i ka propozuar kandidatët.

A ka mundësi ta lë këtë pikë të rendit të ditës më vonë se është votim i fshehtë, pastaj krejt seanca na e merr drejtimin.

Po dalim te pika tjetër:

6. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019

Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar kërkesën Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019 dhe Kuvendin i ka rekomanduar miratimin.

Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar rekomandimin e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore.

Komisioni ku kanë qenë të pranishëm, ka shqyrtuar këtë propozim. Në mbledhjen e Komisionit kanë qenë edhe anëtarët, përfaqësuesit e Fondit të Kursimeve Pensionale, ku kemi analizuar dhe kemi ardhur në përfundim për ta miratuar këtë taksë. Prandaj rekomandojmë edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës që ta përkrahë taksën vjetore në bazë të së cilës mandej hartohet buxheti për Fondin e Kursimeve Pensionale. Këtu është e paraparë taksa për investime dhe taksa për shpenzimet operationale. Ne i kemi miratuar të dy taksat, prandaj rekomandojmë që të miratohet edhe nga Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A shkojmë në votim të drejtpërdrejtë? Znj. Haxhiu a ke kërkuar fjalën? Jo. Atëherë shkojmë në votim të drejtpërdrejtë, pasi s'ka askush të paraqitur as përfaqësuesi i Qeverisë.

Vazhdojmë me votimin e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2019. Votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit. Do të kthehem pastaj në moment. Pasi këto që s'kanë kuorum, edhe një herë do të kthehen. Ulu Bilall se ka kulturë në këtë Kuvend, ka rregulla.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, z. kryetar!

Jo, unë e pata një propozim konkret nëse më lejoni. Duke pasur parasysh që opozita s'po do të marrë pjesë në votim, kanë të drejtë në fund të fundit të mos marrin pjesë në votim. Unë e kam një propozim, pikat e rendit të ditës të cilat na nevojitet votë, t'i lëmë për një ditë tjetër edhe të mobilizohet mazhoranca së bashku me PSD-në t'i votojë.

Sot kalojmë te pikat e rendit të ditës që janë debate, shqyrtim, shqyrtim i parë i projektligjeve, e kështu me radhë. Të mos humbim kohë, se kështu humbim kohë. Nëse doni, nëse nuk doni, vazhdojmë kështu bëjmë teatër e të nxjerrim nga pesë-gjashtë herë në votim. Ata s'duan të votojnë se ka filluar të bie autoriteti, çka të bëjmë tash.

KRYETARI: Propozim shumë... Ka përvojë Bilalli. A po shkojmë një nga një, a po shkojmë t'i shqyrtojmë disa projektligje në parim. Jo Kryesia e ka shkruar. Se edhe këtu lipset mocion procedural. Shkojmë në votimin.

7. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për pesë (5) anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

A ta fusim apo e lëmë edhe këtë më vonë. E qojmë më tutje. Shkojmë pak më tutje, më vonë mbetet.

IV. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare mbajtur më 7 mars 2019

Ju njoftoj se diskutimi për pikat e rendit të ditës nga 1 deri 20 kanë përfunduar në seancat plenare të mëparshme.

1. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat personale

Këtë Projektligj janë propozuar gjithsej 25 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe dy amendamente nga deputetët, amendamenti 7 dhe 16.

Unë do t'i vë në votim në qoftë se ju pajtoheni, 23 amendamentet të cilat janë nga Komisioni funksional, pastaj 7-shin dhe 16-shin veç. Në qoftë se pajtoheni, s'keni kundër. Sa deputetë janë në sallë. 66. Atëherë, a ka mundësi ta marrë miratimin e juaj me ngritje dore? A dëshironi amendamentet? A shkojmë në ngritje dore? Ngritje dore a jo? Fol kryetar i grupit parlamentar i LDK-së se deputetët t'u kanë ndarë. Po disa po thonë po, disa. Elektronike? Ok! Shkojmë elektronike. Një grup në qoftë se s'pranon, shkojmë me elektronikë.

Atëherë e votojmë. A jeni të pajtimit për 23 amendamentet që janë nga Komisioni FunkSIONAL, a doni t'i ndani një nga një. Të gjithë po thonë një.

Amendamentet 1 deri 25, largohet 7-shi dhe 16-shi, votohen në mënyrë elektronike kush është për, kundër ose abstenim, votojmë tash.

Faleminderit! Kjo është situata.

Shkojmë në pikën e radhës:

2. Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave

Janë 24 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe një amendament nga deputeti. Amendamenti 5, njëjtë do të votojmë në mënyrë elektronike. Vetëm amendamenti 5 mbetet jashtë, për 24 amendamentet votojmë tash.

Ky është votimi, do të thotë nuk ka kuorum.

3. Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë tash për raport. Shkojmë tutje:

4. Votimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Procedojmë me votimin e raportit, regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash. Jemi te votimi i,

5. Votimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Votojmë tash! Votojmë tani!...

6. Votimi i raportit të Auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për vitin 2017

Votojmë tash!

7. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017

Votojmë tash!

8. Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Janë 7 anëtarë të Këshillit të Kosovës për trashëgimi Kulturore: Danida Halimi, Premtim Alaj, Arjeta Miftari, Arsim Mehmeti, Muhamet Qerimi, Bego Kulolleri dhe Filko Jovanoviq. Votojmë tash!

9. Votimi për shkarkimin e një (1) anëtari të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Procedojmë me këtë votim i cili ka të bëjë me shkarkimin e një anëtari të Bordit të Autoritet Rregullator të komunikimeve elektronike, zotëri Shqiprim Pula, sipas rekomandimeve të Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

10. Votimi i Vendimit të Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 06/L-043 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Komisioni Funkcional i ka rekomanduar Kuvendit mosmiratimin e vendimit për sponsorimin me këtë ligj. Kërkohet shumica e votave. Pra, të paktën 61 vota për. Votojmë tash! 66 deputetë kanë votuar.

Kuvendi e miratoi vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për kthimin e autoritetit të presidentit sipas Ligjit nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Me ndryshimet e miratuara Ligji nr. 06/L-043 për Lirinë e asociimit në organizata joqeveritare konsiderohet i shpallur.

Fitoi presidenti. Ka autoritet a po? Shihet.

11. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati lidhur me dështimet dhe skandalet në politikën e jashtme të Republikës së Kosovës

Votojmë tani për propozim-rezolutën.

2. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e “shkëmbimit të territoreve” apo “korrigjim të kufijve” në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Procedojmë me votimin e propozim-rezolutës, tash. Demokraci.

13. Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mos liberalizim të vizave

Votojmë tash!

14. Votimi në parim i Projektligjit për Transmetuesin Publik të Kosovës

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij projektligji. Votojmë tash!

15. Votimi në parim i Projektligjit për peticione

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji. Votojmë tash!

16. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratim e këtij projektligji. Votojmë tash!

17. Votimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar mosmiratimin e këtij projektligji. Votojmë tash!

Çdoherë kur vazhdoj tutje, dihet se konstatimi është se s'ka kuorum në vendimmarrje dhe s'ke çfarë konstaton.

18. Votimi në parim i Projektligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar

Komisioni FunkSIONAL ka rekomanduar miratim e këtij projektligji. Votojmë tash!

19. Votimi në parim i Projektligjit për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve

Votojmë tash!

20. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me rastin e ngacmimit seksual, përdhunimit seksual dhe abortit të paligjshëm ndaj të miturës dhe përgjegjësinë institucionale të Qeverisë së Kosovës

Albulena Haxhiu në emër... Urdhëro, Albulena!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ne e kemi lexuar draftin që ka dalë nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, megjithatë kërkojmë që ta shtyjme për shkak se s'janë përfshirë edhe disa çështje që janë tepër të rëndësishme.

Prandaj, me mirëkuptim tuaj, kërkesa jonë është që të shtyhet për seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Me kërkesën e propozuesit shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, pastaj në Kryesi e përcaktojmë se kur do ta mbajmë atë.

21. Miratimi i Deklaratës në lidhje me vëllezërit Bytyqi

Kuvendi ia ka propozuar miratimin e deklaratës në lidhje me vrasjen e vëllezërve Bytyqi nga pushteti serb në vitin 1999. A votojmë tash? Votojmë!

Me 64 vota për, Kuvendi e miratoi deklaratën në lidhje me vëllezërit Bytyqi.

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratim e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Integritet Evropian nuk e ka përkrahur këtë projektligj dhe as amendamentet e propozuara dhe ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk janë kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Albulena Haxhiu për arsyetimin e raportit me rekomandime. Hajdar Beqa, e ke fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar nënkryetarë, ministra, deputetë,

Siç e tha edhe kryetari, Komisioni për Legjislacionin e ka shqyrtuar e projektligjin dhe i ka rekomanduar Kuvendit për votim.

Nëse më lejohet, unë do ta bëja arsyetim. Kam qenë edhe kryetar i grupit punues. Komisioni gjatë procesit të amendamentimit ka punuar ngushtë edhe me Ministrinë e Drejtësisë, përfaqësuesen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, Odën e Avokatëve të Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Si komisioni kemi arritur që ta amendantojmë këtë projektligj, ndonëse në çështjet e caktuara kemi pasur mendime të ndryshme, por që në fund kemi arritur ta kemi një draft të përafëruar.

Risi në Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme janë ndryshimet nëpërmjet të cilave është ristrukturuar edhe forma e funksionimit të brendshëm të gjykatës, duke shuar kolegjet e specializuara në shkallë të parë dhe kalimin e kompetencave të një gjyqtar i vetëm.

Po ashtu, në mënyrë që Dhoma e Posaçme të jetë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit për Gjykatën është shuar pozita e kryetarit të Dhomës së Posaçme duke i kaluar ato kompetenca

Kryetari të Gjykatës Supreme, dhe duke njohur pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës siç aplikohet në rastet e tjera, të degëve të tjera të gjykatave.

Njëkohësisht, është paraparë harmonizimi i plotë i organizimit të brendshëm me Rregulloren të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e sidomos sa i përket përcaktimit të kompetencave të stafit mbështetës si dhe atij menaxherial, si dhe administrimit dhe regjistrimit të lëndëve.

Po ashtu, hartimi i këtij ligji përbën një konsolidim të kësaj materie, pasi që ky ligj ka pasur shumë ndryshime dhe është shumë më mirë që ta kemi një ligj dhe praktikisht do të jetë më lehtë që të zbatohet.

Siç jeni të informuar, arsye tjetër siç e dimë është ajo që ndërlidhet me ndryshimin në mandatin e misionit të EULEX-it në gjyqësor, mandat ky i cili ka përfundua më 14 qershor dhe padyshim që ndryshon edhe përbërja e funksionimit të Dhomës së Gjykatës Supreme.

Miratimi i këtij ligji, po ashtu është një progres në kuptim të marrjes së përgjegjësive nga institucionet vendore. Pra, ky është një hap në avancimin e sistemit të drejtësisë në vend, me kapacitetin vendor.

Ne, po fillojmë t'i arsyetojmë amendamentet një nga një, sepse nuk po fillojnë që t'i bëjnë, për shkak se shumë prej tyre janë teknike, por për ato që janë përmbajtjesore kemi bërë ndryshime për t'i harmonizuar dispozitat e këtij ligji me ligje të tjera.

Për shembull, me Ligjin për Gjykata dhe Ligjin për procedurën kontestimore dhe po ashtu është sqaruar në mënyrë të detajuar procedura e rregullt si dhe ajo që ndërlidhet me mjetet juridike që zhvillohen pranë kësaj gjykate.

Siç e shihni, ka edhe amendamente të grupeve parlamentare, por unë kërkoj nga ju deputetë të nderuar që t'i përkrahni vetëm amendamentet që e kanë përkrahjen e Komisionit Funkcional, sepse tjerat e prishin materien e ligjit.

Siç jeni të informuar, kemi kërkesë nga shumë qytetarë, shumë punëtorë, janë mbi 22 mijë lëndë duke pritur në këto gjykata. Kemi edhe punëtorë të vjetër të cilët çdo ditë ndërrojnë jetë dhe mendoj që është më shumë se esenciale që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta votojë sot këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, fjala për ju!

MINSITRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ashtu siç e ceku edhe deputeti Beqa. Pra, kjo Dhomë e Posaçme në kuadër të Gjykatës Supreme që trajton rastet e procesit të privatizimit është jofunksionale, realisht nga qershori i vitit të kaluar. Pra, prej përfundimit të mandatit të EULEX-it apo largimit të gjyqtarëve të EULEX-it, tashmë nuk është funksionale.

Janë rreth 22 mijë lëndë që janë të pazgjidhura dhe kryesisht janë para të punëtorëve të cilët e presin 20%-in e ndërmarrjeve të privatizuara gjatë viteve të fundit.

Prandaj, unë mendoj që është tejet e rëndësishme që kjo çështje të mos shihet sot si një agjendë politike askujt, mirëpo të shihet si një funksionalizim i mëtutjeshëm i sistemit tonë drejtësisë, sepse kjo na e mundëson rekrutimin e menjëhershëm të gjyqtarëve tanë në kuadër të kësaj Dhome dhe rritjen e efikasitetit të kësaj Dhome.

Mendoj që edhe puna që është bërë në komision në përgjithësi nga të gjitha grupet parlamentare përfshirë edhe opozitën, e përsëritet dhe kërkoj që sot ta miratojmë këtë projektligj në lexim të dytë, që t'i hapim rrugë funksionalizimit të kësaj Dhome, pothuajse, po bëhen afër një vit. Faleminderit!

KRYETARI: Zotëri Kurteshi, e keni kërkuar fjalën? Urdhëro, Sami Kurteshi!

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ky ligj, ky projektligj në të vërtetë është një kohë e gjatë tash që i është dhënë leja për të ardhur në seancë. Nuk ka ardhur seancë. Natyrisht që i ka të metat e veta dhe duhet të sqarohet, domethënë se zvarritja e këtij projektligji në të vërtetë nuk ka të bëjë me askënd.

Këtu u tha që janë duke pritur mijëra punëtorë. Ata mijëra punëtorë janë duke pritur që gati 20 vite. Nuk janë duke pritur që 1 vit. Mirëpo, edhe kjo është e mjaftueshme. Lëndët që janë duke pritur, nuk janë për fajin e deputetëve ose të komisionit.

Çështja tjetër që është diskutuar gjatë kohë edhe në komision edhe në grupet punuese, në të vërtetë ka të bëjë që është themelore. Ka shumë mangësi ky ligj. Vet privatizimi ka qenë një çështje që ka pasur karakter kriminal që është konstatuar edhe në këtë Kuvend, po edhe në forume tjera.

Në të vërtetë, ka pasur vërejtje të ndryshme po vërejtja kryesore ka të bëjë me përbërjen e kolegeve në shkallë të parë.

Me një anë është konstatuar rëndësia e madhe edhe është konstatuar se kemi të bëjmë shpeshherë me vendime që prekin qindra edhe mijëra punëtorë dhe vlera monetare shumë të mëdha, kurse në tjetrën anë kërkohet që për to të vendosë vetëm një gjykatës.

Kjo është arsyetuar, natyrisht me përshpejtimin e zgjidhjes së rasteve. Mirëpo, në asnjë rast qytetarët apo personat e prekur për mjetet e tyre që kanë të bëjnë me 20%-in në vërtetë nuk kanë asnjë interes, që vetëm për shkak të shpejtësisë të humbet në kualitetin e marrjes së vendimeve.

Ky ka qenë kundërshtimi kryesor prej Lëvizjes Vetëvendosje. Ne edhe sot mendojmë se, në të vërtetë vendimet që merren në shkallën e parë në lidhje me çështjen e privatizimit, mandej ato shkojnë deri në fund si tilla.

Ky do të jetë një problem, sepse një gjykatës mund të vendos edhe mandej kjo bartet në të gjitha fazat e vendimmarrjes së drejtësisë.

Unë edhe njëherë i thërras të gjithë deputetët dhe deputetet që të reflektojnë në këtë drejtim. Të mos lënë përgjegjësinë e fatit të mjeteve të qindra punëtorëve në dorën e një njeriu. Një gjykatësi që edhe në raste të ndryshme ka pasur ndikime politik dhe vendimet janë marrë jo sipas meritës, po sipas ndikimeve të ndryshme.

Janë edhe amendamentet të ndryshme që do t'i dëgjojmë. Disa prej tyre që janë propozuar nuk e kanë përkrahjen e komisionit, po unë mendoj se amendamentet duhet të dëgjohen një nga një. Ligji duhet të kalojë, sepse ka nevojë, por amendamentet duhet t'i dëgjojmë të gjithë deputetët, sepse në fund të fundit do të vendosin për fatin e mjeteve dhe të mijëra punëtorëve që kanë mbetur edhe pa punë, edhe mjete e besa një pjesë e tyre edhe po vdesin.

Kërkoj nga koleget dhe kolegët që më shumë kujdes t'i dëgjojnë të gjitha amendamentet edhe të votojnë sipas ndërgjegjes së tyre, sepse preken, edhe unë pajtohem, mijëra punëtorë që me dhjetëra vite kanë mbetur pa të ardhura, pa pagë edhe pa kontributin e tyre, përveç pensioneve edhe atë të ashtuquajturin 20%. Faleminderit!

KRYETARI: Përndryshe, deri këtu e patën deputetët. Veç 49 janë këtu. Janë lodhur. A po dëshironi pauzë më të gjatë deri në seancën e radhës apo në atë të drekës?

Sot, ka votime, ta keni parasysh. Sot mund të rrish... Hajde prapë po rrimë dhe vetëm po rrimë.

Nuk ka kushte për votim. Kur të kthehen deputetët i vë në votim. Shkojmë...

23. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/22 për kinematografinë

Edhe këtu nuk ka kushte për votim, sepse nuk janë 61 deputetë.

24. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Edhe këtu ka kushte, sepse nuk janë 61 deputetë.

25. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-097 për bibliotekat

Edhe këtu ka kushte për votim, sepse nuk janë 61 deputetë. Kur të vijnë, unë pastaj veç i vendos në votim. Ta keni parasysh.

26. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për plotësim ndryshim të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës

Është situatë e njëjtë. Dhe pika e radhës:

27. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit

Njëjtë, nuk ka kushte për votim.

29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomanduar për miratim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Ekrem Mustafa, i cili nuk është këtu, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Shkojmë tek...

Kërkoj falje, e kam kaluar një:

28. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të Procedurës Penale

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projekt-kodin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Sot është edhe një ko incidencë se dje ka hyrë në fuqi Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe realisht trajtimi i Kodit të Procedurës Penale dhe votimi e miratimi i këtij dokumenti është tejet i rëndësishëm dhe e kompletton reformën në drejtësinë penale.

Të nderuar deputetë,

E tërë kjo reformë në drejtësinë penale duhet të përmbyllet me miratimin e Kodit të ri të Procedurës Penale. Si akt që jep thjesht zbatimin të parimit të vendosur në ligjet që i kemi votuar në fund të vitit të kaluar.

Pas një pune intensive për më shumë se një vit, me ndihmën e partnerëve tanë zhvillimorë, Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me kontribut të madh të institucioneve të sistemit të drejtësisë, shoqërisë civile dhe ekspertëve si dhe të profesorëve të Universitetit të Prishtinës, kemi arritur ta hartojmë këtë projekt-kod, si një prej masave më të mëdha në agjendën time legjislative si ministër i Drejtësisë.

Të nderuar deputetë,

Ka qenë përkushtim themelor që fuqizimi i sundimit të ligjit, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të jenë tema dominuese që kanë drejtuar procesin e hartimit të këtij projekt-kodi dhe sot jam i lumtur që punën kaq voluminoze, përveç se po përmbyllet si kapitull i punës time si ministër i Drejtësisë, po ashtu po përmbyllet si kapitull i vendosmërisë së pakompromis për luftë më efektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, për qasje të re dhe efektive të organeve të pavarura të zbatimit të ligjit si dhe për siguri juridike të të drejtave të patjetërsueshme të qytetarëve përgjatë zhvillimit të procedurës penale.

Në kuptimin e përgjithshëm, karakteristikat themelore që përmban ky projekt-kod janë si në vijim:

Nga 547 nene që i ka kodi aktual, 220 prej tyre janë shqyrtuar dhe janë harmonizuar me parimet më të larta të një sistemi ligjor efikas dhe të drejtë.

Pjesa më e rëndësishme e ndryshimeve kanë pasur këto nene që lidhen me adresimin e problemeve praktike që janë hasur gjatë zbatimit të tij.

Një pjesë e konsiderueshme e tyre po ashtu është ndryshuar me qëllim të avancimit të punës, sipas praktikave më të mira ligjore edhe gjyqësore.

Një pjesë tjetër është hartuar me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe rekomandimeve nga raporti për vendin e i Komisionit Evropian, me çfarë kemi përmbushur edhe obligimin e fundit të Ministrisë së Drejtësisë, thotë në agjendën e Reformave Evropiane.

Të nderuar deputetë,

Në rrafshin përmbajtjesor ndryshimet themelore që vlejné të përmendet janë:

Suspendimi i zyrtarëve publikë, për të cilët është ngritur aktakuzë për veprë penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit dhe disa veprave të tjera.

Kjo ka qenë një ndër kriteret për plotësimin e Agjendës së Reformave Evropiane.

Qëllimi i këtij propozimi është që përmes suspendimit të zyrtarëve të akuzuar të parandalohet keqpërdorimi i mëtutjeshëm i autoritetit dhe të mos u lihet mundësia të ndikohet në prova, element ky kyç për t'i siguruar ndjekje penale të suksesshme.

Nenet e propozuara vlejné për të gjithë personat zyrtarë të akuzuar për veprë penale të korrupsionit, duke mundësuar kështu trajtim dhe qasje uniforme ndaj tyre, pa marrë parasysh funksionin ose detyrën që ata mund të ushtrojnë.

Ndër të tjera është paraparë heqja e dëgjimit të dytë, pasi që në praktikë asnjë seancë e dytë nuk është duke u mbajtur dhe kjo është konsideruar se është e panevojshme. Me ndryshimet e bëra kemi mundësuar që të gjitha kërkesat për hedhjen poshtë të aktakuzës dhe kundërshtimit ndaj personave të bëhen me shkrim.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ose kryetari i trupit gjykues tani do të lëshojë një vendim me shkrim për të vendosur mbi kërkesat e tilla.

Ky ndryshim është bërë në mënyrë që thjeshtësohet faza e aktakuzës.

Si pjesë e rekomandimeve të Bashkimit Evropian është shtruar edhe alternativa për zgjatjen e afatit të hetimeve.

Periudha kohore e hetimit në parim është dy vjet. Por mund të zgjasë nga gjyqtari i procedurës paraprake çdo gjashtë muaj për një periudhë maksimale edhe prej dy vjetësh.

Pra, koha e hetimit mund të zgjasë në maksimum të mundshëm prej 4 vjetësh vetëm në disa rrethana specifike. Ky ndryshim është bërë për shkak se afati aktual për hetim konsiderohet të jetë një afat shumë i shkurtër, veçanërisht për vepra penale që kanë të bëjnë me krim të organizuar dhe korrupsion.

Ky ndryshim i jep shumë fleksibilitet sistemit kur është e nevojshme. Gjyqtari i procedurës paraprake do të jetë ai i cili do të vendosë për zgjatjen ose jo të afatit, varësisht nga arsyetimi që do t'i bëjë kërkesa e prokurorit.

Janë bërë ndryshime që lidhen direkt me procedurat e konfiskimit, janë ndryshuar të gjitha dispozitat në lidhje me konfiskimin, sepse ka pasur ankesa se procedurat aktuale të konfiskimit janë shumë të komplikuar dhe zbatuesit kanë hasur në vështirësi në zbatimin e tyre.

Nenet e ndryshuara janë në pajtim me Ligjin e ri për kompetenca të zgjeruara për konfiskim të pasurisë.

Të nderuar deputetë,

Ajo që është shumë e rëndësishme, është shtuar neni i ri lidhur me gjykimin në mungesë, i cili përcakton se nëse i pandehuri, i cili vullnetarisht dështon të paraqitet në seancë gjyqësore, pasi të jetë i informuar për datën nuk duhet të lejohet të vonojë procedurën.

Pra, në ato raste kur prokurori nuk mund të gjejë të pandehurën pas përpjekjeve të arsyeshme, gjykimi duhet të jetë në gjendje të mbahet sipas rrethanave të propozuara në nenin në fjalë.

Propozimi ka ardhur për shkak se shumë raste, kur ka pasur vështirësi për sigurim të prezencës së të pandehurit në procedurë, me ç'rast të pandehurit janë shmangur drejtësisë, e sidomos për krimet më të rënda, siç janë krimet e luftës.

Përveç kësaj mungese të pandehurit në gjykim kanë shkaktuar edhe shpenzime të mëdha si rezultat i mospasjes së një vendimi final nga ana e gjykatës.

Të nderuar deputetë,

Janë lehtësuar masat në marrjen në pyetje të dëshmitarëve ose viktimave në lidhje me peshën e veprës penale, si pjesë e harmonizimit pa dyshim me direktivat e BE-së.

Janë lehtësuar dispozitat lidhur me të drejtën e viktimave apo palëve të dëmtuara, ndryshimet i japin më shumë të drejtë palës së dëmtuar apo viktimës, siç është e drejta për të marrë informata në lidhje me veprën penale, të drejtën për të marrë informata për ofrimin e ndihmës mjekësore, përkrahjes psikologjike, strehimit alternativ dhe të drejtave të tjera që lidhen me interesin e tyre publik.

Gjithashtu është shtuar një nen i ri që lidhet me seancën e caktimit të dënimit pas pranimit të fajësisë apo aktgjyimit fajësues.

Qëllimi i një dispozite të tillë është të lejojë zbatimin e udhëzuesit të dënimeve dhe t'u mundësojë palëve që të argumentojnë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në një seancë të veçantë.

Ka pasur shqetësime se mbrojtja nuk argumenton rrethanat lehtësuese në fjalën përfundimtare kur i pandehuri nuk e pranon fajin, për shkak se ata frikësohen se diçka e tillë mund të nënkuptohet si pranim i fajësisë. Prandaj, mundësimi i një seance dëgjimore pasi personi është shpallur fajtor u jep mundësinë të dy palëve që të bëjnë argumentet e tyre lidhur me rrethanën lehtësuese ose rëndësuese.

Janë bërë edhe ndryshime në kapitullin e masave të fshehta, pothuajse i gjithë kapitulli i masave të fshehta është ndryshuar, sepse nenet aktuale kanë paraqitur vështirësi në aspektin e zbatimit praktik për shkak të mungesës së qartësisë dhe mospërputhjeve ndërmjet tyre.

Të nderuar deputetë,

Sipas këtyre ndryshimeve, procedura për marrëveshjen e pranim të fajësisë dhe dëshmitarëve bashkëpunues është shumë më e thjeshtë dhe më e lehtë për t'u zbatuar në praktikë dhe shpresoj që edhe kjo do të gjejë përkrahjen tuaj.

Të nderuar deputetë,

Parim themelor që më ka udhëhequr në punën që është bërë gjatë hartimit të këtij projekt-kodi ka qenë angazhimi ynë i përbashkët në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, në njërin anë, si dhe barazia dhe siguria për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës para gjykatave dhe para ligjit.

E them me përgjegjësi se me ndryshimet e bëra askush s'mund t'i ikë ballafaqimit me drejtësinë, askush s'mund të llogarisë në pasurinë e fituar me vepër penale, askush s'mund të sfidojë ligjin në Republikën e Kosovës. Dhe jam i hapur për debat dhe për pyetjet tuaja lidhur me këto ndryshime. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit. z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Haxhiu, që ta marrë fjalën në emër të komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Punës, në mbledhjen e mbajtur më 12. 2. 2019 e shqyrtoi Projekt-kodin e procedurës penale numër 06/L-151.

Në këtë mbledhje të komisionit kemi pasur disa shqetësime dhe kjo është arsyeje pse Komisioni për Legjislacionin i ka rekomanduar Kuvendit që të mos e përkrahë Projekt-kodin e procedurës penale.

Vetëm shkurtimisht, sepse do të flas edhe në emër të grupit përveç meje, natyrisht edhe deputeti Sami Kurteshi.

Por, disa prej shqetësimeve të anëtarëve të Komisionit për Legjislacionin, pas të cilave pastaj ka ndodhur edhe kërkesa për mosvotim të këtij projekt-kodi, kanë qenë pikërisht nenet të cilave iu referua ministri i Drejtësisë, neni 177 që flet për suspendimin e personit zyrtar nga detyra.

Pastaj neni 306, që flet për gjykimin në mungesë.

Por po ashtu një prej diskutimeve të cilat i kemi pasur në komision ka qenë edhe zgjatja e afatit të hetimeve për prokurorët nga dy në katër.

Prandaj, pikërisht mbi bazën e këtyre qëndrimeve ne kemi vendosur të mos e përkrahim në parim këtë Projekt-Kod të Procedurës Penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e kanë grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka zoti Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Faleminderit!

Të dashur qytetarë,

Kryesues,

Të nderuar kolegë,

Në emër të Grupit Parlamentar ne e kemi shqyrtuar Projekt-Kodin e Procedurës Penale dhe natyrisht e mirëpresim ardhjen e tij në Kuvend.

Kontributin tonë natyrisht që do ta japim përmes amendamenteve të prezantuara dhe përmes përfaqësuesve në Komisionin për Legjislacionin.

Kështu që mirëpresim një punë të mirëfilltë, duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë që ka ky projekt-kod.

Me shpresë që versioni përfundimtar do të ketë disa prej ndryshimeve që ne supozojmë se janë parakusht për ta trajtuar dhe për ta adresuar këtë temë jashtëzakonisht të rëndësishme në mënyrën se si meriton adresimin, duke i pasur parasysh rrethanat në të cilën operojnë të gjithë ata që janë të ngarkuar me zbatimin e këtij kodi.

Prapë po them që kontributin tonë do ta japim në komision, edhe duke prezantuar amendamentet me shkrim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar, ka pasur vërejtjet e veta, por kanë qenë katër vota për, katër abstenim, do ta jap kontributin përmes grupit punues mes dy leximeve.

Po ky kod është në vazhden e ligjeve që e kompletojnë sistemin e drejtësisë.

Në vitin e kaluar kemi miratuar një numër të madh të ligjeve që prekin sistemin e drejtësisë. Tani është koha të miratojmë sa më parë Kodin e procedurës, pasi që Kod i ri Penal është i miratuar, realisht është i miratuar dhe ka hyrë në fuqi, siç tha edhe ministri i Drejtësisë.

U tha edhe nga ministri që janë shumë çështje që ky kod adreson, çështjet kryesore që adreson kodi që sot po e shqyrtojmë janë fshirja e shqyrtimit të dytë.

U tha se ky ndryshim është bërë në mënyrë që të thjeshtësohet faza e aktakuzës.

Është rishikimi komplet e kapitullit të konfiskimit. Ky ndryshim është bërë sepse ka pasur edhe ankesa se procedurat aktuale të konfiskimit të pasurisë janë shumë të komplikuar dhe zbatuesit kanë hasur në shumë vështirësi në zbatimin e tyre.

Nenet e ndryshuara janë në pajtim me Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, i cili ligj ka kaluar edhe në komision, por ka kaluar edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Zgjatja e afatit të hetimeve, ky ndryshim është bërë për shkak të afatit aktual për hetim, konsiderohen të jenë një afat shumë i shkurtër veçanërisht për vepra penale që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Zgjatja e afatit të hetimit është bërë në mënyrë që t'i jepet prokurorit më shumë afat që të zhvillojë hetimet, e sidomos në çështjet e komplikuar, pra periudha kohore e hetimit në parim është dy vjet, por mund të zgjatë nga gjyqtari i procedurës paraprake çdo gjashtë muaj, për një periudhë maksimale prej dy vjet.

Seanca për caktimin e dënimit pas pranimit të fajësisë apo gjyqimit të fajësisë, edhe këtu në bazë të zbatuesve. Ky ndryshim është bërë, sepse ka pasur shqetësim se mbrojtja nuk argumenton në rrethana lehtësuese në fjalën përfundimtare, kur pandehuri nuk e pranon fajin, për shkak se ata frikësohen se diçka e tillë mund të nënkuptohet pranimi i fajësisë.

Në këtë mënyrë mbrojtja përfshin këto argumente në ankesë, e cila është një nga arsyet për Gjykatën e Apelit, ndryshon shumë gjykimi duke zvogëluar dënimin e shqiptuar nga Gjykata Themelore.

Prandaj, mundësia e një seance dëgjimore pasi personi është shpallur fajtor u jep mundësi të dy palëve të bëjnë argumentet e tyre lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rëndësuese.

Shtimi i dispozitave të reja lidhur me suspendimin e personit zyrtar nga detyra lidhur me veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit.

Gjykimi në mungesë, besoj që edhe kjo është një element i ri, është shtuar neni i ri lidhur me gjykimin në mungesë, i cili përcakton se nëse i pandehuri i cili vullnetarisht dështon të paraqitet në seancë gjyqësore, pasi të jetë i informuar për datën, nuk duhet të lejohet të vonojë procedurën, në ato raste kur prokurori nuk mund të gjejë një të pandehur pas përpjekjes të arsyetueshme.

Gjykimi duhet të jetë në gjendje të mbahet sipas nenit të propozuar.

Ndryshimi i kapitullit të masave të fshehta, e shpjegoi edhe ministri, procedura lidhur me ankesën kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit, me të cilën lëndët kthehen në rigjykim, janë ndryshuar disa dispozita, sipas të cilave do të reduktohet numri i kthimit të lëndëve në rigjykim, me ç' rast i mundëson Gjykatës së Apelit që ta ndryshojë vetë aktgjykimin. Qëllimi i këtij ndryshimi është që të reduktojë numrin e rigjykimeve për lehtësimin, të cilat mund të rregullohen nga vetë Gjykata e Apelit pa e kthyer lëndën në rigjykim.

Të drejtën e palëve të dëmtuara, ndryshimet e këtyre neneve i japin më shumë të drejtë palës së dëmtuar apo viktimës, siç është e drejta për të marrë informata në lidhje me veprën penale, të drejtën për të marrë informata për ofrimin e ndihmës mjekësore përkatëse, përkrahjes psikologjike, strehimit alternativ dhe çdo dispozitë specifike të parashikuar në kod.

Të drejtë për përfaqësim ligjor dhe ndihmë juridike, si dhe për kompensim dhe rimbursim të shpenzimeve të bëra si rezultat i pjesëmarrjes së tij në procedura penale.

Të drejtën për të kërkuar mbrojtje, duke përfshirë masa mbrojtëse, siç parashikohet në këtë kod. E drejta për të hyrë në shërbim të ndihmës së viktimës, përfshirë Zyrën e mbrojtjes dhe ndihmës së viktimave dhe shumë elemente të tjera.

Qasja në aktakuzë nga publiku. Kjo është ndryshuar për shkak të transparencës dhe llogaridhënies.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, edhe kjo është një element i ri në Kodin Penal, ndryshimet e reja në këto nene i japin më shumë fleksibilitet prokurorit për të zbatuar marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Sipas këtyre ndryshimeve, procedura për marrëveshje për pranim të fajësisë dhe dëshmitarëve bashkëpunues është shumë më e thjeshtë dhe më e lehtë për t'u zbatuar në praktikë dhe me shpresë do të inkurajojë zbatimin e nenit lidhur me dëshmitarët bashkëpunues për të zhvilluar prova në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Mbrojtja me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar, kur nuk ekzistojnë, do të thotë, kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtje me shpenzime publike, me kërkesën e tij. Nëse gjendja pasurore e tij nuk mund t'i përballojë shpenzimet e mbrojtjes, si dhe procedura penale zhvillohet për veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me burg nga neni 8, sa ka qenë më parë, tash është zbritur nga 8 në 3 apo më shumë vjet burgim.

Unë konsideroj që ky Kod i Procedurës Penale është shumë më i avancuar se kodi aktual.

Si grup parlamentar do ta japim kontributin tonë mes dy leximeve, edhe përmes grupit, po në të njëjtin kohë edhe si zëvendëskryetar i Komisionit për Legjislacion do ta japim kontributin në grup punues që do të formohet nga Komisionit për Legjislacion.

Në këtë rast e përkrahim dhe i ftoj edhe kolegët e tjerë që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka shqyrtuar Projekt-kodin e procedurës penale.

Kemi disa vërejtje, disa pyetje, meqë ministri është këtu, është mirë që ta marrë fjalën, sepse pastaj kjo ndikon edhe në qëndrimin e Lëvizjes Vetëvendosje në raport me këtë Projekt-kod të procedurës penale.

Së pari, gjykimi në mungesë, ju e dini që ka të bëjë me nenin 306 të Kodit të Procedurës.

Që ne si Vetëvendosje kemi propozuar plotësim-ndryshimin e Kodit aktual që është në fuqi të procedurës penale që lidhet me gjykimin në mungesë, por specifikisht për krimet e luftës dhe aty

besoj, edhe ministri ka arritur të shohë, për shkak se ka pasur propozimin për mendim, ndonëse nuk kanë pranuar të flasin për të.

Mendoj që ka qenë mënyra më e duhur për adresim të gjyqimit në mungesë. Pse po e them kështu? Nëse e shihni propozimin e Ministrisë së Drejtësisë që flet për gjykimin në mungesë, ta zëmë, i akuzuari është i pranishëm në shqyrtim fillestar dhe shqyrtim kryesor, por pastaj në paragrafin 2 thekson se, në qoftë se nuk është i pranishëm, domethënë në shqyrtim gjyqësor në rrethanat e mëposhtme, pastaj vlen paragrafi tre, domethënë gjykimi në mungesë e realizon nëse i akuzuari mungon vullnetarisht pas seancës dëgjimore të paraparë në paragrafin 5.

Pra, është problemi se kjo po kushtëzohet me seancën dëgjimore dhe është problem, sepse në këtë kuptim, po flas vetëm për krimet e luftës, ta zëmë, në Kosovë. Në qoftë se Serbia nuk i dorëzon kriminelët e luftës, kriminelët e luftës ende janë të lirshëm, por që ne nuk kemi pasur të drejtë ligjore për t'i arrestuar, në fakt për t'i gjykuar në mungesë, natyrisht që kjo është e vështirë pastaj për t'u aplikuar sidomos për krimet e luftës dhe këtu e kemi hallin kryesor, për shkak se nuk guxojmë që të lejojmë paragrafë ose fjali, të cilat e pamundësojnë pastaj gjykimin e krimeve të luftës.

Ju e dini që organizatat e të pagjeturve, familjarëve të të vrarëve në luftë, nuk ka asnjë dënim për dhunimet seksuale gjatë luftës, mendoj që rregullimi aktual siç është në Kod të Procedurës, por edhe këtu do ta pamundëson trajtimin e dosjeve që janë aktualisht në prokurori. Mendoj që kjo duhet të pësojë ndryshime në kuptim që të mos lidhet me ndonjë seancë dëgjimore apo ndonjë shqyrtim kryesor, e të tjera, e tjera.

Tjetra, është me nenin 177 dhe po mundohem që t'i referohem të njëjtit, i cili flet për suspendimin e personit zyrtar nga detyra. Tash për Vetëvendosjen qysh e kemi lexuar ne, bie ndesh memorandumit shpjegues me Projekt Kodin e Procedurës Penale, për shkak se memorandumit shpjegues flet që suspendimi do të ndodhë vetëm për zyrtarët që kanë aktakuza për rastet e korrupsionit, krimet të organizuar, pra kapitullit të veçantë të Kodit Penal, por në anën tjetër, në këtë projekt-kod nuk specifikohet saktësisht se për çfarë vepra, të paktën unë s'kam pasur mundësi ta gjej askund. Pra, kjo nënkupton për çfarëdo vepre penale dhe tash, edhe unë do të doja që Kosova ta kishte një sistem të drejtësisë sikur shtetet skandinave, ku aktakuza që e ngrit prokurori dhe kur konfirmohet në gjykatë, aktakuzat në shumës 99% të tyre marrin aktgjykim dënues.

Por, çka ndodh tash në Kosovë është që është goxha problem, sepse aktakuza e një prokurori shumë shpesh po dështon, kjo ka të bëjë edhe me ndikimin e pushtetit në sistemin e drejtësisë dhe në këtë kuptim mendoj që në qoftë se lihet pa kufizime për të gjitha veprat penale, kjo mund të përdoret kundër grupeve apo subjekteve politike, kundër individëve, ta zëmë, një prokuror shumë lehtë e ngrit një aktakuzë për një zyrtarë vetëm që t'ia pamundësojë për çfarëdo vepre

penale, vetëm që të ia pamundësojë atij bartjen e një funksioni publik. Do ta pranoni në qoftë se Kosova do të kishte sistem të fuqishëm të drejtësisë, por nuk mund ta pranojmë një dispozitë të tillë për sa kohë kemi probleme tepër të mëdha në sistemin e drejtësisë, ku aktakuzat e prokurorëve në përqindje të madhe rrëzohen nga gjykata ose nuk përcillen me aktgjykime dënuese, por liruese.

Çka është e rëndësishme të theksohet po ashtu, ne do të mund ta përkrahim një propozim ku specifikisht për rastet e korrupsionit mund të vlejë, vetëm për rastet e korrupsionit suspendimi i personit zyrtar nga detyra, por në këtë mënyrë, për të gjitha veprat penale, ta zëmë edhe ne të gazit lotsjellës, por edhe për aktivitetet politike ose aksionet politike mund të vlejë dispozita në qoftë se lejohet sikur ka propozuar Ministria e Drejtësisë. Dhe, një çështje tjetër që po e ngre ka të bëjë edhe me kërkesat që i kanë adresuar organizatat e shoqërisë civile që merren me monitorimin e sistemit të drejtësisë, ka të bëjë me zgjatjen e hetimeve. Aktualisht prokuroria i ka dy vjet afat për një lëndë, për ta hetuar një lëndë, këtu është bërë 4 vjet, pra plus dy.

Mendoj që, në qoftë se ne do të kërkonim efikasitet nga prokuroria, ne duhet po ashtu të parashihnim mekanizma ku përbrenda dy vjetëve prokurori do të mund ta adresonte një lëndë, tash kjo është gabim qysh është formuluar, është zgjat afati për shkak se neve na është shtuar edhe numri i prokurorëve. Tash në vend të adresimit, ta zëmë 2 vjet, por kur kërkon përgjegjësi nga prokurorët, sepse në këtë mënyrë relaksohen prokurorët, në qoftë se 4 vjet ia ke zgjatur afatin për hetime, le që do t'i mbante nën presion njerëzit, por kjo bie ndesh pastaj edhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, bie ndesh edhe me Kushtetutën e Kosovës, e cila kërkon gjykim të arsyeshëm në kohë të arsyeshme.

Pra, në qoftë se katër vjet mbetet një lëndë në prokurori ose hetohet një person katër vjet, është goxha presion i madh, por në anën tjetër, sa do të zgjasë pastaj afati kohor deri sa të shkojë në gjykatë lënda. Pra, mund të themi lirisht që ne po e bëjmë në mënyrë ligjore aktualisht ndodh, domethënë njerëzit mbeten në paraburgim 5-6 vjet, ne kemi pas raste të monitorojmë burgje, 6 vjet ka njerëz që janë në paraburgim, në fund shpallen të pafajshëm.

Pra, çka po dua të them është që kjo është edhe kundërkushtetuese, sepse Kushtetuta kërkon gjykim në afat të arsyeshëm dhe kjo nëse zgjat 6-7 vjet, që po e bëjmë me ligj, është goxha problematike. Kjo është kundërshtuar edhe nga shoqëria civile dhe e kundërshtuam e dhe ne si Vetëvendosje. Sepse, thjesht, i relakson prokurorët dhe i mban në presion dhe i shkel të drejtat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Janë këto tri vërejtje, të cilat ne i kemi, të paktën që unë kam vendosur që t'i adresoj. Ka edhe disa çështje të tjera që janë teknike, por ato do të mund të adresohen në qoftë se ky projekt kod i procedurës kalon në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të AAK-së, Shkumbin Demaljiqaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i AAK-së është pro Projekt Kodit për Procedurën Penale, sepse po finalizohet dhe po kompletohet kjo pjesë e sistemit të drejtësisë, mirëpo meqenëse edhe ministri është këtu, si sponsorizues, është mirë që këtë skepticizmin midis kësaj hapësire që edhe opozita po e kundërshton, ta trajtojë me kujdes, sepse kemi nevojë ta votojmë, ta kompletojmë edhe këtë pjesë me Kodin e Procedurës, sepse edhe shumë ligje të tjera që janë në fuqi, janë të rregulluara me Kodin Penal, të mos e lëmë në kohëzgjatje.

Aty ku jemi skeptikë si grup parlamentar, edhe ne do të vendosim ndërmjet dy leximeve, mirëpo ju kisha lutur që si sponsorizues të mos lëndohet kjo pjesë. T'i bini ato arsyetimet që po kërkojnë edhe deputetët e opozitës dhe ta kompletojmë infrastrukturën e kodifikimit në fushën e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën, në emër të PSD-së.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Mungesa e sundimit të ligjit natyrisht se është problemi kryesor i shoqërisë sonë, e cila nuk është pengesë vetëm për liberalizim të vizave, e cila çështje është ndër më të diskutuarat, sepse sado që ne pretendojmë se është kusht i plotësuar, të tjerët na thonë se ne ende, si shoqëri po them, si shoqëri dhe si shtet nuk kemi arritur që mjaftueshëm ta luftojmë krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Prandaj, çdo hap që ndërmerret, që çon në drejtim të forcimit të ligjit, natyrisht se është i mirëpritur. Kuvendi si organ që nxjerr ligje duhet t'i kryejë detyrat e tij për të plotësuar kornizën ligjore, e cila u mundëson prokurorëve dhe gjyqtarëve që ta kryejnë punën e vet, por nuk e di sa është e mjaftueshme kjo, sepse ndonëse edhe tani korniza ligjore, infrastruktura ligjore nuk ka qenë as fort e mangët e as e keqe, megjithatë vërejtjet që ne i marrim shkojnë në drejtim të mungesës së zbatimit të këtyre ligjeve. Unë mendoj se tani ky Kuvend i ka bërë disa hapa që do t'ia lehtësonin gjyqësorit në përgjithësi që ta kryejë punën sa më mirë. Besoj që ky Projekt Kod i Procedurës Penale është njëri nga ata hapa që i ndihmon gjyqtarët dhe prokurorët që të paktën të kenë më pak arsye pse ata nuk po mund ta luftojnë mjaftueshëm krimin e organizuar dhe korrupsionin. Kështu që ne në parim do ta mbështesim, ndër vërejtjet të tjera që ne natyrisht do t'i prezantojmë në grupin punues dhe në komision, po vërejtja jonë thelbësore mbetet te afati nën hetime. Edhe në vende të punës kur dikush aplikon, ta zëmë, për një vend të punës, një nga kërkesat që duhet t'i plotësojë ose një nga dokumentacionet që ai duhet t'i dorëzojë bashkë me të tjerat të kërkuara është edhe një dokument që nuk je nën hetime.

Kjo po ashtu vlen edhe për rastet kur kërkohet ta zëmë avancim në ndonjë pozitë, tash paramendojeni kur prokuroria ka filluar hetimet ndaj një X personi dhe ato zgjasin katër vjet. Në fund ky person mund ose hetimet mund të rezultojnë që të mos ketë bazë të mjaftueshme, por ky

person e ka humbur të drejtën qoftë për t'u punësuar, qoftë për t'u avancuar apo diçka tjetër për katër vjet. Prandaj, unë mendoj se tani edhe hapat e tjerë që janë ndërmarrë duhet të ndërmerren, natyrisht edhe të tjerë që për t'ia lehtësuar prokurorisë punën, por afatet duhet të zvogëlohen, sepse kjo pastaj mund të bie ndesh edhe me mosrealizimin e të drejtave të tjera të qytetarëve dhe automatikisht është edhe shkelje e të drejtave të njeriut. Kështu që ne kërkojmë që kjo pjesë të shqyrtohet me kujdes dhe të zbritet, të ulet afati për kryerjen e hetimeve derisa të shpallet aktakuza dhe pastaj të fillojë procesi gjyqësor. Përndryshe, për vërejtjet e tjera ne do t'i përcjellim në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi në emër të Nismës.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues! Edhe Nisma qysh në mbledhjet e komisionit i ka dhënë mbështetje këtij ligji, këtu për të gjitha çështjet, për të cilat u ngritën do të vazhdojmë të japim kontributin tonë nëpër mbledhjet e ardhshme në komision dhe mes dy leximeve, vetëm desha të ngre edhe unë vëmendjen apo, le të themi, të ngre shqetësimin tim rreth pengesës që i bëhet ndjekjes penale të krimeve të luftës në mungesë, duke e kushtëzuar me seancën dëgjimore.

Është një paradoks brenda ligjit, sepse nëse unë apo shteti, Prokuroria arrin ta arrestojë apo ta ketë në seancë dëgjimore një të dyshuar për krime të luftës, atëherë nuk ka nevojë ta dënojë në mungesë, sepse ata do ta mbajnë në paraburgim dhe do të zhvillohen pastaj seancat nga paraburgimi, sepse zakonisht krimet e luftës për nga natyra janë të tilla, të rënda që nuk mund të mbrohet nga liria, pastaj të shkojë në seanca. Kryesisht, dua të them bëhen, zhvillohen nga hetuesia, nga të qenit në paraburgim. Pra, kjo në njërin anë e mundëson ligji ndjekjen penale në mungesë, gjykimin në mungesë, ndërsa përmes asaj dispozite praktikisht e vështirëson, mos thënë e pamundëson fare zhvillimin e një procesi kundër të dyshuarve për krime lufte, gjenocid, në mungesë. Prandaj, mendoj që këtu, ne edhe në komisione që kemi pasur, kemi pasur dilema rreth kësaj dhe me sa di unë, ka pasur një pajtueshmëri të plotë që kjo duhet të hiqet, sepse e vështirëson, siç thashë, për të mos thënë e pamundëson fare ndjekjen e krimeve të tilla.

Në mes të dy leximeve, në cilado faza, Nisma do të vazhdojë të japë kontributin e saj për të kaluar këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Sami Kurteshi. Korab, e ke kryer fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Ministra të Qeverisë,

Ne sot po diskutojmë për Kodin e Procedurës Penale, në të vërtetë ndër aktet normative më të rëndësishme në Republikën e Kosovës, nuk po them që po më vjen keq që s'janë këtu deputetët të gjithë, mirëpo secili duhet ta dijë se me ndonjërin nga normat e këtij Kodi mund të preket

ndonjëherë në jetën e vet, kështu që përveç kësaj të gjithë qytetarët e Republikës i prek ky kod, gjatë tërë jetës i përcjellë, pa marrë parasysh a mund të jetë ndonjëherë në favor ose kundër tyre.

Prandaj, unë mendoj se do të ishte shumë e rëndësishme që edhe ne si deputetë, por edhe njerëz që merren me këtë çështje ta kenë kujdesin më të madh, sepse normat që i votojmë këtu, mandej duhet të zbatohen për ne, s'po them kundër nesh, por për ne. Këtu u përmendën disa çështje, për të cilat folën të tjerët, unë po i prek një nga një përsëri. Ajo që do t'ia drejtoja ministrit të Drejtësisë që është një problem, sepse nuk po na sillen ndryshimet veçmas për krahasimin, a janë bërë ndryshimet më të mira, a më të këqija, si është puna? Po, po integrohen në tekst dhe teksti mandej është i pайдentifikueshëm lehtë, kjo është për krejt çështjet teknike për identifikim më të lehtë.

Çështja tjetër është te neni 157 që ka të bëjë me afatin e hetimeve, do të thotë me kompetencën e prokurorit që i jepet për zgjatjen e afatit të hetimeve. Në kodin e mëparshëm ka qenë dy vjet, plus 6 muaj, në rastet e hetimeve të komplikuar, të ndërlikuara, sido që ta quani. Tash bëhet një kohëzgjatje për 6 muaj, edhe kjo mund të arsyetohet, meqenëse unë do të flas për raste konkrete, mirëpo arsyetimi unë po e them këtu, është jovalid, sepse një prokuror personalisht mund të vendosë kur e zgjat edhe kur nuk e zgjat, mund ta japë një arsyetim cilido qoftë dhe nuk ke çka i bën. Dëgjoni tash pikën 2.4 të nenit 157, paragrafi 4, domethënë bëhet kërkesa, shkon atje, thotë 'edhe për çfarëdo arsye tjetër që arsyeton zgjatjen në interes të drejtësisë', e çka domethënë? Cila është ajo arsye tjetër? Qysh e arsyeton, domethënë prokurori nuk është i obliguar për asnjë arsyetim, 'çfarëdo arsye tjetër që arsyeton'. Kush e interpreton edhe e analizon atë si arsyetohet, 'çfarëdo arsye tjetër'. S'po hyj te dikush tjetër, po hyj te vetvetja, e kam një pikë dhe unë s'kam asnjë arsyetim, veç thotë po ta vazhdoj edhe për gjashtë muaj, se kemi arsye. Cilat janë arsyet?

Unë po ju kallëzoj për një rast, megjithatë duhet ditur, te personat zyrtarë. Kryetari i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka hapur hetime dhe këto i ka përmendur njëherë dikush këtu, gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Brenda dy vjetëve nuk ka gjetur asgjë me gjasë s'ka ngritur aktakuzë. Janë bërë dy vjet e gjysmë, nuk ka ngritur aktakuzë dhe nuk e ka dhënë kurrë asnjë arsyetim apo njoftim, a janë ndërprerë hetimet apo jo? Edhe kur shkojmë në gjykatë, e shohim se ka hetime, të hapura janë. Ky është problemi, prokurori disiplinor i tërheq vërejtjen prokurorit, kryetarit të Prokurorisë Themelore, ia tërheq vërejtjen për shkelje procedurale dhe nuk ka asnjë pasojë, ai njeri sot është rizgjedhur kryetar i Prokurorisë Themelore të Prishtinës.

Po ajo çka ngjan, unë po ju tregoj të gjithëve që mund t'ju ngjajë. Ndalet zhurma, nuk dëgjohe më për rastin. Ditën kur e kam dorëzuar mandatin e Avokatit të Popullit, vetëm një orë pasi e kam dorëzuar zyrtarisht më kanë ardhur Policia te dera për hetime për rastin që ishin bërë mbi tre vjet. Kjo është ajo që mund të ngjajë. Prandaj duhet ta dimë secili, nuk është ajo. Unë nuk e di kurrë sot e asaj dite, a janë mbyllur ato hetime a s'janë mbyllur, a çka ka ngjarë. Bile as avokati i tashëm nuk e di. Sepse kjo është mënyra e sjelljes së papërgjegjshme dhe pa njoftime.

Prandaj, nuk mund të ngjajë të zgjatet afati çdo gjashtë muaj pa asnjë arsytim. Edhe kush e jep atë arsytim? Kush e arsyeton, a ka një trupë tjetër? Kjo është e papranueshme, përndryshe dy vjet e gjysmë janë të mjaftueshme për një prokuror për cilëndo lëndë, natyrisht nëse nuk kërkohet ndihma e prokurorive në botën e jashtme, edhe ajo arsyetohet me letra. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë në të vërtetë për të cilën unë po shqetësohem është gjykimi në mungesë. Unë nuk e di pse qëllimisht është ndryshuar në ndryshim-plotësim që është bërë këtu. Në të vërtetë, Lëvizja Vetëvendosje, tash po e them GP i Lëvizjes Vetëvendosje e ka bërë një propozim. Propozimi ka qenë i arsyetuar dhe shumë i mirë, por nuk ka gjykim në mungesë kur kërkohet domosdo që të jetë i akuzuari, ose i pandehuri, sido ta quani, i akuzuari, në bankë. Sepse nuk është më ai gjykim në mungesë. Ai mund të ketë arsye të tjera, por nuk është më gjykim në mungesë. Edhe kjo është paraparë për rastet e krimeve të luftës, kur ne e dimë se ekziston një shtet, edhe ai shtet është Serbia që nuk i dorëzon njerëzit që kanë bërë krime të luftës, edhe pas kërkesave të shumta.

Propozimi që ka bërë GP i Lëvizjes Vetëvendosje ka qenë relativisht mirë i punuar. Janë bërë grupe punuese, janë bërë diskutime me shoqërinë civile. Madje po ju them edhe në pjesën veriore të Mitrovicës. Edhe e vetmja gjë që është ngritur, i vetmi dyshim ka qenë, “veç për serbët është bërë”. Jo s’është bërë veç për serbët. Për çdo njeri që ka bërë krime lufte dhe nuk vjen të dalë e të ballafaqohet me drejtësinë në Kosovë. D.m.th. ka bërë krime lufte në territorin e Republikës së Kosovës.

Unë kisha kërkuar edhe nga ministri i Drejtësisë, edhe nga kolegët dhe koleget deputetë, të mos ndryshojë neni për gjykimin në mungesë, të merret e të analizohet mirë.

Në propozimin që e ka dhënë Lëvizja Vetëvendosje mund të bëhen ndoshta përmirësime gjuhësore ose teknike, por propozimi, neni 306 që e ka ofruar Ministria e Drejtësisë në Kodin e tashëm të Procedurës Penale nuk i plotëson kërkesat përmbajtjesore të një gjykimi në mungesë. Është në kundërshtim me kërkesën. Nuk ka gjykim në mungesë, nëse gjithsesi kërkohet që i akuzuari të jetë në gjykatë. Nuk është ai gjykim në mungesë. Kjo është kontradiktë jo ‘in-adjectio’. Nuk mund të ngjajë, është kundërthënie logjike.

Këto janë çështjet. Sigurisht është e mirë, edhe një herë po kërkoj nga Ministria e Drejtësisë. Është mirë të bëhen të gjitha ndryshimet, t’u jepen deputetëve në mënyrë të veçantë, ose komisionit të grupit punues që t’i dallojnë mirë, edhe kërkoj nga të gjithë që të kemi kujdes gjatë rregullimit të këtij Kodi të Procedurës Penale se nuk ka të bëjë as me një grup, as me një njeri, as me një grup të njerëzve, po ka të bëjë me të gjithë personat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Drejtësisë, zoti Tahiri.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Do ta nis me çështjen e zgjatjes së hetimeve. Në radhë të parë, mendoj që këto vitet e pasluftës është abuzuar jashtëzakonisht shumë me fjalën “hetim” dhe mendoj edhe sot kur shkojmë në gjykatë dhe e nxjerrim një dokument, kërkojmë dokument që s’jemi nën hetime. Realisht një person i cili është nën hetime, atij nuk i shkruan në certifikatë që është nën hetime. Sepse ai që është duke u hetuar për një çështje të caktuar, ai as nuk duhet ta dijë, edhe hetimi realisht nuk duhet ta pengojë në përditshmërinë dhe në jetën e tij. Hetimi mund të përfundojë edhe pa aktakuzë. Mund të zgjasë një vit, gjashtë muaj, 12 muaj, 18 muaj, 24 muaj, por mund të përfundojë pa një aktakuzë.

Pra, pikërisht në rastet e caktuara e kemi paraparë që kjo mund të zgjasë çdo gjashtë muaj deri në katër vjet. Pra, gjithmonë duke pasur parasysh që kemi gjyqtarë kredibilë, prokurorë po ashtu kredibilë, të cilët nuk abuzojnë me punën e tyre dhe këtu çështja e hetimi në asnjë rrethanë nuk duhet të dalë në publik dhe nuk duhet ta dijë një person nëse është në hetim që është nën hetime dhe që po zhvillohen hetime ndaj tij, sepse më s’ka kurrfarë kuptimi. I humb edhe ai çdo ditë lufton dhe punon që ai hetim të dalë në fund i pabazë, i pavlerë, dhe të mos ngrihet aktakuzë ndaj tij.

Pra, është çështje e gjykimit, është çështje tjetër, pikërisht pajtohem, se ne kemi pasur procedura të stërzgjatura të gjykimit të cilat në një formë apo në një tjetër kanë abuzuar me qytetarë të ndryshëm. Pra, kjo duhet të rregullohet mirë, që mendoj që e kemi propozuar jashtëzakonisht mirë. Me këtë Kod të Procedurën Penale.

Çështja e hetimit nuk duhet të keqkuptohet. Pra, në rast se një person është nën hetime, atij nuk i del në certifikatë, sepse është e adresuar gabim që është duke u hetuar dhe s’mund të punësohet ose s’mund ta vazhdojë jetën e tij qoftë akademike, qoftë institucionale, e kështu me radhë. Pra, hetimi ta keni të qartë se nuk e pengon aktivitetin, punën e një zyrtari, biznesmeni, studenti apo kushdo qoftë ai. Pikërisht për raste të jashtëzakonshme, kjo mund të shkojë me arsyetimin e prokurorit dhe vendimin e gjyqtarit, deri në katër vjet, por jo në secilin rast, jo për secilën vepër, që vlen të theksohet.

Ndërsa sa i përket çështjes së suspendimit, kam pasur normalisht shumë vërejtje, edhe komente prej shoqërisë civile, edhe prej një pjese të deputetëve, e kështu me radhë. Edhe më kanë thënë që është edhe kundërkushtetuese. Pastaj është prezumim i pafajësisë dhe kështu me radhë.

Pra, mendoj që çështja e suspendimit është tepër e rëndësishme të përkrahet. Pse? Ne kemi pasur qindra raste, të mos them disa raste, borde të caktuara që ne si Qeveri i propozojmë, vijnë në Kuvend, votohen dhe realisht ata nesër mund të jenë nën aktakuza e kështu me radhë dhe nuk kanë kurrfarë mbikëqyrësi që nesër mund t’i suspendojë ose mund t’i largojë që ata të mos e

pengojnë një hetim që është duke shkuar ose një aktakuzë që është ngrehur ndaj institucionit në fjalë. Ka agjenci të ndryshme në këtë rast, dhe mendoj që duhet t'i lihet në dorë gjykatës të procedurës paraprake që të vendosë në rast se personi i tillë nuk mund ta ushtrojë pozitën e tij si zyrtar. Pra, është gjyqtari ai i cili vendos, jo shefi i tij, ose jo një institucion të përcaktojë a duhet të suspendohet ai apo jo. Është gjyqtari i procedurës paraprake ai i cili vendos në rast se personi duhet të suspendohet për një periudhë të caktuar.

Në logjikën që është kundërkushtetuese, atëherë i bie që kundërkushtetuese është edhe të vendoset në paraburgim një person, sepse s'është i dënuar dhe nuk duhet të vendoset në paraburgim. Pra, ju e dini që një zyrtar i shtetit kur është në paraburgim, nëse zgjat paraburgimi një vjet, ai mund ta humbë edhe vendin e punës. Pra çështja e suspendimit mendoj që është shumë mirë e rregulluar me këtë Kod të Procedurës Penale siç e kemi paraparë dhe duhet t'i lihet në dorë drejtësisë. Jo vullnetit politik, në rast se personi në fjalë duhet të suspendohet ose s'është të suspendohet.

Mendoj që është e rregulluar jashtëzakonisht mirë. Normalisht jam i gatshëm edhe për komentet, edhe për angazhimin tonë të përbashkët nëpër grupet punuese. Mendoj që ka ende punë për të bërë. S'pretendoj që kemi arritur të bëjmë një diçka perfekt. E kemi arritur ta bëjmë një punë të mirë, t'i adresojmë shumë prej çështjeve që dalin nga raporti për vendin, mirëpo ende kemi punë për të bërë.

Edhe sa i përket çështjes së gjykimit në mungesë, të nderuar deputetë, janë dy rrethana të ndryshme. Pra, në seancën kur i pandehuri refuzon të paraqitet në seancën dëgjimore, atëherë do të jetë trupi gjykues, ose gjyqtari i procedurës paraprake, ai i cili do të vendosë në rrethana të tilla, në rast se duhet të vazhdohet me gjykimin apo jo. Edhe këtu në këtë çështje, pa dyshim që jam i gatshëm të ulemi nëpër grupet punuese, të bashkëpunojmë edhe ta nxjerrim versionin më të mirë të mundshëm. Këtu kemi deputetë të vjetër që janë qe disa legjislatura dhe padyshim mund të japin kontribut dhe mund të angazhohen që ta nxjerrin versionin më të mirë të mundshëm.

Pajtohem me atë që e thanë deputetët që është një dokument që thjesht nuk mund ta lidhim qoftë me një parti politike, qoftë me pozitë ose me opozitë, mendoj që është një dokument, i cili në formë apo në një tjetër mund të ballafaqohemi të gjithë në të ardhmen me procedurat të cilat janë paraqitur në këtë dokument, dhe pikërisht kërkoj angazhimin e të gjithë juve së bashku që në grupet punuese, edhe ato lëshime ku eventualisht ka mund të jenë, ka mund të rrjedhin nga Ministria e Drejtësisë t'i adresojmë bashkërisht dhe t'i përmirësojmë.

Nuk mendoj që çështja e gjykimit në mungesë duhet të mbetet vetëm për krime lufte. Mendoj që duhet të lihet hapësirë edhe për vepra të tjera, qofshin për krim të organizuar, qofshin për korrupsion, qofshin për terrorizëm e kështu me radhë. Pra mendoj që nuk duhet të kufizohet

çështja e gjykimit në mungesë vetëm për krime lufte. Ajo duhet të vlejë për të gjitha veprat e tjera, e sidomos ju e dini këto pesë vitet e fundit jemi ballafaquar edhe me pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në pjesëmarrjen në luftëra të huaja si në Siri e në disa vende të tjera. Pra, unë mendoj që është shumë e rëndësishme që kjo të mos kufizohet vetëm për krime lufte.

Do të jem i gatshëm edhe normalisht të ballafaqohem me secilën çështje, mirëpo edhe çështja e gjykimit në mungesë, edhe zgjatja e hetimeve, edhe ngritja, edhe suspendimi, të gjitha janë analizuar mirë, është bërë një punë për më se 14 muaj, me ekspertë jashtëzakonisht mirë të përgatitur, edhe ndërkombëtarë, edhe vendorë dhe mendoj që kemi arritur ta kemi një dokument shumë mirë të përgatitur para vetes sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka një...

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa për sqarim. Zgjatja e hetimeve, d.m.th. zvarritja e hetimeve është çështje teknike. Parimi i drejtësisë është diçka tjetër. Dikush nuk mund të quhet fajtor para se ta marrë vendimin e një gjykate. Tash ne po duam ta arsyetojmë neglizhencën e gjykatave ose të prokurorive, duke e shkelur parimin që e keni në nenin 3 të Kodit të Procedurës Penale, askush nuk mund të quhet fajtor edhe të merren sanksione kundër tij derisa të merret një vendim.

Kjo është çështja e parë. Te paraburgimi është një arsyetim tjetër, ju e dini sikur unë, nuk po hyj aty.

Çështja tjetër, zoti ministër. Ju thatë se në certifikata nuk shkruhet se dikush është nën hetime. Këtu e kam një dokument i lëshuar me 11.02.2019, të këtij viti dhe është nga Gjykata Themelore në Prishtinë, thotë certifikatë nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe e personave të dënuar, me të cilën konfirmon se kundër parashtruesit të kërkesës, nuk po e përmendi emrin, është duke u zhvilluar procedura penale sipas këtij neni. Ky është dokumenti. Ju mund të thoni që nuk lëshohet, unë po them që lëshohet. Merreni, fotografojeni, këqyreni. Emrin nuk e përmenda se nuk është çështje personale.

Çështja në fund e gjykimit në mungesë. Megjithatë zoti ministër, gjykimi në mungesë nuk mund të quhet ai ku i akuzuari, i dyshuari duhet të jetë aty. Nëse themi në mungesë, është në mungesë. Kurse problem kemi me krimet e luftës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën. Po prit ta bëj Albulena e ka një replikë, edhe bëje sqarimin shtesë ti. Zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Po, faleminderit!

E para, do të doja që të shtoja këtu disa çështje. Së pari, në diskutimin dhe në fjalën e ministrit pash një ngatërrësë ndërmjet masave të fshehta dhe hetimeve. Hetimet që i nis prokurori nuk domethënë që pala ose personi i dyshuar nuk e di që ka nisur hetimi ndaj tij, për shkak se prokurori mund të kërkojë edhe marrjen në pyetjen të personit të dyshuar. Pra, është absurde të thuhet që gjatë hetimeve, pala nuk e di që është duke u hetuar. Pala nuk e di sa i përket masave të fshehta, që është diçka tjetër. Por që je duke u hetuar, plus në Kosovë, gjithçka bre po dihet. Po dihet kush po akuzohet e kush s'po akuzohet, plus kush edhe po amnistohet.

Çështja tjetër është në secilin konkurs që aplikojnë qytetarët e Republikës së Kosovës, për t'u lidhur me atë që tha edhe deputeti Kurteshi, kërkohet certifikata që s'je nën hetime. Po, qytetarët shkojnë në gjykatë për ta marrë certifikatën që s'janë nën hetime. Të gjitha evidencat i marrin, janë apo s'janë në hetim. Tash a është gabim a s'është gabim, kjo është diçka tjetër, po kështu është realiteti dhe kjo s'e adreson ndryshimin, as Kodi i Procedurës Penale.

Edhe një herë po kthehem që zgjatja e afatit e cenon sigurinë juridike që e përcakton Kushtetuta, në nenin 31, paragrafi 2, gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Nuk është afat i arsyeshëm 4, 5 e 6 vjet. Nuk është zoti ministër. Prandaj duhet adresuar.

Sa i përket çështjes të cilën ju pyeta, nuk mora përgjigje. Suspendimi. Sipas këtij ndryshimi, ka të bëjë me të gjitha veprat penale, apo jo? Nëse është kështu, është mashtrim në qoftë se në foltore të Kuvendit, ju deklaroni vetëm për raste të korrupsionit dhe nuk flisni për vepra të tjera, sepse ne e kemi lexuar Kodin e Procedurës Penale. Flet për të gjitha veprat penale. Suspendim për të gjitha veprat penale. Tash nëse një...

KRYESUESI: Faleminderit! Rregullat janë rregulla qysh janë për të gjithë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar deputete,

Tash s'po di a po e ngatërron me qëllim a pa qëllim, po masat e fshehta pikërisht pra përdoren edhe për hetime. Tash nuk e di me çfarë qëllimi po e bën.

Hetimi është diçka tjetër atë që e the në Kosovë gjithkush e di, po pikërisht ajo nuk duhet të ndodhë pra. Hetimi kur zhvillohet ndaj një personi, ndaj një qytetari, qoftë ai zyrtar, qoftë ai student, qoftë ai biznesmen, në një rrethanë normale, normalisht edhe nëse zgjat dy vjet, edhe nëse zgjat tri vjet, ai nuk duhet ta dijë, sepse në fund të fundit, nga ai hetim nesër do të rezultojë procesi gjyqësor, ose ka për t'u mbyllur me hetim pa aktakuzë. Pra, në një rrethanë normale, në një sistem të drejtësisë normale, nuk e di një njeri që hetohet nga sistemi ynë i drejtësisë dhe nuk i shkruan në asnjë certifikatë që është nën hetime. Nëse ka rast që është duke u zhvilluar nëpër gjykata ndaj tij, ajo është diçka tjetër.

Mirëpo hetimi është çështje e ndarë. Hetimi është ajo që e mundëson një hetim efikas. Në fund, i cili personi në fjalë mund të rezultojë i dënuar, me aktgjykim dënues, apo në fund përfundon pa dënim dhe pasojat si rezultat i hetimit, si qytetarë nuk duhet të kemi pasoja, as për punë, as për studime, as për asgjë tjetër. Pra hetimi nuk duhet ta pengojë një qytetar në zhvillimin e karrierës së tij. Nëse ngrihet aktakuzë dhe vazhdon gjykimi, atëherë kemi të bëjmë me një situatë tjetër. Pra, këndej kërkujmë që ky Kod i Procedurës Penale besoj që do të arrijë ta sigurojë një gjykim efikas dhe jo me procedura të stërzgjatura që të kemi persona në paraburgime, siç e the ti edhe me vite të tëra. Se sot p.sh. e kemi njeriun që është në paraburgim që katër vjet, që pesë vjet.

Pra, këto, pikërisht këto probleme jemi duke dashur t'i adresojmë. Çështja e hetimit të jetë sa më efikas dhe kur përfundon në fund me aktakuzë, gjykimi të jetë i shpejtë dhe ajo të lirohet ose të marrë aktgjykimin dënues dhe të përfundojë si çështje. Pra, hetimi është crucial. Është çështja më e rëndësishme për një çështje që ne duam të kemi një aktgjykim dënues. Në këtë rast, nëse duhet të ketë, e thotë drejtësia atë nëse duhet të ketë apo jo.

Ndërsa, sa i përket çështjes së suspendimit, mendoj se kjo është prej çështjeve më të rëndësishme. Se e përmenda edhe më herët, ke raste p.sh. ndoshta të involvuar edhe në institucione, edhe në biznese të ndryshme, njerëz që kanë ndihmuar, individë të caktuar që sot janë nëpër Siri e Irak e vende të tjera. Pra, mendoj që nuk duhet të lihet ekskluzivisht për çështjen e korrupsionit. Janë edhe disa vepra të tjera, si për terrorizëm e çështje të tjera, që duhet pra të suspendohen personat të cilat u ngrihet aktakuza dhe janë të involvuar në vepra të tilla.

Pra, prandaj po them, ne edhe mund të ulemi bashkë, t'i specifikojmë çështjet, mirëpo është shumë e rëndësishme, që kjo si për dispozitë, sidomos për vepra që lidhen me krim të organizuar dhe korrupsion, të kalojë. Pra, nuk ka të bëjë me abuzim, nuk ka të bëjë me cenim të sigurisë juridike për qytetarë. Ka të bëjë me rritjen e efikasitetit dhe me nxjerrjen e atyre personave të përgjegjshëm para organeve të drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe një minutë e ka Albulena. Pastaj t'i jap dy minuta.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Vetëm po dua t'ju sjell në kujtesën tuaj deklaratat e Presidentit aktual. Në një konferencë, tash s'e mbaj mend kush e ka organizuar, ndoshta Ministria e Drejtësisë, por ka qenë edhe Presidenti Thaçi aty dhe ai e pat përdorë pikërisht këtë, suspendimin e personave zyrtarë. Zoti Thaçi nuk e ka fare hall, për shkak se ai nuk ndiqet nga organet e drejtësisë, sepse PDK-ja është përgjegjëse kryesore pse sot organet e drejtësisë janë të kapura. Natyrisht që nuk e ndjekin Thaçin, edhe përkundër pasurisë së pajustificueshme që ai e ka krijuar. Por ai e pat thënë këtë deklaratë për ta përdorur si mjet kundrejt opozitës. Prandaj e pat bërë. Ka reaguar shoqëria civile, jeni tërhequr dhe tash na e servoni një propozim siç ka dashur Hashim Thaçi.

Zoti ministër, nuk do të kalojë kjo, sepse nuk lejojmë që përmes dispozitave të tilla të përdoren si mashë kundrejt opozitës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, edhe ju e keni të drejtën për kundër-replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!
Nuk e kam atë kuptim kundër-replikë. E kam për sqarim.

Megjithatë, po e përsëris edhe një herë. Unë po them, sinqerisht kemi të bëjmë me njërin ndër aktet normative më të rëndësishme edhe pak po shqetësohem për mungesën e diskutimit. Së paku i kemi afër 600 nene dhe nuk do duhej të përfundonin për dy orë.

Unë them se po përziehet parimi me çështjen teknike. Zvarritja e hetimeve dhe zvarritja e një gjykimi është çështje krejt teknike e neglizhencës së njerëzve që bëjnë atë. E drejta e garantuar kushtetuese që deri sa të shpallet dikush fajtor me vendim të plotfuqishëm të gjykatë, këto nuk guxojmë t'i përziejmë, ta suspendojmë njeriun dhe pas dy-tri viteve të del ka qenë i pafajshëm. Ky është problemi.

Këtë e kemi ne. Këtu në këtë Republikën tonë të Kosovës ka ngjarë.

KRYESUESI: Faleminderit, Sami! Fjalën e ka zonja... Bilall edhe ti replikë, nuk ta ka përmendur emrin ty. Zonja Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!
Nënkryetar po ia kaloj fjalën meqë e paska për procedurë dhe mandej vazhdoj unë apo...?
Faleminderit!

Janë disa çështje të cilat u ngritën dhe me të cilat pajtohemi plotësisht, çështje të cilat lidhen sidomos me paraburgime.

Po e nis me faktin që në këtë Kosovën tonë ka pasur paraburgime ekstreme të qindra e mijëra të ish-ushtarëve të UÇK-së. Paraburgimi më ekstrem ka qenë diku 9 vite dhe është liruar dhe askush nuk e ka dhënë asnjë përgjegjësi për vitet e humbura të ish-ushtarit në fjalë. E ky nuk është i vetmi rast, por janë qindra e mijëra raste.

Sot, një grua në Burgun e Lipjanit vazhdon të qëndrojë e paraburgosur mbi 4 vite dhe gjendja e saj është jo e mirë. Domethënë ajo është shumë e varfër. Nuk ka avokat. Nuk e ka asnjë përkrahje prej familjes. Nuk e ka asnjë përkrahje prej shtetit.

Thuhet që, sipas kësaj që e keni sjellë, do të thotë me ndryshime të Kodit Penal, afati i arsyeshëm. Domethënë një prokurori i është dukur afat i arsyeshëm që ta mbajë një grua e cila dorën në zemër fare s'e ka pasur vendin në burg për shkak të gjendjes së saj edhe psikike, mbi 4 vite në burg.

Seancat nuk janë mbajtur kurrë edhe ajo ka vazhduar të qëndrojë aty e braktisur nga të gjithë. Nuk po e shoh që me ndryshimet që i kemi sjellë ne e kemi rregulluar këtë çështje, përkundrazi.

Pastaj, javën e fundit kanë ndodhur një veprim shumë i çuditshëm, kur vëllezërit Dermaku kthehen në paraburgim. Njëri nga ta ka qenë këtu kolegë me neve. Rasti daton prej viti 2010. I kanë mbajtur në paraburgim. I kanë arrestuar. I kanë liruar. I kanë kthyer prapë.

E njëjta ndodh me familjen Morina. Me Jahirin, me vëllain e tij. Domethënë raste shumë të çuditshme. Vitet të stërzgjatura të mbajtura në paraburgim. Edhe në fund askush nuk e jep asnjë llogari për vitet e humbura në burg. Çka po ndodh? Ne, megjithatë jemi vend demokratik.

Nëse dikujt i është mohuar e drejta edhe ka bërë gabim dikush në sektorin e gjyqësisë apo prokurori e të tjera. Nuk dua të paragjykoj. Ndoshta dikush edhe në politikë, qëllimisht ka ndërmarrë veprime të caktuara. Nuk po e shoh që me Kodin Penal, ne e kemi përmirësuar gjendjen edhe i kemi evituar problemet me të cilat jemi ballafaquar në të kaluar edhe po vazhdojmë të ballafaqohemi edhe sot.

U tha, neni 177, u lartësua në opinion thua që ti që bëhet fjalë veç për njerëzit të cilët kanë aktakuza ose hetohen për korrupsion. Por, në fakt po shihet që bëhet fjalë edhe për të tjerët.

Besoj që ju ministër e dini fort mirë për kë e kam fjalën dhe për çka po flas.

Në këtë rast pajtohem me kryetaren e Komisionit për Legjislacion, djalli qëndron në detaje, prandaj votën do ta keni atëherë kur t'i sqarojmë të gjitha shqetësimet e deputetëve. Besoj që kjo është tepër e nevojshme, sepse ka shumë pak paqartësi të cilat u adresuan disa, të tjera besoj që do t'i adresojmë edhe gjatë punës në komision, mirëpo nuk mund ta kalojmë shkel e shko në emër të një vullneti të mirë të cilin të gjithë e kemi. Pajtohem që parimisht duhet ta kalojmë, mirëpo pa i sqaruar disa çështje të cilat janë të paqarta konsideroj që nuk duhet të kemi ngutë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit!

I kam përcjellë me vëmendje diskutimet e shumicë së kolegëve të mi dhe në mënyrë absolute pajtohem me çdo gjë që e ka thënë deputetja Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi e disa të tjerë.

Të mos mendojë dikush në këtë Republikë të Burdushit që ne do të kemi sistem të drejtësisë kur ministri ynë i Drejtësisë, personalisht e ka propozuar si kryetar të Komisionit të Jurisprudencës prokurorin Aleksandër Lumezi.

Pse e ka propozuar ministri i Drejtësisë Aleksandër Lumezin? Sepse në kohë kur kanë qenë miq të ngushtë ky edhe presidenti Thaçi, me Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, edhe jeni ende, edhe unë jam mik me ty, edhe me Hashim Thaçin jam mik, po jemi mik privat.

Jemi kundërshtar të tmerrshëm të politikës e sidomos të sistemit të drejtësisë që e keni bërë çervish të prishtë.

Ju e keni propozuar Aleksandër Lumezin, sepse e keni kapur pisk. Se sikur ai të ishte djali i babait tim, kur Enver Hasani ka dalë me argumente dhe e ka dëshmuar. Enver Hasani nuk ka qenë rrugaç, por është profesor universitar dhe Kryetar i Gjykatës Kushtetuese dhe e ka dëshmuar me argumente se ai, ai jo që nuk e ka dhënë provimin e jurisprudencës, po edhe sikur ta kishte dhënë e ka dhënë te masat e dhunshme.

Ju i çoni në funksione prokurorë e njerëz tuaj vetëm kur i kapni pisk, kur i shantazhoni, sepse vetëm atëherë ata janë të dëgjueshëm për juve.

E njëjta situatë është me kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale. Me Reshat Millakun. E keni çuar prokuror njeriun që e ka dënuar me 12 vite burg motrën e kryetarit, anëtarit tënd të partisë që është kryetar i Ferizajt.

Këshilli Prokurorial i Republikës së Burdushit çohet edhe bën komunikatë kundër deputetit të Republikës së Kosovës, Rexhep Selimit, pse ky ia paska përmendur emrin Aleksandër Lumezit në një emision televiziv apo në foltore të Parlamentit.

Domethënë këta na kërcënojnë neve, ndërkohë që Këshilli Prokurorial dhe Prokuroria e Republikës së Kosovës nuk del që ta mbrojë një deputet kur në mënyrë të rrejshme thuhet se filan deputetit për shembull, i është konfiskuar pasuria pa iu konfiskuar fare.

Ju e keni kapur sistemin e drejtësisë në këmbë e krye. Duke e kapur këtë sistem të drejtësisë, tash po dëshironi t'i shtoni plus edhe dy vite, në mënyrë që ta mbani neve edhe 4 vite të lidhur.

Të çohet një prokuror hajdut, rrugaç, i mpirë me ta marrë një person zyrtar...Shumë mirë e tha Albulena, kujt i frikësoheni ju? Mos u frikësoheni ju atyre policëve që i keni nxjerrë para gjyqit në gjykatën e Gjakovës që akuzohen që i kanë vjedhur 200 gramë dredhëza.

Mos i frikësoheni ju një njeriu që shpërndanë drogë në Pejë e në Prizren e në Gjilan sikur të ishte fasule. Jo. Ju i frikësoheni njerëzve zyrtarë. Ju i frikësoheni deputetëve të Republikës së Kosovë. Ju i frikësoheni mjekëve të mirë. Ju i frikësoheni politikanëve të mirë.

Tash, duke e pasur atje një prokuror kriminel dhe duke e ditur që shumica e gjykatësve të Republikës së Kosovës, të procedurës paraprake, janë vetëm noterë, nuk janë gjykatës. Janë noterë të këtyre prokurorëve. Atëherë, ju dëshironi të na mbani nën shantazh 4 vite, se me 2 pak iu është dukur. Doni të na mbani me shantazh 4 vite.

Ju zoti ministër, e keni ndërtuar një sistem të drejtësisë, ku edhe Parlamenti i Kosovës, Komisioni Hetimor për Inspektoratin Policor, ka nxjerrë vendime. Ka gjetur shkelje drastike në zyrën e krimit të organizuar të hetimeve për ekonomi, konkretisht për Nazim Sahitin dhe këta gjykatësit tuaj e kthejnë Nazim Sahitin në vendin e punës.

Prandaj, kur ne vijmë në përfundim që këtu njeriu nuk është ligj, po ligji është njëri, atëherë unë do ta votoj një ligj të tillë.

Ne s'mund të krahasohemi me Bashkimin Evropian dhe me vendet demokratike. Pse s'mund të krahasohemi? Sepse nuk ka polic në botë. Nuk ka hetues në botën Perëndimore që guxon ta prek një zyrtar të shtetit ose një mjek të mirë, pa i pasur 1 milion argumente.

Unë, do ta përkrahja këtë ligj, sikurse ne të ishim anëtar të Gjykatës së Strasburgut. Sikur të ishim ne anëtar të Gjykatës së Strasburgut, unë 24 orë do të isha lutur që polici dhe hetuesi e prokurori i Republikës së Kosovës dhe të më ngre hetime, edhe të më akuzojë, edhe të më largojë nga puna, e atëherë ju do ta kishit parë sesi unë e kisha sakatuar shtetin e Kosovë.

Sipas një gjykatësi të cilit unë i besoj shumë. Ai thotë se krejt sistemi i drejtësisë këtu mbahet peng për 2 milionë euro. Pra, Ministria e Drejtësisë nuk do që ta rrisë buxhetin e gjykatësve për 2 milionë euro dhe për këtë arsye ne kemi atje lëndë të pafundme.

E para, tha Samiu, gjykimi në mungesë. Gjykimi në mungesë është vërtetë kur njeriu as nuk ia din adresën se ku është se lerë më ta ketë në gjykatë. Lëreni ju krimet e luftës, se për krime të luftës edhe nëpërmjet ligjeve të tilla të bëhemi ne patriotë. Jo.

Vendose që njeriu për korrupsion dhe për hajni do të dënohet, ndiqet e do të akuzohet edhe në mungesë dhe lënda e tij kurrë nuk do të plakët.

Kriminel i luftës është ai që e vjedh parandë publike. Kriminel të luftës janë këta që neve na kanë rrahur, na kanë torturuar, na kanë fyer e na kanë poshtëruar prej vitit 1989 derisa Zoti i madh atje edhe Milosheviqi i ka rrahur edhe këta hunj gardhi.

Këta na kanë rrahur. Këta na kanë torturuar. Këta na kanë lënë me shenja. Këta na i kanë përdhunuar edhe motrat tona kur kanë ardhur në vizitë që të na shohin nëpër burgje.

Këta i kanë marrë dhe i kanë arrestuar nënat tona plaka. I kanë arrestuar nënat tona plaka. Nënë time. Ka ardhur pas 9 vitesh për herë të parë më ka parë në jetën e vet kur u kthyen në Komoran 19 policë e kriminelë në krye me Lutfi Ajazin kanë shkuar dhe e kanë arrestuar.

Këta i ke në sistemin e drejtësisë. Këta faqezinj i ke edhe prokurorë. Edhe hetues, ai Nazim Sahiti që e ka revolen... Ministër, ju i keni mekanizmat sesi ta merrni informacionin. Në '97-tën e ka revolen që organet serbe ia kanë dhënë me leje.

Nuk e votova Ligjin për Pastërti, se pa ardhur në votim thash Zafir Berisha, këtu gjysmës edhe me acid s'mund të na lahet fytyra. Nuk ka Ligj për Pastërti, sepse sikur të donim ne që ta bënim vetingun, moti do ta bënim.

Prandaj, po them edhe njëherë, përderisa në këtë Republikë individë është ligj. Individu është zot. Individu të arreston. Të fyen. Të poshtëron. Polici hetues kriminel të fut kokainë në xhep duke të kontrolluar që vetëm ta ngre aktakuzën, ky ligj për mua nuk ka asnjë vlerë.

Prandaj, unë ju bëj thirrje të gjithë deputetëve që ky ligj nëse vjen i pa reformuar në leximin e dytë, të mos e votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë s'e besoj që individualisht mund të dënohet ose të të dënojnë dikush. Këta thirren në emër të ligjit të gjithë dhe në emër të ligjit të dënojnë.

Në emër të ligjit të arrestojnë. Shyqyr që ka mekanizma ankimes. E paska zgjatë pak procedurën Milaim, po çfarë të bëjmë. Po si jo! Për atë fola unë, që ta marrësh ti replikën. Zotit Milaim Zeka, replikë.

MILAIM ZEKA: Kryesues, Faleminderit! E kam vetëm një vërejtje që Korabit nuk ia dhe fjalën dhe ke bërë gabim.

KRYESUESI: Atëherë, ia humbe të drejtën që t'ia jap fjalën. Unë veç kam komunikuar me Korabin nëpërmjet kryetarit të grupit të tyre parlamentar. Nuk i takon fjala, po meqenëse është, po them specialist dhe është jurist i mirë, mendoj që mund të ketë mendime të mira sa i përket ligjit, po fjala nuk i takon. Zoti Korab e ke fjalën tash. Me Rregullore jo, pa Rregullore po.

KORAB SEJDIU: Si specialist që më ngrite kaq lart, edhe unë po mendoj që ju e keni gabim, se mua më takon fjala. Nëse e sheh Rregulloren, Nenin 40 1c, thotë; kryetarët e grupeve ose të

deleguarit e tyre, natyrisht që ma delegoi mua. Pastaj 1f thotë; deputetët tjerë që e kanë të drejtën e fjalës. Kështu që në nivel personal.

Sidoqoftë, unë po ia bëj sikurse Samiu para disa ditësh, po them, nuk e kam ndërmend të të falënderoj që po ma jep një drejtë që më takon.

Kodi i Procedurës Penale ose Projekt-kodi i Procedurës Penale është një ligj që ndoshta po na vjen pak me vonesë, sepse me sa e kam kuptuar, plani ka qenë që të vijë së bashku me Kodin Penal, në atë pakon e njëjtë të ligjeve që të hyjë paralel, por sidoqoftë mirë që ka ardhur.

Me shpresë që do të hartohet në atë mënyrë përfundimisht që i përket realitetit. Tash, disa gjëra këtu veç u diskutuan. Kisha dashur ndoshta që t'i ritheksoj prej një këndvështrimi tjetër dhe për atë arsye e përmenda realitetin dhe pikërisht çështje të cilat në një mënyrë u prezantuan si të arritura ose si zhvillime pozitive janë edhe atë që ne në të njëjtën kohë, kur të shikohen prej një këndvështrimi tjetër, mund të jenë edhe shqetësuese.

Nëse shikohet aspekti i hetimeve në rastet penale, thënë të drejtën dy vjet e gjysmë mjaftojnë. Nuk janë prokurorët tanë duke e hetuar ekzekutiv të bankave multinacionale me prezencë nëpër krejt botën,

Në shumicën e rasteve janë duke hetuar kriminelë ordinerë, pavarësisht nëse disa prej tyre ndoshta kanë edhe kravata dhe janë të veshur me tesha kat, po pavarësisht kanë krime relativisht të thjeshta. Kështu që dy vite e gjysmë mjaftojnë. Kanë mjaftuar.

Problemi ka qenë më shumë i ndërlidhur me atë se a ka pasur vullnet që të hetohet një rast të caktuar në mënyrën e duhur dhe problemi tjetër ka të bëjë thjesht me atë se a janë të shkathët prokurorët tanë që ta ndërtojnë një rast brenda dy viteve, eventualisht dy vite e gjysmë.

Nuk besoj që këto dy probleme adresohen me rritjen e periudhës së hetimeve, veçanërisht kur e dimë që mos po hyjmë në një territor të rrezikshëm sa i përket cenimit të të drejtave të qytetarëve të cilat mohohen si rezultat i të qenurit nën hetime.

Çështja tjetër që ka të bëjë është rritja shqetësuese e kompetencave të prokurorëve tek masat e fshehta për t'u bërë këto pa vendim të gjykatës. Do të thotë rritja e masave të fshehta që prokurorët guxojnë t'i bëjnë pa vendim të gjykatës. Kjo është një çështje shumë shqetësuese dhe duhet të rishikohet edhe njëherë në kuadër të punës së komisionit.

Çështja tjetër që veç u trajtuar deri diku, po veç po dua që ta theksoj është që suspendimi i zyrtarëve në një vend normal do duhej të ishte akt moral. Do të thotë nuk do të duhej që të

trajtohej as me kod e as me masa disiplinore, por prapë do duhej ndoshta, hapi i dytë të shkohet më lartë dhe të jetë masë disiplinore në kuadër të institucionit ku punon.

Prapë edhe kjo ndoshta nuk do të mjaftonte dhe duhet të bëhet me Kod të Procedurës Penale. Mirëpo, duhet të kemi shumë kujdes. Prapë po them, duke e shikuar nga një këndvështrim tjetër. Duke e pasur parasysh nivelin e Prokurorisë që e kemi. Ndërhyrjet politike që i kemi në prokurori, prej kujtdo qofshin ato, është mirë që të rishikohet kjo.

Tekefundit nëse veç vendoset për suspendim, të shihet mundësia që suspendimi të bëhet në një fazë pak më të vonshme, ku veç shihet qartë që ka ndoshta bazë të mjaftueshme, ndoshta që është quajtur ndonjëherë “konfirmim i aktakuzës” ose diçka e tillë, ku veç po hyjmë në një proces ku po ndërtohet rasti, e jo që në fillim kur inicohet një hetim ose kështu me radhë.

Një çështje tjetër shumë e rëndësishme është gjykimi në mungesë.

Unë besoj dhe e mirëpres përfshirjen në projekt-kod të gjyqimit në mungesë, si ide është shumë e mirë, mirëpo mënyra se si është shndërruar në dispozita lë për të dëshiruar.

Unë vërtet mendoj që duhet të shikohet mundësia që të fuzionohet me projektligjin që është propozuar para do kohe, që ne si komision të arrijmë deri në një version të përkryer që adreson gjykimin në mungesë jo vetëm në dy shtylla, si të themi.

Çështjen e kriminelëve serbë të luftës, të cilët nuk po vijnë të ballafaqohen me drejtësinë.

Po edhe çështjen tjetër që ka të bëjë me krimet e tjera, veçanërisht ato me shumë të pandehur, ku në marrëveshje në mes tyre secili mungon në seancë nga një ditë dhe e pamundëson gjykimin, me shpresën që akuzat e tyre parashkruhen.

Kështu që është mirë që të adresojmë këtë dhe të arrijmë deri në një nivel, ku në njërin anë e trajtojmë si duhet këtë dukuri, po në anën tjetër, i respektojmë të gjitha të drejtat që u takojnë qytetarëve, të cilët i nënshtrohen një gjykimi në mungesë, pasi që e dimë që është një çështje shumë e ndjeshme.

Rrjedhimisht, duke i pasur parasysh këto shqetësime, unë kisha ftuar që edhe në komision, përveç që vijnë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, po e shfrytëzoj këtë rast të ftoj profesionistët e lëmit që të vijnë dhe të marrin pjesë në komision edhe në grupin punues që do të themelohet në Komisionin për Legjislacion dhe të na ndihmojnë në përmirësimin e projekt-kodit që në momentin kur kalon në lexim të dytë, le të jetë një projekt-kod që vërtet është i përkryer dhe që u përket rrethanave me të cilat ballafaqohemi këtu në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, edhe për kulturën tënde!

Po desha të ta sqaroj edhe një herë, që ti s'je kryetar i Grupit Parlamentar dhe nëse autorizohesh, autorizohesh si deputet, jo si kryetar, se kryetarin e ke këtu, e para.

Dhe, e dyta, unë ta kam dhënë fjalën vërtet se kam menduar që ti thua diçka dhe jo të ofendosh, kur të ofendosh, ta marr fjalën, kam të drejtë të ta marr fjalën. Kështu që është hera e fundit që ofendon në kushtet kur unë ta jap fjalën në kundërshtim me Rregulloren.

Fjalën e ka Gani Dreshaj.

GANI DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kam kënaqësinë që e kemi ministrin e Drejtësisë dhe ministrin e Punëve të Brendshme, të cilët i çmoj dhe i respektoj.

Çka po shoh në diskutimet tona në përmbajtje janë të gjitha, në parim jam me paradiskutuesit, të mos ua përmend emrin. Po, nuk ka mundësi që ne ministrin të Drejtësisë t'i drejtohem, e t'ia lëshojmë barrën edhe 20 vjet përpara.

Kodi Penal, se unë nuk jam bash djalë për gjynah, Kodi Penal ka gabime shumë në përmbajtje me Kodin Penal të Bashkimit Evropian.

Mendoj që qëllimi i këtij përmirësimi është gjunjëzimi i deputetëve që kanë gjuajtur gaz. Nuk mund të krahasohet një deputet, se s'ka vdekur fatmirësisht kurrkush, askush s'e ka humbur gishtin, me një njeri që bën një krim banal në rrugë.

Po prapëseprapë s'e kanë ministrat fajin, ministri i Punëve të Brendshme ka ardhur tash, e ministri i Drejtësisë po mendoj që në këtë konstelacion që e kemi s'e di që kishim pasur dikë më të mirë, pa pasur qejf të të ledhatoj ministër.

Gabime të përditshme kemi edhe ne, duhet të përcaktohem a duhet ta kemi Kodin Penal të Bashkimit Evropian apo të gjithë botës.

Ne kemi një Kod Penal të kombinuar, nuk ma merr mendja se gjithmonë janë prokurori dhe gjykatësi fajtorë. Ne i kemi mësuar edhe avokatëve t'u japim lekë nëse e njeh prokurorin.

Ne i kemi mësuar, edhe ne deputetët, po edhe disa parti të tjera kanë mësuar që edhe gazetarët t'i shantazhojnë e t'u japin lekë.

Të mos themi se edhe policia e krimeve të rënda mua janë direkt duke më shantazhuar.

Nëse gruaja ime e di se unë ky që jam, kështu do të mbetem, dhe të më shantazhoj s'mundet askush për jetë, harroni atë punë, ata që po mundohen. Pastaj, nëse e ndërron partinë ose e çel një zyrë pranë një partie tjetër, vinë, edhe aty ke pasoja, të vijnë në kontrollim të firmës.

Të gjithë së bashku, pa e rënduar njëri-tjetrin të mundohemi të bëjmë diçka që do t'u shërbejë gjeneratave edhe pas nesh, se ne përballemi me këto gjëra, të mos i marrim personale asnjëherë.

I nderuar ministër i Punëve të Brendshme,

Kisha pasur dëshirë si mik t'i heqësh policinë rrugore prej autostradës, se po dalin e po na frikojnë, të hiqen dënimet 200 euro, se kush e ka bërë këtë ligj, e ka bërë për të vjedhur policia. Kur dëgjohet që s'janë paratë, 200 euro, thotë paguaje sot, i ke 100, ti po i jep atij 50 dhe përfundon lënda.

Policia rrugore ose Policia e Kosovës nuk ka përgatitje as të përmirësojë një ndeshje në rrugë, nuk ka fshehtë, nuk ka lopatë, edhe po e thirre, nuk vjen të angazhohet. Kam raste konkrete, të cilat i kam denoncuar, po nuk i merr kush parasys.

Unë e di që është mal i madh aty, ku e ke marrë postin, e di që duhet përkrahje e deputetëve, po sa të jesh aty, përdore sakicën kur të mundesh, sa të lënë s'e di, po e ke një detyrë me përgjegjësi, populli dhe policia në rrugë janë të korruptuar, policia e komunikacionit.

Kam katër raste me përgjime, me incizime, që u marrin lekë qytetarëve, fatmirësisht ne e kemi në Dukagjin, atje mund të flitet më shumë që policia rrugore s'është e korruptuar.

Ndoshta mund të flasim pak diçka të mirë edhe kur i afrohet familjes së presidentit. Ne në Dukagjin e kemi dhëndrin e presidentit, po është një ndër shembujt më të mirë të policisë, shef i policisë rrugore që policia nuk marrin lekë.

Ndoshta temës s'ia qëllova, po ky është mendimi im.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministrin nuk po e shoh këtu, desha t'ia bëj dy pyetje lidhur me dispozitën për suspendim, për të cilën kemi debatuar në komision aq gjatë dhe aq shumë, ta pyes se çka i thotë nenit 45 të Kushtetutës dhe nenit 55 të Kushtetutës.

Neni 45, po e lexoj vetëm paragrafin e parë të nenit, nëse ministri nuk e di, shpresoj që ka juristë që ia kanë lexuar së paku Kushtetutën, thotë: "Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e

zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”.

Pra, atë që ministri po kërkon ta bëjë përmes ligjit, që pa vendim gjyqësor të suspendohen, vetëm në nivel të hetimeve apo të akuzës, një herë duhet ta ndërrojë Kushtetutën. Unë jam në parim për dispozitën që e propozon ministri, por jo pa e ndërruar Kushtetutën.

Së pari duhet Kushtetuta ta lejojë një veprim të tillë, pastaj ne mund të votojmë propozimin e ministrisë që përfaqësohet këtu përmes ministrit. Pra, është në kundërshtim me nenin 45, ministër, Të drejtat për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur, dhe nëse ju më thua që një njeri nuk ka të drejtë të zgjidhet as të emërohet, as askund, madje edhe nëse është i punësuar duhet të suspendohet, atëherë duhet së pari të ndërrohet Kushtetua, praktikisht neni 45.

Vazhdojmë me nenin 55 të Kushtetutës.

“Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore”, sepse kjo hyn në kuadër të kufizimit të drejtave. Nëse dikush është në hetime, është në aktakuzë, është në proces gjyqësor dhe ti thua se duhet të suspendohet, pra ti përmes këtij ligji ia kufizon një të drejtë, të cilën atij ia garanton Kushtetuta.

Ja çka thotë neni i Kushtetutës, jo unë.

Këtu shpejt e shpejt i nxora nga Kushtetua, edhe pse i kemi pasur në debat edhe me ministrin, edhe në komision, thotë kështu:

“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj”. Dëgjo tash çka thotë.

“Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi”.

Nuk kam ndonjë argumentim se pse qenka e domosdoshme që përmes këtij ligji të kufizohet një e drejtë e tillë.

Vazhdon pastaj thotë: “Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuar me këtë Kushtetutë nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar”.

Paragrafi 4: “Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t’i kushtojnë kujdes esencës së të drejtave që kufizohet, pra rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.

Paragrafi 5: “Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar, si dhe shpirtin apo frymën e kësaj Kushtetute, prezumimin e pafajësisë”. Pra, shkel mbi këtë dispozitë të Kushtetutës.

Unë, ministër, me dy duar do ta votoj këtë paragraf, sapo ju ta keni ndryshuar Kushtetutën apo të keni propozuar amendamente që e mundësojnë pastaj kalimin e këtij ligji. Në parim jam në dakord, por jo para se të bëjmë amendamentimin dhe ndryshimin e Kushtetutës, sepse konsiderojmë që çdo ligj, në gjuhën popullore thuhet “duhet të ketë një verigë në Kushtetutë ku kapet, ku varet”.

Ky ligj juaj apo kjo dispozitë, të them më shkurt, nuk ka verigë, nuk ke ku e var, nuk e mban asnjë verik propozimin tuaj, ku ju ia leni në dorë jo gjykatës, siç thuhet në Kushtetutë, edhe me ligjet paraprake që kur i humb të drejtat civile, madje të drejtat e njeriut nuk humben edhe pasi të jesh i dënuar, por ke të drejtat civile të cilat mund t’i humbësh sa je i dënuar, vetëm kur t’i të jesh i dënuar me aktgjykim të shkallës së prerë, qoftë deputet, gjykatës, ministër, e ajo që ju po kërkoni ta rregullojmë me ligj në botën perëndimore, ku po synojmë të shkojmë, është e rregulluar duke qenë e vetëkuptueshme.

Pra, partitë politike i largojnë nga radhët e tyre të gjithë ata për të cilët ka hetime, ka aktakuza, janë në proces, sepse zgjedhësit e tyre nuk i votojnë. Pra, dimensionin moral nuk mund ta integrosh në ligj, nuk mund ta luftosh diçka çka nuk arrin përmes mjeteve të tjera, që e thashë dhe që e themi të gjithë, kategoria morale, çka është e pranueshme për një shoqëri, fatkeqësisht është e pranueshme edhe për një parti, çka nuk është e pranueshme për shoqërinë, nuk është e pranueshme as për partinë.

Pra, atë çka s’po arrini ta rregullomë, s’po arrijnë jo vetëm ju, po ne ta rregullojmë me dimensionin moral, nuk mund ta integrojmë dhe ta bëjmë me ligj, sepse pastaj ligji tash ka implikime kushtetuese dhe duhet së pari të ndryshohet Kushtetuta.

Ma thuaj një vend në Bashkimin Evropian, ku kjo çështje është e rregulluar kështu që me ligj sanksionohet suspendimi, i cilitdo, mirëpo parakusht duhet ta kemi një herë Kushtetuta ta lejojë.

Pra, thashë nëse këtu kemi të bëjmë me dëshirën e madhe dhe vullnetin e madh për të luftuar dukurinë e krimit të organizuar dhe korrupsionin, që përfaqësohet edhe në institucione, qoftë nga presidenti, a kryeministri, a ministra, a drejtorë, a gjykatës a deputetë, atëherë kjo është çështje që së pari ta amendamentojmë, edhe një herë po e përsëris, Kushtetutën dhe pastaj të vijmë te ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë para se ta përfundojmë, i jap fjalën ministrit, do t’i kisha lutur deputetët që të mos i përgjithësojmë, qysh u dëgjuan këtu, qenkan kriminelë krejt gjyqtarët, krejt

prokurorët, sepse ata janë vërtet për t'i dënua, njerëzit që bëjnë krime, po ata nuk janë kriminelë. Në qoftë se ka emra të përveçëm që e kanë shkelur ligjin, që e kanë të ndaluar me ligj të punojnë në drejtësi dhe në këtë rast mund ta ketë shkelur ligjin Këshilli Gjyqësor që i pranon ose Këshilli Prokurorial, të diskutojmë dhe të kërkojmë që të shkarkohet njëri që është ngarkuar me detyrë kundërligjshëm. Po të quhen kriminelë nga foltorja e Parlamentit gjyqtarët, të cilët janë në vijë të parë për t'i dënua vërtetë kriminelët, quhen kriminelë prokurorët, të cilët janë në vijë të parë për të ngritur aktakuza kundër krimeve dhe kriminelëve, mendoj që nuk është në rregull për neve si deputetë, kushdo qofshin, edhe neve nëse na ka dënua ndokush ndonjëherë, na ka dënua, nëse s'ia ka ndaluar ligji që të vazhdojë punën, ai është në punën e vet, në detyrën e vet, ne s'kemi çka i bëjmë.

Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Ashtu edhe unë normalisht kisha dëshiruar që ky debat sot të mos shndërrohet në debat për gjyqësorin në Republikën e Kosovës, mirëpo për Kodin e Procedurës Penale, sepse vërtet janë ndryshime rrënjësore, janë ndryshime të mëdha që, në fund të fundit do të ballafaqohemi të gjithë ne si qytetarë.

Ne mendojmë që kemi bërë më të mirën të mundshme, propozimin më të mirë dhe besoj që me grupe punuese do ta plotësojmë.

Çështja e suspendimit, në rast se suspendimi i zyrtarit të shtetit të Kosovës që i ngritet aktakuza është kundërkushtetues, atëherë edhe paraburgimi është kundërkushtetues.

Pra, ne s'po kërkojmë t'i ndërpritet marrëdhënia e punës, mirëpo gjyqtari do të vendosë në rast se zyrtari në fjalë mund ta dëmtojë procesin, i cili është duke u zhvilluar ndaj tij pas ngritjes së aktakuzës, pra, pas fillimit të procesit gjyqësor, atëherë personi në fjalë duhet të suspendohet me vendim të gjyqësorit, jo me vullnet politik.

Shumica, përjashtuar vendet skandinave që s'i kemi hulumtuar, shumica e vendeve në Bashkimin Evropian e kanë sanksionuar këtë çështje.

Nuk ka konventa ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e suspendimit, është çështje e shteteve veç e veç që e rregullon çështjen.

Dhe, në këtë rast, çështja e suspendimit nuk është kundërkushtetues, e kemi konsultuar edhe me ekspertë të Drejtës Kushtetuese dhe nuk është kundërkushtetues. Jemi të bindur në këtë, se e kemi bërë propozimin më të mirë të mundshëm.

Sa i përket gjyqësorit, veç një shifër dua ta jap, meqenëse u fol edhe për këtë.

Në vitin 2017, kur e kam marrë mandatin, Republika e Kosovës i ka pasur 310 gjyqtarë. Sot Republika e Kosovës i ka 428 gjyqtarë dhe janë në regrutim e sipër edhe 28 të tjerë.

Pra, rreth 50% e tyre, të nderuar deputetë, janë më me pak se pesë vjet përvojë pune. Pra, të gjitha këto janë gjenerata të reja, janë njerëz të rinj, të cilët i shërbejnë sistemit të drejtësisë, e që s'kanë të bëjnë as me regjimin e Milosheviqit, as të Titos, të askujt tjetër.

Pra, sot t'i godasësh dhe të hysh në një debat të tillë për gjyqtarë dhe prokurorët, vërtet mendoj që është e pandershme, është e turpshme.

Prandaj, mendoj që kemi një angazhim jashtëzakonisht të madh të këtyre prokurorëve, gjyqtarëve, mirëpo edhe s'ka dyshim që duhet të ngrihen edhe kapacitetet. Jemi në rrugë të mirë, për më pak se dy vjet, janë në regrutim e sipër rreth 162 gjyqtarë të rinj. Pra, mendoj që jemi në rrugë të mirë në ngritjen e kapaciteteve dhe rritjes së efikasitetit në sistemin tonë gjyqësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Ajo që tash tha ministri, është diçka krejt tjetër nga ajo çka ka propozuar. Unë po them që edhe suspendimi është masë jokushtetuese, përderisa e ke të sanksionuar që një e drejtë themelore mund të hiqet vetëm me vendim të veçantë gjyqësor, pra jo me ligj, me automatizëm, por secili rast veç e veç duhet të drejtohet në gjyq, këtë e thotë neni 31, paragrafi 5 i Kushtetutës, të cilin më lejoni ta lexoj, thotë kështu: "Çdo kush, i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet pafajësia e tij, e saj në pajtim me ligjin".

Ajo që ju po kërkoni është që ju anbllok, me një zgjidhje, me një propozim për të gjithë zyrtarët, qofshin ata të dënuar, qofshin në hetime, qofshin në fazë të parë, në fazë të dytë, të suspendohen, ky është dënim, suspendimi është masë ndëshkuese, suspendimi nuk është masë tjetër, pos ndëshkim.

Dhe, ajo që po them unë, jam në parim për këtë, ministër, kupto, po para se ta bëjmë këtë duhet ta ndryshojmë, ta amendamentojmë Kushtetutën që ty pastaj, si ministër, juve, Qeverinë, ministrin ju lejon të bëni propozime të tilla. Nuk mund të miratojmë një ligj, i cili bie në ndesh me këto dispozita të Kushtetutës, ju mund edhe t'i bëni 61 vota, nga 61 i bëni 31 dhe ta kaloni, po kjo çështje pastaj do të shkojë në instanca të tjera, siç është Gjykata Kushtetuese.

Por unë përderisa jam i bindur se ajo është në kundërshtim me Kushtetutën, me një dispozitë të tillë, nuk e votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Po, zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Në asnjë rrethanë nuk qëndron ajo që po e citon, që po e thoni ju, zoti deputet, sepse nuk po kërkojmë që një çështje të tillë ta rregullojmë në bllok, siç e quani ju.

Pra, në secilin rast veç e veç gjykata do të vendosë në rast se do të merret parasysh kërkesa e prokurorit për suspendimin e tij apo jo. Prokurori edhe mund të mos ketë kërkesë fare për suspendimin e personit në fjalë dhe gjykata në këtë rast nuk ka si të marrë vendim, në rast se nuk vjen kërkesa prej tij. Po në secilin rast veç e veç do të vendoset. Kjo i mbetet të vendosë procedurës paraprake, e jo të vendoset në mënyrë kolektive, siç e thua ti, jo të vendoset në bllok, se kjo është e palogjikshme, do të thotë kjo nuk mund të ndodhë.

Dhe, të jeni të bindur, mund ta ballafaqoni edhe në Gjykatën Kushtetuese, pastaj që shpresoj që do të kalojë që kjo nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe nuk ka pse të preket Kushtetuta për këtë çështje. Këtë do ta rregullojmë me ligj. Pra, do të vendoset për secilin rast veç e veç me kërkesën e prokurorit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj ka replikë.

DAUT HARADINAJ: Jo replikë më shumë..

KRYESUESI: Jo, diskutim nuk ka.

DAUT HARADINAJ: Në rast se Kushtetuta e ka përcaktuar, atëherë nuk mundet në secilin rast veç e veç prokurori, se nuk komunikojnë njëra me tjetrën.

Po gjithsesi, meqenëse është në lexim të parë, unë mendoj që ta japim besimin për këtë projektligj dhe të gjitha ato vërejtje ose sugjerime ose amendamente t'i adresojmë në komision ose në grupin punues që do të caktohet dhe të krijohet amendamenti i nevojshëm dhe vjen prapë këtu, në këtë seancë, në lexim të dytë dhe ne i japim përkrahje.

Në anën tjetër, zoti ministër, ju e dini që kemi, për shembull, këtu deputetë, të cilët kanë marrë një dënim, se këtu nuk po specifikohet se në çfarë forme do të sanksionohen personat zyrtarë, e unë nuk pajtohem, për shembull, në rast se këtu bëhet fjalë që secili zyrtar i shtetit, në këtë rast deputetët të cilët kanë hedhur gaz këtu janë sanksionuar me vite. Në anën e kundërt, i njëjti ligj ka qenë në fuqi dhe i njëjti një serb e ka gjuajtur një bombol gazi lotsjellës në market, ku ka pasur edhe fëmijë dhe është dënuar me 300 euro gjobë. Do të thotë, po i njëjti ligj, të njëjtat gjykata.

Kështu që unë mendoj që të shkojmë në dëgjim të parë, të japim besimin, i bëjmë amendamentet dhe kur vijmë këtu, e votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka kuorum për votim.

29. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin

Komisioni Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zoti Ekrem Mustafa, që të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI EKREM MUSTAFA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zëvendëskryeministër Gashi,

Të nderuar ministra,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për letërnjoftime.

Qëllimi themelor i plotësim-ndryshimit të Ligjit për letërnjoftime është njohje e së drejtës së pajisjes me letërnjoftim të bëhet në momentin e lindjes së fëmijëve. Aktualisht me ligjin në fuqi bëhet për të gjithë shtetasit nga moshë 16-vjeçare.

Pra, pajisja me letërnjoftim për fëmijët nën moshën 16-vjeçare, sipas këtij projektligji është çështje e vullnetit, e jo e detyrimit.

E drejtë e pajisjes për letërnjoftim edhe e shtetasve nën moshën 16-vjeçare, pra nga momenti i lindjes mundëson: identifikimin më të lehtë për shtetasit që rrjedhimisht kontribuon në fuqizimin e ruajtjes së sigurisë publike, krijimin e lehtësive për udhëtime jashtë vendit, në shtetet ku letërnjoftimi shërben si dokument për kalimin e kufirit në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore. Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët, pasi që evitohet përdorimi i certifikatave të gjendjes civile për fëmijët, po ashtu me anë të këtij projektligji është bërë harmonizimi i lartësisë së gjobave në Ligjin e ri për kundërvajtje dhe është bërë harmonizimi i përkufizimit të të dhënave biometrike me Rregulloren e Bashkimit Evropian 2/016/679.

Plotësim-ndryshimi i Ligjit për letërnjoftime ndërlidhet me prioritetet e Qeverisë, të parashikuara me programin e punës të Qeverisë 2017-2021, në të cilin plan është paraparë përmirësimi i shërbimeve dhe sigurisë së dokumenteve në Agjencinë e Regjistrimit Civil. Potencoj se ky projektligj ka kaluar në të gjitha fazat e parashikuara në Rregulloren e Punës së Qeverisë, pra

është siguruar deklarata buxhetore nga ministri i Financave dhe deklarata e pajtueshmërisë së legjislacionit të BE-së nga Ministria e Integriteteve Evropiane. Projektligji nuk krijon kosto buxhetore, por rrit të hyrat buxhetore. Andaj, duke e pasur parasysh rëndësinë e këtij projektligji, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin e tij, për t'i hapur rrugë procedimit të mëtutjeshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Fatmir Xhelili, në emër të komisionit ta japë raportin e komisionit dhe arsyetimin për miratimin e këtij ligji. Faleminderit!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat e Kabinetit qeveritar,

Përshëndetje për të nderuarit deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë i ka rekomanduar seancës që të votohen në parim Projektligji nr. 05/L-015 për letërnjoftimin, gjegjësisht plotësim-ndryshimi i këtij ligji, i cili për objektiv kryesor ka përcaktimin e vlefshmërisë së letërnjoftimit në afat prej 10 vjetësh, ashtu siç është edhe vlefshmëria e certifikatës në çift, si dhe mundësia e pajisjes me letërnjoftim për çdo shtetas të Republikës së Kosovës.

Ky projektligj është në harmoni me vendimet për standardet minimale për kartela identifikuese i Bashkimit Evropian me nr. 11092/05 dhe i plotëson standardet e IKAO-s të dokumentit 9303 me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionet përkatëse në fuqi. Më lejoni që edhe në emër të grupit parlamentar të përkrah votimin e këtij ligji në lexim të parë dhe kontributin do ta japim në grupin punues pranë Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare për t'u deklaruar, është paraqitur vetëm zonja Aida Dërguti, në emër të PSD-së, kur të paraqiteni, jua jap fjalën.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Partia Socialdemokrate në parim do ta përkrahë këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim ndërkohë ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën në emër të komisionit.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, nënkryetar! Edhe Aleanca do ta përkrahë këtë projektligj në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues! Ne sigurisht do ta kemi parasysh, ne e përkrahim në parim dhe vërejtjet tona do t'i japim gjatë përpunimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Shala, në emër të Nismës.

HAXHI SHALA: Edhe ne si Nismë në parim e mbështesim këtë ligj dhe e përgëzoj jashtëzakonisht Ministrinë e Punëve të Brendshme për sjelljen e këtij ligji jashtëzakonisht të kompletuar, por njëkohësisht në leximin e dytë ne do ta japim kontributin tonë si parti sa i përket këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, unë, zoti ministër, kam dy fjalë sa u përket dokumenteve të udhëtimit që i prodhoni ju, ose që i prodhon firma, kompania që ka për obligim. Është gjynah çka po ndodh me pasaportat, u fshihet kopertina dhe kanë mbetur veç kopertinat e kuqe.

Nuk e kupton kush, duhet hapur brenda pasaportën, a është e Kosovës, a është e Zvicrës, a e Shqipërisë, a është i ndonjë vendi tjetër. Pra, të gjitha pasaportat e botës në kopertinë kanë ngjyrë speciale që nuk fshihet, kjo është sikur ta kishin bërë fëmijët në shkollë me ato ngjyrat e drurit dhe tri herë ta mbash në xhep, ajo të fshihet. Kështu që është mirë që kompanisë t'i bëhet presion si ministri që këto dokumente të jenë më në rregull dhe ngjyra në kopertina të jetë më e theksuar dhe e pashlyeshme, siç e kanë krejt. Më duket që e kam parë pasaportën e Shqipërisë, nuk ke shans një vijë kund t'ia shohësh të hequr, ndërsa këtu kjo pasaporta jonë është mos pyet. Faleminderit!

Nuk ka të tjerë të paraqitur, zoti ministër, në qoftë se doni fjalën edhe një herë, edhe pse deputetët thanë se jemi dakord me ligjin. Zoti ministër a dëshironi edhe një herë fjalën? Ok!

Konsideroj edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim diskutimet janë shterur, votimin në qoftë se bëhet kuorumi pas pauzës, e bëjmë. Ora është 14:20 deri në 15:30 po shkojmë në pauzë, pastaj vazhdojmë.

* * *

Vazhdim i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Atëherë, ministër, faleminderit që erdhët në kohë, edhe ju deputetë, po vazhdojmë me seancën, pika e 30-të e rendit të ditës:

30. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Komisioni Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Zoti ministër i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ju ftoj ta paraqitni dhe ta arsyetoni projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministria e Drejtësisë në mandatin e saj institucional, krahas hartimit të ligjeve, ka edhe disa komponentë ekzekutive, në mesin e të cilave edhe atë të menaxhimit të Qendrave Korrektuese. Nga përvoja e shumë vendeve, por edhe nga qasja ime politike, e kam kuptuar se menaxhimi i këtyre qendrave kërkon reflektimin e përhershëm në së paku 3 drejtime.

E para, nga perspektiva e rendit dhe sigurisë, e dyta nga perspektiva e menaxhimit efikas, e treta nga perspektiva e të drejtave që në mënyrë të patjetërsueshme u takojnë personave që janë në vuajtje të dënimit. Si pjesë e këtij reflektimi jam angazhuar të avancojmë në përmirësimin e politikave të caktuara të zbatimit të sanksioneve penale, si rezultat i të cilit angazhim sot para jush paraqes për miratim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Janë tre faktorë që na kanë diktuar nevojën për ta rishqyrtuar këtë ligj: e para, kur e kam marrë mandatin e ministrit të Drejtësisë, ndër kërkesat e para që kam pranuar kanë qenë ato të stafit menaxhues të Shërbimit Korrektues të Kosovës, e që ndërlidhen me çështjet organizative brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe kërkesat e të burgosurve në qendrat korrektuese të Republikës së Kosovës, e që kanë të bëjnë me të drejtat e tyre, të cilat me ligjin aktual që është në fuqi u janë mohuar.

Së dyti, realiteti në terren ka ndryshuar edhe në rrafshin e kompetencave të plota të institucioneve vendore në rastin e përfundimit të mandatit të EULEX-it, gjë që kërkon një angazhim dhe përgjegjësi më të madhe të Shërbimit Korrektues të Kosovës. E treta, jam plotësisht i vetëdijshëm, siç besoj jeni edhe ju të gjithë, në një ambient ku bashkëveprojnë rendi dhe siguria, në njërin anë, dhe të drejtat e njeriut, në anën tjetër, nuk është ambient i lehtë për t'u menaxhuar. Prandaj, në agjendën time legjislative ka zënë vend ky projektligj, përmes të cilit jam përpjekur që të ndërtojme një strukturë dhe një konsensus, në mënyrë që këto dy attribute të

përhershme të sistemit korrektues, rendi dhe siguria, në një të anë, dhe të drejtat e njeriut, në anën tjetër, të gjejnë një përputhje që mundëson ko ekzistencën e plotë në mes të tyre. Me këtë projektligj reflektohen nevojat, përgjigjet ndaj sfidave, por edhe forcimi i parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe barazisë para ligjit. Gjatë hartimit të tij jam udhëhequr nga parimet dhe praktikat më të avancuara të standardeve ndërkombëtare që ndërlidhen me të drejtat dhe përgjegjësitë e personave të privuar nga liria, si dhe adresimit të tyre, çështjeve që nuk kanë qenë të mbuluara me dispozitat përkatëse ligjore, e që i referohen ekzekutimit të sanksioneve penale.

Më lejoni që t'i paraqes disa nga aspektet kryesore, të cilat kanë qenë objekt i institucionalizimit dhe i rregullimit përmes këtij projektligji. Me kujdes të veçantë janë rishikuar beneficionet e personave të dënuar dhe janë propozuar beneficionet si më poshtë: të drejtën e zgjeruar në thirrje telefonike, të drejtën e shfrytëzimit për pushim vjetor prej 7 ditës jashtë institucioneve korrektuese nga pushimi vjetor prej 18 ditës, pushimi jashtë institucionit korrektues deri në 7 ditë për çdo vit, pra, për çdo të burgosur. Është propozuar rikonstruktimi dhe funksionalizimi i njësive ekonomike brenda institucioneve korrektuese, si një mundësi për aftësim profesional dhe rehabilitim përmes angazhimit në punë të personave që janë në vuajtje të dënimit. Njësia ekonomike themelohet nga Qeveria, me të cilin përcaktohet statusi i njësisë e cila funksionon dhe e krijon të hyra të dedikuara për nevoja të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Po ashtu, është propozuar themelimi i njësisë për vlerësimin dhe klasifikimin e personave të dënuar. Personat e dënuar do të vendosen në institucionet korrektuese në pajtim me vlerësimin e rrezikut, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e dënimit të shqiptuar, moshën, gjininë, gjendjen shëndetësore dhe veçoritë e tjera karakteristike të të dënuarve.

Janë inkorporuar të gjitha standardet e Këshillit të Evropës për trajtim shëndetësor të të burgosurve, po ashtu i është kushtuar një vëmendje e veçantë çështjes së trajtimit shëndetësor të të burgosurve dhe të drejtat shtesë për këto shërbime. Po ashtu, janë përcaktuar procedurat për ndërrimin e institucionit korrektues dhe procedurat e ankesës, janë paraparë kushtet për fillimin e procedurës, për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit me burg, si dhe procedurat e pranimit të personit të dënuar në institucionet korrektuese. Është paraparë krijimi i mekanizmit për trajtim të ankesave të të burgosurve, në rast të dyshimit të mjekut për ushtrim të dhunës nga zyrtarët korrektues që lidhen me torturën, keqtrajtimin, trajtimin johuman, apo denigrues, i cili të njëjtin e dërgon tek drejtori i institucionit korrektues dhe mekanizmat përkatës kombëtarë për parandalimin e torturës. Është rregulluar çështja e mundësisë së ofrimit të trajtimeve specifike, duke përfshirë edhe arsimimin universitar për personat që janë në vuajtje të dënimit, gjithashtu janë përcaktuar, qartësuar procedurat e rekrutimit të pozitës së drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues, zëvendësrejtoreve, si dhe drejtorëve të institucioneve korrektuese.

Po ashtu, janë paraparë kushtet edhe obligimet e ekzistimit të masës disiplinore të vetmisë dhe detyrimit që personit, të cilit i shqiptohet kjo masë ta vizitojë mjeku ose i deleguari i tij, i cili

përgatit raportet me rekomandime në lidhje me gjendjen e tij shëndetësore, psikologjike e psikiatrike.

Të nderuar deputetë,

Janë edhe disa prej çështjeve që besoj që do t'i ngremë gjatë debatit së bashku me ju, pra i kemi adresuar, siç e thashë, dy çështje: të drejtave të të burgosurve dhe në anën tjetër çështjen e organizimit të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit ftoj zonjën Albulena Haxhiu që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi i 2, të Rregullores së Punës në mbledhjen e mbajtur më 5. 2. 2019, e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L- 140 për ekzekutimin e sanksioneve penale. Sigurisht që si komision e kemi vlerësuar që është projektligj më i avancuar se sa ligji që është në fuqi, megjithatë i kemi adresuar disa çështje, të cilat do të duhej të adresohen: e para, edhe Ministria e Arsimit, por edhe Ministria e Shëndetësisë duhet të kenë rol kyç në këtë çështje, edhe sa i përket shëndetit që duhet ofruar të burgosurve ose atyre që janë në paraburgim, por edhe sa i përket edukimit. Ne jemi dëshmitarë që as Ministria e Arsimit, por as e Shëndetësisë nuk ka bërë diçka në këtë drejtim.

Një çështje që është diskutuar, e që do të doja që ta them edhe këtu në emër të komisionit, ne si komision kemi qenë jo rrallëherë në vizita sa u përket Qendrave Korrektuese, apo qendra të paraburgimit dhe në këto vizitat tona, të burgosurit na i kanë shtruar tri kërkesa, të cilat i kanë pasur ndër vite, pra sa herë i kemi vizituar, këto kërkesa i kanë pasur, e ato janë: nevoja për Ligjin për amnisti, më kujtohet sikur sot, ish-ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, nuk ka pasur javë e muaj që nuk ka premtuar që do ta kenë Ligjin për amnisti dhe, në anën tjetër, çfarë është e rëndësishme që nuk është përfshirë në këtë projektligj, është pakoja e ushqimit. Është mirë që janë përfshirë ditët e pushimit, ndonëse është kërkuar 21 në vit, aktualisht janë 18 me këtë propozim, por pakoja e ushqimit unë mendoj që duhet t'u vihet të burgosurve. Pse? E para, për shkak se ne jemi në dijeni për cilësinë e ushqimit dhe, në këtë kuptim, përveç drekës, mëngjesi dhe darka, nuk janë në nivel të duhur, sa i përket cilësisë. Dhe, sigurisht kur një i burgosur është dënuar me disa vjet burgim, është goxha e padrejtë që të mos i sigurohet, ta zëmë, pakoja e ushqimit.

Ka qenë një pyetje që e kemi parashtruar si komision në këto vizitat tona se kjo pakoja e ushqimit është hequr për shkak të kontrabandës në atë kohë, ne kemi kërkuar sqarime se a e ka ndalur kontrabandën realisht pakoja e ushqimit? Përgjigjja është "jo", sepse për ta ndalë kontrabandën, duhen skanerë, të cilat në vazhdimësi i kanë kërkuar qendrat korrektuese dhe të

paraburgimit, prandaj konsideroj që komisioni duhet të punojë në këtë drejtim, duhet ta përfshijë pakon e ushqimit, përndryshe mendojmë që ne po bëjmë gabim që s'po i përfshijmë disa të drejta që janë të drejta ta zëmë elementare në kohën kur je i paraburgosur apo i burgosur. Prandaj, në fund fare, Komisioni për Legjislacionin i ka rekomanduar Kuvendit që të miratohet në parim ky projektligj, siç e thashë ka avancime, por megjithatë në disa grupe punuese që ne do t'i krijojmë do të duhej të përfshihen disa apo të ndryshohen disa dispozita që janë këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale nuk është hera e parë që kalon në procedurat kuvendore. Domethënë ne e kemi një ligj aktual në fuqi, i cili në bazë edhe të rekomandimeve edhe të monitoruesve, por edhe të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka shfaqur në sipërfaqe nevojat për ndryshim.

E dëgjuam edhe ekspozenë e ministrit, pak a shumë përputhet edhe me kërkesat tona në vazhdimësi, në dy segmente: e para, ka të bëjë me të drejtat dhe liritë që duhet të garantojë shteti edhe për ata të cilët vuajnë dënimin dhe pjesa tjetër që ndërlidhet me stafin e Shërbimit Korrektues në Republikën e Kosovës.

Andaj këto dy mangësi ky ligj duhet t'i ofrojë në përmirësim e sipër të tyre, sepse njerëzit aty janë për të mbajtur dënimin të cilin e kanë të shqiptuar, por ligji duhet të jetë konform praktikave ndërkombëtare të mira, që kur të kthehen në liri, të kenë risocializim adekuat i cili mundëson përmirësimin e tyre dhe kthimin normal në shoqëri, e jo diçka tjetër ashtu siç fatkeqësisht kemi parë deri më tani që njerëzit nga vuajtja e dënimit kalojnë në recidivistë të veprave penale për shkak të trajtimit joadekuat apo mosbashkërendimit të institucioneve të tjera, duke përfshirë edukimin, shëndetësinë e të tjera.

Ky ligj duhet t'i ketë parasysh këto. Pjesa tjetër që ndërlidhet me stafin e shërbimit korrektues në Republikën e Kosovës. Pak a shumë është debatuar edhe së fundi statusi i tyre kur kemi biseduar për Ligjin për pagat, një status i cili nuk është definuar saktësisht dhe mendoj që është koha e mirë që me këtë ligj të ketë avancim, por edhe saktësim të dispozitave ligjore, të harmonizohen dhe besoj që edhe atëherë do të kemi një ligj i cili i kompletton të gjitha këto. Mbi të gjitha, duke eliminuar edhe kërkesat të cilat kanë dalë edhe shoqëria civile, monitoruesit e burgjeve në Republikën e Kosovës.

Grupi parlamentar nëpërmjet deputetëve të vet në këtë komision do të angazhohet në këto dy sfera që të mundësojë përmirësimin e disa normave dhe të jenë konform kërkesave dhe nevojave elementare që çdo shtet demokratik u mundëson qytetarëve të vet që përmes këtij ligji të ketë një

institucion kredibil dhe të respektuar, mbi të gjitha edhe të besueshëm në Republikën e Kosovës.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Elmi Reçica, në emër të GP të PDK-së.

ELMI REÇICA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje zëvendëskryeministër dhe ministër,

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale është një çështje që është shumë me rëndësi dhe është një çështje që do të duhej të ketë vëmendjen jo vetëm të deputetëve por edhe të gjithë qytetarëve.

Ne jemi një sistem që është demokratik dhe duhet ta vlerësojmë në kuadër të atyre kompetencave dhe mundësive që i kemi. Edhe si Qeveri, edhe si deputetë. Në kuadër të kësaj, grupi parlamentar e ka shqyrtuar me vëmendje këtë projektligj dhe pa diskutim, duke i pasur parasysh rrethanat dhe zhvillimet çfarë i kemi ne aktualisht dhe duke i pasur parasysh edhe shumë nga avancimet dhe ndryshimet që kanë ndodhur në kohë, e mbështet plotësisht.

E përgëzoj ministrin Tahiri, i cili i është futur faktikisht për t'i plotësuar dhe ndryshuar këto ligje dhe konform përvojave dhe konform situatave çfarë janë të krijuara aktualisht, t'i begatojmë dhe t'i ndryshojmë.

Ne e dimë që shoqëria jonë, sikur çdo shoqëri tjetër, ka nevojë për burgje dhe ka nevojë që qytetarët të cilët dënohen me aktgjykime të plotfuqishme dhe vuajnë dënimin, qytetarë të cilët janë të paraburgosur, t'i kenë të drejtat e tyre. Në kuadër të kësaj, është shumë e domosdoshme që shoqëria jonë dhe institucionet përkatëse të mendojnë dhe të veprojnë konkretisht se risocializimi është i domosdoshëm për ata qytetarët të cilët ballafaqohen me ligjin dhe pastaj marrin dënime në bazë të vendimeve ose aktgjykimeve dënuese të institucioneve tona gjyqësore.

U përmendën shumë çështje që ne dakordohemi plotësisht, edhe trajtimi njerëzor, edhe edukimi dhe arsimimi i tyre, edhe puna që do të duhej ta kenë ata, në mënyrë që edhe ta mbajnë atë çfarë është shëndet i tyre, por njëkohësisht ta përcjellin zhvillimet që janë jashtë burgjeve dhe jashtë institucioneve, të cilat janë të përcaktuara me ligj.

Është shumë e domosdoshme që të ndahet dhe të bëhet kategorizimi i të burgosurve. Ne e dimë që kemi pasur, e tha edhe zoti Zemaj pak më herët, një pjesë e kemi fatkeqësisht edhe nga përvoja, është shumë e domosdoshme të ndahen dhe të kategorizohen të burgosurit. E dimë shpesh që ka ndodhur që të burgosur që janë dënuar për vepra shumë të lehta penale, pastaj konform asaj që kanë qëndruar nëpër ambiente jo të favorshme, dhe nuk janë ndarë prej tyre,

kanë arritur që jo të bëhen recidivistë, po edhe të bëjnë edhe vepra shumë më të rënda penale. Në kuadër të kësaj është obligim yni si shoqëri që domosdo ta kemi parasysh edhe këtë.

Unë për fund, kisha pasur dëshirë dhe flas edhe në emër të grupit parlamentar siç e thash edhe më herët që domosdo të përshpejtohen sa më shpejt jo vetëm miratimi i këtij ligji. Do të duhej jo sikurse ligjet e tjera, po shumë më tepër sesa ligjet e tjera, të jetë mbikëqyrja e këtij ligji. Edhe nëpërmjet komisionit funksional parlamentar, po edhe përmes institucioneve të tjera. Ne kemi shumë raporte nga organizatat joqeveritare që i kanë monitoruar burgjet dhe kanë dhënë sugjerime shumë konkrete. Në kuadër të kësaj është obligim edhe detyrim i Ministrisë dhe i institucioneve dhe organeve përkatëse që merren me këtë çështje që t'i kenë parasysh ato. Dhe, do të duhej që shumë më shpesh, institucionet që merren me trajtimin dhe mbikëqyrjen e këtij ligji, të jenë atje ku do të duhej vërtet të shihet drejtpërdrejt se çfarë po ndodh me ata të burgosur.

Ka shumë arsye që do të duhej të insistojmë për një ndryshim esencial të trajtimit të burgosurve. Një pjesë e dimë saktësisht se në çfarë gjendje janë dhe një pjesë e dimë saktësisht se si është trajtimi i tyre, por edhe një pjesë dihet saktësisht se çfarë po ndodh me ata pasi që ta vuajnë dënimin e tyre. Po ndodh shpesh po rikthehen si recidivistë dhe po rikthehen edhe një herë po e përsëris me vepra më të rënda penale.

Është obligim që në bazë të këtij ligji, të kenë kompetenca organet e përcaktuara me ligj dhe të jenë të detyruara që vërtet të vlerësohen pastaj. Edhe këtë, duhet të vlerësohen në bazë të punës së e bëjnë dhe në bazë të trajtimit që ua bëjnë të dënuarve dhe në bazë të asaj se çfarë bëjnë ata pasi ta vuajnë dënimin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi, në emër të LVV-së.

SAMI KURTESHI: Faleminderit kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Për shumë arsye, ne e kemi trajtuar këtë projektligj. Ka edhe arsye edhe objektive individuale. E përmendi edhe kolegu pak më parë, disa e kanë edhe personale, e kanë pasur, edhe kemi bërë përpjekje që t'i shfrytëzojmë të gjitha ato përvoja, po edhe njohuritë që i kemi.

Ky është një ligj që mirë është të kalojë. Në emër të GR të Lëvizjes Vetëvendosje, ne e përkrahim këtë ligj. Natyrisht, ne do të kemi edhe vërejtjet tona, sugjerimet gjatë punës para leximit të dytë.

Unë po i ngre dy-tri çështje. Mund të them që e kam shikuar ligjin me shumë kujdes. Edhe tash e kam para vetes. Natyrisht që ka vërejtje, ka edhe një numër të vërejtjeve gjuhësore, teknike, po ka edhe vërejtje përmbajtjesore.

Para së gjithash, meqenëse edhe ministri i Drejtësisë është këtu, po edhe kolegët deputetë, një çështje që e përmendi zoti Zemaj ka të bëjë me pagat e punëtorëve në shërbimin korrektues të Republikës së Kosovës. Ata nuk e kanë të definuar në ligjin për pagat, nuk janë definuar. Ne si grup parlamentar i kemi amendamentet e gatshme dhe mendojmë se është e drejtë dhe legjitime që pozicioni i tyre të saktësohet në Ligjin për pagat dhe unë mendoj se ata nuk bëjnë asnjë punë tjetër që dallon në funksion, të themi edhe në rreziqet, sepse s'ka privilegje aty. Ata janë të barabartë me Policinë e Kosovës, edhe punëtorët e shërbimit korrektues duhet ta kenë të njëjtin nivel, të njëjtin kod të pagave sikurse Policia e Kosovës. Ne mund të flasim për numrin e tyre, a ka shumë a ka pak, a janë punësuar shumë a janë punësuar pak, a ka reduktim a jo. Ajo është një çështje krejt tjetër për të cilën tash nuk do të flasim, po ajo që është me rëndësi, unë mendoj se duhet në Ligjin e pagave të saktësohet pozita e këtyre njerëzve që punojnë në Shërbimin Korrektues të Republikës së Kosovës.

Një çështje tjetër që duhet të ngrihet, ka shumë çështje, po them ka edhe në lidhje me arsimin e njerëzve, në mënyrën e përcaktimit të formave edhe të instituteve kush i lejon edhe kush i ndalon disa gjëra. Por, po dal te pakot, te numri 67, paragrafi 3. Unë e kam lexuar me kujdes dhe e kam parë se është ndarë, e përmendi edhe deputetja Haxhiu në emër të komisionit, megjithatë e kam parë se në kuadër të pakove që u dërgohen nga familja të burgosurve, tash kemi me kategori të burgosur, meqenëse në këto qendrat tona po mbahen nganjëherë edhe të paraburgosurit. Që kjo çështje të rregullohet më mirë se që është tani. Mund ta kuptoj ndalimin e cigareve, po edhe të pijeve mund ta kuptojë, po jo të ushqimeve. Sepse nuk arrihet asnjë qëllim, ose qëllimi parësor për çfarë është vendosur ky sanksion ndaj të burgosurve nuk arrihet me ndalimin e pakove ushqimore. Kjo është dëshmuar nga përvoja, se kontrabanda në të vërtetë në emër të cilës janë ndaluar pakot ushqimore, nuk është ndaluar.

Ka një verifikim ose një kontroll të dyfishtë të pakove ushqimore. Një bëhet me rastin e dorëzimit dhe tjetra bëhet në rastin e pranimit. Ne i kemi parasysh të gjitha faktet, po unë mendoj se këtu duhet të bëhet një lejim i pakove ushqimore. Mund të caktohet një periudhë kohore. Nuk e di sa shpesh tash janë vizitat nga familja, po së paku një herë në muaj ose dy herë në muajt, pako në masë të caktuar 4-5 kilogramë, edhe gjatë festave shtetërore. Se edhe ata janë njerëz megjithatë, që në festa shtetërore, kanë përjetim emocionale, po edhe duan në format e tyre të organizimit, ata duan t'i festojnë, pa marrë parasysh që janë të burgosur, ajo është një çështje krejt tjetër. Atyre ua ka shqiptuar gjykata dënimin, por nuk ua ka hequr të gjitha të drejtat. Edhe për festa, edhe atje festohen, që të lejohen pako më të mëdha. Mirëpo për këtë do të diskutojmë gjatë para leximit të dytë në grupet punuese.

Një çështje tjetër është që duhet të shihet me kujdes shpërblimi për punën e bërë në institucionet korrektuese. Si caktohet vlera e punës së bërë, kush e cakton edhe me cilin ligj. Kjo sigurisht do të diskutohet. Ne nuk kemi arsye që të mos i lidhim të gjitha ligjet në mënyrë organike, sepse ato

janë të lidhura në mënyrë organike, po vlera mandej duhet të caktohet në bazë të kritereve që janë të vendosura edhe nuk mund t'i lëmë të pacaktuar.

Një çështje të cilën dua ta ngre dhe është me rëndësi, nuk është më e rëndësishmja, por megjithatë duhet të kihet parasysh, është neni 99, paragrafi 3, njoftimi për vdekjen e të burgosurve. Nga përvoja po e them se institucionet ndërmjet vete informohen edhe njoftohen për vdekjen e të burgosurve, të paraburgosurve, apo sidoqoftë të arrestuarve. Po ne kemi raste, dhe kjo nuk është e specifikuar këtu, si dhe kush e informon familjen në atë rast, sepse pala e parë përveç institucioneve që e kanë obligim ligjor të këmbëjnë informatat për rastin, gjykata, shërbimi korrektues, edhe shtëpi korrektuese apo institucioni korrektues, personi i parë jashtë institucioneve shtetërore është familja. Ne kemi raste kur ka ngjarë, ka vdekur personi i burgosur ose i paraburgosur edhe familja kurrë nuk është informuar në mënyrë zyrtare. Kjo në mënyrë zyrtare, do të thotë me një dokument ku së paku jepen arsyet fillestare, dyshimet apo çfarëdo qoftë, apo ndonjë konstatim i mjekut, dyshimet mbi vdekjen e personit. Kjo duhet të rregullohet.

Në 250, 260 nene që i kemi këtu, edhe nga memorandumit shpjegues, unë kam parë se janë involvuar shumë institucione në këtë drejtim. Sigurisht, ne do të bëjmë përpjekje si grup parlamentar. Edhe unë po them si grup parlamentar do të bëj përpjekje që unë të jem në grupin punues që punon për këtë ligj. Edhe do të punojmë që ky ligj të jetë në pajtim edhe me normat ndërkombëtare, por përveç normave ndërkombëtare, edhe insistimeve ndërkombëtare, të jetë në të vërtetë në përputhje me ligjet tona edhe me kushtet tona specifike. Se ne nuk mund të flasim për kushte specifike të trajtimit të pakove në shërbimin korrektues sikurse flitet në Gjermani, në Francë, në Zvicër apo në Suedi. Nejsë Suedia po i heq krejt burgjet, sepse kanë arsyet e veta. Po këto do të bëjmë ne përpjekje që t'i rregullojmë. Edhe unë shpresoj shumë se do të bëjmë një ligj, i cili e respekton edhe vendimin e gjykatës për shqiptimin e dënimit, po në anën tjetër edhe e respekton minimumin e asaj që quhet njeri, dinjitetit të njeriut, pa marrë parasysh në cilat rrethana, që është obligim i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, fjalën e ka zoti Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit nënkryetar!

Zëvendëskryeministër, ministër,

Projektligji për ekzekutimin e sanksioneve penale tani është projektligj më i avancuar se ai më parë. Shpresojmë që gjatë leximit të dytë mos të kemi ndonjë zbrazëturë që mund të shkelë ndonjë të drejtë të privuarve nga liria. Kështu që e përkrahim plotësisht projektligjin. Do të punojmë edhe si grup parlamentar, po edhe personalisht si anëtar i Komisionit për legjislacion, edhe ky projektligj të orientohet dhe të marrë drejtimin e duhur pa u ndalur në të drejtën e asaj mundësie për t'i përfshirë krejt mekanizmat e tjerë, që janë të rregulluar me ligje të tjera, në diskutimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina, në emër të PSD-së.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në parim, Partia Socialdemokrate e përkrah Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale. Natyrisht vërejtjet tona që kanë të bëjnë me përmbajtjen e ligjit do të përcillen në grup punues. Ajo çka unë do t'i kërkoja vëmendje komisionit dhe grupit punues, se u përmend këtu shkarazi nga dy parafolësit, është që të rregullohet edhe statusi i shërbimit korrektues të Kosovës.

Këtu u përmend Ligji për pagat, po në fakt nuk ka të bëjë me Ligjin për pagat. Ka të bëjë me Ligjin për zyrtarët publikë. Në Ligjin për zyrtarët publikë, Shërbimit Korrektues i është lënë status i veçantë, që nënkupton se tani detajet duhet të rregullohet në një ligj të veçantë, siç ndodh edhe me shumë institucione të tjera, punonjësit e të cilave kanë status të veçantë. Pra ky Komision dhe besoj se vendi është në këtë ligj, duhet ta detajojmë statusin e punëtorëve të shërbimit korrektues, duke filluar nga procesi i rekrutimit, procesi i gradimit e kështu me radhë. Po ashtu, duke i zërthyer në detaje edhe koeficientet e pagave.

Përndryshe, për pjesën tjetër përmbajtjesore, siç thashë, ne vërejtjet tona i prezantojmë në punën e komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Nismës.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë në emër të Nismës, edhe në cilësinë e anëtarit të komisionit, i jap mbështetje këtij ligji dhe ndërmjet dy leximeve do ta japim kontributin tonë për ta përmirësuar ligjin.

Megjithatë, kisha pasur dëshirë t'i them dy-tri gjëra për të cilat kemi biseduar edhe në Komision, po disa herë edhe me ministrin, rreth disa çështjeve të cilat më shumë janë tradicionale, sesa që mund të çojnë peshë në atë që quhet mbajtja e cilësisë së ushqimit. Kjo sepse të heqësh paketën, është për arsye se nuk mund të kontrollosh, është veprim i gabuar. Mendoj që nuk mund ta ngarkosh një të dënuar, ta ndëshkosh me një paaftësi të institucionit për të marrë masa që ajo të mos keqpërdoret. Pra, në emër të asaj se po keqpërdoret një e drejtë t'u mohohet pastaj të gjithëve, sepse një apo dy po e keqpërdorin, mendoj se është qasje e gabuar. Paketa kush ka qenë në burg e di, edhe unë e di si ish i burgosur ka një rëndësi edhe të lidhjes emocionale me familjen, sepse dërgohen dërgohen gjëra të cilat nuk i gjen as në kantina dhe as në kuzhina të burgut. Pra, më shumë ka të bëjë me mbajtjen e lidhjes edhe kujtimeve me familjen, gjë për të cilat, ne jemi njerëz, ata që janë në burg pa marrë parasysh se për çfarë janë dënuar, ju e dini që të drejtat e njeriut me Kushtetutë i gëzojnë kudo që ata të jenë.

T'u mohohet kjo e drejtë, mendoj që është e padrejtë.

Meqë po e shoh që ministri po merr shënime ta shënojë edhe këtë, sepse disa grupe ose disa deputetë e ngritën këtë çështje. Pra, të mos penalizohen të burgosurit e sjellshëm e mirësjellshëm për shkak të mundësisë për t'iu keqpërdorur një e drejtë.

Gjithsesi, ajo që e tha e zonja Pantina, duhet të rregullohet statusi i punëtorëve që punojnë në institucionet që kanë për detyrë zbatimin e këtij ligji, sepse kam përshtypjen që ky ligj nuk e rregullon përfundimisht. Së paku ky është pozicioni i tyre, që janë të atakuar apo që pretendohet të rregullohet statusi i tyre.

Është mirë që në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e tyre, edhe me komisionin, edhe me ministrinë, të arrijmë ta bëjmë një ligj me të cilin të gjithë do të binim dakord dhe në fazën e ardhshme ta votojmë të gjithë së bashku.

Ka rëndësi shumë, sepse mos të harrojmë që ky ligj trajton një pjesë të shoqërisë që do të na kthehet sërish këtu. Në burgje, gjithmonë dikush jep shkollë. Është mirë që atë shkollë ta japë shteti, sepse nëse shteti nuk është aty. Nuk është prezent për t'ua përcjellë shkollën duhur, ata do të marrin një shkollë të gabuar, dhe kur të kthehen në shoqëri sërish, pas atë vitësh sa e ka paraparë ligji, gjykatat, atëherë të gjithë do të ballafaqohemi me ta dhe është mirë që ata të kthehen të risocializuar.

Sa investojmë ne që ata të risocializohen, po atë do të mund presim rezultate. Nuk mund të presim rezultate më shumë sesa që ne investojmë. Më shumë sesa që ne vetë angazhohemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hajdar Beqa e ka fjalën.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë do t'i them vetëm disa risi që i rregullon shqyrtimi i parë i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

U tha edhe nga kolegët që e diskutuan. Ne e kemi diskutuar shumë edhe në Komision për Legjislacion. Njëra prej risive është krijimi i qendrës për vlerësimin e të burgosurve. Kushtet e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionin e Shërbimit Korrektues.

Procedurat e punësimit të të dënuarve jashtë institucioneve korrektuese. Kompetencat dhe përgjegjësitë të njësisë ekonomike në kuadër të Shërbimit Korrektues. Kompetencat dhe

përgjegjësitë e inspektoratit. Procedurat dhe mënyra e vendosjes së personave të dënuar në institucione korrektuese.

Përkujdesja shëndetësore dhe lirimi i mbikëqyrjes për përkujdesje mjekësore, kur dihet se shpesh ka edhe vështirësi në këtë pjesë. Pranimi i pakove për të dënuarit, por te pakot e rregullon neni 67 i ligjit. Unë mendoj që duhet të shikojmë... Ne e kemi pasur si komisionin vizitë te të burgosurit dhe ka qenë kërkesë, mund të them e të gjithë atyre që kemi takuar t'ju lejohet edhe ushqimi derisa të rritet cilësia e ushqimit në burg nga shteti.

Unë mendoj që ka vend për një ushqim më cilësor dhe mendoj që duhet të lejohen pakot, por duhet të shikojmë që normal të ndalet kontrabanda, të ketë kontrole të tjera në këtë, po megjithatë do ta jap kontributin si anëtar i komisionit, në këtë rast ndërmjet dy leximeve.

E përgëzoj ministrin e Drejtësisë, respektivisht ministrinë për punën e mirë që e ka bërë me sjelljen e këtij ligji në tërësi, ngase ndryshimet e shpeshta po shkaktojnë probleme në zbatim dhe në aspektin praktik është shumë funksionale kjo mënyrë e punës, pra është më funksionale se sa të sjellët pjesë-pjesë. Pra, mendoj që e ka rregulluar mirë.

Ne përkrahim në parim në këtë rast dhe e thashë edhe më herët që do ta japim kontributin tonë, edhe siç tha edhe zoti Reçica edhe si grup parlamentar, por edhe si Komision për Legjislacion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar i Parlamentit!
Është kryetar se më shpesh se Kadriu po i udhëheq seancat.

Dy gjëra desha t'i them. Së pari e përgëzoj ministrin, që tash këtu jemi domethënë në një autostradë me ministrin e Drejtësisë, i cili e ka sjellë këtë ligj.

Ne duhet të tregohemi shumë human ndaj njerëzve të cilët në çfarëdo situatë ose në çfarëdo rrotullimi ose veprë penale i dënon shteti.

Në qoftë se një njëri ma vret një njëri të familjes, unë personalisht nuk kisha pasur dëshirë dy herë të dënuar atë njëri, edhe në burg edhe me qenë i dënuar nga ligji. Mbi bazën e kësaj në foltoren e Parlamentit ka muaj që kam kërkuar të hiqen sanksionet e vendosura nga e UNMIK-ut dhe EULEX-it, sepse kurrkund në botë nuk ka ndëshkim kolektiv ndaj të burgosurve, përpos që ka ndodhur në Kosovë.

Unë, zoti ministër, kam qenë përkthyes, përpos gazetar në Skandinavi dhe kam përkthyer nëpër burgje. Për të burgosur. Atje ka kontrabandë që e kanë sigurinë më të lartë, traditën më të lartë të shtetit, por nuk ndëshkohen të gjithë të burgosurit që dikush e fut një telefon, tash t'u ndalen paketat.

Kështu që për këtë do të luftojmë dhe do të llobojmë fuqishëm si deputetë në mënyrë që të burgosurit t'i gëzojnë të drejtat. Pra, të burgosurit të kenë televizor. Të kenë mundësi që të shikojnë programe televizive. Dhe, mbi të gjitha që të respektojmë edhe jetën private të njerëzve që janë të martuar ose të martuar që gjatë vizitave të kenë edhe një dhomë të posaçme që të rrinë me të dashurit e tyre, qoftë gruan, qoftë dashnoren e ku ta di unë.

Kam diçka për t'i thënë kryetarit të grupit tim parlamentar zotit Bilall Sherifi, i cili ka qenë i burgosur politik. Ky ka vuajtur në burgjet e Titos, po pa vuajtur në burg të Atifet Jahjagës dhe të Hashim Thaçit s'mund ta dish se çfarë është burgju.

Kështu që mbi bazën e kësaj, le ta dijë Bilalli që edhe në atë kohën e Titos kur na kanë dënuar na i kanë lejuar paketat. Na e kanë sjellë ushqimin familjarët tanë.

Veç UNMIK-u dhe EULEX-i, se bëra pa shaka se as Atifetja, dhe as presidenti Thaçi nuk e kanë sjellë këtë vendim, por megjithatë ministër e ke mbështetjen tonë të fuqishme që t'i trajtosh në mënyrë humane njerëzit e dënuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha të ndërlihem për faktin se nëpër burgje kanë ndryshuar në aspektin pozitiv kushtet edhe për të burgosurit edhe për qëndrimin në burg do të thosha.

Para disa kohësh ata i kanë marrë edhe rrobat nga shtëpia, domethënë dyshekun ose "postakinë" që i thoshim, me vete që të rrinë në burg. Por, kjo koha e sotme është një çështje krejt tjetër, mendoj unë.

Ne e kemi në Kosovë një sistem dhe ligj modern, por nuk e aplikojmë në kushtet e sotme, sepse në burgje dihet që kontrabandë të madhe dhe ka kontrabandë droge dhe ka njerëz që pasurohen nëpërmjet kësaj kontrabande në burgje.

Është krejtësisht normale që shqyrtimi ose ndalimi i paketave që mund të jetë bërë, është bërë për shkak të këtij fenomeni që është në burgje.

Çështja tjetër është, gjithmonë nga burgjet ose në burgje janë kontrabanduar gjëra të cilat ia kanë mundësuar të burgosurve të që arratisen. Edhe kjo është një çështje nëpërmjet së cilës, ndoshta edhe vet ata që e kanë menduar ligjin dhe që e kanë menduar vendimin, e kanë parë se kanë hyrë sharra speciale nëpërmjet ushqimeve.

Unë besoj që çdo i burgosur që ka qenë në burg është përpjekur dhe ka menduar çdo ditë sesi të ikë nga burgju. Si të dilet jashtë. Se kjo është detyra e të burgosurve.

Tani kemi dy gjëra, fenomenin e të burgosurit të dhunshëm ku është dashur edhe bukën ta merrte me vete, sepse sikur t'i mos i dërgohej bukë s'ka pasur bukë për ngrënë. Dhe e kemi fenomenin tjetër që ata që kanë qenë nëpër burgje e dinë më mirë, por ka pasur paketa dhe kryesisht paketat kanë qenë në burgjet e vendeve të varfra të cilat nuk kanë mundësi të mjaftueshme, s'kanë vitamina të mjaftueshme dhe ua çojnë prej shtëpisë.

Në Evropë, po ju them sinqerisht, unë kam parë dhe kam qenë edhe vetë ndonjëherë; para po, lekë, që të blesh çfarë të duash nëpërmjet kujdestarisë. Këtë ke mundur ta bësh njëherë në javë, por të futet paketë me pite e me flija, e me gurabija, nuk ka në Evropë. Pra, nuk mund që në burgjet e Evropës të fusë dikush gurabija asnjëherë.

Unë nuk e di pse. Ja ku është edhe ministri, po unë po diskutoj asgjë tjetër më shumë se ato që i kam përjetuar vet. Mua nuk më janë lejuar që as cigaret të më sillen në burg, as në Itali dhe as në Gjermani. Në ato dy vende kam qenë edhe kam qëndruar në burg dhe e di si janë rregullat aty. Nuk të lejojnë.

Prandaj, unë s'po them t'ua kufizojmë të drejtat të burgosurve. Unë nuk po dua që të flas as për votat e të burgosurve se janë diku tre mijë ose katër mijë vota dhe nganjëherë kur flasim ne shikojmë, a thua a na votojnë të burgosurit, apo jo.

Problemi është që në burgje ka njerëz të mirë që kanë rastisur, kanë hyrë në çështje të caktuar, ua ka thyer në rezë dikush, por ka edhe të burgosur që janë kriminelë të regjuri të cilët janë të rrezikshëm në qoftë se dalin jashtë.

Tani, në shpinë të atyre që janë të rrezikshëm duhet të vihet rend dhe rregull për të gjithë të tjerët. Mendoj se sistemet e reja, tash elektronike për mbikëqyrjen e futjes së gjërave, e futjes së njerëzve, domethënë janë këto që donim t'i sillnim në Kuvend dhe patëm marrë një vendim këtu dhe s'e kemi sjellë kurrë aparatën për incizim të thellë, nuk e kemi sjellë as këtu.

Vendosni aparataturat speciale që të mos mund të hyjnë as gardianët e burgut pa qenë të fotografuar krejtësisht në trup dhe pa i fotografuar edhe ushqimet fort mirë në skaner, atëherë në rregull le t'i lejojnë. Përndryshe, na duhet të bëjmë edhe kontrolle më shumë. Nevojiten edhe përforcime, pra të ketë gardianë më shumë.

Tjetra, cilat janë të drejtat e të burgosurve? A kanë të drejtë ata që të shkollohen? Mendoj që nuk mjafton sot për të burgosurit, veçanërisht për të rinjtë, t'ju themi eja t'ua mësojmë ABC-në se nuk e dini mirë ose eja se po ua japim klasën e tetë.

Në qoftë se ka të rinj të cilët janë të gatshëm që të studiojnë, t'u mundësohen studimet në universitet. T'ju mundësohet që të marrin zanate të mira dhe të dërgohen profesorë të cilët i edukojnë dhe i shkollojnë ose më mirë të themi me gjuhën e atyre që janë në burgje i socializojnë.

Kjo është detyra e shtetit, t'i socializojë ata që janë të inkriminuar dhe ata që janë të dënuar. T'i përgatisë për jetë normale kur të dalin nga burgju. E nëse është pyetje vetëm t'ju dërgohet pite, në rregull. Si të doni, ligji është ligj, vendosni t'ju dërgohet pite dhe të dalin ata dhe prapë të luajnë nëpër kazino, prapë të bëjnë gjëra ose të vrasin njerëz nëpër kazino është keq. Ministër, e ke fjalën.

Nuk ta kam përmendur emrin dhe nuk kam kurrfarë pune me ty. Rrini aty!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar, kryesues!

KRYESUESI: Pata diskutim dhe nuk bëra replikë me juve.

MINISTRI ABELART TAHIRI: Të nderuar deputetë,

Sa i përket pakos, kërkoj që ta shihni nenin 67 të këtij ligji për pranimin e pakove. Pakot nuk janë larguar. Po flasim për çështjet ushqimore. Për ushqimin, cigaret e të tjera.

Ju po flisni në tërë për pakon. Pako përfshinë edhe çështje të tjera dhe jo vetëm ushqim. Ndërsa sot, të burgosurit e kanë mundësinë, pra i kanë kantinat dhe ato mjete të cilat i shpenzojnë familjarët e tyre për t'u blerë çfarëdo ushqimi, ata e kanë mundësinë që t'i blejnë nëpër kantinat të cilat sigurohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Çështja e SHKK-së, e Shërbimit Korrektues të Kosovës është në agjendën time legjislative që të rregullohet me ligj të veçantë gjatë vitit 2019. Pra, është e papranueshme që gjatë tërë këtyre viteve, 20 vite pas lufte, pra nuk e kemi rregulluar me një ligj të veçantë çështjen e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Mund ta imagjinoni e zgjedhim drejtorin e një qendre korrektuese, qoftë Burgu i Sigurisë së Lartë, qoftë Burgut të Dubravës, qoftë cilësdo dhe aty i jepet mundësia që të konkurrojë kujt të dëshirojë, secili nga jashtë.

Pra, ne nuk i kemi dhënë një prioritet Shërbimit Korrektues të Kosovës, oficerëve korrektues që në radhë të parë ata ta kenë përparësinë që të jenë drejtues të atyre qendrave, sepse e kanë edhe profesionalizmin edhe përvojën, dhe jo të vijnë nga jashtë.

Me përjashtim të drejtorit të përgjithshëm të tjerët... Ne duhet ta ndryshojmë dhe jemi në ndryshim e sipër të këtij sistemi që t'ju jepet mundësia oficerëve korrektues që të zgjedhën drejtorë të këtyre qendrave.

Sa u përket çështjeve që kanë të bëjnë me ditët e pushimit, gjithsej i bie që t'i kenë 21 ditë pushim brenda vitit. Ato janë 18 ditë pushim për ata që punojnë në tërësi. Brenda 18 ditëve të pushimit, 7 mund t'i shfrytëzojnë jashtë qendrave korrektuese.

Ndërsa ligji përveç atyre 7 ditëve ua garanton edhe 7 ditë të tjera pushim, që i bie 14 dhe i kanë edhe 7 të jashtëzakonshme e që janë 21 ditë brenda vitit, ku maksimumi një i burgosur mund t'i kalojë jashtë qendrave korrektuese.

Privimi prej kësaj të drejte me ligjin aktual i ka demoralizuar ata të burgosur dhe në anën tjetër s'kanë pasur kurrfarë motivi që të punojnë. Pse të punojnë, kur prej atyre 18 ditëve nuk kanë mundur që ta shfrytëzojnë asnjë ditë jashtë.

Pra, pikërisht është kjo e drejtë që po propozojmë tua kthejmë ne sot, që ata të jenë të angazhuar në punë në mënyrë që prej 18 ditëve pushim që ua siguron edhe Ligji i Punës atyre që punojnë brenda viti, 7 t'i kenë jashtë qendrave korrektuese të Kosovës ose pranë familjeve të tyre.

Unë mendoj që kemi arritur që t'i adresojmë shumë problematika dhe të drejta të të burgosurve. Ndërsa, Ligji për Shërbimin Korrektues, i cili do të vijë në Kuvend brenda këtij viti do ta sqarojë qartë statusin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, njëkohësisht kemi themeluar një grup punues së bashku me Ministrinë e Financave dhe jemi duke e bërë vlerësimin dhe kategorizimin për punën e pagave që u ngrit për Shërbimin Korrektues, në mënyrë që të nivelohen me Policinë e Republikës së Kosovës.

Faleminderit në parim për përkrahjen dhe do të angazhohemi bashkërisht që edhe në grupet punuese, Ministria e Drejtësisë së bashku me juve ta japim maksimumin që ta nxjerrim një ligj që vërtetë edhe i siguron, garanton të drejtat e të burgosurve, por në anën tjetër edhe e rrit efikasitetin e Shërbimit Korrektues të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk po të marr vesh asgjë. Faleminderit, ministër! Kalojmë në pikën:

31. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Diasporën

Nuk ka replikë. E ka përfunduar ministri. Zoti ministër, e ke fjalën. S'ka pas ministrit replikë. Kështu e thotë Rregullorja.

MINISTRI DARDAN GASHI: I nderuar kryesues!

Të nderuari deputetë,
Të nderuar kolegë ministra,

KRYESUESI: Vazhdo ministër, vazhdoni ju lutem!

MINISTRI DARDAN GASHI: A ta lexoj unë këtë dhe pastaj vazhdoni ju.

KRYESUESI: S'ka replikë, Bilall. Më kë e ke replikën? S'ka replikë. Sicili që flet, ju dëshironi të bëni replikë me të? A ta ka përmendur dikush emrin? A ta ka përmendur emrin? Rri bre burrë! Rrini edhe ju aty!

MINISTRI DARDAN GASHI: Të dalim në Diasporë njëherë, Bilall!

Me Projektligjin për Diasporën synojmë që të përmirësojmë më tutje aktivitetet tona që konsistojnë në ruajtjen e kultivimit të identitetit kombëtar...

Jemi në pikë tjetër. Jemi në pikë tjetër tash.

KRYESUESI: Shiko, tri herë ke folur. Tri herë ke folur për këtë ligj. S'do të flasësh më. S'do të flasësh. E ke thënë fjalën si kryetare e komisionit.

MINISTRI DARDAN GASHI: Nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në mësimin plotësues. Organizimin sa më të mirë të mësimin të gjuhës dhe kulturës kombëtare për fëmijët në Diasporë.

Bilall, kryesuesi e vendos këtë punë.

BILALL SHERIFI: Ngadalë, çdo deputet ka të drejtë që përpos emrit edhe kur t'i referohet fjalëve të tij ka të drejtë replike. Shikoje nenin 40. Kadri Veseli, kryetari e interpreton kështu, ndërsa ju e interpretoni ndryshe.

KRYESUESI: Ministër, e ke fjalën. Bërtit sa të duash. Vazhdo ministër! Unë jam kryetari tani. Unë jam kryetar! Në këtë moment unë jam. Pesë herë ke diskutuar, Bilall.

MINISTRI DARDAN GASHI: Në rregull, edhe një herë, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra të Qeverisë,

Me Projektligjin për Diasporën synojmë që t'i përmirësojmë më tutje aktivitetet tona që konsistojnë në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar dhe kulturor të pjesëtarëve të Diasporës, forcimin e lidhjeve të tyre me Kosovës, nxitjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në mësimin plotësues, organizimin sa më të mirë të mësimin të gjuhës dhe kulturës kombëtare për

fëmijët nga Diaspora, promovimin dhe nxitjen e investimeve. krijimin e lehtësirave për investime, si dhe përmirësimin e pozitës së Diasporës, në përgjithësi.

Një theks i veçantë me këtë projektligj i është kushtuar definimit të statusit dhe rolit të qendrave kulturore që do t'i themelojmë me qëllim të organizimit më të mirë të diasporës, si dhe organizimit të aktiviteteve në promovimin e mundësive për pjesëtarët e diasporës.

Projektligji është përgatitur në bashkëpunim me të gjitha institucionet përkatëse dhe i është nënshtruar një konsultimi publik, përfshirë konsultimet me vet pjesëtarët e diasporës, me qëllim të pasurimit sa më të mirë të nevojave dhe interesave të pjesëtarëve të diasporës.

Pjesë aktive e këtyre konsultimeve kanë qenë edhe të gjitha grupet parlamentare, respektivisht komisioni përkatës. Bashkërisht kemi vizatuar 10 shtete dhe 20 qytete ku koncentrohet diaspora jonë. Besoj se si i tillë, projektligji i ka përfshirë të gjitha idetë e grupeve të interesit.

Nëse kanë mbetur ide të pa përfshira në këtë projektligj, pra mes dy lexime do të kemi mundësi që të përfshihen të gjitha idetë dhe kërkesat me synim që ligji si i tillë të mos jetë i politizuar dhe t'i përfshijë interesat e të gjitha grupeve të interesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Paraprakisht, para se të hyjmë në diskutime dua t'ju them që neni 40 i Rregullores përcakton: Komisioni FunkSIONAL, së pari e ka fjalën ministri i Drejtësisë ose ministri në fjalë, cildo qoftë. Së dyti, fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL, në këtë rast për Legjislacion e kishte.

Së treti, kryetarët e grupeve parlamentare, deputetët, së katërti sipas radhës dhe përmbillet pika e rendit të ditës me fjalën e përfundimtare që e ka ministri.

Unë e di që për burg të gjithë dimë, sepse shumica këtu kemi qenë ndopak në burg. Pra, dimë të gjithë ndopak. Kështu që të mos e problatizojmë, ngase duam t'i kryejmë këto pika të rendit të ditës. Ky është problemi. Ne duhet të bëjmë punë.

Në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Komisioni FunkSIONAL, Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, bazuar në nenin 56.2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2019 e shqyrtoi në parim Projektligjin numër 06/L-148 për Diasporën dhe vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë që të miratohet në parim projektligji në fjalë.

Andaj, i ftoj edhe grupet e tjera parlamentare dhe deputetët që ta votojnë këtë projektligj.

KRYESUESI: Grupet parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zonja Doruntinë Maloku.

DORUNTINË MALOKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Bashkatdhetarë tanë në Diasporë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës konsideron se mërgata e Kosovës ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm në botë, në të gjitha etapat e historisë moderne të Kosovës.

Bashkatdhetarët tanë në Diasporë janë kontribuuesit më të mëdhenj të lirisë, pavarësisë dhe shtetndërtimit të vendit tonë.

Duke vlerësuar këtë rol tepër të rëndësishëm shumëdimensional, Lidhja Demokratike e Kosovës beson se një ligj i ri për Diasporën do të duhej të ishte një urë e pathyeshme lidhëse ndërmjet shtetit të Kosovës dhe bashkatdhetarëve tanë kudo ku jetojnë në botë.

Në këtë kuadër, ne besojmë se ruajtja e identitetit kombëtar, pra ruajtja e gjuhës, kulturës dhe e traditave tona është obligimi kryesor që kanë institucionet e Kosovës karshi Diasporës.

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë të gjithë mekanizmat, në mënyrë që të përfshijë pa asnjë përjashtim në programet e saj të mësimi të gjuhës shqipe të gjithë fëmijët shqiptarë kudo ku jetojnë, dhe ky duhet të jetë mision i vazhdueshëm i qeverive tona.

Si çështje e dytë me rëndësi për Diasporën është që ata të mund të marrin pjesë në zgjedhjet në Kosovë.

Kuvendi do të duhej sa më parë ta ndryshojë Ligjin për zgjedhjet, në mënyrë që bashkatdhetarëve tanë t'u krijohen lehtësira në votim dhe të mundësohet shfrytëzimi i të drejtës së tyre për të votuar nëpër përfaqësitë diplomatike të Kosovës nëpër botë, ashtu siç e kanë të rregulluar shumica e vendeve të zhvilluara.

Asnjë shteti ku ka shqiptarë nuk duhet t'i mungojë të paktën një qendër kulturore. Pra, ligji duhet ta specifikojë nevojën e të pasurit qendra kulturore në secilin shtet dhe statusi i këtyre qendrave të rregullohet me hollësi, në mënyrë që ato të shërbejnë si për ruajtjen e identitetit kombëtar, ashtu si dhe adresë për lidhjen ndërmjet Kosovës, pra institucioneve me intelektualët tanë në Diasporë, të cilët janë të shumtë, por që zëri i tyre nuk dëgjohet asnjëherë.

Institucionet e Kosovës duhet t'ua mundësojnë këtyre profesionistëve nga Diaspora që të vijnë në Kosovë, qoftë edhe nëpërmjet programeve të ndryshme të shkëmbimit, që të sjellin njohuri të tyre këtu, pse jo edhe të angazhohen direkt në institucionet qendrore apo lokale.

Përtej angazhimit të drejtpërdrejtë, intelektualët në Diasporë apo edhe biznesmenët do të mund të krijojnë ura të bashkëpunimit afatgjatë ndërmjet vendeve ku ata jetojnë dhe Kosovës.

Angazhimi i Diasporës në fushën e zhvillimit ekonomik është esencial për Kosovën. Qeveria duhet të mendojë që përtej Ligjit për Diasporën, t'i riorientojë remitencat që sjell Diaspora, që vitin e kaluar kapnin shifrën e 700 milionë eurove.

Programe të detajuara të Qeverisë duhet të konsistojnë në një plan afatgjatë të investimeve të bashkatdhetarëve tanë në Kosovë dhe kështu ky proces do të ishte fitimprurës për të dyja palët, edhe për bashkatdhetarët tanë me potencial investiv, por edhe për shtetin e Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi fatin që kemi një numër shumë të madh të mërgimtarëve tanë nëpër botë që kanë potencial të jashtëzakonshëm intelektual, ekonomik, kulturor dhe sportiv.

Qeveria e Kosovës duhet ta orientojë në mënyrë të duhur këtë potencial dhe ta angazhojë dhe ta promovojë Diasporën tonë në çdo aspekt.

Si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të angazhohet maksimalisht që ndërmjet dy leximeve të projektligjit të hartojë amendamentet konform kërkesave dhe nevojave të Diasporës sonë, në mënyrë që ata ta ndjejnë dorën e shtetit të Kosovës, i cili do të duhej që mundin e mërgimtarëve të bërë me dekada t'ua kthejë nëpërmjet angazhimit dhe promovimit të interesave të tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Evgjeni Thaçi.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës të paraqes mendimin lidhur me Projektligjin për Diasporën.

Në radhë të parë dua të shpreh mirënjohje për ministrin dhe gjithë stafin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për bashkëpunimin me Kuvendin dhe komisionin përkatës gjatë gjithë kohës sa është përgatitur dhe draftuar projektligji.

Paraprakisht janë mbajtur konsultime publike me pjesëtarët e Diasporës sonë. Kemi mbajtur mbledhje në komision, ku është diskutuar gjerë e gjatë lidhur me çështjet kryesore që duhet të përfshihen në ligjin e ri dhe ajo që është, duhet theksuar me shumë kënaqësi, që ky është një ndër projektligjet të radha, ku të gjithë deputetët, pa dallim partie, janë angazhuar dhe kanë diskutuar në mënyrë shumë konstruktive, në mënyrë që Diaspora jonë të gjejë mbrojtje dhe përkujdesje ligjore nga ana e shtetit të Kosovës.

Siç e tha edhe ministri, objektivat kryesor të këtij projektligji janë ruajtja dhe kultivimi i identitetit kombëtar dhe kulturor të pjesëtarëve të Diasporës, forcimi i lidhjeve të tyre me Kosovën, promovimi dhe nxitja e investimeve të Diasporës, duke përfshirë investimet strategjike, krijimi i lehtësirave për investime të Diasporës si dhe përmirësimi i pozitës së Diasporës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Siç mund të jeni në dijeni, ligji aktual apo Ligji në fuqi për Diasporën dhe mërgatën ka hasur në shumë vështirësi në zbatueshmërinë e tij.

Ato pak qendra kulturore, të cilat u hapën në disa shtete, nuk mundën ta kryejnë funksionin e tyre për shkaqe të ndryshme, sidomos për shkak të mos definimit të statusit ligjor të tyre dhe si pasojë i kësaj funksioni i tyre u pezullua.

Me projektligjin e ri të Diasporës, statusi i qendrave kulturore për Diasporën rregullohet në atë mënyrë që me pëlqimin e shtetit pritës, ato veprojnë në kuadër të misionit diplomatik të Republikës së Kosovës dhe do të udhëhiqen nga një drejtor me gradën diplomatike të atasheut të Republikës së Kosovës për Diasporë.

Këto qendra kulturore, sipas këtij projektligji, themelohen në vendet me interes për Diasporën dhe Republikën e Kosovës, e ne mendojmë se qendra të tilla duhet të hapen në çdo shtet ku Kosova ka përfaqësim diplomatik dhe ka Diasporë, ndërsa në shtetet ku Diaspora jonë është në numër më të madh, për shembull, si në Gjermani, Zvicër e të tjera, numri i këtyre qendrave duhet të jetë më shumë se një, pra të hapen qendra kulturore duke iu përshtatur nevojave të Diasporës sonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Mësimi plotësues në gjuhën shqipe dhe gjuhëve të tjera zyrtare në Kosovë për pjesëtarët e Diasporës, fatkeqësisht është në nivelin më të ulët të zhvillimit, e kjo jo për shkak të vullnetit të mësuesve dhe nxënësve, po për shkaqe financiare e logjistike.

Sipas informacioneve që kemi, Ministria e Diasporës ka bërë përpjekje për bashkëpunim me vendet pritëse.

Në disa shtete është arritur të sigurohet përkrahja institucionale e plotë, ndërsa në disa shtete të tjera ka përkrahje të pjesshme.

Mënyra e financimit të personelit arsimor në Diasporë ndryshon varësisht nga rregullimi ligjor i brendshëm në shtetet pritëse, për shembull, duke referuar gjithmonë informacioneve që kemi, në Zvicër mësimdhënësit paguhen nga vetëfinancimi i prindërve, në formë të pagesës mujore. Në Gjermani kjo çështje rregullohet në mënyra të ndryshme, varësisht nga republikat. Në Austri dhe Suedi mësimi plotësues është plotësisht i integruar në sistemin arsimor dhe financohet nga buxheti i shtetit pritës.

Me projektligjin e ri bëhet përpjekje që të ndihmohet krijimi i kushteve për ruajtjen dhe mësimin e gjuhëve amtare të Diasporës. Mirëpo, prapë nuk i jepet zgjidhje problemit të financimit të mësimin plotësues, në rastet kur shteti pritës nuk e ka të integruar në sistemin e vet arsimor.

Të nderuar kolegë deputetë,

Pjesë e rëndësishme e projektligjit është edhe kapitulli për tërheqjen e investimeve dhe përfshirjen e Diasporës në zhvillimin ekonomik. E kjo synohet të bëhet përmes krijimit të mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet rrjeteve të shoqatave të bizneseve të Diasporës me Republikën e Kosovës dhe bizneseve në Kosovë.

Nga ana tjetër, ministria obligohet të hartojë dhe të zbatojë projekte zhvillimore për orientim të remitencave të pjesëtarëve të Diasporës në investime nëpërmjet promovimit të mundësive investive në Kosovë si dhe nëpërmjet programeve të veçanta mbështetëse.

Sigurisht që komunikimi mediatic është pjesë shumë e rëndësishme e krijimit të mbajtjes dhe vajtjes së lidhjeve të Diasporës në vendin tonë. Ne edhe gjatë monitorimit të Ligjit aktual për Diasporën kemi konstatuar se dispozita ligjore që parasheh mbulimin e aktiviteteve të Diasporës në normën 6 dhe 9% nuk është zbatuar.

Me projektligjin e ri ky problem parashihet të eliminohet përmes nenit 16.2, sipas të cilit RTK-ja obligohet të hapë kanal televiziv për Diasporën.

Kjo edhe pse në Komision Parlamentar, në fazën kur projektligji po draftohej, të gjithë anëtarët e komisionit i kemi rekomanduar ministrisë se një gjë e tillë nuk është në të mirë të Diasporës tonë dhe kemi rekomanduar që, në vend që të hapet një kanal i ri, në fakt, në kuadër të RTK-së të parashihet një program i veçantë për Diasporën.

Pra, sa i përket kësaj çështjeje, projektligji duhet të jetë në pajtim me ligjet në fuqi, pra ligjet e tjera në fuqi, të bëhet harmonizimi edhe me Projektligjin për transmetuesin publik, të cilin sot nuk mund ta kalojmë dhe të merren parasysh të gjitha pasojat që do të mund të sillen hapja e një kanali të ri.

Këto ishin vetëm disa nga çështjet e trajtuara në projektligj dhe disa nga vërejtjet tona.

Grupi Parlamentar i PDK-së do ta përkrahë projektligjin në fjalë në parim, por sigurisht që vërejtjet tona do t'i paraqesim në mes të dy leximeve.

Ndërkohë, unë u bëj thirrje gjithë deputetëve dhe të gjithë të interesuarve në Kosovë e në Diasporë t'i paraqesin sugjerimet, vërejtjet, rekomandimet e tyre në Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike deri në fund të afatit ligjor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Fitore Pacolli, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë që jeni jashtë Republikës së Kosovës,
Sidomos sot është në interesin e shqiptarëve që jetojnë jashtë shtetit të Kosovës që diskutojmë për këtë projektligj.

Është e vërteta që tha ministri se është tentua të bëhet një bashkëpunim edhe me Komisionin për Punë të Jashtme, Diasporë si dhe me Diasporën në shtete të ndryshme. Mirëpo këtu ka disa probleme.

Në fakt, ky ministër dhe ministria e tij kanë organizuar takime me Diasporën në shumë qytete të shteteve evropiane, po fatkeqësisht organizimi ka qenë shumë i keq.

Nuk ka pasur informim të Diasporës, pra, diskutimet kanë qenë për Diasporën, pa Diasporën. Kanë dështuar shumë diskutime publike, ka dështua diskutimi publik në Londër, në Vjenë, në Parisë e në shumë qytete të tjera. Paramendoni, shkojmë në Parisë, qytetarët nuk janë të informuar dhe ne hyjmë në një diskutim që është rezervuar për diskutim për investime strategjike, jo për Projektligjin për Diasporën.

Prandaj, të gjithë ato shpenzime që kanë shkuar nga kjo ministri, kanë shkua kot, se Diaspora nuk është informuar.

Po ashtu, përveç se nuk janë informuar saktë, ne kemi bërë çmos që të ftojmë sa më shumë pjesëtarë të Diasporës që të marrin pjesë në këto takime dhe ata qytetarë nga Diaspora, të cilët kanë marrë pjesë në këto takime, kërkesat e tyre nuk janë marrë parasysh.

Pra, ky projektligj ashtu siç është prezantuar në takimet në Diasporë nuk ka ndryshuar aspak sa i përket asaj nga ato rekomandime që i kemi marrë ne në Diasporë. Pra, shpenzime të buxhetit, por asnjë kërkesë e Diasporës nuk është marrë parasysh.

Një ndër arsyt kryesore pse kjo ministri ka sjellë në Kuvend këtë projektligj, thotë ndryshimin e statusit të qendrave kulturore. Çështje tjera nuk kanë ndryshua shumë.

Sa i përket kërkesës së parë, themelore, nga Diaspora e cila kërkon që shteti i Kosovës të marrë përsipër financimin dhe organizimin e mësimit të gjuhës shqipe.

Ky projektligj nuk dallon aspak nga ligji në fuqi. Pra, Diaspora mbetet prapë pa mundësi për të pasur hapësirë dhe shkolla ku mësohet gjuha shqipe, pa mësues të mjaftueshëm dhe të trajnuar mirë edhe kur kalon ky projektligj.

Ngase kjo ministri nuk ka bërë asnjë ndryshim sa i përket ligjit në fuqi. Ministria nuk ka marrë parasysh as kërkesat e deputetë të Komisionit për Punë të Jashtme.

Ne kemi kërkuar që ministri ta specifikojë, se shteti obligohet të sigurojë financimin e mësimit të gjuhës shqipe në të gjitha shtetet ku ka shqiptarë dhe ku nuk mundësohet mësimi nga shteti pritës.

Ky projektligj nuk ka ndryshuar aspak.

Neni 7, pika 1.3 dhe 1.4. përdor fjalën “nxit mësimin në gjuhën shqipe dhe organizon mësimin plotësues”. Pra, kjo nuk është që obligohet ministria ose obligohen ndonjëra prej ministrisë, por thotë “nxit dhe organizon”.

Neni 12, i cili flet për përkrahjen e mësimit të gjuhës shqipe. Pika 1, thotë: “Ministria e Diasporës e ndihmon krijimin e kushteve për mësimin e gjuhës shqipe”, pra e “ndihmon”.

Sa u përket neneve, të cilat janë në ligjin aktual rreth mësimit të gjuhës shqipe dhe në këtë projektligj nuk ka ndryshuar asgjë thelbësore.

Pra, edhe në praktikë nuk mund të ndryshojë asgjë, nëse nuk merren parasysh rekomandimet tona, të cilat do t’i paraqesim në leximin e dytë.

Çështje tjetër të cilën e kanë ngritur po thuaj se të gjithë pjesëmarrësit në takimet në Diasporë ka qenë përfaqësimi i tyre në Kuvend, përfaqësimi i tyre politik në Kosovë dhe mundësia për pjesëmarrje në zgjedhje, por asnjëra nga këto nuk është përfshirë në këtë projektligj.

Një gjë e mirë që ka ndodhur është se Komisioni për Legjislacion ka ndërmarrë iniciativën për ndryshimin dhe përmirësimin e Ligjit për zgjedhje, në mënyrë që shtetasit e Kosovës jashtë shtetit të kenë mundësi të marrin pjesë në zgjedhje duke votuar direkt në ambasada dhe konsullata.

Dhe, unë po ua përcjell deputetëve të këtij Kuvendi se kur të vijnë këto ndryshme është mirë t'i votojmë, sepse janë kërkesa direkt nga Diaspora e Kosovës.

Arsyeja të cilën e përmenda edhe fillimisht pse ky ministër e ka sjellë në Kuvend këtë projektligj janë qendrat kulturore.

Qendrat kulturore janë diskutuar mjaft edhe në takimet që i kemi pasur me Diasporë, por edhe në tryeza këtu në Kosovë. Në asnjë vend në Diasporë dhe asnjë takim në tryeza nga organizatat joqeveritare dhe nga njohës të kësaj fushe nuk janë përkrahur qendrat kulturore, modeli të cilin e ka prezantuar kjo ministri.

Ministri ka marrë vendim që të mbyllë qendrat kulturore funksionale me arsyetimin se nuk kanë funksionuar, por kjo ministri nuk ka bërë asnjë hulumtim pse kanë dështuar këto qendra.

Ministria mendon se modeli i qendrave kulturore, të cilat i ka prezantuar në këtë projektligj, është modeli më i mirë, por edhe për këtë fatkeqësisht nuk ka studim se ku bazohet kjo ministri se ky do të jetë modeli që funksionon.

Ministria nuk është e sigurt se ky është një model i duhur për Kosovën dhe qendrat kulturore të Kosovës në Diasporë.

Dhe në shumë takime zyrtare të kësaj ministrie kanë thënë: “Ani de, po e provojmë si model”. Unë mendoj se ne nuk kemi kohë që të provojmë modele, për të cilat nuk ka studime dhe analiza paraprake dhe nuk kemi as buxhet që të shpenzojmë kod që të provojmë modele të cilat nuk funksionojnë qysh në start. Pa një analizë të saktë, sepse ka dështuar modeli i parë i qendrave kulturore dhe vështirë se mund të përzgjedhim një model funksional për hapjen e qendrave të reja kulturore.

Pastaj, kërkesa e Diasporës dhe organizatave shqiptare në Diasporë janë kërkesa e tyre janë se qendrat kulturore shtetërore të mos politizohen dhe të mos futen nën kontrollin e partive politike.

Këtë pikërisht po tenton ta bëjë kjo ministri, përmes caktimit të një atasheu kulturor si drejtor të qendrave kulturore, do të thotë kontrollimi direkt i qendrave kulturore dhe kryesorja rehatimi i militantëve në këto pozita, njëjtë sikurse janë rehatuar nëpër misione diplomatike.

Përveç drejtorit të këtij atasheu, këtij drejtori do t'i duhej një asistent, një shofer, një veturë, e pastaj edhe staf tjetër mbështetës.

E buxheti i drejtorit për këtë qendër kulturore është 100 mijë euro. 100 mijë euro nuk do të mjaftojnë të mbulohen shpenzimet elementare cilësdrejt qendrës kulturore, e as mbështetjes së stafit që do t'i duhet këtij drejtori.

Unë propozoj që qendrat kulturore të mos përfshihen fare në këtë projektligj përderisa ministria ka model që na siguron se do të funksionojë.

Instituti Demokratik i Kosovës ka bërë një studim për qendrat kulturore dhe ka prezantuar modelet më të mira të qendrave kulturore që kanë shtetet me Diasporën dhe të cilat e kanë Diasporën më të organizuar në botë.

Prej këtyre modeleve, modeli i Ministrisë së Diasporës është shumë larg të qenit model, i cili mund të funksionojë për rrethanat aktuale shteti i Kosovës dhe Diasporës që kemi.

Po ashtu ministria gjatë diskutimeve ka thënë që qendrat kulturore do të jenë të përbashkëta me Shqipërinë, që është shumë e mirë, por do të ishte mirë sikur Kosova dhe Shqipëria të bëhen bashkë, së pari të dalin me një model funksional dhe pastaj të ecin tutje jo me një model që është në interes të rehatimit të militantëve partiakë.

Në Komision të Punëve të Jashtme të gjithë jemi koordinuar dhe kemi caktuar deputetë, të cilët do të jenë pjesë të grupeve specifike punuese.

E në grupin punues për qendrat kulturore ne do të ftojme deputetë nga Republika e Shqipërisë, organizatat qeveritare, përfaqësues të Diasporës që bashkërisht të dalim me një model funksional për Kosovën dhe Shqipërinë, pra me një model funksional për qendrat kulturore.

Ky model që ka sjellë ky ministër për qendrat kulturore është për t'i futur në kontroll qendrat kulturore dhe për t'i rehatuar militantët e tij.

Çështje tjetër ka qenë Kartoni e gjelbër. Në secilën komunikatë të ministrisë që ka publikuar ministria pas takimeve, thuhet se janë diskutuar çështje të ndryshme, përfshirë edhe Kartonin e gjelbër.

Në këtë projektligj të cilin e ka sjellë ministria nuk gjendet askund asnjë paragraf për Kartonin e gjelbër dhe nuk e di ministrit nëse ia kanë përcjellë të gjitha ato që janë diskutuar nëpër takime zyrtare të tij, e sidomos diskutimi në Zvicër, Bernë e Gjenevë.

Në këtë projektligj nuk përmendet Kartoni i gjelbër dhe, çka është më qesharake dhe që tregon mendësinë e ministrive tonë kur sjellin ligje këtu në Kuvend se si punojnë ato. Në draftin e parë të këtij projektligji ka qenë një fjali: “Shtojë edhe Kartonin e gjelbër, vetëm le të jetë aty”. Pra, kjo tregon se ka aty propozime, të cilat janë futur në ligj vetëm për të qenë aty sa për sy e faqe dhe asnjëra nuk janë në interes që kjo Qeveri të ofrojë ndonjë zgjidhje për to.

Pra, ne do ta përkrahim në parim, por ne do të punojmë shumë që të bëjmë ndryshimet e nevojshme në këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër ose zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra të tjerë,

Kolegë deputetë,

Unë fillimisht dua t’ju falënderoj për bashkëpunimin që e kemi pasur gjatë procesit të amendamentimit të këtij projektligji dhe dëgjimeve publike, sepse në një farë forme, na ke mundësuar dhe i ke minimizuar shpenzimet, sepse nëse ne nuk do t’i kishim organizuar së bashku këto dëgjime publike, ishte dashur të investojë Kuvendi dhe komisioni pa tjetër ishte dashur të shpenzohet ekstra, në mënyrë që ne si komision të realizonim disa dëgjime publike me pjesëtarët e Diasporës.

Po këtu e kam një vërejtje, sepse ne disa nuk e kemi kuptuar çka janë dëgjimet publike dhe që këto dëgjime publike duhet mbajtur me grupet e interesit dhe keni gabuar, zoti ministër, bashkë me stafin tuaj, sepse nuk na keni mbledhur diku nga 1 000 veta në mënyrë që ne të shpalosnim programet politike dhe të bënim politikë, ashtu siç jemi munduar të bëjmë politikë, në mënyrë që edhe ato dëgjime publike të prishen, duke dashur të thuhet se “asgjë s’është e mirë, as ky ligj nuk është i mirë, se Qeveria nuk po punon mirë, se Ministria e Diasporës s’po bën mirë”. Normalisht që edhe për Kartonin e gjelbër ju kemi thënë që po plaçkiten e kështu, edhe pse e kemi ditur dhe e dimë se e kemi pasur një debat në Parlamentin e Kosovës, ku kemi debatuar për Kartonin e gjelbër dhe kemi thënë që është mirë të hiqet, po mundësitë nuk kanë qenë dhe e dinë krejt deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Diaspora jonë është e mrekullueshme dhe sado që bën Qeveria e Kosovës dhe ministria juaj, është e pamjaftueshme në krahasim se çka ka bërë Diaspora për Kosovën dhe kjo është më e

pakta që po bëjmë me një ligj, po megjithatë, më mirë me një ligj dhe të mundohemi ta trajtojmë Diasporën tonë, se sa të mos bëhet asgjë.

Është mirë që është lidhur një memorandum bashkëpunimi në mes të dy ministrive, Ministrisë së Diasporës së Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës së Shqipërisë, në mënyrë që bashkërisht të investohet edhe për mësimin në gjuhën shqipe, por edhe të investohet për qendrat kulturore.

Qëllimi i projektligjit është rregullimi i marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të Diasporës. Ruajtja dhe kultivimi i identitetit kombëtar dhe kulturor, promovimi dhe nxitja e investimeve kapitale, krijimin e lidhjeve dhe rrjeteve të bashkëpunimit në mes të Diasporës, si në ekonomi, shkencë, kulturë, sport, bashkëpunim juridik, shëndetësi dhe fusha të tjera, përcaktimi i statusit të pjesëtarëve të Diasporës, përcaktimi i statusit të qendrave kulturore dhe arsimimi në gjuhën shqipe.

Gjatë këtyre vizitave që kemi pasur, kemi parë që një pjesë e Diasporës sonë është mjaftë e integruar, sikurse në Suedi, sot kemi pasur një grup të nxënësve shqiptarë të Suedisë, bashkë me arsimtarët e tyre e kanë vizitua Kuvendin e Kosovës dhe ne kemi parë se atje gjuha shqipe mbahet, është lëndë zgjedhore, marrin nota, poentohen dhe kjo është një e mirë.

Po ashtu një situatë të tillë e kemi pasur edhe në disa qendra, po është shqetësuese, sepse në disa qendra nuk mbahet mësimi në gjuhën shqipe apo nuk është e rregulluar me ligj.

Andaj, është mirë që edhe Qeveria, edhe ministria të kontaktojnë për marrëdhënie bilaterale me shumë shtete të tjera, në mënyrë që gjuha shqipe të jetë lëndë zgjedhore, që edhe arsimtarët në Diasporë të paguhen nga buxheti i atyre shteteve, siç është e rregulluar në shumë shtete.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka përkrahur projektligjin dhe kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve.

Andaj, unë ftoj që të gjithë deputetët ta votojnë, sepse ky projektligj është i rëndësisë së veçantë dhe mendoj që Diaspora është e veçantë për të gjithë deputetët pa dallim partie politike.

Dhe unë kisha dashur që atë ditë që votohet ligji, ta ketë përkrahjen e të gjitha subjekteve politike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu, në emër të PSD-së.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të dashur qytetarë,
Diasporë e Kosovës,

PSD-ja ka shqyrtuar këtë projektligj, duke marrë parasysh rëndësinë që ka, sepse kemi të bëjmë me një kategori shumë të rëndësishme, apo me një pjesë më të rëndësishme më të mirë të shoqërisë apo popullit tonë, po njëkohësisht mund të them edhe me pjesën më të përvuajtur të popullit tonë.

Mund të themi që ky ligj ka shumë gjëra të mira që janë përfshirë, që mund të ndikojnë në jetën dhe mirëqenien e mërgatës tonë, qoftë këtu në Kosovë, qoftë jashtë Kosovës. Natyrisht që vetëm ky projektligj nuk mund t'i zgjidhë çështjet apo t'i plotësojë nevojat që ka mërgata, sepse shumë çështje sikurse të pjesa tjetër e popullatës që është në Kosovë nuk mund t'i zgjidhë vetëm Ministria e Diasporës, por këtu sigurisht mund të ndikojë pozitivisht edhe Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe shumë ministri të tjera që lidhen me zhvillimin ekonomik të vendit.

Ligje kemi, por nëse nuk implementohen apo nuk zbatohen, nuk mund ta ndryshojmë gjendje, deri më tash ka qenë shumë keq për Diasporën, për njerëzit që jetojnë jashtë dhe që kanë pasur vullnet të mirë të investojnë në Kosovë.

Por deri tash nuk kemi pasur ndonjë klimë të favorshme investive për mërgatën tonë, nuk ka pasur lehtësira në nisje apo inicime të bizneseve, qoftë për leje, për shembull, për ndërtimin e objekteve afariste, apo qoftë edhe për lëndën e parë që është bazë për fillimin e një biznesi të ri në Kosovë.

Gjithashtu nuk ka pasur edhe siguri për investitorë të huaj e shqiptarë që janë jashtë vendit, sepse shumë thjesht, mërgata jonë ka qenë gjithmonë e gatshme të kontribuojë, por ata lehtë po pyesin pse ne t'i sjellim paratë tona t'i investojmë në Kosovë, kur si Qeveri paratë e Trustit Pensional, paratë e privatizimit me normë të interesit shumë të ulët, madje nuk di a mbërrin 1%, janë dërguar jashtë vendit, ndërkaq ne kërkojmë që ata t'i sjellin paratë e tyre në Kosovë.

Pra, këtu shihet qartë se nuk ekziston një besim në qeveritë tona nga mërgata dhe ky mirëbesim jo që është tani, por është krijuar dhe është rritur vazhdimisht që nga paslufta, për arsye se asnjëherë nuk kemi dëshmuar se ne mund t'ua garantojmë investimin e tyre apo kapitalin e tyre që ata donë të ndërmarrin në Kosovë.

Ne duhet të krijojmë mbështetje për projektet e tyre zhvillimore inovative që mund të kenë impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik tregtar të Kosovës, mund të krijojmë lehtësira për kthimin e kuadrove, njerëzve që kanë kryer shkollime të mira atje e që ka nevojë Kosova, e jo të vijnë, të bëjnë përpjekje dhe për shkak të barrierave nëpër konkurse, të kthehen përsëri mbrapa, sepse konsideroj se një pjesë bukur e mirë e mërgatës kanë kryer shkollime mjaft të forta, mjaft të mira atje që sigurisht janë deficitare në vendin tonë.

Unë po them, për shembull, mërgata sot çon në Kosovë gati 1 miliard remitencë dhe komplet 1 miliard remitencë ne nuk dimë të menaxhojmë me këtë para dhe ajo çka ndodh, komplet 1-miliardshi sikurse që vjen në Kosovë, përsëri në mungesë të prodhimit vendor, të industrisë ushqimore, komplet shkon përsëri jashtë vendit, kryesisht në Serbi për importin e produkteve ushqimore dhe bujqësore në përgjithësi, e kjo është normalisht një dëm i madh ekonomik, sepse 1 miliard është thujse se sa gjysma e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Paramendojeni po të kishte një Qeveri e mirëbesimit dhe sikur mërgata me kapitalin që ka kursyer dhe që i kanë lënë nëpër bankat perëndimore, për shkak të mungesës së besimit t'i sjellin paratë në Kosovë, po t'i merrim ne ato të holla dhe të krijojmë një Qeveri të mirëbesimit, ku do t'ju garantojmë se kapitali i tyre nuk do të humbë, paramendojeni çfarë kapitali do të ishte i krijuar, ku do të mund ta krijojmë një fond zhvillimor, me cilën mandej këto mjete ne do t'ua shitnim qytetarëve të Republikës së Kosovës me norma të interesit 3-4%, përderisa ne tash paguajmë norma shumë të larta të interesit prej 6 deri në 10%.

Pra, janë edhe një varg çështjesh të tjera teknike, të cilat ndikojnë direkt në jetën e Diasporës sonë. Për shembull, u përmend taksa, e cila që sa vjet diskutohet dhe nuk largohet. Pra, kjo është me të vërtetë një vjelje e mërgimtarëve, sepse në momentin që hyjnë në kufi, mërgimtari nuk pyetet fare për asgjë tjetër, së pari duhet të paguajë taksën e Kartonit të gjelbër dhe në qoftë se i thua ti unë s'kam pra as sigurim për fëmijë, jo thotë, sigurimin për fëmijë e ke të Zvicrës, Gjermanisë apo të Austrisë, ndërkaq për veturë nuk vlen, duhet paguar taksën, përndryshe nuk mund të hysh në Kosovë.

Dhe, kjo është një vjelje goxha e madhe, sipas statistikave janë diku rreth 8 milionë euro në vit, që ne ua marrim mërgimtarëve vetëm në momentin që hyjnë në Kosovë. Pastaj, janë rritja e shërbimeve apo ofrimi i shërbimeve të shpejta për marrjen e dokumenteve personale të mërgatës tonë, qoftë në Kosovë kur vijnë në pushimet e tyre, qoftë jashtë vendit, nëpër ambasada dhe konsullata, të cilët shpesh për shkak të vonësive ata i humbin pushimet përderisa të pajisen me dokumentet e nevojshme për të udhëtuar për Kosovë.

Dhe, një dukuri tjetër apo një kërkesë tjetër që shpesh mërgimtarët tanë diskutojnë në Kosovë, është rregullimi i infrastrukturës së duhur rrugore. Ju e keni vërejtur se mërgimtarët tanë natyrisht punojnë shumë dhe kur të vijnë kënde, vijnë me një veturë e cila pak a shumë nuk është edhe e lirë dhe në momentin që hyjnë në Kosovë has nëpër gropa, nëpër barriera që krijohen pa kurrfarë paralajmërimi në rrugë dhe ju mendojeni se sa mund t'i kushtojë një mërgimtari tonë në qoftë se ai e shkatërron një gomë, ose e prish, për shembull, komplet rrotën për shkak se nuk ka asnjë sinjalizim të duhur në rrugë që me kohë të paralajmërohet mërgimtari ynë në Kosovë, që të ketë kujdes sepse është barriera në rrugë, apo kujdes se janë punimet në rrugë, por dëmet që u shkaktohen këtyre nga mungesa e sinjalizimeve të duhura në infrastrukturën rrugore janë goxha të mëdha.

Pra, në përgjithësi të gjitha këto që i përmenda më lart, PSD-ja do ta japë kontributin e vet në mes të dy leximeve dhe duke e pasur parasysh thjesht kontributin e mërgatës para luftës, gjatë luftës dhe pas luftës dhe duke e parë parasysh potencialin që e kanë edhe investiv, por edhe kadrovik e intelektual, ne jemi që në parim ky projektligj të votohet dhe natyrisht që do të kontribuojmë në mes të dy leximeve që t'i japim këto vërejtje që unë sapo i potencova më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Sa i përket Ligjit për Diasporën, unë mendoj që ka një keqkuptim fatal këtu, a po rregullojmë ligj që t'i hapim perspektivë dhe mundësinë Diasporës të na ndihmojë neve, apo ne t'i ndihmojmë Diasporës. Diaspora s'ka nevojë për neve, ne kemi nevojë për Diasporën, dhe nëse nuk ndërrojmë perspektiva, konceptin, qasjen, atëherë jam shumë i sigurt që do të vijmë te ajo që e kam thënë para një viti në këtë sallë, po e përsëris këtu, sidomos atyre, të cilët e kanë në dorë për të rregulluar këtë çështje.

Ose ne do t'i presim ata këtu për të ndihmuar zhvillimin ekonomik të këtij vendi, për të hapur vende pune këtu, përmes kapitalit të tyre, dijes, ose ata do të na i presin fëmijët tanë atje për t'ua gjetur ndonjë vend pune dhe për të vazhduar për t'u shtuar numri i komunitetit të Diasporës shqiptare në përgjithësi, dhe pse jo, edhe asaj të Kosovës, në veçanti. Kam përshtypjen që nuk jemi duke e marrë seriozisht gjendjen, jemi duke vazhduar ta trajtojmë Diasporën si diçka, si një trup, si një tërësi që veç e ka për detyrë të dërgojë para dhe asgjë tjetër. Mendoj që është gabim dhe duhet të fillojmë të reflektojmë, nëse nuk duam pastaj të vijmë këtu në seanca të vajtojmë se po na zbrazet Kosova.

Diaspora jonë, njerëzit tanë atje, mërgata ka shkuar në rrethana të ndryshme, në faza të ndryshme dhe kanë pasur arsye të veçanta secila periudhë. Kemi ardhur në përfundim që tanimë nuk ekzistojnë arsyet për braktisje të vendit, të Kosovës, atëherë le ta trajtojmë Diasporën si një aset kryesor, si një mundësi nga më kryesoret për të ndihmuar zhvillimin e vendit tonë. Ne mund të vazhdojmë të sillemi kështu sikur gjithçka është në rregull, duke e bërë një ligj, pra të hapim ca zyra atje, ca zyra këtu, pak më shumë burokratë atje, pak më pak burokratë në një vend tjetër, por ajo nuk është rruga e duhur përmes së cilës do të mund të sillnim, do të mund të nxisnim kthimin e atyre që kanë mundësi të investojnë dhe të ndihmojnë në ndezjen e motorit të zhvillimit ekonomik të këtij vendi.

Deri më tani nuk e kemi bërë, shpresoj që gjatë dy leximeve do të mund, së bashku me ministrinë, ministrin dhe aktorët e tjerë, të bëjmë ndryshimet e nevojshme që ligji t'u përshtatet rrethanave të sotme, ligji t'u japë përgjigje edhe këtyre çështjeve. E përmendi kolegu Salihu hyrjen në vendin tonë në Kosovë dhe ku u kërkohet të regjistrojnë veturat, por jo edhe jetën e tyre, fëmijët e tyre, pra një absurd i llojit të vet, pra urgjent pengesat që u vihen atyre për të

ardhur në vend duhet të eliminohen, në mënyrë që të hapen rrugët dhe të mos shihen si dy pjesë, Kosova dhe Diaspora, por të shihen si një pjesë e ndarë në dy vende, ku veprojnë në kohë të njëjtë, por në kushte krejt të ndryshme.

Unë në emër të Nismës i jap përkrahje në lexim të parë këtij ligji, me shpresën që së bashku do të arrijmë t'i integrojmë të gjitha vërejtjet që u dhanë këtu dhe që mund të jepen në dëgjime publike, në grupet punuese dhe në mes të dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Veçanërisht ju në mërgatë, është mirë që ky projektligj vjen në Kuvendin e Republikës së Kosovës, edhe nuk ka nevojë të theksohet vlerësimi që të gjithë ne duhet dhënë gjithë asaj që Diaspora jonë ka bërë për Kosovën dhe për shqiptarët në tërësi, besoj që ka ardhur koha që edhe ne, në njëfarë mënyre të kthejmë të mirën me të mirë.

U përmendën këtu që vërtet ka pasur takime anembanë botës me Diasporën tonë edhe nga Komisioni për Punë të Jashtme, por edhe nga ministria përkatëse dhe, thënë të drejtën, kam pritur pak më shumë se një skelet të çështjeve që i përkasin Diasporës. Natyrisht që ka edhe shumë çështje të tjera që ndoshta ishte dashur të inkorporoheshin, po s'po dua t'i përsëris, sepse disa nga parafolësit veç i theksuan, prandaj dua ta fokusoj diskutimin tim në 2-3 çështje që ndoshta mundet edhe ministri të na ndihmojë që ta kuptojmë pak më mirë ligjin.

Qëllimi. Unë mendoj që qëllimi i një ligji të tillë duhet të jetë njëfarë lloj mbështetje e simbiozës mes Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj që jetojnë jashtë, ndoshta mund të na tregojë sa mendon se është arritur ky qëllim, do të thotë që t'i fuzionojmë këto dy botë që nganjëherë duken se funksionojnë ndaras, por në fakt nuk janë, sepse të gjithë kemi lidhje qoftë nëse jetojmë jashtë në Kosovë, qoftë ne që jetojmë në Kosovë me familjarët, miqtë që i kemi jashtë.

Çështja tjetër që kisha dashur ndoshta të marr përgjigje është çështja e kostos buxhetore, se e pashë që po planifikohen diku 8,5 milionë të jenë implikimet, po implikimet shtesë nga Ministria e Financës duket se janë 2,7 milionë kosto. Tash në projektligj nuk e pashë që ka ndonjë hierarki të investimeve, ndonjë planifikim strategjik se ku do të investohet më së pari, cilat shtete do të jenë ato që do të përfitojnë, gjithashtu flitet edhe për çështjen e ndërtimit të databazave të ndryshme, mbledhjes së informatave që të gjitha në vete ngërthejnë goxha shumë përpjekje, qoftë në aspektin e IT-së, por edhe në kontekst të burimeve njerëzore që janë të nevojshme.

E ndoshta ministri pak mund të na shpjegojë në atë drejtim. Njëkohësisht nëse mund të flasë pak për afatet kohore, pra sa i përket qoftë hapjen e qendrave kulturore në Diasporë, e kështu me radhë. Kështu që ideja është të na shpjegohet pak më mirë që të kuptojmë edhe projektligjin që të

na jepet edhe mundësia të kontribuojmë pastaj në mes të dy leximeve për të plotësuar nëse ka diku hapësirë për të ndihmuar, duke e pasur parasysh që është një temë që shumë prej nesh e konsiderojnë afër vetes, veçanërisht duke pasur parasysh që një pjesë e jona edhe kanë kaluar një pjesë të jetës në Diasporë.

Edhe përfundimisht kisha thënë që është mirë dhe rekomandim për Komisionin për Legjislacion që gjatë punës të ftojë jo vetëm përfaqësuesit që zakonisht vijnë në Komisionin për Punë të Jashtme, po veçanërisht përfaqësuesit e Diasporës, edhe të organizatave ose OJQ-ve të ndryshme, të cilat përfaqësojnë grupe të ndryshme të Diasporës, qoftë bizneseve, jetës kulturore e kështu me radhë, me qëllim që ta pasurojmë këtë ligj mes dy leximeve aq sa kemi mundësi, prapë që me qëllimin përfundimtar që të arrihet plotësimi i plotë i qëllimit të ligjit që është pra ndërtimi i një bote të përbashkët mes dy, si të themi, gjymtyrëve të ndara të të njëjtit komb. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Sala Berisha e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Media,

Ju të pranishëm,

Të nderuar bashkatdhetarë kudo që jeni,

Sot kemi në rend dite Shqyrtimin e parë të Projektligjit për Diasporën. Që në fillim dëshiroj të shpreh një rezervë timen rreth emërimit të Diasporës, sepse po të hysh në parathënie ose në një etimologji të fjalës “Diasporë”, nuk tingëllon bash hijshëm, i bie si ‘farë e shkapërderdhur’. Sidoqoftë, ideja e këtij projektligji është më i mirë se sa ajo që thuhet në këtë shprehje.

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Asnjëherë nuk është e tepërt të theksohet kontributi i bashkatdhetarëve tanë që jetojnë jashtë atdheut dhe të theksohet se Diaspora jonë është një potencial me një vlerë shumë të madhe, edhe pse gjendet jashtë vendit, ajo është pjesë e pandarë e kulturës shpirtërore dhe materiale të historisë së popullit tonë. Bashkatdhetarët tanë me dekada kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në jetën politike, sociale e kulturore në Kosovë. Kanë qenë arteria kryesore që ka mbajtur gjallë jetën në Kosovë në vitet më kritike për vendin dhe fatin e saj. Një rol të rëndësishëm veçanërisht kanë luajtur viteve ‘90 - ‘99, me rastin e financimit të sistemit të pavarur arsimor dhe shëndetësor dhe me gjerë. Gjithashtu, një rol të jashtëzakonshëm, të rëndësishëm Diaspora ka luajtur edhe në sensibilizimin e çështjes së shqiptarëve të Kosovës për dhunën dhe represionin që ushtrohej ndaj tyre nga pushtuesi. Po ashtu, Diaspora konsiderohet promotori dhe mbështetësi kryesor dhe i gjithanshëm i luftës për liri dhe pavarësinë e Kosovës.

Meqenëse Kosova vazhdon të jetë shteti më i ri në Evropë, bashkatdhetarët tanë, përkatësisht Diaspora, luan një rol shumë të rëndësishëm në reflektimin pozitiv të shoqërisë tonë në shoqëritë perëndimore. Së këndejmi, Diaspora mund të luajë një rol jashtëzakonisht të madh edhe në ndërtimin e imazhit pozitiv të Republikës së Kosovës në raport me shtetet e tjera. Ndonëse, nga pavarësia e Kosovës, domethënë nga viti 2008 janë bërë disa përparime sa i përket krijimit të një fryme mbështetëse të Qeverisë së Kosovës ndaj Diasporës, të cilat kryesisht kanë pasur në fokus miratimin e infrastrukturës ligjore të nevojshme, që më pastaj edhe me krijimin e vijave institucionale të komunikimit, megjithatë për të arritur në një situatë të kënaqshme ende na duhet punë dhe përkushtim i të gjithëve bashkërisht.

Edhe, më tutje vazhdon që sfidë të jetë në të ardhmen të përballet karshi Diasporës edhe krijimi i kushteve të votimit të tyre apo edhe përfaqësimit të Diasporës në Kuvendin e Republikës së Kosovës përmes rezervimit të ulëseve në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Aktualisht, ne e dimë se mundësia e institucioneve të Kosovës për t'iu përgjigj plotësisht të këtyre kërkesave mbetet shumë e vogël. Dihet se kjo ndodh për shkak se një gjë e tillë ka ndikim direkt në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Megjithatë, gjetja e mundësisë dhe e mënyrës së përfaqësimit të Diasporës mbetet një prioritet për të ardhmen dhe ne duhet të marrim modele të shteteve, të cilat janë bazuar edhe në bashkëpunimin me Diasporën, siç janë: izraelitët, armenët, e kështu me radhë, nuk e di se sa ka arritur grupi i punës apo Qeveria gjatë draftimit të marrë modele të tilla për bazë, të cilat modele do ta ndihmonin në këtë rast edhe Kosovën shumë mirë.

Ne e dimë se Kosova ka prodhuar edhe dokumente, siç është strategjia për Diasporën, në strategji ka pasur edhe disa parime, siç është: parimi i mundësisë së votimit, një gjë e tillë që parashihet edhe me Ligjin për zgjedhjet, i cili saktësisht përcakton se të drejtë vote kanë shtetasit e Republikës së Kosovës, si dhe ata që jetojnë jashtë territorit të saj, mirëpo është pak e vështirë për shkak të procesit dhe procedurave të votimit që u përmend këtu edhe nga disa kolegë të tjerë. Në atë strategji besoj që është bazuar edhe hartimi këtij draftligji, parimi i gjithëpërfshirjes, ku kërkon nga institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe nga mekanizmat e tjerë të japin maksimumin për përmirësimin dhe përparimin e bashkëpunimit me Diasporën, po ashtu kërkohet nga shoqëria brenda territorit të Republikës së Kosovës që të vazhdojë t'i mbajë lidhjet e forta me anëtarët e familjes, të cilët gjenden nëpër botë.

Nëpërmjet mbajtjes së lidhjeve të forta, çdo qytetar i Kosovës kontribuon në ruajtjen e kulturës, gjuhës, traditës dhe zakoneve të vendit të origjinës, edhe pse ne e kemi pak problem të mbajmë këtë lidhje, të vazhdojmë komunikimin ose vizitat e ndërsjella për shkak të problemit të liberalizimit, por megjithatë qytetarët tanë po gjejnë mundësi që të dalin dhe unë besoj që në këtë Kuvend dhe jo vetëm në këtë Kuvend nuk ka familje që nuk e ka ndonjë anëtarë të familjes së ngushtë apo edhe më gjerë që s'e ka duke jetuar përkohësisht jashtë atdheut. Mandej, ndikimi politik dhe kulturor në vendet ku ata jetojnë i jep Diasporës një dimension diplomatik, i cili

duhet të mbështetet dhe të shfrytëzohet, natyrisht në bashkëpunim me institucionet tona. E kam analizuar draftligjin në detaje, u përmendën shumica prej neneve dhe dispozitave ligjore që janë në këtë draft ligj, por unë duke qenë e angazhuar në Komisionin për Zhvillim Ekonomik më ka interesuar sidomos neni 20, ku parashihen hulumtimet për bizneset e Diasporës, ku thuhet se ministria me qëllim të evidentimit të potencialit ekonomik të Diasporës, në bashkëpunim me organet kompetente të Republikës së Kosovës mbledh dhe përditëson bazën e të dhënave për biznese në Diasporë. Kjo nuk është e mjaftueshme, duhet gjithsesi me urgjencë të shfrytëzojmë edhe zyrat tona diplomatike dhe ambasadat që të bëjnë një evidentim të bizneseve tona, të bashkatdhetarëve tanë që janë në Diasporë dhe që t'ju krijojmë mundësi jo vetëm përmes njoftimit, siç shihet në dispozitën e neni 20, paragrafi 2, ku thotë 't'i njoftojmë', po edhe t'i japim kriteret ose kuota me përparësi në kushte të barabarta që ata të vijjnë të marrin statusin e investitorit strategjik.

Është shumë e rëndësishme edhe përfshirja e studentëve, studentët tanë, të bashkatdhetarëve tanë që jetojnë dhe veprojnë jashtë të marrin përvojat nga institucionet e Kosovës. E vlerësoj të rëndësishëm edhe vijën e komunikimit përmes Radiotelevizionit të Kosovës, si dhe shumë çështje të tjera. Krejt në fund, dëshiroj të them se ky projektligj duhet të orientojë potencialin e Diasporës në funksion të zhvillimit të Kosovës, qoftë përmes nxitjes së investimeve strategjike apo kthimit të trurit. Ne nuk duhet të kuptojmë vetëm remitencat financiare me Diasporë, por edhe kapacitetet shkencore, politike dhe kapacitetet intelektuale dhe biznesore, se a do të arrijë ky projektligj me zbatimin e tij që vlerat politike dhe intelektuale, rrjetet e bizneseve, organet, shoqatat kulturore, sportive, shkencore, që e përbëjnë Diasporën të kthehen në faktorë influencues në sferat e jetës në Kosovë, por jo vetëm në Kosovë, por edhe në shtetet ku jetojnë në relacion me Kosovën, na mbetet që të angazhohemi të gjithë bashkërisht. Unë do ta mbështes, faleminderit për vëmendjen.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Berisha Shala! Fjalën e ka Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Të nderuara kolege dhe kolegë,

Unë e kam ndërmend të shqyrtoj vetëm një çështje që e preku, e trajtoi në njëfarë mënyre dhe parafolësja, që është një vërejtje e drejtë. Në të vërtetë, qysh ndryshimi i emërimit në Ligj për Diasporën është i padrejtë. Është i padrejtë për arsye se me gjasë ekspertët që kanë punuar në tekst nuk janë të familjarizuar me konceptet themelore 'mërgatë' dhe 'Diasporë'.

Ne kemi edhe mërgatë, edhe Diasporë, Diaspora domethënë prej një gjuhe të huaj që vjen, flet për njerëz e shpërngulur dhe të ngulitur në mënyrë të përhershme në një vend tjetër jashtë atdheut të tyre. Ne kemi ashtu Diasporën tash fatkeqësisht në Turqi, që ka bërë afër një shekull, kemi pjesë të njerëzve tanë që janë ngulitur një herë e përgjithmonë në Belgjikë që është një shpërngulje më e vonshme se në Turqi, por më e hershme se në pjesë e tjera dhe kemi të bëjmë

kryesisht me njerëz të ikur për shkaqe politike, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, menjëherë. Edhe kemi pjesën e njerëzve që në periudhën prej viteve '60, sidomos prej mesit të viteve '60 e këndeje, edhe tash kemi 50 vjet e tepër që kanë shkuar në vendet perëndimore kryesisht, për shkaqe ekonomike, ka edhe për politike, sepse kemi valë të ndryshme të emigrimit, edhe këta e kanë mbajtur një lidhje jo vetëm emocionale, por edhe një lidhje pronësore, administrative, të pashkëputshme me atdheun, me vendlindjen.

Ne kemi njerëz domethënë që quhen “mërgatë” që nuk janë të ngulitur në vendet ku kanë shkuar. Edhe “mërgatë” quhet e tërë pjesa që fatkeqësisht dalëngadalë po shndërrohet në Diasporë, për shkak krejt rrethanave që i ka krijuar pushteti i mëparshëm jugosllav, po edhe ne tash, po shndërrohen në Diasporë, sidomos njerëzit e gjeneratës së dytë e të tretë që kanë lindur atje dhe janë shkolluar atje. Fatkeqësisht ata po shndërrohen në Diasporë, por ende kanë një lidhje jashtëzakonisht të madhe, edhe administrative, emocionale me vendlindjen, sepse i kemi vazhdimisht këtu, edhe fëmijët që kanë lindur atje në gjeneratën e dytë, megjithatë nuk e kanë shkëputur lidhjen. Prandaj, unë mendoj se dallimi Diasporë dhe mërgatë duhet të jetë në emërtimin e ligjit, dhe ta bëjmë jo vetëm dallimin konceptual, por ta bëjmë edhe dallimin përmbajtësor të asaj për çfarë po flasim ne. Unë e di që shumë prej neve këtu kanë qenë pjesë e mërgatës, por nuk kemi qenë pjesë e Diasporës. Ne nuk jemi ngulitur, pa marrë parasysh kush prej nesh ka marrë shtetësinë e një shteti tjetër, apo jo, nuk jemi ngulitur në mënyrë të përhershme jashtë Kosovës apo jashtë atdheut, jashtë vendlindjes tonë.

Edhe këtë dallim nëse e bëjmë, që është nominativ, e bëjmë edhe dallimin përmbajtësor, prandaj i trajtojmë problemet në mënyrë të veçantë, sepse pjesa e njerëzve që ende e quajnë veten me prejardhje shqiptare në Turqi jeton, ka krijuar rrethana të tjera dhe jeton në rrethana të tjera nga ajo që është në Zvicër, në Gjermani e Francë ku kemi shpërngulje të kohëve të fundit, po edhe në vendet ballkanike, fatkeqësisht në 2-3 vjetët e fundit, ajo është mërgatë, ajo nuk është Diasporë.

Edhe trajtimi i problemeve të arsimit, edhe të lëvizjes së tyre, lidhjeve tyre me atdheun, me vendlindjen, është i ndryshëm, sepse fëmijët e njerëzve në Diasporë në të vërtetë nuk e kanë vendlindje Kosovën, ata e kanë vendlindje Turqinë, Italinë, Argjentinën, ku di unë çka, por fëmijët e shumë mërgimtarëve tanë në të vërtetë që jetojnë në Zvicër e kanë vendlindje Kosovën, mirëpo po vendosen në mënyrë të përhershme atje. Unë mendoj se këto dallime ne duhet t'i kemi parasysh, dhe bazuar në këto dallime që janë përmbajtësore duhet ndryshuar emërtimi i ligjit, me ndryshimin e emërtimit të ligjit vërtet duhet të futen pjesë përmbajtësore, pragmatike në ligj që trajtojnë problemet në mënyrë adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fitore unë e kam bërë një përjashtim me zotin Sejdiu sot, por po të them sinqerisht nuk ke të drejtë që të flasësh dy herë. Unë, pas Teutës, në qoftë se veç po insiston, s'e kam problem atë punë, por vërtet nuk keni të drejtë dy herë të diskutoni për një

temë, është i njëjti zë i grupit parlamentar dhe i yti, besoj që është i njëjti zë, nuk ke diçka më shumë. Zonja Haxhiu e keni fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sinqerisht, nënkryetar, ndonjëherë ndoshta pa vetëdije mund ta kemi mikrofonin afër edhe t'i shqetësojmë deputetët, mirëpo duhet edhe të na e tërhiqni vërejtjen, por kur dikush reagon, duhet shikuar edhe veten nganjëherë, ishte tmerruese. Gjithkush ka të drejtë deri sa nuk e shkel të drejtën e tjetrit.

Prandaj, edhe ajo ishte dhunë për neve.

I nderuar ministër,

Sinqerisht kam pritur që ky ligj, meqë në legjislaturën e tretë Ligji për Diasporën i kishte 17 nene, tani ky ligj, me gjithë këtë ekip i ka 25 nene. Shqetësimet në legjislaturën e tretë kanë qenë tri, që janë po të njëjtat, po flasim, pra: shqetësim kryesor edhe atëherë, edhe sot ka qenë mësimi në Diasporë. Shqetësim tjetër ka qenë hapja e qendrave kulturore nëpër Diasporë dhe, e treta do të thotë kërkesa e tyre për një lloj rezervimi të vendeve qysh në atë kohë në Kuvend të përfaqësimit të Diasporës.

Po flasim për Ligjin dhe kërkesat e Diasporës që nuk janë të vetmet, mirëpo unë kam shprehur shumë në këtë projektligj, ngase ka ndodhur diçka që rrallëherë ndodh në Kosovë, në Kuvendin e Kosovës, kur ju si ministri keni qenë shumë dorëlibër dhe keni marrë të gjithë deputetët kudo nëpër Evropë, shtetet skandinave e deri në Amerikë në turne, dhe, në fund të fundit, të gjitha këto kritika prej të njëjtëve që jua keni paguar edhe shpenzimet me taksa të qytetarëve të Kosovës, e zëri bukur shumë po ju shkon, po bash zëri që po ju shkon janë po të njëjtit që e kanë shpenzuar buxhetin e Kosovës dhe nuk e kanë bërë asnjë ndryshim të vetëm.

Tani, të mos harrojmë se puna e deputetit fillon tash, ju keni filluar dhe tani deputetët në leximin e parë. Prej leximit të parë në leximin e dytë, pastaj fillon punën nëpër komisione, që është puna kryesore. Dhe janë të obliguar të mbajnë dëgjime publike, bazuar në Rregulloren e Kuvendit. Kjo i bie tash po i thërrasim Diasporën e vijnë këtu. E unë besoj shumë që Komisioni, të zëshmit, kanë për të kërkuar të dalë tash prapë edhe një herë për së dyti në Diasporë dhe për ta bërë një ligj më të mirë.

Shqetësimi i Diasporës si tha Bilalli, nuk është vërtet për të folur ne për Diasporën, se ata kanë folur si në këtë Qeveri si në qeverisjen e kaluar, si para neve, po edhe vite-vite atëherë kur është dashur të flitet, qoftë në kohën kur i është dashur vendit edhe gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Ne nuk jemi dhe nuk guxojmë të lëshohemi në to, se s'mund t'i ndryshojmë ne ata. Çka ne po bëjmë për Diasporën? Unë konsideroj që pos këtyre tri shqetësimeve që duhet të rregullohen, ngase mësimi vullnetar dhe dërgimi i fëmijëve nga prindërit dhe pagesa e prindërve, për mua mendoj që është prapë shqetësim dhe do të duhej të rregullohej në mes të dy qeverive, Qeverisë së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës, në mënyrë që mësimdhënësit pra të paguhen nga buxhetet e këtyre vendeve. Por, të jenë mësimdhënës që të jenë jo vetëm si të jenë me honorarë, por ta kenë një pagë të dinjitetshme, në mënyrë që vërtet të mbahet mësim në mërgatë.

Hapja e qendrave kulturore, unë mendoj se nuk duhet të mbetet vetëm në vullnetin e organizatave joqeveritare, por vërtet të jenë nën ombrellën e Ministrisë së Diasporës.

Rreth përfaqësimit në Kuvend apo jo, prapë mendoj që gjatë punës në Komision, duhet të vijnë ekspertët të cilët janë shumë që ne vërtet ata të vijnë pra le të punojnë në Komision bashkë me deputetët, në mënyrë që të bëhet një ligj që është me interes pra për Diasporën tonë.

Shqetësimet e tyre të vazhdueshme janë që të përkrahen televizionet ose kanalet televizive që janë të hapura në Diasporë ministër, me projekte të ndryshme. Unë nuk e di vërtet qysh shkon, por është mirë që të përkrahen këto programe të cilat janë për Diasporën.

Por, gjithashtu një shqetësim i tyre është edhe pritjet e gjata që po ndodhin, sidomos gjatë festave, edhe gjatë pushimit veror, por edhe gjatë festave kur ata vijnë prapë se prapë se asnjëherë nuk ndalen, sado që neve nuk e kemi ndonjëherë një pasqyrë të mirë që e përçojmë përmes Kuvendit. Ndryshe, ata dëshirojnë të na shohin. Mirëpo, të paktën të ketë lehtësira, mos të bëhen kolonat ose të mundohemi të bëjmë më të mirën të mundshme që ata të mos presin me orë të tëra.

Ajo që vërtet ndoshta duket pak qesharake, por ata kanë kërkuar që të paktën të ketë edhe, ose ju si ministri bashkë edhe komunat të shikoni në vendet ku ata presin me orë të tëra, të jenë disa shporta ku ata mund të hedhin edhe mbeturinat, ngase gjithë kohën, ndoshta edhe ato që me familjarët kanë edhe fëmijë, detyrohen t'i mbajnë brenda nëpër vetura. Nuk është pjesë e ligjit, por është shqetësim i Diasporës dhe unë po e përcjell prapë këtu.

Gjithherë e kemi përcjellë dhe po e themi prapë dhe nuk është pak t'u themi komunave që mos të ruajnë ndërtimin e rrugëve në kohën kur ata vijnë në Kosovë, ngase vërtet secili prej neve si familjar ndoshta i kemi disa vetura, por edhe pjesa e jonë, pra pjesa më e çmueshme e familjeve tona, sepse secili prej nesh siç u tha kemi familjarë në Diasporë. Tani i kemi ngarkesë e stërngarkesë që vetëm një rrugë qarkulluese prej Gjakovës në Pejë duhet më shumë sesa dy orë e dikë po e pengon autostrada, ndoshta për të dalë një rast urgjent, nuk mund të kalosh.

Pra, të kërkohet prapë prej komunave që t'i lënë investimet jashtë kësaj sezone. Sa më pak koncerte festive, është kërkesë e tyre, por të shihet thjesht çka ne po bëjmë që ata të shohin diçka duke përparuar, siç kanë për të ardhur dhe kanë për të parë pastërtinë që ka ndodhur kudo, fatmirësisht, jo ndoshta në masën sa dëshirojnë, por që po ndodh kohëve të fundit në Republikën e Kosovës, duke e bërë vendin tonë më të pastër. Pra, është një vetëdijësim shumë më i mirë, jo vetëm i qytetarëve, po konsideroj edhe i pushtetarëve.

Pra, ministër, po, në mes të dy leximeve edhe unë do të mundohem të jap kontributin tim, mirëpo pres prej Komisionit që të reflektojë në mënyrë që ta arsyetojnë gjithë atë shpenzim të parasë që e kanë bërë kudo nëpër Evropë e deri në Amerikë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të them të drejtën nuk desha të flas, mirëpo më provokoi ky fjalimi i fundit i zonjës Haxhiu, sepse unë bashkë me një kolege të saj jemi ata që i ke harxhuar këto para dhe desha të flas pak.

Desha të flas sepse këtu dëgjova prej shumë deputetëve zhvillimin e disa pikëpamjeve që për mendimin tim janë shumë jodemokratike dhe shpërfaq një mentalitet politik autoritar dhe shumë të rrezikshëm. Sipas këtyre deputetëve, Qeveria e ka për punë të marrë deputetët me vete, e deputetët e paskan për detyrë t'i thonë Qeverisë faleminderit. Kjo i bie që Qeveria i paguan shpenzimet, kurse deputetët e mbyllin gojën.

Në vendet demokratike ne e dimë mirë se Qeverinë nuk e çojnë përpara as lëvdatat, as servilizmi, por në vendet demokratike vendin e çon përpara kritika e mbështetur dhe dhënia e opsioneve dhe propozimeve.

Rregullimi ynë kushtetues, institucional e definon Kosovën si republikë parlamentare demokratike, prandaj ia jep Kuvendit të Kosovës, këtu ku jemi ne, një funksion specifik i cili është kontrollimi dhe mbikëqyrja demokratike e Qeverisë. Ai deputet që nuk e kupton këtë punë të veten, që duhet të kontrollohet Qeveria, duhet të mbikëqyret Qeveria dhe duhet kërkuar llogari Qeverisë, ai deputet lirisht mund të themi ia ka huq punës së vetë totalisht, edhe nuk e di pse është këtu, në këtë Kuvend të Kosovës.

Prandaj, meqë puna është kështu, atëherë edhe unë po i them dy-tri fjalë për Ligjin për Diasporën. Ministria ka bërë shumë mirë që e ka organizuar këtë koncept, që së bashku me punëtorët e Qeverisë. Edhe anëtarët e Komisionit për Politikë të Jashtme, sepse ligji bie në atë komision të kenë mundësinë të dëgjojnë atë grupin të cilin e trajton ky ligj e që është mërgata jonë, t'i dëgjojmë shqetësimet e tyre. Kjo ka qenë puna jonë, e jo t'i mbyllim veshët dhe ta mbyllim gojën. Në momentin që ti i ke dëgjuar problemet e tyre, duhet të vish edhe t'i thuash

problemet e tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo është detyra jonë, kjo është për çka paguhemi dhe kjo është për çka na ka thirrur Qeveria.

Unë besoj që edhe ministrin edhe zëvendëskryeministrin me shku me pyet sot a është detyrë e imja të të lëvdoj sot, del në foltore e thotë jo nuk është ajo detyra jote, nuk besoj që është. D.m.th. kur vetë ministri nuk do ta thoshte këtë gjë, çka po çohen këtu disa deputetë të mazhorancës, kishe ne po tregojmë si janë shpenzuar paratë në këtë Kuvend të Kosovës. Paratë janë shpenzuar pikërisht për këtë arsye, unë të shkoj dhe të kuptoj problemin e saktë. Pikërisht pse e kam kuptuar problemin e saktë, për mendimin tim çështja më e rëndësishme është kjo, të cilin edhe e kam formuluar bile në Komisionin për Politikë të Jashtme. Më shumë se gjyma e kuptimit të ligjit, më shumë se gjysma e rëndësisë së këtij ligji, është shkollimi i fëmijëve në gjuhën shqipe. Ku kemi shkuar na e ka thënë mërgata jonë. I dyti prej problemeve që ka dominuar, është t'u krijohet e drejta që të votojnë prej vendeve ku jetojnë. E dyta ka qenë kjo. Këto dy probleme.

Shkollimi i fëmijëve në gjuhën shqipe dhe votimi nëpër vendet ku ata jetojnë, nëse ne nuk i reformojmë ligjet dhe nuk i përfshijmë këto vërejtjet e Diasporës në ligje, atëherë kot janë këto që po bisedojmë. Kështu që mua më vjen keq që me Ministrinë ka ndodhur një keqkuptim. Ne në njërin prej takimeve të Komisionit për Politikë të Jashtme, kemi thënë se çka ka mbetur pa u përfshirë edhe pas këtyre vizitave që i kemi pasur ne. Vizitat qysh e di unë kanë qenë në tetë shtete. Unë kam qenë në katër prej tyre. Të tjerët kanë qenë edhe në më shumë shtete dhe e kanë parë saktësisht në cilin shtet qysh funksionon Diaspora dhe cilat janë nevojat e Diasporës.

Kështu që, në njërin prej mbledhjeve të komisionit, ne e kemi formuluar saktë, bile edhe është votuar me koncensus, me unanimitet është votuar aty dhe e kemi formuluar qartë që: Republika e Kosovës duhet ta marrë përsipër organizimin e shkollës shqipe në mërgatë si dhe koston financiare të këtij organizimi, të shkollimit të gjuhës shqipe. Këtë e kemi përfshirë, ia kemi dërguar Ministrisë. Unë e lexova ligjin, po e shoh që në ligj Qeveria nuk e ka përfshirë atë formulim, që e kemi votuar ne në Komisionin për Politikë të Jashtme dhe Investime Strategjike e Diasporën.

Tash, çka na duhet prej ministrit është një zotim këtu në Kuvend të Kosovës, sepse mendoj se nëse jepet një votë, edhe e Vetëvendosjes, LDK-ja mund ta shpreh mendimin e vetë. Nëse e keni votën në parim në lexim të parë prej Vetëvendosjes, e keni vetëm deri në lexim të dytë. Nëse kjo çështje që e shpjegova unë, shkollimi në gjuhën shqipe, organizimin ta marrë tërësisht Republika e Kosovës, aty ku shteti pritës nuk e financon mësimin e nxënësve në gjuhën shqipe, atëherë në votimin e dytë Lëvizja Vetëvendosje nuk mund ta votojë këtë ligj, sepse është turp para atyre njerëzve të shkosh dhe t'i dëgjosh nëpër ato qytete të Evropës, ata të thonë që halli ynë kryesor është shkollimi në gjuhën shqipe, të vijmë këtu, të fshehim problemin, t'ia bëjmë rrafsh njëri-tjetrit dhe të mos përfshihet ajo që është më e rëndësishmja për mërgatën tonë. Kështu që

ministër të lutem, krejt çka pritet prej teje është ky zotim në Kuvend të Kosovës. Nëse e bënë këtë zotim, kalon ligji në lexim të parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu ka replikë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar!

Faleminderit prej Glaukut, se s'e kam ditur, kam menduar që veç Fitorja, po dy paskan qenë të Vetëvendosjes në turne. Tjetra, faleminderit edhe një herë Glauk, që i përsërite fjalët e mia. Mund ta marrësh transkriptin. Shqetësimet tri, tash në mandatin e tretë, legjislativën e tretë, tri ishin, dy i përsërite ti. Faleminderit që i përsërite, që i thashë. Vetëm qendrat kulturore nuk i përsërite, kurse çështja e mësimi ishte shqetësim i imi, në fakt prej legjislativës së tretë, edhe sot po e përsëriti edhe një herë. Njëkohësisht edhe përfaqësimi i Diasporës dhe votimi i tyre, prapë ishin dy, qendrat kulturore nuk i përmend.

Për mua është turp kur sot thua jemi keqkuptuar me Ministrinë, me ministrin, ku nuk u keqkuptove sa ishe nëpër turne. Shpenzim i parasë së buxhetit të Republikës së Kosovës dhe keqpërdorim ka qenë ai turne. Prej sot fillon puna e Komisionit, prej sot fillon puna e deputetëve. Brenda dy leximeve punojnë deputetët dhe nuk mund t'i thuash sot po të kushtëzojë. Se në fund fundit, fare për ministrin, ministër mund të jetë sot ky, nesër tjetri, apo qeveritë shkojnë e vijnë, ligji bëhet për Diasporë. Dhe sot nëse thua jemi keqkuptuar me ministrin, për mua është turp, se nuk e ke keqkuptuar në Diasporë sa ke qenë. A ia ke thënë atje? Nëse ia ke thënë atje, është keq që ke vazhduar katër turne. Është dashur të kthehesh me të parin këtu.

KRYESUESI: Kundër-replikë, Galuku!

GLAUK KONJUFCA: Së pari një përmirësim. Me shumë keqardhje për analfabetizmin e njerëzve që arrijnë të zgjidhen deputetë në Kuvendin e Kosovës, edhe thonë prej juve paskan ardhur dy deputetë, prej neve veç një. Po veç një e kanë në komision. Nuk e ka, Aleanca e ka veç një në komision. LDK i ka dy, kanë ardhur, Vetëvendosje i ka dy, kanë ardhur, AAK e ka një, ka ardhur një. Nuk mund t'i bësh dy edhe po të duash. D.m.th. prej këtij analfabetizmi elementar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kur nuk e di deputetja këtë problem, për besë po përtoj të u merrem me tjerat.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë mendoj që ligji është tepër i rëndësishëm edhe siç duket burimi është shumë i mirë, pavarësisht se mund të kemi vërejtje, po pajtohem edhe rreth shkollimit, ajo që duhet të jetë brenda ligjit. Por, për herë të parë e kemi një ligj dhe shpresoj që gjëja e parë që ky ligj ta ketë,

harmonizimin me ligjet e tjera dhe ministrinë e tjera, për shkak se bëhet fjalë për investime, bëhet fjalë për sport, për kulturë, për rini, për arsim, për transport, për kontroll kufitar, për lëvizje më të lirë në qarkullimin e tyre.

Unë mendoj se Diaspora këtu i ka problemet esenciale në raport me Kosovën, me Republikën e Kosovës. Sepse ne e dimë që pse ata nuk jetojnë në Kosovë, ata jetojnë qytetarë të Kosovës që jetojnë në Evropë. Pra, cili është problemi me sa ne i kemi parë? Është kartoni i gjelbër problem shumë serioz dhe e dimë që nuk jemi anëtar i Organizatës. Përndryshe kemi pasur një debat parlamentar.

Problemi i dytë që atakohet Diaspora kur vjen në Kosovë, sidomos kur kanë qarkullim tokësor, janë kontrollet e stërzgatura kufitare që duhet të merren masa urgjent.

E treta është shkollimi që duhet të jetë pjesë e ligjit. Votimi po ashtu duhet të jetë pjesë e ligjit. Duhet të marrim obligime t'ua japim të drejtën qytetarëve tanë të cilët jetojnë në Evropë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës që ta shfrytëzojnë të drejtën e votimit.

Tjetër çka është me interes, edhe shpresoj që edhe kjo do të jetë pjesë e reformës zgjedhore. Pjesëmarrja ose përfaqësimi i tyre në Kuvend, në rast se p.sh. veç dakordohen të gjithë.

Për investimet po e shoh që ka shumë brenda për brenda ligjit. Unë mendoj që edhe në kuadër të Ligjit për investime strategjike që tash është bartur në Ministrinë e Diasporës, edhe këtu shpresoj që e kenë parë mirë, se edhe kjo mund të krijojë konfuzion. Por, në përgjithësi, ky ligj është për herë të parë duke i dhënë një kompetencë ekzekutive ministrit të Diasporës, se po shoh që ka atashe përfaqësues të Diasporës, ka përgjegjësi të qendrave kulturore nëpër shtete të ndryshme të Evropës, se në të kaluarën kanë qenë me rregullore, me akte nënligjore, me vendime të Qeverisë, kurrë s'është ditur as çfarë përgjegjësie kanë, as çfarë detyrimi kanë ndaj qytetarëve. Ndërsa sot, shumica prej tyre janë të shënuar këtu. Ka, p.sh. mbajtja e evidencave, që është shumë me rëndësi. Çfarë kuadrosh kemi nëpër Evropë, çfarë sportistësh kemi, çfarë natyre të ekspertizës kemi?

Tjetra që ishte shumë me rëndësi, që ishte brenda për brenda ligjit, është hapësira në universitetet tona kur Diaspora kërkon, ose t'u ofrojmë mundësi, që ata të jenë, sidomos për edukatorët tanë. P.sh. gjatë verës ne e dimë që fakultetet tona janë në pushim në kuptimin studentor, ata mund të vijnë këtu dhe t'i shfrytëzojnë ato praktika dhe të krijohen kuadro edhe për edukimin në Diasporë, se e dimë që e kanë shumë problem edhe për nivelin e edukimit. Kanë shumë fëmijë, por nuk kanë edukues.

Unë mendoj që në parim, ky ligj është i domosdoshëm për të marrë përkrahjen e të gjithë deputetëve. Ndërsa kush më shumë e kush më pak ka kontribuar, ta lëmë, ne deri tash i

lavdëruam Diasporën, e dimë shumë mirë, mos të bëjmë shumë fushatë këtu. Diaspora e ka dhënë provimin historikisht, ta japim edhe ne sot provimin. Ta votojmë ligjin e në lexim të dytë, shpresoj që në Komision i jepni të gjithë kontributet.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë nuk kam dashur të flas fare për Ligjin për Diasporën sepse komentet tona, vërejtjet në ligj i paraqiti deputeti Salihu.

Megjithatë, u përmend shumë këtu një çështje, e cila ka të bëjë me zgjedhjen. Qoftë të drejtën për t'u zgjedhur, apo qoftë të drejtën për të zgjedhur për të marrë pjesë në zgjedhjet e Diasporës. Për mendimin tim nuk u shtrua drejt nga kolegët deputetë. E kuptoj se kjo bëhet për çështje populliste, se ne dëshirojmë të flasim sa më shumë gjëra që qytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit dëshirojnë t'i dëgjojnë sesa se çka mund të bëjmë në të vërtetë.

Sa i përket çështjes së përfaqësimit të Diasporës, nëse duam që vërtet ne të kemi përfaqësues nga Diaspora, ky është një debat shumë i gjerë, i cili është bërë edhe më herët, por që kërkon ndryshime kushtetuese. Nuk mund të rregullohet vetëm me një ligj, sepse çështja e ulëseve në Kuvend, është e rregulluar me Kushtetutë, kështu që për mua ky është më shumë debat populist sesa në të vërtetë mund ta zgjidhë problemin.

Po ashtu edhe pjesëmarrja e qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit në zgjedhje, më shumë kërkon rregullim të procedurave, sesa rregullim të së drejtës me ligj, sepse ajo është e rregulluar. Janë bërë edhe hulumtime, e janë testuar edhe nga vende të tjera, çështja e organizimit të zgjedhjeve nëpër ambasada dhe nëpër konsullata, gjegjësisht përfaqësi të shteteve. Ka dalë që kjo më shumë e vështirëson pjesëmarrjen e lehtë në zgjedhje sesa e lehtëson atë. Kjo sepse nuk ofron qasje të barabartë. Ta zëmë, nëse ne organizojmë zgjedhje në Gjermani. I organizojmë ato në Berlin, sepse atje e kemi ambasadën. Dikujt i bie të udhëtoj 5 apo 10 kilometra për të ardhur për të votuar, kurse dikujt tjetër i bie me mijëra kilometra për të ardhur deri në Berlin për të votuar. Ajo çka ne duhet të kërkojmë është që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve t'i lehtësojë procedurat për pjesëmarrje përmes Postës, e cila edhe është më e lehta si procedurë për të marrë zgjedhje, edhe i garanton të gjithë atyre që janë të interesuar për të marrë pjesë në zgjedhje, që ta gëzojnë këtë të drejtë. Kurse kjo tjetra, mund të organizohet edhe si e drejtë, por organizimi i zgjedhjeve jashtë vendit nëpër ambasada dhe konsullata nuk ofron qasje të barabartë të të gjithë zgjedhësve të gjithë qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit.

Çështja tjetër është se ne kur po flasim për Diasporën, po flasim si për një komunitet krejtësisht të veçantë. Në fakt, ata janë qytetarët tanë të cilët një pjesë e tyre, përkohësisht, për arsye të ndryshme jetojnë jashtë vendit, dhe ajo çka ne duhet të bëjmë për ta, është që t'i ofrojmë të drejta

pothuajse të barabarta si ne që jetojmë këtu. Pse them pothuajse? Sepse megjithatë një diskriminim pozitiv është i pranueshëm sidomos në kohën kur janë ata këtu dhe kanë nevojë për rregullim të dokumentacionit e kështu me radhë. Kanë nevojë për lehtësim edhe në procedura me rastin ose nëse janë të interesuar të investojnë këtu.

Por, shumë nga ta, sepse janë organizuar edhe këtu në Kosovës për fat të mirë disa takime me përfaqësues të Diasporës dhe unë e falënderoj organizatën Germin që e ka bërë një gjë të tillë. Shumica e tyre nuk janë ndjerë mirë për mënyrën sesi trajtohen këtu dhe bile e kanë thënë se ne jemi qytetarë të këtij vendi dhe nuk duam të na presin me këngë e valle, thjesht duam që të na trajtojnë si qytetarë të këtij vendit dhe të na mundësojnë qasje të lehtë, të shpejtë, në realizimin e të drejtave, të drejta të cilat tashmë janë të garantuara me një sërë ligjesh të tjera. E ajo për të cilën duhet të mendoj Qeveria jonë, është po qendrat kulturore dhe si të jenë në shërbim më të mirë edhe ambasadat edhe konsullatat që i kemi atje. E për të cilat kanë nevojë për mbështetjen dhe për shërbimet e tyre kanë nevojë qytetarët tanë e nganjëherë këto ambasada dhe këto konsullata nuk e ofrojnë këtë mbështetje në mënyrën më të mirë të mundshme, ashtu siç është dashur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit z. nënkryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Qytetarë,

Po flasim për një projektligj për të cilin kemi folur disa herë, dhe është folur edhe në disa mandate. Është mirë që është tash në Kuvend edhe është shumë mirë nëse bëhet sa më shpejt.

Në fakt Kuvendi i Kosovës ka mundësi ta bëjë edhe më të mirë këtë projektligj. Unë nuk po dua t'i përsërit që u tha sidomos për fjalët e mira që i kemi të gjithë ne për Diasporën, për mërgatën tonë, por mundohem të jap një propozim, ndonjë kontribut të vogël, po mendoj sidomos në këtë pjesën ku ka të bëjë me zbatimin e këtij dokumenti, nëse vjen shpejt si i aprovuar. Në fakt, tani e kemi përmblylljen e hartimit të politikave tona shtetërore në raport me këtë komunitet, me këtë pjesë të rëndësishme të popullit tonë. Kjo nuk ka filluar sot, nuk fillon as prej një partie, as prej një koalicioni. Mendoj këtu në Kuvend kemi njerëz të cilët i kanë filluar aktivitetet e tyre për të ndërmarrë diçka për këtë komunitet me vite të tëra, duke filluar prej nënkryetarit të kuvendit që është këtu dhe kjo fazë është prej asaj kohës kur kanë filluar ta shkëputin ndikimin jugosllav me ato klubet jugosllave nëpër shtetet e Evropës e deri sot kur ne e kemi shtetin dhe po duam ta bëjmë, edhe pse vonë, një ligj për ta.

Mendoj që ky ligj duhet t'i kalojë këta kufijtë e këtyre politikave tona ditore dhe synimeve tona ditore. Ky komunitet nuk është më i njëjti. Nuk është as për nga emancipimi, as për nga numri.

Nuk është as për nga referencat, as për nga interesat. Kemi të bëjmë me një kohë krejtësisht tjetër, e po besoj ministër, që një ditë do të keni më shumë të dhëna, më shumë statistika, për ta dëshmuar cili është ky komunitet i yni, cila është në të vërtetë tash kjo pjesë e rëndësishme e jona që jeton jashtë shtetit. Unë mendoj që sa më shpejt që t'i kemi këto të dhëna, do të dimë të sillemi më mirë ne si shtet në raport me ta. Por, në fund është mirë që e kemi një ligj dhe një ligj të cilin mund ta bëjmë edhe më të mirë në Kuvend.

Unë po propozoj, meqenëse thash edhe këtu mund të konsiderohet si të doni, por ka pasur njëfarë tendence edhe për kulturën ta bartë pjesën ekzekutive diku ku ka më shumë, ku preket më shumë ky element. Diaspora, ose komuniteti njerëzve tanë që jetojnë jashtë ka prej regjioneve të ndryshme dhe nuk mund t'i veçoj, por regjioni i Anamoravës është një prej regjioneve që tradicionalisht ka pasur më shumë njerëz atje. Propozoj ministër të fillohet iniciativa, ia bëj kërkesën edhe Kryetarit të Kuvendit si shef i koalicionit, edhe Kryeministrit, të dërgohet në Gjilan, në qendër të Anamoravës, dikasterin e ministrisë suaj, të fillohet me disa njësi dhe të çohet atje. Është Presheva, Bujanoci, është një regjion i tërë, i cili është duke u varur zhvillimi i tyre prej resurseve që i kemi në Diasporë. Mendoj që zbatimi i këtij ligji në të mirë të tyre mund të bëhet më së miri nëse zbarkohet, ose vendoset një dikaster i tillë i Qeverisë së Kosovës në atë regjion. Mendoj që ta merrni, edhe propozoj, edhe mendoj që do ta merrni seriozisht këtë propozim, ministër dhe Qeverisë në përgjithësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli i ke pesë minuta, meqenëse kam bërë lëshim vetë.

FITORE PACOLLI: Faleminderit!

Pata të ndërhyj aty te ajo që ne duhet të japim ne si deputetë që kemi shkuar në vizita, duhet veç të sjellim fjalë miradije për ministrin e mos të flasim se qysh kanë ndodhur dhe qysh kanë shkuar gjërat. Më falni, po ne jemi deputetë dhe përfaqësojmë qytetarët dhe Diasporën, jo ministrin, as Ministrinë. Mirë e shpjegoi shumë mirë Glauku që në demokraci ne përfaqësojmë popullin dhe nuk lavdërojmë ministrinë. Ne e kritikojmë ministrinë që ajo të përmirësojë punën e vet.

Gjatë vizitës tonë në Turqi, si ekip që kemi shkuar për të takuar Diasporën atje, ne kemi ardhur në përfundim që ky projektligj duhet të jetë në dy pjesë në fakt. Të adresojë edhe nevojat e veçanta që kanë Diaspora jonë në Turqi. Ky projektligj nuk adreson në asnjë mënyrë kërkesat e Diasporës së Turqisë. Kur kemi shkuar aty, ne kemi takuar qytetarë nga Izmiri dhe nga Stambolli, të cilët kanë ngritur kërkesat jetik të tyre. Ne i kemi dërguar edhe Ministrisë një kërkesë që Ministria të marrë parasysh kërkesat e shqiptarëve të shpërngulur në Turqi, por kjo nuk është marrë parasysh. Ky projektligj unë mendoj se duhet të ndryshojë që të paraqesë edhe nevojat dhe t'i zgjidhë problemet e shqiptarëve që jetojnë në Turqi.

Ministrit unë po mundohem t'ia bëj disa pyetje dhe po shfrytëzoj mundësinë që t'ia bëj disa pyetje dhe të pres përgjigje prej tij. Në nenin 5 ministër, pika 2 shkruan: Republika e Kosovës nxit integrimin e pjesëtarëve të Diasporës në jetën shoqërore dhe politike në vendet pritëse.

A mund të më tregosh sesi do ta bëni këtë nxitje? Si do t'i nxitni qytetarët që jetojnë në vende të ndryshme nëpër Evropë që të integrohen atje? Sepse në shtetet ku ata jetojnë, ato shtete kanë politika të integritit.

Nuk na ka mbetur si Kosovë të shkojmë t'i integrojmë ata të themi, në politikë të shtetit gjerman apo në jetën kulturore dhe shoqërore të Gjermanisë, sepse këtë e bën më mirë Gjermania.

Nëse mund të na tregosh sesi e keni menduar ju këtë punë? Neni 13, pika 2, flitet për lehtësimin e procedurave për regjistrimin e studentëve në universitetet publike. Këtu ju mund t'i lehtësoni procedurat. Mund të bëni që ata të regjistrohen hiç pa asnjë procedurë.

Por, përderisa universitete tona janë të pa ndonjë, janë shkatërruar plotësisht, janë partizuar, pra partitë politike i udhëheqin këto universitete, unë nuk besoj që ka ndonjë student shqiptar që i lë studimet e veta në shtete më të avancuara të Evropës e të botë e të vjen në universitet tona, ku nuk ka as cilësi, e as kushte pune.

Po ashtu, pyetja tjetër ka të bëjë me kanalin e veçantë. Ne kemi marrë shumë ankesave gjatë takimeve tona nëpër vendet e ndryshme nëpër Evropë, ku mërgata është ankuar se RTK-ja nuk arrin ta respektojë atë përqindjen që e ka me ligj tani për tani, dhe ka ngritur çështjen se RTK-ja po udhëhiqet nga partitë politike, pikërisht nga PDK-ja.

Sa herë që kanë dashur që të transmetojnë ndonjë program me rëndësi për Diasporën, iu është kërkuar shumë e madhe e parave, dhe për këtë është informuar edhe Ministria e Diasporës. Zyrtarët të cilët kanë qenë në takim me neve kishin pranuar email-a nga mërgata se RTK-ja u ka kërkuar të holla.

Prandaj, a mund të na tregosh, se ne e kalojmë ligjin, po kush na garanton që RTK-ja do ta respektojë programin e veçantë për Diasporën dhe do ta transmetojë programin që kërkon Diaspora dhe jo të cilin ia imponon Qeveria ose përkatësisht partia politike e cila e kontrollon televizionin e RTK-së.

Pyetje tjetër ministër, edhe kisha të mos më tregosh se çfarë mendon ti, por kisha dashur përgjigje të drejtpërdrejt po ose jo. Ministër, a ka ndonjë studim për qendrat kulturore, sepse ka dështuar modeli i cili është aplikuar më herët, pasi i keni mbyllur ato, a keni bërë një studim para se t'i mbyllni?

A keni bërë ndonjë studim paraprak për modelin e qendrave kulturore që e keni propozuar në këtë projektligj, po ose jo? Dhe, a ju kanë informuar zyrtarët tuaj se në çdo takim që e kemi pasur nëpër mërgatë, asnjë pjesëmarrës dhe asnjë organizatë shqiptare nuk e kanë përkrahur modelin që ju keni propozuar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, dy minuta deputetja Teuta Haxhiu, para se t'ia jap fjalën ministrit.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit për fjalën!

Për pa dijeninë tuaj, po ua rikujtoj edhe njëherë, shpenzimet e dy deputetëve nëpër Evropë shtetet Skandinave dhe Amerikë nuk është e njëjta gjë, sikurse një.

Ndoshta s'keni komunikuar, po do duhej që të paktën, ju që flisni për korrupsion edhe për një euro të vetme t'ia kurseni buxhetit të Republikës së Kosovës, do të ishte me interes.

Tjetra, ministër tani po ju drejtoj pyetje, a i keni çuar ju në atë turne apo jo? Ka pasur edhe deputetë të partive politike që janë deklaruar në fillim se nuk do të shkojmë në turne edhe nuk do të shkojmë të shpenzojmë bushet koti.

Kanë qenë deputet të këtij Kuvendi që kanë përfaqësuar subjekt politik siç janë ish-kolegët tuaj nga PSD-ja. Pra, asnjë s'ka shkuar. Tjetra, ajo që vërtetë, po dua të tregoj se në këtë filozofinë boshe të tyre, pyetjet parlamentare e kanë edhe hapësirën se kur... Nuk paskeni komunikuar as me Qeverinë me ministrin të cilin vërtet e kritikova se ju sugjeroj që ta lexoni transkriptin, e ju fare nuk e kritikuar.

Por, edhe në atë turne të paktën a keni folur me këta njerëz të Qeverisë që i keni pasur me vete të cilët ju kanë sponsorizuar a jo?

Pra, në të gjithë këtë filozofi boshe tuajën, po tentoni të dukeni se po thoni diçka, ama bash kurrgjë nuk thatë. Sinqerisht e kam.

Tani prej tash fillon puna për qytetarët. Për ata që dinë. Pra, puna e deputetëve fillon nga leximi i parë deri në leximin e dytë. Qeveria, ministria tani më nuk punë. Deputetët, Kuvendi e miraton ligjin. Qeveria e ka kryer punën. Kë po doni ta mashtroni ju?

Me atë filozofinë... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, kundër-replikë!

FITORE PACOLLI: Deputete, puna e deputetit fillon në ditën e parë kur ne hyjmë në këtë Kuvend. Por, edhe në ditën e parë kur ne shkelim në këtë Kuvend dhe japim betimin, ne përfaqësojmë qytetarët dhe jo Qeverinë dhe jo ministrinë.

Kështu që ta kesh që qartë. Kjo është sa për paditurinë tuaj.

Për të na kritikuar neve që si deputetë kemi shkuar të t'i vizitojmë qendrat shqiptare dhe shqiptarët në të gjitha pjesët ku ata jetojnë, kjo ka qenë pjesë e detyrës sonë, e punës sonë.

Po të kisha heshtur unë, do të binte se nuk i përfaqësoj qytetarin, por kam shkuar për shëtitje.

Tjetër, shikoje raportin e publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës, se cila parti politike, e cili deputet ka shpenzuar më shumë para për vizita të kota dhe pastaj mund të flasim.

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë, deputeti i fundit i paraqitur për fjalë është zoti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: S'ka lidhje, këtu jemi. Faleminderit!

Së pari desha t'ia jap dorën ministrit që e ka sjellë ligjin. Një punë e mirë. Domethënë po bëjmë diçka po këto diskutime mendoj se janë...Kush tha ka shpenzuar, janë muhabetet sa për ta shpenzuar kohën dhe për ta humbur interesimin e Diasporës që të na përcjellë.

Më me rëndësi do të ishte që vërtetë këtë ligj ta bëjmë, pra një ligj të mirë nëpërmjet të cilit edhe e stimulojmë Diasporën që të integrohet në botën ku ata jetojnë, po edhe ta stimulojmë Diasporën që të investojë në Kosovën.

Mandatin e kaluar kam qenë pjesë e Komisionit të Arsimit, edhe atëherë ka qenë edhe Ministria e Diasporës prej ministrive që e kemi monitoruar. Kemi pasur disa kontakte e vizita në mandatin e kaluar me qytetarët tanë jashtë. Fillimisht është filluar me ato qendrat kulturore të cilat edhe tani me anë të ligjit janë përfshirë si pjesë e këtij projektligji.

Edhe atëherë e kam thënë dhe më vjen mirë që tani është marrë si koncept, që këto qendra kulturore, pra të jenë të udhëhequr nga ambasadat tona apo konsullatat tona kudo në botë.

Termi i përdorur këtu, atashe i Diasporës, mendoj që duhet të ndërrohet me termin atashe kulturor, i cili do duhej të propozohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emërohet nga ministri i Punëve të Jashtme.

Atashe i Diasporës, nëse e shikojmë si tërësi, si koncept, janë ambasadorët. Ambasadorët e luajnë këtë rol dhe konsujt tanë kudo në botë, ata janë për të gjithë Diasporën. Por, nëse flasim për qendrat kulturore e ku do të përfshihen edhe qendrat sportive brenda mundësive ose mbështetja e sportistëve tanë jashtë vendit, atëherë sigurisht që atasheu kulturor do të ishte ai i cili do të përfaqësonte këtu.

Një çështje shumë e rëndësishme që e kemi diskutuar edhe në të kaluarën ka qenë arsimi. Arsimi në Diasporë. Gjuha shqipe në Diasporë.

Atëherë e kam thënë edhe po e përsërisë edhe njëherë që është shumë me rëndësi që arsimi shqip në Diasporë t'i përshtat kohës. Pra, ministria duhet të krijojë mekanizmin e arsimit online.

Sot, në këtë botë të zhvillimit të teknologjisë informative, pak mund të gjesht fëmijë në Diasporë të cilët pas orëve të mësimit do ta kenë dëshirën që të shkojnë edhe dy orë të tjera shtesë në mësim që ta mësojnë edhe gjuhën shqipe.

Edhe nëse abetarja ka mbetur e viteve të kaluara e paplotësuar dhe e pandryshuar, jo atraktive për fëmijët, atëherë sigurisht që dëshira e këtyre fëmijëve nuk do të jetë e kënaqshme, sikur nëse ministria e promovon arsimin online dhe kjo jep mundësi që fëmijëve, bashkë me prindërit e tyre pas orëve të punës dhe pas orëve të mësimit të fokusohen në arsimin online në Diasporë.

Një fakt është mesë evident, që duhet pasur në konsideratë që po flasim për Diasporën në shekullin XXI e që dallon shumë me Diasporën e shekujve të kaluar, edhe atë të shekullit XX dhe XIX.

Nëse e shikojmë si tërësi, mund të themi se Diaspora në shekujt e kaluar ka qenë më e organizuar se Diaspora sot. Paramendojeni numrin e revistave që në shekullin XIX, ka botuar Diaspora jonë jashtë. Aktivitetet dhe organizimin që ata e kanë pasur. Vet fakti që ne kemi qenë të robëruar edhe Diaspora ka qenë shumë e organizuar.

Prandaj, fal atij organizimi të Diasporës edhe jemi çliruar edhe e kemi shtetin tonë të pavarur, por sot në shekullin XXI, ne duhet ta stimulojmë atë Diasporë që këtë lehtësira për investime në Kosovë, sepse përfitimi është i dyanshëm. Do të përfitojë Diaspora, por edhe do të përfitojmë ne si shtet prej investimeve që ata i bëjnë.

Një çështje, i nderuar ministër, mendoj që duhet të përfshihet këtu edhe që e kam hasur gjatë punës. Sportistët tanë jashtë që dëshirojnë ta përfaqësojnë Kosovën, kanë shumë vështirësi që ta marrin pasaportën e Kosovës.

Federata jonë e Futbollit dhe Federata e Hendbollit dhe e Basketbollit në tërësi kanë vështirës që ta sigurojnë pasaportën e Kosovës për cilindo të ri që sot dëshiron ta përfaqësojë Kosovën. Procedurat janë të stërzgjatura. Derisa shteti shqiptar brenda tri ditësh ia jep pasaportën cilindo qytetar i cili dëshiron ta përfaqësojë në sport e kulturë, Kosova e ka një procedurë e cila zgjatë deri në tre muaj.

Prandaj, këtu duhet pasur në konsideratë, se nëse dëshirojmë në përfaqësim më të mirë të Diasporës e të fëmijëve tanë që janë të zhvilluar dhe të na përfaqësojnë ata neve në Kosovë, atëherë duhet t'i krijojmë edhe këto lehtësira.

Krejt në fund, për dëgjimet publike. Unë ju propozoj i nderuar ministër edhe udhëheqje të Komisionit Parlamentar që dëgjimet publike të bëhen në Kosovë. Të bëhen në Parlament dhe të ftohen shoqatat e Diasporës, lobin shqiptar. Le të vijnë këtu. Ia mbuloni shpenzimet. Ju kushton shumë më lirë dhe do të ishte shumë më e këndshme edhe për vet përfaqësuesit tanë të Diasporës që këtë diskutimin për projektligjin për ta, të bëhet në Parlamentin Kosovës, për të cilin ata kanë punuar dhe kanë sakrifikuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur për fjalë, kështu që ia jap fjalën përfaqësuesi të Qeverisë, ministrit Gashi. Është fjala përfundimtare lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të nderuar,

Bashkatdhetarë,

Së pari edhe njëherë falënderoj të gjitha grupet parlamentare për përkrahjen edhe sot edhe gjatë përpilimit të këtij projektligji.

Siç e thashë në fillim edhe të gjithë ju e përmendet, puna mbetet të kryhet mes dy leximeve që të përfundojë një projektligj, i cili nuk është i politizuar dhe i cili në çdo mënyrë do t'i përfaqësojë të gjitha idetë që kanë qarkulluar me të drejtë gjatë gjithë këtyre debateve.

Sa i përket pikës që u fol shumë rreth debatit publik sesi është organizuar, natyrisht që është e logjikshme që debati publik në rastin e Diasporës të mbahet në Diasporë. Ideja që të sillen të gjithë përfaqësuesit e Diasporës në Kosovë, mund t'ju siguroj që jo njëfish e jo dyfish po njëqindfish më shumë do t'i kushtonte edhe Qeverisë edhe Kuvendit.

Vetëm fakti i përzgjedhjes se kush mund të vjen e kush jo do të kishte pasur kokëçarje politike e lëre më organizimi teknik.

Po ndalem pak në disa pika që u përmenden sa i përket ligjit. Në të vërtetë temave që u përmend edhe pse mund të mos jenë drejtpërdrejt pjesë e ligjit.

Kartoni i Gjellbër u përmend. Fatkeqësisht Kosova nuk ka asnjë ndikim sa i përket heqjes ose mos-heqjes së Kartanit ose detyrimit të pagimit të Kartanit të Gjellbër, sepse nuk tatimohet pjesëtari i Diasporës për makinën që ai e vozitë.

Nëse cilido prej jush ose ne, vozisim një makinë me tabela të huaja, po e zëmë të Gjermanisë, kur i ofrohem kufirit të Kosovës duhet të paguhet ajo shuma 15, sepse sigurimi në Gjermani nuk e pranon territorin e Kosovës si të siguruar nga sigurimi në Gjermani ose Zvicër ose Austri.

Do të thotë nuk është ky problem i dëshirës së Qeverisë së Kosovës ose institucioneve të Kosovës, por i institucioneve që i sigurojnë makinat e pjesëtarëve tanë të Diasporës. Fatkeqësisht, ne nuk kemi mundësi, edhe pse kemi provuar gjithçka.

Ju këtu keni pasur debat. Keni emëruar edhe një komision me sa e di unë, parlamentar që të merret me këtë çështje. Dhe nuk ka pasur as ai komision sukses.

Sa i përket votimit, pra e përmendi edhe deputetja Pantina, nuk është mundësia që me anë të këtij të rregullohet çështja e pjesëmarrjes së Diasporës në jetën politike në Kosovë. Është çështje kushtetuese ose i përmirësimit të gjendjes aktuale e cila në parim ofron mundësi, mirëpo organizimi është jashtëzakonisht i dobët, që e ka sjellë pjesëmarrjen e Diasporës në pamundësi. Numrat janë aq të vogël që nuk ia vlen as të përmenden.

U përmend arsimit plotësues. Ne me Republikën e Shqipërisë kemi marrëveshje dy shtetërore sa i përket organizimit të arsimit plotësues. Kemi filluar me pikën më kryesore që ka qenë kurrikula e përbashkët. Tash jemi në procesin e trajnimit dhe certifikimit të mësimeve.

Është vetëm në proces e sipër me Ministrinë së Diasporës sonë dhe asaj të Shqipërisë dhe Ministrinë së Arsimit tonë ose të Kosovës dhe të Shqipërisë. Një bashkëpunim jashtëzakonisht i mirë që dy vite.

Problemi gjithmonë mbetet te financimi dhe nëse ju si Kuvend, si deputetë u ndihmoni këtyre katër ministrive që të kenë mundësi që ta financojnë arsimin plotësues, unë si ministër dhe të gjithë ministrat e përfshirë, do të thotë edhe ministrat e Arsimit të Republikës së Shqipërisë dhe të Kosovës, do t'ju ishim shumë mirënjohës.

Pra, ta kemi mundësinë që të kalojmë prej këtyre fakteve që i kemi krijuar në infrastrukturë që të kalojmë, pra edhe në mundësinë e pagimit dhe financimit të pagesës për mësuesit dhe financimit të shkollave ose mundësive për shkollim të fëmijëve tanë në Diasporë.

Deri tash nuk i kemi këto mundësi. Nuk ka pasur as Republika e Shqipërisë dhe as ne. Pra, presim një vendim nga ju brenda dy leximeve mes dy leximeve mund të kemi një vendim, së paku sa i përket Qeverisë së Kosovës.

U përmenden edhe investimet dhe nuk po tentoj ta zgjasë shumë, mirëpo ishte debat relativisht i gjatë dhe sidomos Diaspora e meriton që t'i qasemi edhe disa minuta.

Investime të Diasporës në Kosovë ka pasur sporadikisht. Ne si ministri së bashku me grupet e ndryshme të interesit sa i përket bizneseve të Diasporës, kemi marrë disa vendime. Një prej tyre është krijimi i zonë ekonomike të Diasporës në Kosovë. Do të jetë një vend specifik në bashkëpunim me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Dhe marrëveshja mes dy ministrive dhe pjesëtarëve të Diasporës, në këtë rast që janë kryesisht nga Gjermania, do të nënshkruhet nga fundi i muajit maj, kur pritet të mbahet forumi ekonomik i radhës të Diasporës në Prishtinë, në Kosovë.

Ky është forumi i tretë që organizohet në mënyrë të suksesshme, ku kemi gjithmonë mbi 400 ose 500 kompani të ndryshme nga Diaspora. Pra, tash edhe interesimi që të investohet në Kosovë, në mënyrë të drejtpërdrejt me ndihmën e Qeverisë, ku nuk do të ketë nevojë për leje, nuk do të ketë nevojë për leje ndërtimi, sepse do të përfshihen në kuadër të zonës ekonomike.

Qendrat kulturore, nuk kemi marrë asnjë model. Ne vetëm kemi vendosur që qendrat kulturore të jenë pjesë e sistemit diplomatik të Republikës së Kosovës. Deri tash ka qenë i paqartë statusi i tyre në shtetet pritëse. Ka qenë e paqartë kontrata e njerëzve që janë marrë me këtë punë. Dikush ka pasur kontratë mbi vepër, dikush nuk ka pasur kontratë fare.

Kurse nuk mund të jetë dikush që punon në një shtet po zëmë si Suedia, të ketë kontratë mbi vepër me Qeverinë e Kosovës dhe të mos paguaj tatim atje, dhe të mos ketë gjendje të rregullt juridike në një shtet ku vepron.

Kemi mundur të hasim, fatmirësisht shtetet ku këta kanë vepruar nuk na kanë nxjerrë kokëçarje, por kanë mundur të na nxjerrin kokëçarje, sepse ne në esencë në dy shtete kemi punuar pothuajse ilegalisht. Kjo ka qenë arsyeja e mbylljes. Po ashtu aspekti i performansës nuk ka qenë aq i kënaqshëm, mirëpo faktet kryesore kanë qenë që juridikisht kemi qenë në problem.

Sa i përket televizionit, kurrë nuk është kërkuar televizion i veçantë. Ka qenë iniciativë e dy qeverive, të Shqipërisë dhe të Kosovës, që Televizioni i Shqipërisë dhe RTK-ja bashkërisht në ato që ofrojnë sot të krijojnë një kanal të përbashkët, ku do të furnizohej me informata nga dy shtetet, por jo të krijohet një televizion i ri.

Pra, ky ka qenë një keqkuptim deri sot, së paku sa i përket Kuvendit.

Ne e kemi sqaruar edhe në komision përkatës që nuk kemi kërkuar kurrë televizion të veçantë, mirëpo vetëm të krijohet një kanal i veçantë në infrastrukturën ekzistuese.

Dikush i përmendi statistikën. Zenun, meqë më duket se ju e përmendet. Po, janë 700 mijë pjesëtarë të Diasporës nga Kosova nëpër botë. Çka është me rëndësi, është edhe një statistikë tjetër, ata në çdo vit, së paku këto dy vite që unë e përcjelli duke qenë ministër, kontributi i tyre zyrtar në raportime të Bankës Qendrore është afër 700 milionë euro në çdo vit. Kurse joformalisht ne të gjithë besojmë se është mbi 1 miliard.

Prandaj, edhe ky ligj dhe që u përmend çështja e arsimit plotësues, duhet të reflektojë në kontributin e sotshëm të Diasporës, jo vetëm atë historik, dhe tua kthejmë edhe këtë borxh Diasporës, duke i ndihmuar fëmijët e tyre që të shkollohen së paku në arsimin plotësues, ashtu siç e meritojnë këta njerëz që kontribuojnë shumë për Kosovën dhe natyrisht kanë kontribuar edhe në të kaluarën.

Besoj që përgjigja edhe në disa pyetje të zonjës Pacolli, nëse jo jemi këtu që t'i përgjigjem. Po, qendrat kulturore i patët. Po, unë e shpjegova se pse janë mbyllur. Unë ju shpjegova zonja Pacolli pse janë mbyllur.

Pra, të nderuar deputetë,

Ju falënderoj edhe njëherë për përkrahjen dhe shpresoj se kur të jemi në votim, edhe në leximin e dytë do ta kemi bashkëpunimin e njëjtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 37 deputetë. Kështu që ne s'mund të zhvillojmë procedurën e votimit. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës:

32. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të punës

Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar ta miratojë.

Unë e ftoj ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Skender Reçica që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministër,

Sot, para jush prezantoj Projektligjin e ri të Punës i cili është hartuar në bazë të obligimeve që i kemi marrë me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, për transpozimin e direktivave të Bashkimit Evropian nga fusha e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për hartimin e këtij projektligji, ne si ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi pasur kërkesa të vazhdueshme edhe nga punëdhënësit edhe nga të punësuarit me qëllim të avancimit të kushteve të punës dhe rregullimit sa më të mirë të kësaj fushe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të vendit tonë me vendet e Bashkimit Evropian.

Hartimi i Projektligjit të Punës konsiderohet si një prej akteve ligjore më të rëndësishme të hartuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në të cilën janë transpozuar 15 direktiva dhe janë marrë praktikat më të mira nga vendet e Bashkimit Evropian.

Por, gjithashtu është synuar që eliminohen të metat e Ligjit aktual të punës me qëllim që të rregullojmë marrëdhënien e punës mes punëdhënësit dhe të punësuarit sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe rrethanave socio-ekonomike të vendit.

Në aspektin përmbajtjesor, Projektligji i punës cilësohet si akt modern që ofron më shumë mbrojtje për punëtorët me qëllim përmirësimin e kushteve të punës, e në veçanti të përmirësojë dhe të avancojë punësimin e grave të reja në tregun e punës.

Dispozitat e projektligjit do të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe biznesin e Kosovës, sepse do të stabilizojnë tregun e punës dhe do ta bëjnë tregun në Kosovë më tërheqës për punëtorët.

Dispozitat e këtij projektligji veçmas do të kenë ndikim në luftimin e punësimit informal apo punës së padeklaruar.

Krahas ligjit në fuqi, ky projektligj është shumë më i avancuar dhe më përmbajtjesor duke rregulluar konceptet e reja nga marrëdhënia e punës, marrëdhënie këto të reflektuara nga puna dhe përcjellja e zhvillimit ekonomik siç janë: Shkurtimi i afatit, përkatësisht periudhës së kontratave të lidhura në kohë me afat të caktuar, fleksibilitetin në orarin e punës, dispozitat të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e grave në punë, marrëdhëniet parakontraktuale, diskriminimi në procesin e rekrutimit, puna e natës, shpenzimet e kontrollit mjekësor, agjencinë e përkohshme të punësimit, të drejtat dhe detyrimet ndaj kësaj agjencie dhe institucioneve të tjera.

Pastaj, mbrojtja e të drejtave të të punësuarve në rast të transferimit të ndërmarrjeve apo bizneseve, njohja e punës së praktikantit si përvojë pune, pagesa e pagave vetëm nëpërmjet llogarive bankare, ndalimi i konkurrencës, kompensimi i dëmit, paga minimale, gjobat dhe shumë çështje të tjera.

Të nderuar deputetë,

Për ta kompletuar Projektligjin e Punës të cilin sot e keni para jush për lexim të parë, ne si Qeveri jemi duke punuar dhe së shpejti do tua përcjellim në Parlament edhe projektligjin për Pushimin e Lehonisë.

Po ashtu, dua t'ju informoj se për herë të parë, risi në legjislacionin e vendit është ndarja e pushimit të lehonisë nga Ligji i punës për t'u trajtuar me një ligj të veçantë, dhe dua tua shpjegoj arsyen pse ne e kemi ndarë për herë të parë që pushimin e lehonisë ta trajtojmë me një ligj të veçantë.

Arsyeja ka qenë që në Ligjin për Lehonat, për pushimin e lehonisë apo pushimin prindërorë siç e kemi quajtur ne, për herë të parë do të trajtohen edhe lehonat, nënat lehona të cilat nuk kanë marrëdhënie pune.

Prandaj, këtu konsiston ajo që ne e kemi ndarë Ligjin e punës nga Ligji për pushimin e lehonisë.

Vonesa e cila ka bërë që sot ta keni vetëm Ligjin e punës në shqyrtim dhe jo edhe Ligjin e Lehonave të cilat duhet të shkojnë paralelisht të dyja bashkë, ka qenë sepse na janë dashur konsultime shtesë për Ligjin e pushimit të lehonisë dhe së shpejti ky Kuvend do ta ketë në duart e veta edhe Ligjin për pushimin e lehonisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sa për procedurë. Në rastet kur nuk ka kuorum, unë nëse e filloj vet seancën edhe e ndërpres, por kësaj herë s'e kam filluar, kështu që po e vazhdoj. Kushte për diskutimin e projektligjeve kaq të rëndësishme nuk ka.

Me 1/3 e Kuvendit nuk bëhet.

Tani, fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale, deputetja Besa Baftiu, për ta arsyetuar raportin e komisionit.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Nëse më lejohet, fillimisht po e jap raportin nga komisioni dhe më pastaj do ta jap edhe qëndrimin nga Grupi Parlamentar i PSD-së.

KRYESUESI: Jo, qëndrimin ndaras.

BESA BAFTIU: Në rregull. Faleminderit!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 shkurt 2019, shqyrtoi në parim Projektligjin e Punës dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

Të miratohet në parim Projektligji i Punës.

Arsyetim

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në Nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me sa shoh deputetja Mirjeta Kalludra në emër të grupit.

MIRJETA KALLUDRA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Edhe grupi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin e Punës dhe konsiderojmë se është i një rëndësie të veçantë pasi që ka të bëjë me rregullimin e njëjës nga të drejtat themelore të njeriut, siç është e drejta e punës dhe zgjedhja e lirë e profesionit e cila hyn në kuadër të të drejtave dhe lirive të themelore të njeriut.

Me këtë projektligj tentohet që të rregullohen marrëdhënia e punës mes punëdhënësit dhe të punësuarit.

Ne të gjithë e dimë se edhe Ligji aktual i Punës i rregullon në masë të mirë marrëdhëniet e punës në Kosovë, mirëpo më tepër kemi pasur moszbatim të tij, dhe në mungesë të mekanizmave mbikëqyrës apo jofunksional në zbatimin e tij si dhe në sanksione minimale për subjektet që nuk e kanë zbatuar.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se legjislacioni i ri që miratohet duhet të përafrohet me legjislacionin e BE-së, mirëpo ne duhet t'i kemi edhe parasysh që të përshtaten nevojat e vendit në kontekstin e zhvillimit ekonomik në përgjithësi.

Do të ndalem te Inspektorati i Punës si mekanizëm apo organi i vetëm i cili mbikëqyr zbatimin e dispozitave nga marrëdhënia e punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili asnjëherë nuk është mbështetur apo fuqizuar në rolin dhe mandatin e tij të plotë në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit nga marrëdhënia e punës.

Pra, edhe aktualisht kemi në mungesë të stafit, është momenti i duhur që nëpërmjet Ligjit të Punës dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës të fuqizohet ky mekanizëm dhe të kemi zbatim sa më të mirë të këtij legjislacioni.

Unë do të ndalem tek disa dispozita apo çështje të caktuara të cilat besoj se do të kenë vëmendjen gjatë shqyrtimit të këtij projektligji nëpër komisionit parlamentare përkatëse.

Të përcaktohet qartë afati minimal i kohëzgjatjes së kontratës që të mos lidhen kontrata afatshkurtra dhe punëmarrësit t'i nënshtrohen presionit të vendit të punës. Tekst të veçantë duhet t'i kushtohet edhe orarit apo kohëzgjatjes së punës, mbështetjes së të rinjve në punësim, trajtimi i barabartë në pagesë për meshkuj dhe femra, ndalimi i diskriminimit gjatë procesit që rekrutimit, mbrojtja e grave gjatë kohës së shtatzënisë dhe gjdhënies, mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve.

Po ashtu duhet të përcaktohet qartë edhe puna me afat të caktuar, punët me afat të pacaktuar, largimet kolektive, të cilat kanë ndodhur dhe po ndodhin edhe aktualisht në emër të riorganizimit.

Po ashtu vëmendje duhet t'u kushtohet edhe dispozitave, ku rregullohet krijimi dhe procedurat e ndërprerjes së marrëdhënies në punës, puna praktike apo puna vullnetare duhet të rregullohen që të mos keqpërdoren punëtorët apo të rinjtë, në këtë rast të luftohen punësimet joformale.

Po ashtu duhet të kemi kujdes në rregullimin e moshës tek të rinjtë apo fëmijët, të cilët kanë të drejtë të lidhin kontratë pune apo të angazhohen në punë. Pasi që Inspektorati i Punës nuk ka arritur të kontrollojë në masë të duhur punën e fëmijëve nën moshën 18-vjeçare.

Duhet të kemi parasysh që të rregullohen qartë edhe çështjen e kompensimit adekuat, pagesat e rregullta për punëtorët, si dhe çështjen e pushimit ditor, javor dhe vjetor, si dhe ruajtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të punëtorëve, me qëllim që të mos vazhdojnë dhe në të ardhmen me humbjen e jetës së punëtorëve në vendin e tyre të punës si rezultat i sigurisë jo të duhur në vendin e punës.

Po ashtu duhet të parashihen edhe dispozita të qarta apo sanksione për ata të cilët e shkelin ligjin.

Dhe, krejt në fund, pas miratimit të këtij ligji dhe Ligjit për Inspektoratin e Punës, kërkoj nga Qeveria që të kenë parasysh që në të ardhmen të parashihet edhe rritja e buxhetit në favor të zbatimit të Ligjit të punës.

Po ashtu Qeveria të parasheh edhe kampanjat e informimit të punëdhënësve dhe punëmarrësve për Ligjin e ri të punës në zbatimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin dhe i jep mbështetje.

Konsiderojmë si parti politike që është në interes të të gjithë qytetarëve që ky projektligj dhe Projektligji për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror të shqyrtohen paralelisht dhe të analizuar pastaj të vijnë për votim në lexim të dytë.

Pasi jam edhe pjesë e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ne edhe si komision jemi në përfundim të draftimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe konsiderojmë në këto tri projektligje pothuajse në aspektin legjislativ ne po e përmbushim kërkesat për të ruajtur dhe mbrojtur të drejtat e punëtorëve, por edhe për të garantuar edhe punëtorët se ata kur investojnë në punëtorë të caktuar, të kenë kontrata afatgjatë që të mos e dëmtojmë biznesin.

Jemi dëshmitarë që viteve të fundit ka pasur shumë raste të lëndimeve dhe vdekjeve në punë. Prandaj, kjo ka bërë që më të nevojshme shikimin edhe një herë të legjislacionit për arsyet e mospërmbushjeve të detyrimeve ligjore nga kompanitë e caktuara.

Nuk do mend se në cilindo market të Kosovës sot shkojmë apo në cilëndo punishte të ndërtimtarisë po të shkojmë shohim që ka moszbatim të Ligjit për sigurinë dhe shëndetin në punë, ka moszbatim të kontratave të punës, ka pagesa të ulëta për punëtorët edhe në sektorin privat dhe, derisa këto pagesa dhe mosmbrojtja e punëtorit është në këtë nivel, atëherë sigurisht që nuk mund të presim një zhvillim më të mirë të këtij sektori.

Pra, i japim mbështetje si subjekt politik këtij projektligji dhe kërkojmë nga ministri që vërtet në një afat sa më të shpejtë kohor të sjellë edhe Projektligjin për lehonat dhe pushimin prindëror, është më se e nevojshme që këto dy projektligje vërtet t'i trajtojmë njëkohësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, deputetja Fatmire Kollçaku e ka fjalën.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Që në fillim, edhe pse ministri qëndroi këtu tërë ditën në pritje të debatit rreth këtij projektligj, me të vërtetë kjo praktikë e vazhdimit, qoftë edhe të diskutimit për projektligje që tani është e sigurt që nuk ka gjasa të votohet, duhet të ndërpritet në Kuvend të Republikës së Kosovës. Si do që të jetë le të bie kjo kritikë në çdo deputet, pozitë dhe opozitë, me 24-25 deputetë nuk

diskutohet projektligji, ndoshta ndër më të rëndësishmit në Republikën e Kosovës që e prek çdo qytetar, çdo punëtor.

KRYESUESI: Ju lutem, të na jepni qëndrimin e grupit tuaj parlamentar.

FATMIRE KOLLÇAKU: Kryesues, mos po doni të ma kufizoni të drejtën e asaj çka po them, edhe po e them konkretisht që ka të bëjë pikërisht me këtë ligj.

Pra, të diskutohet në këto rrethana është për keqardhje...

KRYESUESI: Qëndrimi kërkohet.

FATMIRE KOLLÇAKU: ...dhe kjo do të vazhdojë, ky projektligj sot do të diskutohet, po nuk dihet fati i tij kur do të kemi mundësi ta votojmë. Ju e dini që 50 pika këtu janë duke u zvarritur seancë pas seancë pikërisht për shkak të keqmenaxhimit të seancave, për shkak të parregullsisë në këtë Kuvend, ku nuk kemi agjendë të seancave të rregullta dhe në orët e vona lihet të diskutohen ligjet kaq të rëndësishme.

Sa i përket qëndrimit, është e pakuptimtë që është sjellë Ligji i punës, pa u sjellë në të njëjtën kohë edhe Projektligji për lehonitë, për pushim prindëror. Është dashur të vijnë të dyja në të njëjtën kohë, sepse pikërisht kjo është ajo ku kemi pasur vazhdimisht pengesa edhe në zbatimin e Ligjit për punë, ku vazhdimisht kemi pasur diskutime dhe probleme për zbatimin e pushimit të lehonisë apo tashmë pushimit prindëror.

Prandaj, kërkesa e parë për ta votuar ka qenë që të sillen të dytë në të njëjtën kohë, nëse nuk keni dashur ta rregulloni çështjen brenda Projektligjit të punës, është dashur të vijnë dy projektligjet në të njëjtën kohë, që të kemi në situatën e qartë sa i përket gruas dhe ju e dini që diskriminimi më i madh për gruan, e cila sot punon në veçanti në sektorin privat, lidhet pikërisht me pushimin e lehonisë, sepse aty shpesh për gra të cilat planifikojnë familjen dhe në kohën e pushimit të lehonisë në një farë forme gjendet një modalitet që t'u ndërpritet marrëdhënia e punës. Kjo është vërejtja e parë dhe vërejtja bazike që e kemi ne.

Ju e dini që Projektligji i punës, siç e thashë, prek çdo të punësuar. Ne edhe tani e kemi një Ligj të punës, i cili deri në miratimin e këtij të riut është në zbatim. Po çfarë po ndodh, a po zbatohet?

Ministër, ne problemet më të mëdha i kemi në zbatueshmërinë e ligjeve. Ju e dini që në sektorin privat, në veçanti nuk ka fare siguri në punë, nuk ka kontrata të qëndrueshme, të rinjtë dhe të rejtat sot punësohen qoftë në organizata të ndryshme, në kompani mediale, në organizata të tjera në periudhë prodhuese tre muaj, gjashtë muaj dhe pastaj fare nuk i paguhet as ajo punë dhe merret punëtori tjetër.

Ju e dini që kontratat nuk kanë qëndrueshmëri, brenda 24 orëve një punëtor sot e humb punën në Republikën e Kosovës dhe nuk ka kush t'ia mbrojtë të drejtën.

E dimë që nëse i referohemi si 'dita zero' periudhës pas luftës, sepse te ne ashtu siç ndodhi çdo gjë i referohemi pas luftës, sikurse mos të kishim pasur fare ligje më herët dhe mund të themi lirisht që nga përfundimi i luftës Kosova është duke u ballafaquar me një deficit në aspektin e punësimit dhe të qëndrueshmërisë së tregut të punës në përgjithësi.

Ky deficit, i cili shprehet me tregues statistikorë, që tregojnë një gjendje të mjerueshme të marrëdhënies në prodhim, është treguesi më i mirë për gjendjen faktike e cila mbretëron në terren.

Kosova me një kapacitet të popullsisë aktive të aftë për punë, që tejkalon çdo mesatare në krahasim me vendet e tjera në rajon, por bile edhe në shumë shtete evropiane, ka një papunësi prej mbi 45% të popullsisë aktive.

Kjo gjendje e përcjellë dhe e shkaktuar me politika qeveritare të paqëndrueshme dhe afatshkurtra, kanë shkaktuar një mjerim në aspektin e politikave të gjenerimit të vendeve të reja të punës.

Kjo politikë e paplanifikuar ka shkaktuar një gjendje të ashpër në tregun e punës, e shprehur në disbalancin në mes të ofertës të punëdhënësve dhe kërkesës, numrin enorm të punëkërkuësve, të papunëve.

Dhe, rezultati i gjithë këtij epilogu është varfëria e mjerimi i 45% të popullsisë që jeton me më pak se 1,42 euro në ditë dhe 18% megjithatë e popullsisë jeton ende në varfëri ekstreme, me më pak se 0,93 euro në ditë.

Këtë gjendje e rëndon brishtësia e funksionimit të institucioneve ekzekutive dhe gjyqësore që në aspektin e zbatimit të legjislacionit të kualifikuar nga marrëdhënia e punës ka treguar vetëm një dështim të përcjellë për më shumë se dekadë tashmë.

Kur merret parasysh edhe niveli i mosorganizimit të të punësuarve në organizata përfaqësuese, kjo na tregon më së mirë se punëtorët janë kryesisht të pambrojtur dhe të paorganizuar.

Ne konsiderojmë se edhe pse pushtetet janë të ndara, është rendi juridik, i cili siguron ndërlidhjen e tyre. Me sigurimin e zgjedhjeve efikase ligjore, të cilat para së gjithash do t'u përgjigjen nevojave konkrete shoqërore, janë nga garant kryesor me të cilët do të vijmë deri te përmirësimi i tregut të punës në përgjithësi dhe marrëdhëniet e punës në veçanti.

Ne angazhohemi për një infrastrukturë ligjore, e cila do të garantojë një ambient të sigurt dhe të dinjitetshëm për të punësuarit. Në fokus të strategjisë legjislative është avancimi i rregullimit të Ligjit të punës, si ligj bazik për rregullimin e të drejtave në punë.

Çështje tjetër që do të rregullohej me ndryshimin e Ligjit të punës është edhe orari i plotë i punës, i cili do të modelohet në kohëzgjatje 35 deri 40 orë në javë. Kështu që orari prej 40 orëve paraqet maksimumin e kohëzgjatjes së orarit, me ç' rast puna shtesë nuk mund të ketë kohëzgjatje më tepër se pesë orë në javë për dy javë brenda tre muajve.

Ne mendojmë se kohëzgjatja e orarit nuk është element i vetëm i produktivitetit në punë. Sot efikasiteti në punë mungon për shkak të demotivimit të të punësuarit karshi kushteve në të cilat ai punon. Me sigurimin e standardeve bazë, me të cilat sigurohet puna e dinjitetshme, do të sigurohet edhe efikasiteti dhe produktiviteti i të punësuarve.

Gjithashtu çështje tjetër që duhet të rregullohet me Ligjin e punës është ndërprerja e marrëdhënies së punës me rastin e skadimit të kontratës së punës.

Ligji i punës, në mungesë të fondit për të papunët do të përcaktojë pagesën e dy pagave me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës së punës. Kështu do të kufizohet arbitrariteti, i cili shprehet në shfrytëzimin e zbrazëtisë ligjore për kohën minimale të lidhjes së kontratës së punës, nga se punëdhënësi nuk do të jetë në gjendje të lidhë kontrata për periudha të shkurta disamujore.

Po ashtu nivelimi i pagave sipas rrezikshmërisë së punës deri më 20% sipas shkallës së rrezikshmërisë është çështje tjetër që duhet të synohet të rregullohet me ndryshimin e Ligjit të punës.

Me këtë do të kompensohej i punësuarit në mënyrë më të dinjitetshme për shkak të kryerjes së punëve me rrezikshmëri më të lartë.

Me qëllim të sistemimit të pagave sipas përvojës së punës, me ndryshimin e Ligjit të punës do të parashihet dhe vlerësimi i benefitit, pra që vazhdon edhe me këtë ligj, për përvojën e punës për çdo pesë vjet me ngritje 5%, duke kalkuluar indeksimin vjetor për 0,5% të pagesës.

Me gjithë këto rregullime alternative, pra synojmë që të rregullojmë gjendjen në tregun e punës dhe që të punësuarit të gëzojnë një situatë më të volitshme në marrëdhënien e punës. Të gjitha duke i pasur në konsideratë se puna është mjeti kryesor i sigurimit të mirëqenies së secilit punëtor.

Po ashtu është tepër i rëndësishëm edhe zhvillimi i dialogut social në nivel sektori dhe ndërmarrjeje. Dështimi i funksionimit të Këshillit Ekonomik-Social, si niveli më i lartë deri më tani, pra si niveli më i lartë i zhvillimit të dialogut trepalësh social, tregon qartë se nevojitet një angazhim në nivel më të drejtpërdrejtë të partnerëve socialë dypalësh, në mënyrë që të konkretizohet avancimi i të drejtëve në marrëdhëniet e punës.

Lëvizja Vetëvendosje, si alternativë afron planifikimin e themelimit të këshillave socialë në nivel ndërmarrjeje dhe sektori me bazë ligjore.

Përfaqësimi i të punësuarve dhe punëdhënësve: Në çdo ndërmarrje që ka mbi 10 punëtorë të punësuar, me themelimin e këtyre këshillave do të sigurojë kultivimi i dialogut social në nivel ndërmarrjeje, i cili do të kontribuonte në lidhjen e kontratave kolektive në nivel të ndërmarrjes.

Me këtë do të arrihet qëllimi kryesor i mbrojtjes kolektive të të drejtave në punë, pra zgjerimi dhe konkretizimi i të drejtave në punë.

Po e ndërpres, meqenëse edhe sekondat janë në përfundim.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Sot, meqenëse jam pjesë e dy komisioneve, më ra pak më shpesh të flas, ndokujt i dhemb kryet, po, po flas.

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të gjithë ata që na dëgjojnë,

Ky është një prej projektligjeve më të rëndësishme në sferën e punës.

Detyra e komisionit dhe e deputetëve është jo veç amendamenti i projektligjeve, por është edhe monitorimi i ligjeve sa po gjejnë zbatueshmëri.

Ne si komision e kemi bërë edhe monitorimin e Ligjit të punës edhe plot ligjeve të tjera.

Dhe, në fakt, kemi hasur që nuk zbatohen në praktikë ashtu siç janë ligjet dhe e kemi parë që është domosdoshmëri që këto ligje të sillen në Kuvend qoftë për plotësim-ndryshim apo si ligje të reja, sepse nëse flasim tash për Ligjin e punës, e shohim se janë shkelur të drejtat e punëtorëve, sepse gjatë monitorimit dhe inspektimit që e kemi bërë në plotë institucione publike,

po edhe në institucione private, kemi parë se nuk respektohet orari i punës, nuk respektohet pushimi vjetor, nuk respektohet pushimi mjekësor dhe këtu me automatizëm po bëhet shkelja e të drejtave të punëtorëve.

Po më vjen mirë që tash ky projektligj, meqenëse është edhe si obligim nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, parasheh avancimin e kushteve të punës të punëtorëve, po është bërë edhe sipas direktivave të Bashkimit Evropian, sepse është bazuar edhe në 15 direktiva të Bashkimit Evropian që e rregullojnë sferën e marrëdhënies së punës.

Ne si Komision për Punë dhe Mirëqenie Sociale njëkohësisht e kemi në amendamentim edhe Ligjin e Inspektoratit të Punës, por e kemi edhe Ligjin ekonomik-social dhe mirë që ministri e tha që së shpejti do të silltet edhe Ligji për pushimin e lehonisë apo për pushimin prindëror, siç do të quhet tash në të ardhmen.

Njëkohësisht duke u trajtuar të gjitha ligjet, ne kemi mundësi që të bëjmë ligje që nuk bien ndesh me njëri-tjetrin dhe të jenë ligje të implementueshme.

Ne si Grup Parlamentar i Aleancës e kemi trajtuar këtë projektligj dhe konsiderojmë që është një projektligj shumë i rëndësishëm dhe gjithë kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve, në punën që do të bëhet gjatë amendamentimit në Komisionin Parlamentar.

Andaj, ftoj të gjithë deputetët, meqenëse është ligj i kësaj rëndësie, që ta votojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Republika e Kosovës ka një Ligj të punës, ligj i cili është miratuar në Kuvend në vitin 2010, ligj sado që ka mangësi, ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëdhënia e punës.

Ky ligj nuk është zbatuar, u tha edhe nga kolegët paraprakë, sepse edhe Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka monitoruar këtë ligj dhe ka parë shkelje të mëdha që janë bërë në këtë drejtim.

Po ashtu edhe në këtë Kuvend, qoftë në mandatin e kaluar, qoftë në këtë mandat, edhe në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale shumë herë janë diskutuar shkelja e të drejtave të punëtorëve në punë, që shumë herë kjo shkelje ka shkuar edhe në shkelje të të drejtave të njeriut.

Prandaj, po them se nuk është problem ky ligj aktual që e kemi, mirëpo problem është moszbatimi i tij.

Projektligji i sotëm i punës që e kemi në shqyrtim të parë është më i avancuar se ligji aktual. Megjithatë, një pjesë e ndryshimeve janë kozmetike.

Ky ligj do të ishte kuptimplotë nëse krahu i tij do të ishte funksional Ligji për sigurime shëndetësore, Ligji për siguri dhe shëndet në punë, nëse do të kishim të rregulluar Ligjin për fatkeqësinë në punë, Ligjin për sigurimin e papunësisë.

Derisa këto ligje nuk janë funksionale dhe nuk i kemi, mbrojtja e punëtorëve, respektivisht të drejtat e tyre do të jenë vetëm sipërfaqësore.

Po ashtu ky projektligj është dashur që të vijë në pako, ashtu siç e potencoi edhe ministri, së bashku me Projektligjin për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror, sepse nëse ky ligj kalon, miratohet në lexim të parë, po ashtu edhe në lexim të dytë, u pa interesimi i të gjitha grupeve parlamentare që do të japin kontributin në këtë drejtim, atëherë Ligji për pushimin prindëror dhe pushimin e lehonisë, i cili është i cekur në këtë ligj, nuk ka ardhur në Komision për Shëndetësi dhe nuk ka ardhur në Kuvend.

Do të mbetet një vakum në mes të miratimit të këtij ligji, e normalisht dihet që ligji paraprak bie prej funksionit.

Prandaj, periudha prej miratimit të Ligjit të ri të punës deri në miratimin e Ligjit për pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror, që po shpresoj që do të vijë shumë shpejt, ashtu siç tha ministri, atëherë mbetet një vakum sepse nuk mund të përcaktohet me ligjin paraprak.

Ndërsa në këtë ligj në nenin 118 që e rregullon këtë çështje thuhet se “saktësisht pushimin e lehonisë dhe pushimin prindëror e përcakton ligji i veçantë”.

Ne në komisionin do të japim vërejtjet dhe sugjerimet tona, meqenëse jam edhe kryetare e komisionit do të jem shumë e vëmendshme që të marrim insintivat e shumë shoqërive civile, të përfaqësuesve të organizatave jo qeveritare, të sindikatave dhe do të punojmë si grup dhe me të vërtetë të bëjmë një ligj, i cili do të jetë i zbatueshëm në praktikë.

Prandaj, këtu më lejoni që të shpreh vetëm disa vërejtje apo sugjerime, që në emër të Grupit Parlamentar të PSD-së do t'i them, ndërsa shumicën e vërejtjeve ne do t'i themi në punën që do ta bëjmë në komision.

Në nenin 21, që ka të bëjë me punën provuese, ku puna provuese mund të dakordohet në kontratë të punës, por më së shumti gjashtë muaj, ne mendojmë se afati prej tre muajsh për punë provuese është i mjaftueshëm, sepse nëse vazhdon, ekziston mundësia për keqpërdorime.

Afati prej tre muajsh është i deklaruar në çdo kontratë pune, pothuajse në vendet perëndimore.

Neni 21.6, që lejon shkëputjen e kontratës së punës për gratë shtatzëna, nëse punëdhënësi ka arsye të tjera që s'kanë të bëjnë me shtatzëninë, thuhet. Prandaj ky nen mundëson që çdo grua shtatzënë të largohet nga puna, sepse punëmarrësi gjithnjë do të gjejë një arsye tjetër për ta larguar nga puna.

Ky nen u hap derë punëdhënësve, ashtu siç është vepruar deri më tani, në shumicën e rasteve për të mos mbajtur në punë një grua shtatzënë.

Neni 27, që ka të bëjë me kontratat e punësimit për afat të caktuar, edhe pse ka avancim në krahasim me ligjin aktual, sepse Ligji aktual i punës nuk ka përcaktuar afat minimal të kohëzgjatjes së kontratës. Ne mendojmë që kufizimet, siç janë edhe në këtë projektligj, nuk janë të nevojshme.

Çdo kontratë duhet të jetë e përhershme pas punës provuese.

Nëse punëdhënësi nuk do të mbajë në punë një të punësuar, atëherë mund ta largojë nga sipas procedurave të parapara me ligj.

Neni 35 përcakton afatet e largimit të punonjësve nga puna.

Mendoj që këtë çështje duhet ta diskutojmë në komision, pasi që ka praktika të ndryshme në Evropë në këtë drejtim, ku punonjësit largohen nga puna. Ata trajtohen me Ligjin për papunësinë, kjo te ne nuk është e rregulluar. Për këtë arsye, meqë nuk kemi sigurim për papunësinë, afatet duhet të jenë më të gjata, jo 30 ditë për një vit siç është tani, 45 deri në 10 vjet dhe 60 ditë më shumë se 10 vjet. Zgjatja e afateve, respektivisht kompensimi duhet të diskutohet, po ne do të propozonim që ata persona që kanë punuar një vit të kenë 30 ditë, deri në 10 vjet, 90 ditë dhe mbi 10 vjet, 180 ditë.

E njëjta gjë duhet të diskutohet edhe për largimin kolektiv nga puna në nenin 44, që po besoj se gjatë diskutimeve që do t'i kemi, qoftë me dëgjim publik, qoftë në komision me ekspertë të këtij lëmi, ne do t'i kemi parasysh këto nene.

Neni 59, që ka të bëjë me ndarjen e orarit të punës, duhet të rishikohet po ashtu me kujdes.

Në nenin 76, që ka të bëjë me pushim nga puna në rastet e dhënies vullnetare të gjakut, thuhet se personi që jep gjak vullnetar ka një ditë pushimi në ligjin, ndërsa që është në kolizion me Ligjin për transfuzionin e gjakut, sepse siç e dini, Ligji për transfuzionin e gjakut ka kaluar vitin që shkoi dhe ne si komision gjatë draftimit apo amendamentimit kemi mundësuar që personi vullnetar të ketë dy ditë pushim, që do të thotë se këtu duhet të jetë dy ditë.

Neni 89, që ka të bëjë me kompensimin e pushimit mjekësor, potencohet se punonjësit në rast të sëmundjes ka të drejtë deri 20 ditë pune brenda një viti me kompensimin 100% të pagës. Ka sëmundje, e di ministër, që kërkojnë trajtim jo vetëm një muaj, po gjashtë muaj, njëvjeçar ndonjëherë edhe më gjatë, natyrisht nuk presim që punëdhënësi të kompensojë gjithë periudhën sa është i sëmurë punonjësi. Mirëpo për të rregulluar kjo çështje duhet rregulluar një fond, i cili merret me kompensimet e rrogës gjatë sëmundjes, fond i cili mbulohet bashkërisht nga punëdhënësi dhe punëmarrësi.

Sipas këtij neni, nëse dikush sëmurët më gjatë se një muaj, ai e humb të drejtën e punës.

Këto janë disa nga vërejtjet, edhe pse kemi edhe shumë të tjera, të cilat, siç thashë në fillim, do t'i paraqesim gjatë draftimit të projektligjit në komision.

Në fund, si shtet jemi shumë larg nga mbrojtja e mirëfilltë e të drejtave të punëmarrësve. Sa më shumë të jetë i siguar punëmarrësi, aq më shumë do të jetë i sigurt edhe punëdhënësi.

Nëse duam të bëhemi pjesë e BE-së, duhet angazhim i përbashkët, vullnet politik i të gjithëve, racionalitet, shqyrtim të mundësive, trajtim real të problemeve.

Ligji i punës është një hap i vogël drejt ecjes përpara. Mbetet shumë, jashtëzakonisht shumë për të bërë në këtë drejtim.

Partia Social Demokrate është e përkushtuar maksimalisht që përmes këtij ligji të përmirësojë të drejtat e punëtorëve, sepse kjo është edhe pjesë e programit tonë qeverisës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi.

BILALL SHERIFI: Kur jemi te Projektligji i punës mendoj që është bërë një punë e mirë në krahasim me ligjin paraprak, por nga shumë vërejtje dashamirëse që i dëgjova nga kolegët, besoj që edhe ministri do t'i ketë parasysh që në fazat e mëvonshme të përfshihen në variantin përfundimtar, sidomos në komision në mes të dy leximeve në grupet punuese.

Ajo që më bëri përshtypje kështu nuk e di ku e keni gjetur atë gjashtë muaj punë provuese, gjithkund është tre muaj, në cilindo vend të Bashkimit Evropian është tre muaj, jo gjashtë, së

paku kur flas për Bashkimin Evropian kam parasysh edhe 12 vende themeluese, nuk di çka ka ndodhur pastaj pas zgjerimit që është bërë, ku janë inkorporuar edhe vendet, të cilat vijnë nga një transicion, siç është edhe vendi ynë.

Ndërsa sa i përket respektimit të ligjit, jemi vend që kemi shumë mungesa në këtë drejtim, të zbatimit të ligjeve, mbrojtjes së të drejtave, heshtjes së punëtorëve për shkak të frikës nga ndëshkimet që mund të pasojnë për shkak të ngritjes të shkeljes së të drejtave të tyre, mosrespektimi i orarit të punës, kushtet e rënda të punës, e shumë të tjera. Ato janë çështje të cilat shteti ka për detyrë të ndërtojë mekanizma, mekanizma shtesë që një ligj të cilin e miraton, edhe të krijojë mekanizma në mënyrë që të gjejë zbatim dhe të mbrojë atë kategori, për të cilin është krijuar ligji.

Por, një gjë unë desha, ministër, ta ngre këtu dhe besoj që ky është shqetësim edhe i gjithë deputetëve, por sidomos i atyre që janë të prekur, ka të bëjë me pagën minimale.

Sipas ligjit, pagën minimale e cakton çdo vit Këshilli Ekonomik Social mes Qeverisë, punëdhënësve, Odës Ekonomike, më duket janë disa aktorë që përfshihen në këtë ndërmarrje dhe, sipas ligjit ata do të kenë parasysh koston e jetesës, do të kenë parasysh indeksin e çmimeve dhe, me sa dimë ne, edhe pse çmimet çdo vit lëvizin, nuk lëviz paga minimale, nuk di ku është arsyeja. Prandaj, nuk duhet t'i lihet kjo vullnetit të Qeverisë dhe të Këshillit Ekonomik Social, nuk duhet të lihet në vullnetin e tyre, por duhet të rregullohet me ligj dhe të sanksionohet mirë që paga minimale të rritet edhe të ndryshojë çdo vit varësisht nga lëvizja e çmimeve.

Ne e dimë që çmimet lëvizin diku në fund të vitit dhe në fillim të vitit gjithmonë kemi çmime të tjera në krahasim me çmimet që i kemi pasur gjatë 12 muajve, nuk i kemi më në vitin tjetër. Dhe, nëse çmimet lëvizin, duhet të lëvizë edhe paga minimale, nëse paga minimale ka disa vjet që është, më duket 135 euro, ndërsa çmimet kanë lëvizur deri në 10-15% në raport me disa vjet më parë, atëherë duhet të lëvizin edhe çmimet. Pra, duhet të rregullohet, unë nuk di, besoj që ju me ekspertët e ministrisë, si dhe me aktorët e tjerë që janë të përfshirë, si Zyra e Bashkimit Evropian, me sa di unë, dhe të tjerat për të ndihmuar që të bëhet një ligj sa më i mirë, duhet të shihni një mënyrë që e detyron Këshillin Ekonomik Fiskal apo nuk e lë në vullnetin e tyre ngritjen e pagës. Pra, të krijohet një mekanizëm automatik për aq sa janë rritur çmimet, për aq për qind së paku të rritet menjëherë paga minimale. Unë mendoj që kjo më shumë është fjalë se sa realitet, kur thuhet se paga minimale i përgjigjet shportës, kjo veç në Kosovë nuk mund të flitet për pagë minimale dhe shportë, sepse janë në shpërputhje të plotë shporta me pagën minimale.

Është thënë disa herë që paga minimale duhet të bëhet 250 euro, po unë nuk di edhe një pagë minimale prej 250 eurosh a do të mbulonte shportën e një familje katër anëtarë. Zakonisht shporta gjithmonë kalkulohet me familjen katëranëtarëshe, çifti, plus dy fëmijë qoftë të vegjël, qoftë të moshës së adoleshencës. Pra, nëse kalkulojmë shportën, na del që as pagat e punëtorëve

nuk janë të mjaftueshme, as të sektorit publik, se lëre më të sektorit privat. Pra, kur kemi parasysh Ligjin e punës zakonisht nënkuptohet apo menjëherë aludohet, asociohet në punëtorë të sektorit privat, sepse sektori publik janë më të organizuar përmes sindikatave, përmes grupeve të tjera, të cilët mbrojnë të drejtat e tyre, si dhe punëdhënësit i kemi mjaft mirë të organizuar nëpër disa asociacione, siç janë Oda Ekonomike, Oda e Afarizmit të Kosovës, e disa të tjera që mbrojnë bukur mirë interesat e tyre dhe kategoria që më së shumti apo më e pambrojtur është ajo kategoria e sektorit privat, për të cilin, zoti ministër, duhet të ndjeni një detyrim shumë më të madh se sa për kategoritë e tjera, jo se të tjerat nuk e meritojnë, por se mendoj se kanë krijuar mekanizma për të mbrojtur interesat e tyre më shumë, ndërsa kjo kategori është vërtet totalisht e pambrojtur, është e në mëshirën e disa inspektorëve, të cilët herë kanë raporte më të mira me punëdhënësit se sa me punëmarrësit dhe herë i raportojnë shkeljet, herë nuk i raportojnë.

Megjithatë, nuk po lëshohem në atë çka të gjithë e dëgjojmë nëpër ndeja me punëtorë, me punëmarrës, punëdhënës. Të gjithë e dinë të vërtetën dhe realitetin në Kosovë, po pak ka gatishmëri që kësaj çështje t'i shkohet me një dinamikë dhe me një vendosmëri më të madhe përpara. Unë shpresoj që ky ligj do të përmirësojë më shumë të drejtat e punëtorëve dhe nëse ka diçka që nuk është përfshirë në proces, unë besoj që ju si ministër dhe si ministri do të jeni të hapur që të përfshihen, se kam përshtypjen që kur vjen ligji në Kuvend, vjen në Kuvend që së bashku me deputetët dhe me Qeverinë të bëhet më i mirë. Shpeshherë vërej një fanatizëm nga disa ministra që me çdo kusht mbrojnë atë që ata e kanë sjellë, thua ti se krejt mendtë e botës kanë qenë të shkruara te ministria e tyre dhe te ministri dhe nuk duan fare të bashkëpunojnë apo ngurrojnë të bashkëpunojnë me deputetët, ndërsa kërkojnë votën e tyre.

Kur kërkohet vota dhe mbështetja e deputetëve, pa marrë parasysh pozicionin e tyre pozitiv apo opozitiv, është mirë që të mbahet veshi hapur dhe të dëgjohen këshillat e deputetëve, qoftë nga pozicioni i pozitës apo i opozitës, në funksion të përgatitjes të një ligji sa më të mirë, i cili pastaj do të lërë sa më pak vend për interpretime të dyfishta, trefishta, apo të ndryshme. Unë pres që ju si ministër të jeni bashkëpunues me të gjithë deputetët, të gjitha grupet parlamentare dhe në veçanti tash në mes të dy leximeve në komisione dhe në grupet punuese, pse jo edhe nëpër debate publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Po diskutojmë për një prej ligjeve që ndoshta ka fushëveprimtarinë më të gjerë, sepse prek qindra a mijëra qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët janë të inkuadruar në sektorin e punës, në sektorin privat, veçanërisht dhe pajtohemi me kolegun Kujtim Shala që tha nuk ka kuptim të diskutohet ky ligj kur kemi prezencë kaq të vogël, në mungesë kuorumi. Por, sidoqoftë po mundohem që, pasi ministri është këtu ta diskutoj këtë projektligj duke i krahasuar me disa prej problemeve që kanë buruar nga zbatimi apo moszbatimi i legjisllacionit aktual të punës.

Një prej problemeve më të mëdha, dhe prapë po ju përgëzoj që e keni sjellë këtë ligj këtu, sepse ka pasur nevojë për azhurnim të legjislacionit që i përket kësaj sfere dhe një prej problemeve më të mëdha që ka ekzistuar ka qenë, në fakt, mosadresimi i duhur i disa çështjeve që, pasi që ka hyrë ligji aktual në fuqi, është parë që është dashur të adresohet dhe problemi që ndërlidhet me atë është edhe kur disa çështje janë adresuar, kanë qenë nëpërmes dispozitave të paqarta. Dhe, çka kam parë kur e kam lexuar projektligjin aktual është se, edhe pse jo në masë të njëjtë sikur ligji aktual, edhe ky ligj lëngon nga paqartësia në një numër të caktuar të neneve. Do të thotë, mbetet për komisionin dhe përfaqësuesit edhe të ministrisë që besoj vijnë në komisionin përkatës që e trajton këtë projektligj për t'i trajtuar deri në pikë të fundit dispozitat që mund të jenë të paqarta, sepse në praktikë pastaj po nxjerrin problem shumë të madh, qoftë te punëdhënësit që s'po dinë çka të bëjnë, qoftë te punëtorët që nuk po kuptojnë çfarë të drejta kanë, e pastaj edhe në rangun e tretë, edhe te Inspektorati dhe gjykata se si ta interpretojnë një dispozitë të caktuar.

Çështja tjetër që është paraqitur ka të bëjë me një problem, ose një balancim të të drejtave që duhet t'ua ofrojmë ne si shoqëri punëtorëve, në njërën anë, mirëpo në të njëjtën kohë të kemi kujdes që të mos stërngarkojmë komunitetin e biznesit në Republikën e Kosovës, duke pasur parasysh që një numër i madh i bizneseve në Kosovë janë në kufij të ekzistencës. Po flasim veçanërisht te bizneset e vogla, do të thotë ato me pak punëtorë ose me 1, 2, 3 punëtorë, të cilët e kam parë që as Ligji i cili është në fuqi aktualisht, po as projektligji që e keni sjellë nuk e diferencon ngarkesën nga bizneset e vogla në ato të mëdha, që shpeshherë në praktikë ka krijuar anomali. Për shembull, kemi pasur raste ku Inspektorati ka shkuar te një biznes, ku vetë pronari ka qenë punëtor dhe ka kërkuar prej tij a e ke Rregulloren e Punës, a e ke këtë, a e ke atë dhe ndoshta ka pësuar edhe gjoba, kur ai, në fakt, ka qenë një person, vetë pronari, tash natyrisht që ai vetë s'mund të ketë Rregullore të Punës. Edhe vetë kërkesa për Rregullore të Punës ka qenë keqinterpretim i ligjit, sepse bizneset e tilla nuk kanë qenë të obliguara për Rregullore. Kështu që po flasim për disa anomali që janë paraqitur edhe ngarkesat te bizneset e vogla veçanërisht, për arsye se shpeshherë janë paraparë ngarkesa tepër të larta që nuk janë të përbalueshme për bizneset e natyrës të tillë.

Edhe, çështja e fundit që shpresoj se do të adresohet në njëfarë mënyre ndërlidhet me moszbatimin edhe keqzbatimin e ligjit. Arsyeja pse po them për moszbatimin është se, ministër, edhe ju e keni cekur edhe vetë, është cekur edhe prej kolegëve deputetë që keni numër të vogël të inspektorëve dhe çka ka ndodhur në realitet është që Inspektorati i Punës është shndërruar në një rrjet që zë miza e lëshon elefantë, edhe arsyeja pse elefantët kanë kaluar është se kanë paguar. Kështu që unë ju kisha inkurajuar, edhe po më vjen keq që para disa ditës që ishte në agjendë diskutimi për çështjen e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve nuk u mbajt, por shpresoj që t'i vijë radha, sepse desha të sugjeroj që Inspektorati i Punës të ketë një strategji të punës që fokusohet aty ku mundet të ketë zbatimin më të madh të së drejtës, do të thotë të fokusohen aty ku puna e tyre ka më së shumti efekt, jo të shkojnë te një biznes edhe te bëjnë telashe, për shembull, pse s'e ke një dokument në këtë mënyrë ose në atë mënyrë, por të shkojnë aty ku

mund të adresojnë edhe i mbrojnë të drejtat e 1 mijë punëtorëve, 500 punëtorëve, 50 punëtorëve, e kështu me radhë. Do të thotë, le t'i alokojnë ato pak burime, edhe ne pajtohemi që janë pak, t'i alokojmë aty ku mund të prodhojnë më së shumti efekt.

Edhe çështja tjetër që ndërlidhet me çështjen e mosdefinimit të qartë të dispozitave, për shembull, kemi pasur raste ku Inspektorati ka tejkalluar kompetencat edhe pastaj gjykata ka vendosur që s'ka kompetencë t'i adresojë, çështjet që kanë të bëjnë a ka, a s'ka marrëdhënie të punës, a është bërë ndërprerja e duhur, a jo. Edhe, pastaj është dashur të shkohet nëpër procedura administrative për t'ua rrëzuar vendimet që t'i tregohet Inspektoratit që s'ka kompetencë, se është kompetencë ekskluzive e gjykatës për t'i vendosur këto çështje që janë të natyrës juridike. Dhe, rrjedhimisht kjo do të thotë po krijon në praktikë gjëra që janë të padëshirueshme, që humbin kohë edhe për Inspektoratin, për bizneset, për punëtorët, të cilët dëshirojnë t'i realizojnë të drejtat e tyre që u përkasin me ligj dhe që do t'u përkasin me projektligjin në fjalë kur hyn në fuqi. Është mirë që të ketë një definim sa më të qartë në këtë projektligj, t'i eliminojmë çfarëdo paqartësie apo çfarëdo dykuptimësie që mund të ketë në mes të dy leximeve që përfundimisht vërtet të kemi një projektligj që, në njërin anë i mbron punëtorët jashtëzakonisht shumë, por në të njëjtën kohë e kupton që ne nuk jemi as Norvegji, Suedi, Francë, as Gjermani për të bërë ngarkesa të tepërta, duke e pasur parasysh që sektori i biznesit në Kosovë është tejet fragjil, është jashtëzakonisht i dobët dhe ngarkesat e tepërta mund ta fundosin një biznes vetëm për arsye se s'ka kapacitet qoftë njerëzor, qoftë financiar për t'i mbuluar ato.

Edhe një herë po them, t'i eliminojmë anomalitë, një prej çështjeve që u përmend është çështja e lehonisë, një ide shumë e mirë, por çka ka ndodhur në realitet është që i ka detyruar një pjesë e madhe e bizneseve thjesht nuk kanë dashur të marrin në punë pastaj gratë që kanë qenë të moshës për të bërë fëmijë. Prandaj, të mundohemi të mendojmë pak më gjerë dhe të kuptojmë esencën çka po duam të rregullojmë me këtë projektligj, të mundohemi të mos i ngarkojmë bizneset e vogla tepër, sepse ato nesër bëhen të mëdha edhe mund t'i marrin të gjitha përgjegjësitë që i kanë, dhe së fundmi që të sigurohemi që institucionet shtetërore po e zbatojnë në tërësi ligjin edhe mënyrën e duhur, dhe në përputhje me atë çka thotë, jo me çka ata mendojnë që thotë një projektligj i caktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndonëse jemi në diskutimet e fundit sa i përket Projektligjit të punës, konsideroj që është njëri prej projektligjeve tepër të rëndësishme, për shkak se është pjesë edhe e kontratës sonë me Bashkimin Evropian, Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe ne duhet të jemi të përgjegjshëm karshi punës tonë si institucione, jo për faktin që është pjesë e marrëveshjes, por sepse është njëri

prej ligjeve që duhet të garantojë trajtim dinjitoz për punëtorët, veçanërisht për ata në sektorin privat.

E dëgjova me vëmendjen ekspozenë e ministrit dhe ndër argumentet që i përmendi, ndryshimet që do t'i ketë projektligji në fjalë e përmendi edhe mbrojtjen për punëtorët, përfshirjen e grave të reja në tregun e punës, mbrojtjen e grave në punë, si dhe shumë argumente të tjera, të cilat ministri i dha në ekspozenë e tij. Natyrisht që janë tejet të rëndësishme për shkak se ekziston një diskrepancë e madhe ndërmjet punësimit të grave dhe burrave në sektorin publik dhe atë privat, pastaj besoj shumë që projektligji në fjalë do t'i adresojë këto shqetësime. U përmend që është një projektligj më ndryshe nga ligji paraprak, natyrisht që edhe ligji ka ofruar masa dhe nene, të cilat kanë garantuar trajtimin dinjitoz të punëtorëve dhe shumë argumente tjera, të cilat janë trajtuar me ligjin aktual, por që telashe gjithmonë ka qenë zbatimi i tyre dhe nëse ministria ka pasur mekanizma që përmes sanksioneve t'i adresojë shqetësimet, të cilat janë thënë me të drejtë nga shkelësit, ata që do të thotë kanë qenë shkelës të normave dhe të këtij ligji në fjalë.

U tha po ashtu që është pritur që Projektligji i punës të vijë po ashtu bashkë me Ligjin për pushimin prindëror dhe pushimin e lehonisë. Në fakt, kam pritur edhe unë që në pakon e ligjeve, të cilat do t'i sjellë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të kemi edhe Projektligjin e lehonisë, sepse mendoj shumë që e plotëson një kornizë ligjore sa u përket adresimeve që sot u thanë, sepse kemi pasur shumë raste kur ndërprerja e kontratave të punës nga punonjësit do të thotë është bërë pikërisht te gratë lehona për shkak të pushimit të tyre të lehonisë dhe për shkak të asaj që këto kanë pasur, do të thotë janë sfiduar pikërisht për shkak të asaj që janë bërë pjesë e pushimit të lehonisë dhe mu për këtë rast ka pasur edhe kontrata njëmujore dhe kontrata fare pak që punëdhënësi ka ofruar për gratë, për faktin se është sfiduar nga një barrë e rëndë, e cila do të thotë është dashur që të ofrohet për gratë, të cilat e kanë gëzuar pushimin e lehonisë. Unë besoj shumë që gjatë trajtimit të pushimit të lehonisë ne do t'i marrim me seriozitet këto shqetësime, të cilat janë adresuar pothuajse në të gjitha shqetësimet, jo vetëm të shoqërisë civile, por edhe në angazhimin e grave dhe vajzave të reja në punë, që ky projektligj, bashkë me Projektligjin për pushimin e lehonisë duhet t'i trajtojë me shumë seriozitet. Nëse vetëm i shohim statistikat do të thotë një studim të vitit 2017 të D4D-së e kemi pasur një anketë të qytetarëve, ku thuhet se 26% e qytetarëve kanë deklaruar që ka pasur diskriminim pikërisht të grave në tregun e tyre të punës për shkak të pushimit të lehonisë, prandaj ministër, konsideroj që kjo duhet të trajtohet dhe të merret me seriozitet nga ministria që ju e drejtoni.

Ndonëse kolegët e mi deputetë përmendën disa nga sfidat që i prekin kryesisht punëtorët në sektorin privat, ky Kuvend disa herë ka trajtuar çështjen e punëtorëve në sektorin privat dhe sfidat me të cilat ata përballen, kemi bërë edhe rezoluta për t'i adresuar shqetësimet dhe humbjet e jetëve të punëtorëve në sektorin privat, fundja institucionet e kanë për obligim që të marrin masa për rastet e shumta që gjatë këtij viti kanë ndodhur, ku kanë humbur jetën punëtorët e shumtë në sektorin privat dhe e kemi për obligim që Inspektorati të jetë më i vëmendshëm në

trajtimin e këtyre rasteve. Mendoj që është momenti i fundit që shteti të marrë masa konkrete në përmirësimin e kushteve të punëtorëve në sektorin privat në mënyrë të veçantë për pagat dhe trajtimin e tyre konform ligjeve në fuqi. E përmendën edhe kolegët e mi deputetë, do të thotë është momenti i fundit që shteti të ndërhyjë me një reformë ligjore për të ndikuar në pagën minimale, e cila aktualisht në sektorin privat është 130 deri 170 euro dhe për këtë ndikim shteti duhet të veprojë në secilin profesion veç e veç ashtu siç është e rregulluar edhe në një pjesë të madhe të shteteve të Bashkimit Evropian.

Në secilin shtet të BE-së, shteti e përcakton pagën minimale të pagës do të thotë në sektorin publik dhe në atë privat, prandaj duhet të ketë vullnet më të madh që të angazhohemi që kjo pagë të jetë pagë më dinjitoze dhe shteti ta rregullojë këtë problem një herë e mirë, aq më tepër që do të thotë që nga viti 2011 nuk është shqyrtuar rritja e pagës minimale dhe u përmend këtu saktë që përderisa kostoja e jetesës po rritet, paga minimale është ajo e cila është e papërbalueshme për punëtorët në sektorin privat. Kjo pagë natyrisht që duhet të jetë më së paku 300 euro, sepse ka pasur shifra që janë thënë edhe nga përfaqësues të tjerë politikë, se deri ku duhet të arrijë, por meqë sot po flasim për Projektligjin e punës, ministër, konsideroj që ministria, Qeveria, Ministria e Financave duhet ta marrë me seriozitet dhe ta trajtojë çështjen e pagës minimale, të ketë rritje dhe të ketë presion dhe vullnet politik që kjo pagë të rritet një herë e mirë, në mënyrë që edhe këto kuadro profesioniste, të cilat po largohen nga Kosova për të punuar në sektorin privat, të paktën të arrijnë që të kenë një jetë më të dinjitetshme me pagën që atyre ua ofron shteti.

Në fund, ne do t'i japim argumentet dhe qëndrimet tona sa i përket Projektligjit të punës, po ashtu edhe Projektligjit të lehonisë, presim shumë shpejt që projektligji të vijë në mënyrë që të ketë një balancim ndërmjet këtyre dy projektligjeve, të cilat aktualisht na vijnë si të ndara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Edhe mua shumë po më vjen keq që jemi duke e trajtuar Ligjin e punës në mungesë të kolegeve dhe kolegëve, sepse do të ishte një diskutim shumë i mirë, pa marrë parasysh se dikush s'pajtohet dhe dikush pajtohet. Sepse, kemi të bëjmë, në të vërtetë, me ligjin mbi ligjet, ky është ligji kryesor, rregullon veprimtarinë tonë që e rregullon jetën tonë, punën.

Është fatkeqësi kjo, mirëpo unë nuk kam çfarë të bëj tjetër përveçse të koncentrohem në atë që është themelore, thelbore. Ne e kemi analizuar këtë ligj në hollësi, po them në hollësi, nuk ka fjalë, normë, paragraf, pikë që nuk është analizuar me kujdesin më të madh. Zoti ministër, unë duhet t'i theksoj që në fillim dy çështje: një, ligji ka përmirësime që kanë ardhur prej ligjeve të ndryshme, prej direktivave të Unionit Evropian, që është punë e mirë, a përputhen ato me

realitetin tonë a jo, ajo është një çështje tjetër. Mirëpo, një duhet ta kemi parasysh se ky ligj i mbron 350 mijë njerëz në sektorin privat, për arsye po e theksoj në sektorin privat, sepse të punësuarit në sektorin publik janë të mbrojtur me një varg ligjesh të ndryshme edhe janë të mbrojtur jashtëzakonisht shumë, edhe mirë. Problemi është që sektori privat është i diskriminuar në Kosovë, edhe pse ka raportin 4 me 1 gati me të punësuarit në sektorin publik, është i diskriminuar në aspektin ligjor dhe financiar. Në të vërtetë, burimi i të ardhurave për ta mbushur buxhetin e Republikës së Kosovës është sektori privat, thjesht në këtu nuk prodhojmë mbivlerë që paguhet që e mbush buxhetin. Ne konsumojmë, në fund të fundit, ne marrim vetëm paga, por janë ata njerëz jashtë atje që tash momentalisht janë duke prodhuar, me kushte shumë më të këqija se këtu edhe kanë paga shumë më të vogla.

Nuk ka vend në Evropë, edhe këtë thonë ne mund ta arsyetojmë dhe e arsyetojnë, jo i kemi kështu ligjet, jo rrethanat, nuk ka vend në Evropë ku pagat në sektorin publik janë më të larta se në sektorin privat, ajo është vetëm Kosova. Pse? Sepse, Kosova është shndërruar në vend që e mbron të fortin. Nuk e mbron të dobëtin, ky është problemi. Ne kemi dallim jashtëzakonisht të madh të mbrojtjes të punësuarve në sektorin publik edhe privat, jashtëzakonisht shumë. Veç shihni ligjet që mbrojnë njerëzit, shërbyesit civilë apo në forma të ndryshme të punësuarit në sektorin publik, edhe shihni çka kemi në sektorin privat. Një Ligj i punës që i mbron në mënyrë goxha të sakatosur. Kurse, dallimi në të ardhura mesatare në të vërtetë është 1 me 2, dy paga për një në sektorin publik. Mirëpo, kjo është çështje tjetër.

Zoti ministër, ne e kemi trajtuar këtë ligj në hollësi, ka aq shumë çështje, do të dalin aq shumë amendamente sa është e pamundur t'i trajtojë Kuvendi në leximin e dytë.

Ka probleme konceptuale, terminologjike, politike, drejtshkrimore, po ajo kryesorja ka probleme ligjore, juridike, që i përmendën disa nga ta. Duke filluar nga neni i parë, por sidomos te përkufizimet. Unë mund t'ju sjell edhe shembuj. Shembulli i parë është te konceptet punonjës, punëmarrës dhe punëdhënës. Ne kemi këtu punonjës. Punonjës janë të gjithë njerëzit, por jo të gjithë njerëzit marrin punë nga dikush tjetër që i shpërblen për punën e bërë. Domethënë, kemi punëdhënës, edhe nëse kemi punëdhënës, kemi punëmarrës, edhe punëmarrësi dhe punëdhënësi tregojnë një relacion të caktuar ligjor që duhet të rregullohet edhe me përkufizimin, por edhe me konceptin. Prandaj, unë mendoj se në vend të “punonjës” duhet të bëhet “punëmarrës” dhe të bëhet “i barabartë” ose të jetë i njëjtë me punëdhënës, sepse ai që jep punë, i jep dikujt, i jep punëmarrësit, por jo një punonjësit.

Një çështje tjetër domethënë, kemi edhe koncepte të tjera, diskriminimi apo përkufizimi i fëmijëve. Unë po jua tregoj një anomali ligjore, pa i shqyrtuar të gjitha. Tash, e kemi te neni 8, zoti ministër, shiheni si definohet veprimi juridik, merreni një jurist që nuk e keni të njohshëm dhe i thoni se veprimi juridik nuk e ka këtë definicion. Veprimi juridik e ka një definicion tjetër, që e gjeni në kodet e tjera nëse nuk e kemi në kodin tonë. Këtu thuhet se veprimi juridik është

shprehje e vullnetit. Shprehja e vullnetit interpretohet në mënyrë të tillë që lidhur me rrethanat në të cilat është bërë korrespondon me mirëbesim. Merreni cilin doni jurist dhe nuk ka për t'jua dhënë këtë definicion, se është i pakuptimtë, këtë po e them. Vullneti juridik definohet në këtë mënyrë: “Veprim juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta dhe detyrime civile”.

Kjo është shprehja e vullnetit juridik. Pse po e përmend këtë? Domethënë, ky definicion duhet të ndryshohet. Po e përmend për një arsye, sepse në nenin 11.2., thuhet: “Marrëdhënia e punës gjithashtu mund të themelohet me një punonjës të ri në moshë sipas këtij ligji”, edhe ky punonjësi i ri në moshë po ta shihni te përkufizimet është nën moshën 18, prej moshës 18 deri 15-vjeçar. Një njeri në Republikën e Kosovës nuk i pranohet shprehja e vullnetit juridik në mënyrë të ligjshme nëse është nën moshën 18-vjeçare, sepse nuk ka zotësi juridike, këtë duhet ta kemi parasysh. Nuk ka të drejtë të lidh kontratë.

Po, sigurisht juristët tuaj do ta marrin parasysh edhe do ta trajtojnë këtë çështje. Unë, zoti ministër, e kam propozimin, edhe propozimi im krejt miqësor dhe interesant po më bie te ju më së shumti kritika të kem, po ndoshta edhe ju po punoni më shumë, krejt miqësisht ju kisha propozuar ta tërhiqni projektligjin, ta dërgoni te një lektor dhe jurist të mirë, ta bëni një përpunim që të hiqet mundësia e ofrimit të shumë amendamenteve. Unë po ju them vetëm në kompjuterin time edhe jua jap lirisht këtë e kam bërë, dalin rreth 1 mijë amendamente që as ju s'do t'i kundërshtoni, qofshin teknike, gjuhësore, juridike, konceptuale apo të ndryshme. Prandaj, krejt miqësisht po ju them, është e drejtë juaja, është mundësi juaja, nuk është kurrfarë humbje, merrini, i dëgjuat edhe sugjerimet, propozimet, kritikatat qëllimmira të deputetëve dhe deputeteve të tjera, e përpunoni një ligj dhe e sillni, do të ketë numër shumë më të vogël të amendamenteve, sepse kështu do të bëhet një mishmash aq i madh sa as ju nuk do ta njihni ligjin që e keni ofruar.

Unë e kam shumë, po them, unë jua jap lirisht vërejtjet që i kemi ne si grup parlamentar, ju mund t'i shihni a janë të arsyeshme, apo jo, po propozimi im miqësor është tërhiqeni këtë projektligj sa nuk ka hyrë në procedura kur duhet të amendamentohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Është për të ardhur mirë që më në fund çështjet që ndërlidhen me të drejtat e punëtorëve, në rend të parë, sidomos të atyre në sektorin privat, kanë zënë vend në atë që njihet si Agjendë Publike. Edhe përkundër që është vonë dhe kemi diskutuar gjatë gjithë ditës, mendoj që ministri do të marrë parasysh disa nga rekomandimet tona, të cilat do të përkthehen edhe në amendamente konkrete.

Arsyeja pse po diskutojmë tani po ndodh jo me pahir, sepse punëtorët e sektorit privat tash e sa vjet vërtet i kanë të pafavorshme kushtet e punës. Ndonëse ka ekzistuar Ligji i punës, Kontrata kolektive, Ligji për organizimin sindikal dhe Inspektorati i Punës, instanca këto që administrojnë me pronën publike me përjashtim të pronës private. Llojet e tjera të pronës nuk janë të përkufizuara në mënyrë të qartë në Republikën e Kosovës. Në shumë raste shprehjet e përdorura në ligjet aktuale kanë dykuptimësi dhe krijojnë konfuzion dhe pasiguri juridike lidhur me autorizime për administrimin e pronës publike, si dhe të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky autorizim.

Andaj, me këtë projektligj sigurohet një përkufizim standard i pronës publike, të qartësojë kategoritë e pronës publike, format e pronës publike si dhe t'i rregullojë çështjet e tjera që kanë të bëjnë me disponimin, shfrytëzimin, menaxhimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen, vlerësimin dhe evidentimin e gjërave dhe të mirave të tjera të pronës publike.

Ky ligj, do të thotë ky projektligj, ndër të tjera, parasheh edhe kushtet që duhen të merren parasysh gjatë administrimit të pronës publike nga organet shtetërore dhe administrimi i pronës publike nga organet e njësisë së vetëqeverisjes lokale.

Pastaj, obligimet e organeve shtetërore dhe institucioneve apo subjekteve tjera publike që kanë të bëjnë me regjistrimin, vlerësimin dhe regjistrimin e sendeve të paluajtshme dhe të luajtshme.

Afatet për regjistrim dhe dërgimi i të dhënave në Drejtorinë e Administrimit të Pronës.

Andaj, në këtë fazë si grup parlamentar e përkrahim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve. Të bëhet thirrje që të votohet, ashtu-kështu kolegët deputetë s'qenkan këtu. Faleminderit, nënkryetar!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë.

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Sot po e shqyrtojmë edhe një ligj me rëndësi për pronën publike. Ne e dëgjuam vendimin e komisionit, edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, e ka shqyrtuar këtë ligj me shumë kujdes dhe ne kemi vërejtje krejt parimore që janë të mbarsura me probleme politike.

Duke filluar nga neni 4 për herë të parë, tash po ballafaqohemi me një risi edhe ajo është njëjtësimi i pronës publike me atë shtetërore. Kjo nuk ka ngjarë më parë, dhe vërtet kjo duhet të sqarohet edhe me dallim që është bërë përpara dhe çka do të thotë kjo tani.

Në kuadër të pronës ose të organeve shtetërore nxirret edhe niveli lokal. Dallohet tash niveli qendror me nivelin lokal, cilat janë ato prona. Njëherë bëhet njëjtësimi; pronë publike, pronë shtetërore dhe tash ndahet në dy nivele, që është një problem.

Problemi tjetër me radhë që unë po dua ta theksoj është për shembull neni 16. Meqenëse janë këtu ata që kanë punuar në këtë ligj prej Ministrisë së Drejtësisë ne po i hyjmë kësaj çështjeje.

Thotë te bartja e paluajtshmërisë në pronësi publike. Është interesant të shihet, sepse askund as te përkufizimet nuk është dhënë asnjë definicionin se cili është interesi publik, kush e përkufizon atë.

Ndoshta, do të ishte mirë të shihet kjo çështje sesi behet kjo punë. Ngase kjo është shumë me rëndësi, po bartja e pronës për interesin publik edhe mandej kush edhe si e përcakton interesin publik.

Kjo ka të bëjë po ashtu menjëherë me nenet tjera. Neni 17, kemi paragraf që ka të bëjë me qiranë. Kush jep me qira pronën publike, nëse është e tillë domethënë. Edhe e kemi aty njëfarë kufizimi. Ky 15-vjetëshi është interesant, nuk e di pse është instaluar në Kosovë, në institucionet e Republikës së Kosovës.

Qeveria ka të drejtë që të japë me qira deri në 15 vjet, kurse për një afat më të gjatë, pastaj duhet të pyeten kuvendet komunale. Do të thotë nuk pyetet se cila është vlera edhe destinimi. Natyrisht, që secila qeveri ka mundësinë ta bëjë këtë edhe ka ngjarë që e bëjnë domethënë mund ta bëjnë, pa marrë parasysh se cila është vlera. Dhe kështu vendos për diçka që është jashtëzakonisht e rëndësishme. Vendos edhe për tri-katër qeveri që mund të vijjnë pas saj.

Domethënë, ua lidh duart.

Natyrisht, kjo nuk duhej të ishte e lejueshme që një qeveri e aty natyrisht një qeveri në nivelin komunal, tash e kemi një kryetar komune që mund të jetë goxha fort pse një kryeministër goxha i fortë dhe kështu mund ta japë për shembull KEK-un për 15 vjet pa e pyetur as Kuvendin dhe askënd tjetër.

Nëse e kemi pasuri shtetërore dhe pasuri publike është e njëjta gjë, pra pronë shtetërore dhe publike, sepse nuk bëhet dallimi.

Në nenin 23, për shembull në paragrafin 1 kemi edhe koncepte të tilla; parashkrimi fitues. E shikoj në përkufizime, unë për vete nuk e kuptoj konceptin; parashkrim fitues. E shikoj te përkufizimet, kjo nuk është e thënë që duhet t'i dimë të gjitha gjërat edhe nuk ka përkufizim të kësaj terminologjie. Të këtij koncepti.

Ndoshta e dinë këta që e kanë bërë ligjin, unë nuk e di dhe nuk kam mundur ta gjej diku që mund të shpjegohet domethënia e kësaj.

Kemi edhe çështje tjera që dua t'i ngriti. Është te Neni 15 në lidhje me Nenin 32. Neni 32 ka të bëjë me shqiptimin e gjobave edhe thotë: Disa gjoba, edhe çka është shumë e rëndësishme, gjoba për kundërvajtje nga 1 000 deri në 2 000 euro i shqiptohet personit fizik apo juridik që bën bartjen e pronësisë, që është shumë e rëndësishme.

Kurse me gjobë shumë më të rëndë, për shembull disa mijëra euro, tash e kam edhe këtu po nuk po ku e kam momentalisht, shqiptohet vetëm për atë që e jep me qira pa informimin, pa njoftimin e saktë të atyre institucioneve që duhet të njoftohen.

Thotë: Gjykata shqipton gjobë për kundërvajtje e cila nuk mund të jetë më pak se 1 000 e më shumë se 2 000 euro për personin fizik apo për personin përgjegjës të organit të autorizuar në rast se e nxjerr aktin e tjetërsimit të paluajtshmerisë. Domethënë bartjen e pronës që është në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 1.4.

Kurse pak më vonë thotë: Gjykata shqipton gjobë, domethënë në paragrafin 2, e cila nuk mund të jetë më pak se 10 mijë euro e më shumë se 20 mijë euro për personin juridik me autorizimin për administrimin e pronave publike në rast se, e jep me qira pronën publike pa pëlqimin paraprak të një njësie atje. A po e shihni sesi është.

Domethënë, ai që e tjetëron pronën, të drejtën mbi pronën mund të dënohet me 1mijë deri në 2 mijë euro, kurse ai që gabon e jep me qira gabimisht dënohet nga 10 mijë deri në 20 mijë euro.

Tash, ose kanë bërë ndonjë përzierje ose është ndonjë pakujdesi, po unë vetëm pyeta. Pra, cili mund të jetë ai person juridik edhe fizik që e di që dënohet me një kundërvajtje prej 1 mijë deri në 2 mijë euro që nuk e jep një pronë që e ka vlerën, e bart të drejtën e pronës me një vlerë me disa qindra mijëra euro ose miliona, sepse s'ka dënim më të madh. Shumë në rregull kjo.

Kjo s'mund të jetë, zoti ministër, kundërvajtje.

Unë mendoj se në këtë ligj ka probleme thelbësore juridike dhe ideologjike që duhet të shikohen. Por, ka edhe paqartësi juridike. Unë po e përmend një, natyrisht që ka edhe të tjera që duhet t'i shikojmë. Nuk është ligj shumë i gjatë.

Në nenin 53, megjithatë zoti ministër po flasim hapur, shfuqizimi i legjislacionit ekzistues. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji thotë, shfuqizohen dhe pushojnë se vepruari dispozitat e legjislacionit përkatës që janë në kundërshtim me këtë ligj. Cili është ai legjislacion përkatës? A kemi ndonjë ligj?

Secili gjyqtar mund të thotë; jo ky legjislacion ky ligj që po e përmendi ju, tash nuk vlen se nuk është legjislacioni përkatës ngase është një ligj tjetër.

Megjithatë, në literaturën juridike gjatë formulimit të akteve, normave juridike thuhet: Ligji duhet të jetë i qartë, i saktë edhe i shkurt dhe i kuptueshëm. Këtu s'kemi as qartësi, as qartësi edhe unë nuk e kuptoj cili është legjislacioni tjetër përkatës.

Sigurisht, ka edhe gjëra të tjera. Unë mendoj se këtu e kemi një mospajtim parimor, politik dhe ideologjik edhe momentalisht, ne di grup parlamentar në parim nuk e mbështesim këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Këtë ambient i cili nuk po duket se ka hapësirë që të diskutohet shumë përmbajtësisht edhe do të mundohem brenda dy-tre minutave ose më shkurt.

Sa i përket përmbajtjes së vërejtjeve në përmbajtje të ligjit, ne ato i përcjellim gjatë punës në komision. Mirëpo, ministër, unë desha të përcjellë një shqetësim i cili është diskutuar kur kemi qenë në proces të diskutimit të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale.

Disa prej komunave e kanë ngritur një shqetësim e i cili nuk është adresuar as në këtë ligj. Ka të bëjë me pronën publike, përkatësisht pronën komunale. Pra, tokat që i takojnë komunave e mbi të cilat janë ndërtuar shtëpi nga persona fizik.

Tani, komunat nuk munden, sepse krijohet krizë sociale që t'i përzënë nga këto shtëpi të gjithë këta njerëz dhe t'i shkatërrojnë shtëpitë e tyre në mënyrë që të marrin përsipër pronën publike. Po ashtu nuk kanë mundësi që ta rregullojnë këtë çështje.

Për këtë duhet Kuvendi, gjegjësisht Qeveria fillimisht ta hartojë një ligj të veçantë. Ndoshta vendin do ta kishte në këtë ligj, por nuk e pashë që e keni adresuar. Pra, është problemi i pronave komunale të cilat tashmë komunat nuk i kanë në zotësinë, ndonëse juridikisht janë titullar, de facto tashmë ata nuk janë titullar të këtyre pronave.

E dyta, e që uzurpim klasik, kjo ndoshta duhet të adresohet ndryshe, ka të bëjë me pronat e ndërmarrjeve publike. Po e marr një shembull; hekurudhat. Unë kam familjarë që jetojnë edhe në Klinë edhe Prizren dhe nëpër të dyja këto qytete kalojnë hekurudhat ose dikur ka pasur hekurudha sepse ajo në Prizren tashmë as shinat nuk ekzistojnë, sepse edhe ato janë çmontuar.

E dimë që Qeveria jonë e ka marrë një kredi bukur të madhe për rivitalizim të sistemit hekurudhor, por shumë nga, siç thashë, këto hekurudha edhe janë bërë jofunksionale, ndërkaq jo

që janë ndërtuar vetëm shtëpi, po edhe pika karburantesh e kështu me radhë, e që bie në pronësi në këtë rast të hekurudhave.

Edhe kjo çështje duhet adresuar. Ndonëse është ndoshta më lehtë, sepse siç thash janë uzurpime klasike, por megjithatë Qeveria duhet të nxjerrë një vendim, një ligj i cili do t'i zgjidhte këto dy probleme.

Pra, ne presim nga ju që të paktën, çështjen e pronave komunale ta adresoni, qoftë në këtë ligj nëpërmjet propozimeve shtese, amendamenteve që mund të shqyrtohen në komision apo nëse e nevojshme që sa më shpejtë ta hartoni një ligj të ri në mënyrë që komunat ta dinë saktësisht se cilat janë pronat e tyre të cilat janë të shfrytëzueshme nga komunat dhe ato prona të cilat tashmë një kohë të gjatë janë në përdorim nga, në këtë rast ose nga persona fizikë që kanë ndërtuar shtëpi apo dikush tjetër t'u bëhet zgjidhja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Edhe Nisma besoj që gjatë dy lexime, në proces të dy leximeve do të jep kontributin e saj. Në parim e mbështesim tani ligjin dhe besojmë që mes dy leximeve do të merren parasysh rekomandimet e deputetëve nga të gjitha grupet parlamentare. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, a dëshironi që ta merrni fjalën për t'ju përgjigjur dikujt? Në rregull. Nuk ka ndonjë përgjigje që dëshiron ta thotë ministri. Faleminderit!

34. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pijet e forta alkoolike

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka rekomanduar për miratim.

Ministri i pylltarisë nuk është këtu. A ka dikush diçka? Jo, nuk ka. Atëherë, e heqim këtë pikë të rendit të ditës meqenëse s'është askush i autorizuar që ta prezantojë.

35. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Mjedisit, respektivisht të ngarkuarin zotin Gashi që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI DARDAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në pamundësi që zoti Matoshi të jetë këtu do ta prezantojë, unë e bëj këtë propozim sot.

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor në kuadër të hartimit dhe zhvillimit të politikave për planifikim hapësinor, ndërtim dhe banim, ka marrë iniciativë që ta përgatisë këtë projektligj dhe ta procedojë tutje me qëllim të zhvillimit të procesit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore dhe publike, në të gjitha rastet kur është fituar e drejta banesore apo e drejta e shfrytëzimit të përhershëm dhe me qira.

Departamenti për Planifikimin Hapësinor, Ndërtim dhe Banim i ministrisë dhe grupi punues ndërinstitucional ka shqyrtuar, analizuar dhe hartuar këtë projektligj të cilin po ua prezantoj sot.

Qëllimi i këtij projektligji është që të gjithë personave që nuk kanë mundur të blejnë apo të cilëve u është pamundësuar blerja e banesës, e që në mënyrë ligjore kanë fituar të drejtën banesore, do t'ju mundësohet blerja e banesës me kushte të njëjta siç janë procedurat në Ligjin bazik nr. 06/L-61, e që nuk kushtet e blerjes së banesës janë për afërsisht të ngjashme siç është bërë privatizimi i banesave në periudhën 1992-1999, pra në kohën e okupimit.

Bazuar në raportet e komisioneve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij procesi, gjendja aktuale e shitjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, thuhet se ky proces është i papërfunduar, sepse afati për aplikim për privatizimin e banesave sipas këtij ligji ka skaduar më 27 mars 2015.

Prandaj, me këtë projektligj propozohet që të zgjatet afati për shitjen e këtyre banesave dhe të përfundojë si proces brenda tri vitesh, përkatësisht deri në vitin 2021.

Andaj, duke u bazuar në arsyeshmërinë të cilën e theksova më lart, kërkoj mbështetjen tuaj për këtë projektligj dhe të procedohet sa më shpejtë në mënyrë që të gjithë afektuarit të marrin të drejtën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, zonin Muharrem Nitaj për arsyetimin e raportit të komisionit. Zoti Nitaj, e keni fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministër,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2019, e ka

shqyrtuar në parim Projektligjin nr. 06/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit e shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore e ndryshuar dhe e plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247 dhe ka vendosur që Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin që të miratohet në parim projektligji i përmendur.

Pra, për arsye se ky ligj, domethënë ky projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247, është vlerësuar si projektligj i cili i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Realisht i përmendi edhe zëvendëskryeministri Gashi arsyet dhe kohëzgjatjen e këtij projektligji i cili do të shndërrohet në ligj.

Natyrisht, ne do ta kryejmë punën tonë në kuadër të komisionit dhe i rekomandojmë seancës, kur të krijohen kushtet ose numrat që ta miratojë në parim këtë projektligj.

Më falni që isha i shkurtër, sepse shumica e kolegëve duket që janë parapaguar që të flasim 10 minuta.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve të saj në Komisionin për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe ambient e kemi shqyrtuar ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247.

Duke e pasur parasysh që ky ligj, vërtetë ka peshën e vet në problemet e shumta të qytetarët e Republikës së Kosovës, natyrisht që vlen për të punuar në të. Më vjen shumë keq që sot nuk është ministri i Ambientit i pranishëm.

Nuk ishte as ministri paraprak për Ligjin që e kishim për pijet e forta alkoolike, prandaj nuk ia vlen absolutisht, sepse ne nuk kemi më kë të flasim ose t'i japim komentet tona sot në këtë seancë.

Kështu që unë me kaq po e mbyll sa i përket këtij ligji në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritje zoti zëvendëskryeministër,

Edhe Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj që ka të bëjë me ndryshimin e plotësimin e Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-247.

Duke e pasur parasysh që periudha nëpër të cilën ka kaluar Kosova dhe duke e pasur parasysh që çështja e pronësisë banesore është shumë e komplikuar dhe do të duhej që vërtetë të zgjatet afati ligjor për shkak që ajo është tejkaluar, e tha edhe përfaqësuesi i Qeverisë në këtë rast, ne jemi të interesuar që çështja e banesave me pronësi të trajtohet në bazë të ligjeve në fuqi dhe t'ju jepet mundësia atyre qytetarëve që e kanë atë të drejtë që ta realizojnë në formën ma të mirë të mundshme.

Normal që ne jemi të gatshëm që mes dy leximeve ta plotësojmë dhe ndryshojmë dhe t'i japim idetë tona. Kuptohet që deputetët të cilat janë në Komision Funkcional janë më të thirrur dhe me të përgatitur për këtë, dhe sigurisht që mes dy leximeve do të japin kontributin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sali Zyba, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje.

SALI ZYBA: Faleminderit!

Edhe Lëvizja Vetëvendosje e ka marrë në shqyrtim këtë projektligj. Në parim nëpërmjet anëtarëve të komisionit, subjekti ynë i ka dhënë mbështetje në parim, ndërsa kontributin në vazhdim do ta japim nëpërmjet të njëjtit komision, pse jo edhe në seancat e radhës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zyba. Fjalën e ka zoti Muharrem Nitaj, në emër të grupit, apo je habitur dhe e ke shtypur prapë.

MUHARREM NITAJ: Në emër të grupit.

KRYESUESI: Në rregull!

MUHARREM NITAJ: Fare shkurt. Ajo që e thashë në cilësinë e kryetarit të komisionit është qëndrim edhe i Grupit Parlamentar të Aleancës. Realisht problemi që e shqyrton ose e trajton ky projektligj është bukur i ndjeshëm dhe ne jemi të interesuar që të ketë një votë pozitive në Kuvend, edhe natyrisht se do ta mbështesim kurdo që të vjen në votim.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Ministër, e dëshiron fjalën? Jo! Atëherë, mbetet për votim.

Ju njoftoj që kanë ngelur, kuptohet votimet, po ashtu kanë ngelur dy interpelanca; një me kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, dhe një interpelancë me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar, prapë Partia Socialdemokrate.

Ju njoftoj që këto të dy interpelanca do t'i mbajmë të mërkurën, në orën 10:00. Fillojmë me kryeministrin dhe pastaj vazhdojmë me zotin Lluka.

Të mërkurën, pra pasnesër, do të mbahet seanca. Mirupafshim!

* * *

E mërkurë, më 17 prill mars 2019

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 15 prill 2019

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Ju lus që t'i zini vendet!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Paraprakisht kam dy çështje. Kemi një numër të madh të ligjeve, vendimeve dhe rezolutave të cilat i kemi diskutuar dhe s'i kemi votuar. Janë disa çështje tepër të rëndësishme për interes publik, të cilat për shkak të qëndrimeve politike të njërit apo tjetrit grup politik nuk janë votuar dhe që janë interes i të gjitha grupeve politike, mendoj unë, për qytetarët, bizneset dhe shoqërinë, me i miratua.

Do t'i lusja kryetarët e grupeve parlamentare që të merren vesh në mes vete, ta caktojnë një takim dhe t'i marrin një për një këto çështje që mund të votohen dhe duhet të votohen, se janë interes publik, t'i bëjmë pako të gjitha ato që mund të kalojnë dhe t'i votojmë. Mendoj se është në interesin e të gjithëve.

Paraprakisht, dua të them se nënkryetarja e Kuvendit, zonja Aida Dërguti, para se të fillojmë vazhdimin e seancës ka kërkuar fjalën për ta bërë një deklaratë. Zonja Dërguti dhe Ganimete Musliu.

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryesues!

Tash më shumë se një vit që prej ndarjes së Vetëvendosjes po vazhdon një debat i degraduar, në të cilin nuk kam dashur të përfshihem meqë jam mësuar që gjatë tërë jetës dhe angazhimit tim politik të flas mirë për Vetëvendosjen dhe në momentin që nuk mund të flas mirë për Vetëvendosjen unë kam vendosur që të hesht.

Megjithatë, para dy netësh Glauk Konjufca më ka apostrofuuar në emisionin Interaktiv si pjesë e SHIK-ut dhe besoj se ia kam borxh këtë sqarim opinionit, edhe pse e kam mundësinë e dërgimit të një padie për shpifje unë vazhdoj të kem respekt dhe vlerësim për Glaukun dhe e kuptoj situatën në të cilën tashmë ndodhet. Po e them publikisht, sepse nuk mohoj asnjë ditë të angazhimit tim politik e çfarëdo veprimtarie që kam pasur dhe shërbimi im në UÇK ka qenë nder dhe krenari, ka qenë një kontribut modest, por në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret e luftës. Pas përfundimit të luftës, domethënë pas armëpushimit, ku unë kam qenë pjesë e operacionit "Shigjeta", kemi dorëzuar armët. Na është dhënë urdhër që të paraqitemi në zonat tona për të vazhduar angazhimin dhe për të dhënë kontributin e mëtejshëm.

Në këtë kuadër, bashkë me ish-burrin tim, në atë kohë kemi qenë të fejuar, jemi lajmëruar në shtabin në Kolovicë ku komandant ka qenë ish-deputeti i LDK-së, Nuredin Ibishi, i ashtuquajtur i “Komandant Leka” dhe i cili më ka sistemuar në Zonën Operative të Llapit, respektivisht në G2-sh. Detyra ime ka qenë verifikimi i një liste të gjatë të atyre që pretendonin se kanë qenë në UÇK, pra të luftëtarëve që ktheheshin nga zonat tjera dhe qysh në atë kohë patën filluar të paraqiten edhe këta veteranët e rrejshëm, të cilët ktheheshin prej kampeve të refugjatëve në Shqipëri dhe rrugës siguronin ndonjë uniformë. Mirëpo, meqë nuk kisha shërbyer në Zonën Operative të Llapit, rrjedhimisht nuk i njihja as ushtarët e zonës së Llapit dhe nuk mund ta kryeja këtë detyrë mua më është dukur vetja se nuk po mund të jap një kontribut të mjaftueshëm dhe kam dalë prej aty. Pra, pra kam qenë pjesë e G2-shit gjatë periudhës korrik-gusht dhe prej aty kam dalë diku kah gushti. E vërteta është se SHIK-u është themeluar diku kah fundi i tetorit, nëse s’gaboj, pas transformimit të UÇK-së dhe nuk e di nëse ka qenë Glauku, ose nuk ka qenë.

Mendoj se secili për çdo veprim të vetin duhet të marrë përgjegjësi publike dhe në këtë rast unë as nuk jam përfshirë e as nuk dua të përfshihem në këtë debat. Sidoqoftë, dua ta sqaroj edhe pjesën që e ka përmend për bisedën që e kemi pasur këtu prapa në bufe. Siç e thash, ky është debat i degraduar, sepse debati për SHIK-un ka qenë debat në mes LDK-së dhe PDK-së, kur akuzat kanë qenë në njërin anë SHIK dhe në anën tjetër Jugosllavë dhe në fund kanë përfunduar në koalicion dhe mendoj se ky debat është heshtur. Mendoj se pikërisht duke u marrë me debate koti i kemi anashkaluar shumë probleme të rëndësishme, madje-madje nuk kemi ngritur as padi për Serbinë për shumë krime të bëra dhe kjo zhvendosje e vëmendjes në vazhdimësi na ka kushtuar.

Unë i thash Glaukut atë ditë, më vjen shumë keq që ke marrë barrën e një beteje, ku je në krye të kësaj beteje, edhe pse për gjithçka që ka ndodhur brenda Vetëvendosjes Glauku nuk ka qenë fajtor. Bashkë me mua kemi qenë ndër të fundit që kemi marrë vesh se çfarë po ndodh përbrenda Vetëvendosjes, pra një problem që ka qenë për më shumë se një vit. Dhe tani, duke u gjendur në ballë të kësaj beteje, duke mos u mjaftuar me atë që ka ndodhur dhe deklaratimet që janë bërë në fillim, vazhdon akuza se ne jemi ndarë për shkak se ka qenë investim i SHIK-ut, madje-madje atë çka flasin aktivistët e Vetëvendosjes në terren në kuadër të agjitacionit e propagandës, flitet për milionët që i kam marrë unë, Dardani, Visari e kështu me radhë.

Pra, mendoj se kjo është prapë një zhvendosje e vëmendjes prej problemit të vërtetë, sepse në Vetëvendosje ka njerëz që gjuajnë gurin dhe fshehin dorën dhe pastaj në paravan i vendosin të tjerët që ta marrin betejën përpara. Mendoj se në krejt këtë periudhë ka munguar një ballafaqim, një ballafaqim i vërtetë në mes Dardanit dhe Albinit, kur ka qenë edhe fillimi i këtij problemi dhe jo ta marrin këtë barrë të tjerët, të cilët kanë qenë absolutisht të pafajshëm për çfarë ka ndodhur aty.

Por, meqë kjo nuk ka ndodhur, ka ndodhur një rast, kur është marrë për bazë një mesazh imi dhe pastaj është përdorur arsyetimi se arsyeja e problemit është që nuk e kemi lejuar Albinin të bëhet kryetar, e tjerë, e tjerë... mendoj se problemi i vërtetë ka qenë diku tjetër. Sidoqoftë ia kanë borxh opinionit një debat dhe ballafaqim në mes Dardanit dhe Albinit dhe mendoj se nuk duhet t'i iket përgjegjësisë për çfarëdo veprimi në çfarëdo momenti. Unë nuk i ik përgjegjësisë për asnjë veprim gjatë tërë jetës sime.

Mendoj se pjesën më inkriminuese e kam gjatë angazhimit në Vetëvendosje, ku ende i kam të hapura 11 lëndë, ku ka elemente të veprave penale, për të cilat prapë marr përgjegjësi dhe nuk u iki, sepse mendoj se çdo veprim e kam bërë në mënyrë të vetëdijshme dhe nuk mund të marrësh përgjegjësi për vendin, kur nuk merr përgjegjësi për veprimet tua. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Një deklaratë ka kërkuar ta bëjë zonja Musliu. Ju lutem pesë minuta e jo më shumë, asnjërit. Edhe Abdullahu, edhe ti ke...

GANIMETE MUSLIU: Unë e kam vetëm një minutë, as pesë minuta.

I nderuari nënkryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Ministra, kolegë dhe ju të nderuar deputetë,

Sot në Poklek të Drenasit përkujtohet masakra më e tmerrshme që ka ndodhur në Republikën e Kosovës gjatë vitit 1999, ku 54 anëtarë të familjes Muçolli bashkë me mysafirët që i kanë pasur prezentë, janë pushkatuar, janë karbonizuar dhe një lopatë hi është varrosur në një varr të përbashkët nga 54 anëtarë.

Konsideroj që sot në këtë Kuvend, meqë ka koinçiduar të kemi seancë, do të duhej të mbahej një minutë heshtje në nderim të të gjithë të rënëve në Poklek dhe po ashtu, në orën 12:30 nëse ka mundësi të marrim pauzë, për shkak se kemi me shkua në akademi përkujtimore, e cila mbahet në Teatrin e Kosovës. Pra, kërkoj 1 minutë nderim në shenjë respekti dhe nderimi për të rënë në masakrën e Poklekit në Drenas.

(Një minutë heshtje)

KRYESUESI: Nderim! Zoti Hoti, e keni kërkuar fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, nënkryetar!

Ne kemi ardhur në seancë për pikat e të mbetura të të hënës dhe dy interpelanca që janë sot. Unë nuk besoj fare që, me gjithë respektin, fjala e nënkryetares së Kuvendit është relevante për deputetët këtu në Kuvend. Problemet që i kanë në mes vete dy grupe parlamentare ose dy deputetë, deklaratimet e tyre nëpër studio televizive, be4soj se duhet ta zgjedhin një platformë

tjetër për t'u ballafaquar në mes vete dhe jo t'i maltretojnë deputetët këtu në Kuvend të Kosovës, me çështje që janë të tyre personale e që nuk i interesojnë absolutisht askujt.

Unë e lus deputeten, nënkryetaren e Kuvendit, të jetë e kujdesshme edhe kur i referohet të së kaluarës së deputetëve, edhe të së kaluarës së grupeve parlamentare dhe veprimtarëve të tjerë, edhe luftën politike që e kemi pasur vazhdimisht edhe me Vetëvendosjen, tash edhe me PSD-në, edhe me PDK-në, e tjera, e tjera, krejt në suaza të ballafaqimit të koncepteve tona për Kosovën, për të ardhmen e Kosovës.

Unë ju lus juve kryetar, unë nuk ju tregoj juve si ta kryeni punën e juaj, ju e dini më mirë, por të koncentrohemi në punë për të cilat jemi thirrur sot këtu në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë sipas Rregullores kam të drejtë kur të paraqitet deputeti me kohë, ose kryesuesi dhe kryetari, për një deklaratë. Unë nuk mund t'ia ndaloj asnjërit deklaratat. Në qoftë se, kuptohet e shoh, ose kryetari e sheh të arsyeshme se mund ta bëjë.

Tani, edhe unë jam dakord me ato që i thatë ju personalisht dhe po besoj shumica e deputetëve, që çështjet që kanë të bëjnë me studio televizive, me luftën politike, se lufta politike bëhet në Parlament, por ato personalet mendoj se e kanë vendin në variantet tjera të luftës.

Por, sidoqoftë gjatë debateve mund të nxiten edhe personalet edhe ato. Ne s'i kemi ndaluar asnjëherë, ka ndodhur edhe ndodh gjithkund në parlamente, edhe këtu ka ndodhur, kështu që besoj se nuk e ka dëmtuar gjë Parlamentin ajo, përveçse i mori disa minuta për shkak të një sqarimi publik që e bëri.

Po hyjmë në seancë, sepse edhe kryeministri ka punë dhe ministri që ka tjetër interpelancë, ka detyrimet e veta.

Po fillojmë sipas rregullave që i kemi:

1. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zotit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate në lidhje me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës

Të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i PSD-së ka parashtruar kërkesën për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj në lidhje me mosçaktimin dhe rritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë tri orë. Propozuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në dhjetë minuta dhe në

fund të debatit deri në pesë minuta, neni 44, pika 7 i Rregullores. Në bazë të nenit 48.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, e paraqet dhe arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjet e ngritura në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash dhe në fund pyetjeve dhe çështjeve që kanë shtruar deputetët në interpelancë mund t'u përgjigjet kryeministri, sa u përket të gjitha çështjeve që janë ngritur dhe përgjigjet e kryeministrit janë përgjigje të përfunduara dhe nuk ka debat pas përgjigjeve të kryeministrit. Se si përgjigjet është çështje e kryeministrit, sepse nganjëherë po futemi për së dyti në debat.

Koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetët pa grup parlamentar është si në vijim: LDK ka 25 deputetë dhe ka 37,5 minuta; PDK me 23 deputetë, ka 34,5 minuta; Grupi Parlamentar Vetëvendosje ka 19 deputetë dhe 28 minuta; AAK-ja me 13 deputetë ka 19,5 minuta minus 3,5 minuta për kryeministrin, që do të thotë i ka 16 minuta; Grupi PSD ka 12 deputetë dhe 18 minuta; Lista Serbe ka 10 deputetë – 15 minuta; Nisma Socialdemokrate 8 deputetë, që ka 12 minuta minus dy minuta për kryeministrin, do të thotë i ka gjithsej 10 minuta në dispozicion; Grupi 6+ ka 6 deputetë me 9 minuta, minus 1 minutë për kryeministrin, gjithsej 8 minuta; pa grup parlamentar 4 deputetë kanë 6 minuta.

Tani, sipas rregullores ftoj në emër të ushtruesit, kërkuesit të interpelancës, ftoj zotin Visar Ymeri si propozues i interpelancës ta marrë fjalën, që ka dhjetë minuta. Zoti Ymeri, e keni fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues i kësaj seance plenare!

I nderuar kryeministër,

Ministra që jeni prezentë në këtë seancë,

Të nderuar deputetë,

Kjo kërkesa për ta diskutuar pagën minimale dhe gjendjen e punëtorëve në përgjithësi të interpelancës është shkruar më 4 shkurt të këtij viti dhe prej atëherë është duke pritur që të vijë në rend dite në seancë plenare. Sot jemi më 17 prill, që i bie se kanë kaluar saktësisht 72 ditë që prej se është dorëzuar kërkesa e deri te momenti kur u mbledhëm më në fund që ta diskutojmë këtë çështje kaq të rëndësishme dhe urgjente, sipas mendimit tim.

Duket që për institucionet e Kosovës kjo edhe mund të mos jetë e ngutshme dhe nuk po e bazoj këtë vetëm në këtë 72 ditësh prej se ka pritur kërkesa për interpelancë, por po e bazoj në 8 vjet e 100 ditë, ose më shumë se 100 ditë, që prej për herë të fundit institucionet e Republikës kanë marrë vendim për pagën minimale, pra është viti 2011 atëherë kur ishte vendosur që paga minimale të jetë e ndarë në dy nivele, 170 euro për të punësuarit mbi moshën 35 vjeçare dhe 130 euro për ata nën moshën 35-vjeçare.

Kështu ne si institucione e kemi harruar dhe dorën në zemër nganjëherë edhe kujdesemi që ta harrojmë për çdo ditë vështirësinë ekzistenciale që është përditshmëri e punëtorëve në Kosovë.

Sigurisht se secili prej nesh për çdo ditë takojmë e flasim me njerëz që punojnë në këto kushte. Në Kuvend me të punësuarit e Kompanisë për pastrim e mirëmbajtje, në supermarket me punëtorët e krahut e arkëtarët, në ndërtimtari me punëtorët e krahut, në rrobaqepësi, në kompanitë e sigurimeve e në shumë e shumë punëdhënës e ndërmarrje tjera. njëra prej këtyre punëtoreve, e cila më është lutur të mos ia publikoj emrin për shkak të frikës nga hakmarrja nga ana e punëdhënësit, më tregoi se ishte nënë e dy fëmijëve, burrin nuk e kishte në marrëdhënie pune, pagën e kishte minimale 170 euro, që i bie nëse e përpjesëtojmë me numër të anëtarëve të familjes dhe me ditë të muajit t'i ketë 1,40 centë për çdo ditë për çdo anëtar të familjes.

Me këtë 1 euro e 40 centë, natyrisht më tha, duhet të vendoset, pra si familje një muaj të ushqehemi e ta lëmë anash veshmbathjen, muajin tjetër tha detyrohemi të paguajmë disa prej faturave, si rrymën, ujin, e të tjera, dhe ta lëmë anash veshmbathjen e ta reduktojmë ushqimin, një muaj tjetër, pastaj tha, na bie të shpenzojmë në barëra dhe t'i lëmë anash të gjitha këto. Me të nuk arritëm të diskutojmë fare edhe për çështje të tjera të rëndësishme, siç janë shkollimi i fëmijëve, higjiena apo kushtet e banimit, sepse këto vështirësi për të cilat biseduam ose me të cilat ballafaqohet dhe për të cilat biseduam edhe mjaftuan, ta zëmë, krejt kohën e diskutimit dhe të dëshmojnë në fakt se çfarë jete të vështirë ka ajo familje. Dhe, natyrisht se nuk është e vetmja.

Të jesh i rrezikuar nga varfëria do të thotë të mos kesh ushqim të mjaftueshëm për vete dhe fëmijët, do të thotë të jesh i uritur, por edhe kur e mbush barkun je i kequshqyer, sepse ushqimi që ke marrë nuk i përmban kaloritë e nevojshme dhe nuk është i shëndetshëm. Të jesh i rrezikuar prej varfërisë do të thotë të mos e mbyllës dot muajin pa e hapur fletoren e huas tek dyqani i lagjes apo fshatit. Punëtori në Kosovë e veçanërisht ai me pagë minimale nuk është vetëm i varfër, ai është edhe i harruar nga shoqëria. Pra, prej vitit 2011, po e përsëris, në Kosovë ka pasur rritje edhe ekonomike edhe akumulim të pasurisë. Pra, pasuria është akumuluar, kurse paga minimale ka mbetur e njëjtë. Prej vitit 2011 janë rritur tri herë pagat në sektorin publik, kurse paga minimale nuk ka ndryshuar.

Në fakt, paga e tyre është ulur sepse për 8 vjet ne edhe kemi pasur inflacion, rritje çmimesh, që do të thotë se me pagën e njëjtë ata mund të blejnë sot më pak, se sa që kanë blerë ta zëmë në muajin 2011. Rritja e pagës minimale në 250 euro është masa e parë urgjente. Sipas ligjit, paga minimale duhet të ndryshojë çdo vit dhe propozimi për nivelin e saj duhet të shkojë nga këshilli ekonomik-social tek Qeveria, por Qeveritë në vazhdimësi i kanë injoruar kërkesat e sindikatave dhe e kanë sabotuar në njëfarë mënyre dialogun social dhe po flas për të gjitha qeveritë që kanë shërbyer në Kosovë në mandate të ndryshme.

Ligji i punës dhe infrastruktura ligjore në përgjithësi nuk parasheh kurrfarë mekanizmi për ta shtrirë zbatimin e pagës minimale në të gjitha organizatat punuese në mbarë territorin e vendit. Kjo rritje duhet t'i përfshijë të gjithë të punësuarit, pa dallim moshe e gjinie. Parimi pagë e njëjtë për punën e njëjtë duhet përforcuar. Partia Socialdemokrate propozon që ndarja moshore që

parasheh ligji aktual me 130 euro pagë minimale për të rinjtë deri në 35 vjeç të hiqet menjëherë, pra ta kemi një pagë minimale për secilin të punësuar, pavarësisht çfarë moshe e gjinie i takon.

Pas rritjes së pagave në sektorin publik hendekun e të ardhurave midis sektorit publik dhe atij privat është thelluar, andaj rritja e pagës minimale ka efekt kryesisht tek punëtorët në sektorin privat, duke e zvogëluar dallimin e tyre me sektorin publik si dhe duke e zbutur eksploatimin apo shfrytëzimin nga punëdhënësi privat. Niveli i ulët i pagës minimale i godet në mënyrë të veçantë gratë. Përveç se rreth 80% të grave janë të papunë, shumica e grave që punojnë paguhen pak.

Gjendja më e rëndë, sa i përket nivelit të pagës te gratë, është po ashtu në sektorin privat. Dallim tjetër është edhe dallimi moshor. Sipas ligjit aktual ata, ose të punësuarit në Kosovë, trajtohen në mënyrë diskriminuese, veçanërisht ata që janë të rinj, pra nën moshën 35-vjeçare.

Deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Deri sot në Kosovë është folur kryesisht për pagën minimale dhe ajo është e sanksionuar edhe me ligj, mënyra se si merret vendimi dhe se si zbatohet ai. Mirëpo, kjo paraqet edhe një koncept të caktuar dhe ky koncept, për mendimin tim, është i gabuar. Pra, ne duhet të kalojmë na koncepti i pagës minimale tek ai i pagës për të jetuar, pra nga paga për të mbetur gjallë te paga për të jetuar më mirë. Paga për të jetuar nuk duhet ta lerë asnjë grup larg dhe prapa grupeve tjera. Punëtorët që paguhen me pagë për të jetuar duhet të jenë pjesë e integruar e shoqërisë me të drejta dhe trajtim të barabartë. Asnjë grup shoqëror nuk duhet të mbetet mbrapa, sepse shoqëria natyrisht nuk mund të konsiderohet e zhvilluar nëse nuk zhvillohet në mënyrë të barabartë dhe nëse nuk zhvillohet bashkërisht.

Partia Socialdemokrate propozon që paga për të jetuar urgjentisht të ngritet në vlerën prej 250 eurosh. Ky propozim vjen nga konsultimet me sindikatat e punëtorëve dhe është në përputhje me kërkesat e tyre, madje-madje është në përputhje edhe me vendimin e Këshillit Ekonomik Social, i cili është marrë në vitin e kaluar dhe i është dorëzuar atëbotë Qeverisë. Të drejtën në pagë për të jetuar duhet ta ketë secili punëtor nga moshë 18 vjeçare. Ndarja moshore, që parasheh Ligji i punës për pagë minimale më të ulët për punëtorët nën moshën 35 vjeç, duhet të hiqet. Metodologjia e përcaktimit të pagës për të jetuar duhet t'i përshtatet qëllimeve të saj. Qëllimet kryesore të pagës për të jetuar janë luftimi i varfërisë dhe reduktimi i pabarazisë në të ardhura.

E di që kur flasim për këtë çështje, shpeshherë edhe mund të ketë keqkuptime. E kam vërejtur që kur e kemi dorëzuar kërkesën për interpelancë dhe në secilin aktivitet që e kemi pasur për pagën minimale, pra prej tryezave e te konferencat për shtyp, ka pasur keqkuptime thua ti se Partia Socialdemokrate po kërkon që të gjithë punëtorët të paguhen nga 170 euro dhe tash nga 250 euro.

Duhet ta kuptojmë një gjë. Nga aspekti ekonomik, se s'po flas njëherë për drejtësinë sociale, nga aspekti ekonomik është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptohet një gjë. Kur paga minimale rritet, ta zëmë, nga 170 euro në 250 euro, kjo nënkupton që përbrenda ndërmarrjes dhe përbrenda strukturës së pagave në përgjithësi në Republikën e Kosovës secila pagë të rritet proporcionalisht me të. Pra, nuk mundet për shembull punëdhënësi sot, i cili ta zëmë i ka 10% të punëtorëve me pagë minimale dhe 50% të punëtorëve me një pagë më të lartë, për me e marrë një shembull, e ka një punëtor me 170 euro dhe pesë punëtorë me 250 euro dhe nëse paga minimale bëhet 250 euro atëherë natyrisht që ky 250-euroshi më i hershëm duhet të rritet proporcionalisht, sepse këtu po flasim për kategori të ndryshme dhe nivele të ndryshme të punësimit, të cilat e bartin një pagë të caktuar. Pra, kjo nuk nënkupton që me rritjen e pagës minimale secili i punësuar në Kosovë të barazohet me pagën minimale.

Dhe e dyta, e kam vërejtur veçanërisht nga ekonomistët, që thonë se rritja e pagës minimale e ulë konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve dhe bizneseve tona. Një gjë duhet ta kuptojnë secili afarist dhe këtë edhe po ta shtrosh në terme të teorisë ekonomike del e vërtetë. Trajtimi i mirë i të punësuarve i konvenon para së gjithash dhe mbi të gjitha më së shumti pronarit të ndërmarrjes, sepse punëtorët e kënaqur me kushtet e punës janë shumë më produktivë, se sa ata që janë të pakënaqur me kushtet e punës. Dhe në anën tjetër, edhe një gjë duhet ta kuptojmë, rritja e pagës minimale dhe rritja ose një rishpërndarje më e mirë e pasurisë brenda shoqërisë nënkupton që kërkesa agregate në popullin në përgjithësi të rritet dhe rritja e kësaj kërkesë agregate...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë që ta përmbyllë diskutimin.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Për ta përmbyllur, ne si parti Socialdemokrate e kemi dorëzuar një rezolutë, prapë po e përsëris, me 4 prill dhe natyrisht se ajo rezolutë është për t'u diskutuar dhe është për t'u dakorduar edhe me grupe tjera parlamentare.

Konsideroj se është jashtëzakonisht e rëndësishme, që sa më shpejt Kuvendi të marrë vendim dhe të kërkojë nga Këshilli Ekonomik Social që edhe një herë ta diskutojë dhe ta dorëzojë kërkesën në Qeveri dhe po ashtu, të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me këtë rast nga kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, që sa më shpejt ta marrë vendimin për rritjen e pagës minimale, në mënyrë që secili i punësuar në Kosovë ta ketë të paktën mundësinë që me pagën e vet ta bëjë një jetë më të mirë dhe më të pranueshme për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha është e kryeministrit të Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me çështjet e shtruara. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti,
Të nderuar deputetë,
Kolegë ministra,

I nderuar deputet Ymeri, parashtrues i kërkesës për interpelancë,
Tema është mjaftë e rëndësishme, pra është paga minimale. Mendoj se është një temë jetike, që ka një interesim të madh për këtë temë në gjithë vendin. Pra, nuk ka shtresë të shoqërisë sonë që s'është e interesuar për këtë temë dhe e mirëpres mundësinë për të qenë sot bashkë me ju me deputetët.

Më vjen keq pra si kohë, koincidoi me homazhet në Poklek dhe nuk munda t'u bashkohem atje, por i falënderohem deputetes Musliu që të nderojmë prej këtu dhe të jemi në akademi pastaj.

Këto ditë janë të gjitha këto përvjetorë dhe është një situatë vërtetë e një dhimbjeje e një respekti për të gjithë që janë flijuar për lirinë tonë.

Dua të shkoj edhe unë pak me shifrat, vetëm që të kemi një qartësi se si është gjendja sot dhe në çka po synojmë. Paga minimale në Kosovë është 130 euro për të punësuar nën moshën 35 vjeçare dhe është 170 euro për grupmoshën prej 35 deri në 60 vjet. Pra, në këtë rast i kemi dy paga minimale, e kemi pagën minimale për ata që janë nën 35 vjet, që është ajo që e ceka, pra që është 130 euro dhe e kemi pagën mbi 35 që është 170 euro.

Është interesant të theksohet dhe ju lus që këtë ta diskutojmë bashkë, se koeficienti i parë, koeficienti 1, i Ligjit për pagat në sektorin publik është 239 euro. Pra, veç ta kuptojmë, se nuk ka pagë në sektor publik 239 euro, këtë e kam edhe për qytetarët, jo për ju deputetë, se ju e dini. Por, koeficienti i parë është 239 e pastaj pagat në sektor publik fillojnë 1,5... e kështu me radhë si koeficiente. Në Kosovë, po ashtu janë të regjistruar pra 348 000 të punësuar sipas ATK-së. 80 224 nga këta janë në sektor publik. njëkohësisht, është me rëndësi ta dimë që 37 317 janë në nivelin qendror dhe 42 907 janë në nivelin lokal. Pra, këto janë sipas raportit fiskal 2018.

Dua të ju siguroj, ose të ju informoj, se paga minimale çfarë rezulton nën 35 dhe mbi 35, pra ajo prej 130 dhe 170 janë në fuqi nga viti 2011. Pra, kanë kaluar mbi 7 vjet, gati 8 vjet, me këtë pagë minimale. Tani procedura, ose ta quajmë ashtu, procesi i marrjes së një vendimi është Këshilli Ekonomiko Social i propozon Qeverisë propozimin për pagën minimale. Ne kemi pasur një propozim të mëhershëm, mirëpo nuk kemi ndërmarrë vendim për disa arsye. Po ekziston edhe një arsye parimore e nuk ka pasur kuorum ky këshill, mandati i ka dalë, s'ka pasur kuorum. Edhe pa rikthimin e këshillit, pra të anëtarëve ka qenë e pa zbatueshme ligjërisht marrja e një vendimi për një organ që është i kaluar mandati. Vendimi ka qenë i plotfuqishëm, se është marrë në kohë të mandatit të rregullt, mirëpo megjithatë ka paraqitur një situatë konfuze.

I kam kërkuar edhe ministrit Reçica, që është këtu me ne, para tre javësh me shkresë zyrtare, pra emërimin e anëtarëve të bordit, fuqizimin e këtij këshilli dhe propozimin aktual pra të pagës minimale nga ky këshill. Sipas dinamikave kohore që jam në dijeni dhe informatave që kam marrë nga ministri Reçica, këshilli konstituohet nesër, që i bie koincidençë data 18. Pra, megjithatë dinamika nuk është e caktuar sot, kjo ka qenë e caktuar para shumë ditësh, po i bie me e bë nesër këshilli. Edhe këshilli që nga dita e nesërme mund t'i propozojë Qeverisë Propozimin për pagën minimale, që i bie në afate kohore, në mbledhjen e ardhshme të Qeverisë, javën tjetër, Qeveria mund të marrë vendim. Ne nuk kemi të drejtë me paragjykua propozimin, por si orientim, si kryetar Qeverie e kam menduar koeficientin 1, 239 është një bazë e nisjes e parë që kishte me qenë e respektueshme. Megjithatë, nuk kemi të drejtë ne me dhënë numra, se ajo na vjen propozimi, aty do të diskutojmë në bazë të propozimeve që na vijnë. Kuptohet, 239-shin e kemi menduar për kategorinë nën 35 vjeç, pra ideja është që mos me lënë pagë nën 239, po flas edhe një herë nën koeficientin 1.

Tani a bën një shpjegim i shkurtër edhe pse po mendojmë se i ka ardhur koha me u marrë një vendim i këtillë. Më së pari, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm, heronjtë ekonomikë sot në Kosovë janë sipërmarrësit, janë njerëzit që punësojnë njerëz, pra ai që e hap një vend të punës. Disa prej tyre janë të mëdhenj, disa më të vegjël, disa prej tyre ia nisnin sot, ose kanë me ia nis nesër si sipërmarrës. Edhe ne i kemi këta heronjtë tanë. Ne e dimë që nuk mund ta rrisësh pagën minimale pa i forcuar këta, pa ua dhënë edhe këtyre mundësinë e zhvillimit. Mendoj se si Kosovë, pra i kemi ndërmarrë disa veprime si Kosovë, nuk po dua t'ia atribuoj meritën kësaj apo asaj qeverie, ju thash se që nga viti 2011 kjo temë është në tavolinë, i kemi ndërmarrë disa veprime. E para nuk duhet harruar, që ne kemi rregulluar në mënyrë të respektueshme statusin e të punësuarve në sektorët publik me Ligjin për pagat. Nuk po them se është shumë edhe mjafton, por e kemi rregulluar në mënyrë të respektueshme me atë ligj, falë juve, falë Parlamentit, falë përkrahjes që i keni dhënë atij ligji.

Me këtë nënkupton që një pjesë e të punësuarve në Kosovë kanë një status të respektuar, por që me mund me e rregullua statusin e punëtorëve të punësuar në sektorin privat është dashur me e përmirësua klimën e të bërit biznes, pra është dashur me ua dhënë disa mundësi, disa përparësi e përkrahje atyre që punësojnë njerëz. Pra, me u rregullua tregu, fuqia blerëse, me u rritë konsumi, që me mund me i rritë pagat minimale.

Mendojmë se lirimet në tatim të lëndës së parë të makinerisë ose teknologjisë për prodhim, pastaj Ligji për TVSH-në që është në proces, disa veprime tjera, qoftë edhe taksës së fundit, e cila jo të gjithëve, po një pjese të madhe të sidomos prodhuesve u ka dhënë tash fuqi, na mundëson neve më në fund dhe besoj se na respektojnë sipërmarrësit, të cilët e kanë atë po ashtu në interesin e tyre, më në fund ta marrim një vendim që është i përbashkët dhe i respektueshëm e që do ta kishte pikënisje koeficientin 1.

Pse po them na respektojnë sipërmarrësit? Shikoni, në Kosovë informaliteti megjithatë është prezent dhe ne duhet të punojmë së bashku, pra të gjitha palët: punëdhënësit, punëmarrësit, sindikatat... që të rregullohet po ashtu edhe jo veç atmosfera ose klima, ose mundësit e të bërit biznes, po të rregullohet edhe trajtimi i respektueshëm i të punësuarve në sektorin privat. Pra, nuk është vetëm paga, për fat të keq, problemi këtu, ose paga minimale, por është edhe mënyra e trajtimit të të punësuarve në sektorin privat. Na duhet një kujdes i ndërsjellë. I kemi disa mekanizma që mund ta përkrahin pra përmirësimin e gjendjes së kushteve të të drejtave të të punësuarve në sektor privat. Janë plotë mekanizma institucionalë, janë prej Inspektoratit, zbatimit të Ligjit të punës e gjithë mekanizmat tjerë duhet të jemi së bashku.

Dua të theksoj si Qeveri ne mirëpresim përkrahjen e juaj, vendimet e Parlamentit, që të heqim, pra nuk është kjo se një meritë e kësaj Qeverie, assesi, ose një ndërhyrje arbitrare e kësaj Qeverie për ta rritur një pagë si populliste, është një moment kohor i duhur, se është prej 2011 paga minimale, ashtu siç u tha.

Politikat fiskale që i zbatojmë ne nuk janë tonat, ato janë vendosur në Qeverinë e mëhershme, por ne po i zbatojmë. E tani, meqë janë në zbatim ato kanë krijuar një klimë më të mirë të bërit biznes, pra sot. Njëkohësisht, rritja e pagave në sektorin publik na obligon tani, pra nuk mund të anashkalojmë edhe çështjen e të punësuarve në sektor privat dhe të pagës minimale. Duke qenë kështu, pra mendoj që duhet të jemi të bashkuar në rritjen e pagës minimale edhe po ashtu të marrim koeficientin, megjithatë pra ende është herët me paragjykua se si do të vijë propozimi, por ta kemi si pikënisje koeficientin 1.

Si Qeveri, pra do të ishim çdoherë të gatshëm me bashkëpunua në sektorin privat me të gjithë, për të gjitha shqetësimet e tyre që i kanë, por po ashtu jemi të interesuar që të zvogëlojmë informalitetin dhe të mundësojmë të punësuarve në sektor privat, jo vetëm pagë më të dinjitetshme, pagë minimale po se po, por pagë më të dinjitetshme, po edhe kushte të të drejtave në punë. Siç e dimë janë vrarë ose kanë vdekur a lënduar plot punëtorë, një numër i respektueshëm pra i njerëzve në kantiere e vendpunishte e me radhë. Nuk themi se për këtë përgjegjësia duhet të bartet vetëm tek njëri, por duhet ta ndiejmë përgjegjësinë të gjithë, edhe institucionet e vendit, po edhe sipërmarrësit, pra duhet të jemi bashkë në këto tema.

Unë po ndalem me këto që i thash. Mendoj se në total kujdesi për pagën minimale është produkt i kohës dhe i ka ardhur koha. Mendoj se do ta bëjmë së bashku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare, ose përfaqësuesve të grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur zoti Zemaj.

ARBEN ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Duke marrë parasysh që çështja e pagës minimale ka qenë pjesë e debateve edhe në të kaluarën dhe tendenca është për të arritur një zgjidhje, duke ruajtur edhe balancën në mes ekonomisë së tregut të lirë, çfarë e promovon Republika e Kosovës, elementi bazik që e ka vënë në lëvizje dhe e ka përkeqësuar situatën është rritja e pagave të Qeverisë.

Gjithçka që ka vënë në lëvizje negativisht ka qenë e iniciuar nga kjo dhe jo e arsyetuar mirë, nga e cila lindën edhe debatet dhe shprehjet populliste edhe brenda dikastereve qeveritare në Republikën e Kosovës. Ju kujtohet shumë mirë që njëri nga ministrat e përcaktoi vetë pagën minimale dhe tha “kjo është punë e kryer”, ndërsa ministri tjetër i Financave tha, “kjo është e pamundur”, në të njëjtin vit në të njëjtën kohë.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës, qoftë edhe nga kjo interpelancë në vazhdimësi kanë kërkuar që punëtorët në Republikën e Kosovës të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme, sidomos edhe ata në sektorin privat, duke marrë për bazë shërbimet që bëjnë për sektorin publik dhe kjo është e paimagjinueshme gjithmonë duke e krahasuar pragun e pagave në Republikën e Kosovës.

Paramendoni se si ndjehet një punëtor ku në trustin pensional dikush e ka pagën pesëmijë euro, ndërsa paga minimale është 130 euro dhe në shportën shpenzuese të një personi në Kosovë kërkohen 115 euro vetëm për të jetuar thjesht. Andaj, gjithë kjo mund të potencohet si kërkesë për përgjegjësi, por është më shumë kërkesë që ta bëjmë të mundshme të kalojmë nga një nivel në një stad tjetër të zgjidhjes së kësaj problematike.

Kolegë deputetë,

Gjithmonë duhet filluar nga vetvetja. Ne takohemi me punëtorë që kryejnë shërbime edhe këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës nëpër korridoret tona. Kur takohesh me njerëz që kryejnë shërbime për institucionin publik dhe paga e tyre nuk mbërrin 170 euro, janë pastrues të dinjitetshëm që mbajnë familjet e tyre dhe cila është përgjigja jonë sot, cila është përgjigja e Qeverisë edhe aktuale, po mos të mbetet edhe për të ardhmen. Andaj kjo temë duhet të ketë një trajtim dinjitoz, edhe jo vetëm të shprehjeve dhe mekanizmave që gjithmonë iniciojnë diçka që është populliste, jo luftë, qoftë brenda grupeve politike, as brenda dikastereve qeveritare, por një zgjidhje adekuate, duke ruajtur edhe stabilitetin ekonomik, duke bërë të mundshmen në bazë edhe të kursimeve dhe të nevojave që i ka edhe që i ofron Buxheti i Republikës së Kosovës.

Kështu që, ky dallim edhe në mes pagës mesatare në sektorin publik edhe në sektorin privat duhet të harmonizohet me atë që është kërkesë elementare për jetë e qytetarëve në Republikën e Kosovës.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës do të ndihmojë në këtë proces, do të japë edhe argumentet dhe mundësitë e veta, që punëtorët qoftë në sektorin privat, qoftë edhe ata që kryejnë shërbime edhe për sektorin publik, sepse u potencua dhe saktësua këtu që paga në sektorin publik e ka një lloj trajtimi të dinjitetshëm në raport me të tjerët dhe të rregullohet pa përdorur mekanizma dhe pa përdorur institucione tjera që mund të lënë shije të hidhur, siç ishte me sindikatat e arsimit dhe pagat e arsimtarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj! Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më vjen mirë që sot po diskutojmë për çështje të cilat janë me interes për qytetarët. Për ne është shumë me interes që të zgjidhen sa më shpejt çështjet me interes nacional, në mënyrë që të hiqen nga agjenda ditore të subjekteve politike këto çështje dhe ne të kthehemi tek problemet me të cilat përballen qytetarët tanë, te problemet me të cilat përballen bizneset, si dhe të punojmë në krijimin e stabilitetit dhe kushteve më të mira për bizneset e fuqishme ndërkombëtare që të vijnë dhe të zhvillojnë veprimtarinë e tyre edhe në Kosovë, thjesht t'i kthehemi mirëqenies dhe jetës më të mirë të qytetarëve.

Është fakt që rritja disa herë e pagës në sektorin publik ka rritur edhe diferencat me pagat në sektorin privat si dhe ka thelluar dallimet në mes të pagës mesatare në këtë sektor dhe pagës minimale të përcaktuar nga Këshilli Ekonomik Social. Është mirë që sot po debatojmë për këtë çështje duke shpresuar që do të ketë një debat shumë konstruktiv dhe të argumentuar dhe jo thjesht sa për të debatuar.

Të nderuar deputetë,

Paga minimale tek në është rregulluar me ligj. Ligji i punës parasheh që Qeveria në çdo vit të përcaktojë pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomik Social bazuar në koston e shpenzimeve të jetesës, shkallën e papunësisë, situatën në tregun e punës, konkurrencën dhe produktivitetin në vend. Pra, ne kemi një rregullim ligjor për pagën minimale, sepse është e paraparë me Ligjin e punës një gjë e tillë. Në vende të ndryshme çështja e pagës minimale është e rregulluar në mënyra të ndryshme.

Mendoj që edhe në momentin kur është përcaktuar paga minimale me ligj në dy nivele, domethënë 130 dhe 170 euro, nuk ka qenë përcaktim i mirë. Ne nëse duhet të përcaktojmë pagën minimale është mirë që mos të përcaktohet në dy nivele, por të ketë një pagë minimale. Nuk mund të vesh dallim në moshën e të punësuarve, që të përcaktohet edhe paga minimale.

Rregullimi ligjor i pagës minimale tek ne nuk ka kaluar pa debate në lidhje me atë se një rregullim detyruet jep apo nuk jep efekte pozitive. Ne kemi nevojë për një analizë të mirëfilltë për rritjen e pagës minimale, sepse ne kushtet kur informaliteti është i lartë një rritje e pagës minimale mund të mos jep efekte pozitive, si dhe mund të sjellë deri te shkurtimi i vendeve të punës apo rritja e kostos që do ta kenë bizneset në bazë të rritjes së tillë.

Mendoj se marrja e vendimit për pagën minimale duhet të bëhet, sepse e parasheh edhe ligji, por shumë e rëndësishme për punëtorët është që Ligji për punën të ketë zbatueshmëri. Ne tani e kemi në Kuvend në shqyrtim Ligjin për punën dhe mendoj se të gjithë duhet të japim kontributin që të evitojmë zbrazëtitrat që kanë qenë në këtë ligj, në mënyrë që ligji që do të miratohet të jetë vërtet i zbatueshëm.

Është shqetësuese që shumë punëtorë, të cilët janë të punësuar në sektorin privat, nuk e konsiderojnë atë si vend pune. Shtrohet pyetja pse? Nuk është atraktiv sektori privat për të punuar dhe të gjithë presin momentin të ikin nga ky sektor dhe të gjejnë një vend pune në administratën publike.

Kështu si ka shkuar zbatimi i ligjit deri më tani, ia humb rëndësinë përcaktimit të pagës minimale, sepse të punësuarit në biznesin privat përballen me vështirësi edhe më të mëdha, krahas marrjes së pagës jo të dinjitetshme për punën që bëjnë.

Ata diskriminohen në vendin e punës në mungesë të zbatueshmërisë së ligjit dhe në mungesë të monitorimit të bizneseve se sa po e respektojnë të drejtën e punëtorëve, e cila është e përcaktuar me ligj.

Ne shpesh nuk flasim se si trajtohen të punësuarit në biznesin privatë, sepse duam ta ruajmë në një farë mënyre ‘paqen’ me bizneset.

Ne duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur në krijimin e lehtësirave për zhvillimin e bizneseve, por duhet të bëjmë edhe gjithçka që është e mundur që bizneset të respektojnë ligjin, sidomos të drejtat e punëtorëve.

Ne duam që punëtorët të ndihen mirë në punën e tyre, mirëpo realiteti është ndryshe. Punëtorët në sektorin privat nuk e kanë sigurinë e duhur, në disa sektorë punëtorët punojnë 12 apo 13 orë në ditë, punojnë edhe ditëve të vikendit, nuk e gëzojnë pushimin vjetor siç e parasheh ligji, nuk marrin pagën siç është e shkruar në kontratë dhe me probleme të tilla ne ballafaqohemi çdo ditë.

Secili prej deputetëve i ka rastisur t’i dalë një punëtor i ndonjë ndërmarrjeje shumë efektive dhe e madhe në Kosovë dhe t’i thotë që këto çështje nuk respektohen dhe janë të parapara me ligj.

Ne duhet të fokusohemi në zbatueshmërinë e ligjit, institucionet të jenë në nivelin e përgjegjësisë, në mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjit, sepse vetëm kështu mund të arrijmë të ulim papunësinë, të zvogëlojmë informalitetin dhe të ulim pak presionin e madh që bëhet për punësimin në sektorin e Administratës Publike.

Të nderuar deputetë,

Qëllimi i përcaktimit të pagës minimale është zbutja e papunësisë dhe rritja e drejtësisë sociale.

Në disa vende paga minimale ka pasur efekte në zvogëlimin e pabarazisë në të ardhura, zbutjen e varfërisë, zvogëlimin e shpenzimeve qeveritare që kanë të bëjnë në benificione sociale si dhe në forcimin e stabilitetit social.

Por, gjithashtu kanë mbizotëruar edhe mendimi se përcaktimi për pagën minimale mund të ulë nivelin e punësimit dhe të rrisë punësimet informale, derisa pagat më të larta minimale mund të zvogëlojnë gjithashtu edhe konkurrueshmërinë, siç u tha këtu, edhe në sektorin privat.

Në vendet e ndryshme kjo çështje është e rregulluar në mënyra të ndryshme, për shembull, të gjitha vendet e regjionit e kanë të përcaktuar pagën minimale, mirëpo kjo pagë minimale është e përcaktuar në nivel më të lartë se sa paga minimale në vendin tonë dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur që të harmonizohen të paktën me vendet e regjionit.

Në disa vende të Bashkimit Evropian nuk është e rregulluar paga minimale me ligj.

Nëse e analizojmë më me kujdes këtë çështje, bazuar në analizat e ekspertëve ndërkombëtarë, vërejmë se rregullimi politik i pagave ka efekte negative në punësim, sepse nuk lejon konkurrueshmërinë në tregun e punës.

Sipas tyre, nëse shteti ndërhyr në funksionimin e tregut dhe vendosjen e një page minimale dhe kjo është më e lartë se paga ekuilibër, kërkesa për punë edhe mund të bie. Si rrjedhojë, vjen rritja e papunësisë dhe bëhen dëmtime të grupeve të caktuara të profesionalistëve.

Në rrethanat ekonomike në të cilat ndodhet vendi ynë duhet të analizohet me kujdes çështja e rritjes së pagës minimale dhe nga aspekti i ndikimit social, por edhe nga aspekti i zhvillimit të biznesit dhe nga aspekti i ndikimit buxhetor. E them nga aspekti i ndikimit buxhetor, sepse disa skema sociale, të cilat i kemi të përcaktuara, janë të rregulluara bazuar në pagën minimale dhe kjo çështje mund të ketë efekte edhe në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Nga debatet e shumta në lidhje me këtë çështje ne kemi vërejtur se ekzistojnë mospajtme në mes të partnerëve socialë dhe bizneseve në Kosovë sa i përket rritjes së pagës minimale, ku të parët

konsiderojnë se paga minimale nuk është pagë e jetesës, e cila i plotëson nevojat elementare të një familje mesatare në Kosovë. Ndërsa të dytët konsiderojnë se një rritje e tillë e pagës do ta dëmtojë konkurrueshmërinë në sektorin privat.

Rritja e pragut për pagën minimale është e drejtë dhe është e përcaktuar edhe me ligj, bazuar në koston e jetës.

Por ne duhet të jemi të kujdesshëm në dhënien e rekomandimeve për pagën minimale, sepse paraprakisht duhet të ketë hulumtime, analiza nga Qeveria dhe duhet të ketë konsultime paraprake me grupet e interesit.

Duhet të bëhen analizat të indikatorëve të matshëm ekonomikë, siç janë niveli i zhvillimit ekonomik, niveli i papunësisë, gjendjen në tregun e punës dhe shumë çështje të tjera.

Është shumë e rëndësishme të analizohet efekti i një vendimmarrjeje të tillë edhe të punëdhënësi, po edhe tek punëmarrësi, si dhe të analizohen efektet e kësaj vendimmarrjeje në raport me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në mbështetjen e investimeve të huaja.

Vetëm pas analizave të tilla, mund të ketë një vendimmarrje të drejtë.

Kurse, ne që po diskutojmë sot këtu nuk i kemi analizat e tilla për të dhënë rekomandimet e duhura tona për një vendimmarrje më efektive pozitive për të dy palët, pra për të punësuarit, por edhe për bizneset. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zonja Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Edhe po të dua unë të jem kritike ndaj kësaj Qeverie, ndoshta nuk mund të jem aq kritike si parafolësja, e cila bash mirë e ceku si nuk po zbatohen ligjet në Republikën e Kosovës, pra si nuk po respektohen ligjet nga punëdhënësit në sektorin privat dhe i listoi pikë për pikë. E falënderoj shumë, sepse këtu po pajtohem, edhe deputetët e pozitës edhe opozitës, që legjislacioni në fuqi nuk po zbatohet.

Pikërisht pse ai nuk po zbatohet në këtë Kuvend ditë më parë, të mos them dje, erdh në rend dite Ligji i punës, i cili kinse synon ta përmirësojë këtë situatë, në veçanti ta përmirësojë a ta zvogëlojë hendekun mes sektorit publik dhe atij privat.

Prandaj, kur flasim për pagën minimale ne fillimisht duhet të flasim për pagat në përgjithësi se nuk është problemi vetëm te paga minimale. Ne kemi një diskriminim të theksuar sidomos sa u përket pagave në sektorin privat dhe aty veçanërisht në kompanitë e mëdha, të cilat edhe

zakonisht kanë një farë imuniteti edhe nga mbikëqyrja, sepse zakonisht janë ose në pronësi të vetë zyrtarëve të lartë politikë apo familjarëve të tyre dhe kryesisht kanë mundësi të vazhdojnë me këtë diskriminim, bazuar edhe në legjislacion.

Ligji i punës në një farë forme e përcakton një farë orari 40 orësh të punës gjatë javës, ndërsa i kontrabandon tetë orë të tjera, të cilat janë për sektorin privat, ku punëtorët kryesisht punojnë 48 orë, por ato tetë orë as nuk llogariten si punë shtesë, as si punë e rregullt. Zakonisht qeverive u takon të përcaktojnë paga mujore dhe jo paga të përlllogaritura në bazë të orëve të punës që pastaj do të dihet qartë nëse në sektorin privat duhet të punohet 48 orë edhe ligji lejon edhe mbi 48 orë, por kur ka rritje të vëllimit të punës dhe siç duket në sektorin privat në vazhdimësi ka rritje të vëllimit të punës dhe nevojave të jashtëzakonshme.

Prandaj, nëse bëhet përlllogaritja si në shtete të tjera në regjion në bazë të orëve të punës do të zvogëlohej kjo pabarazi dhe do të paguhej punëtori në bazë të orëve të punës. Po ashtu do t'i përlllogaritej edhe puna gjatë orëve të natës, shtesë do të jetë puna gjatë festave, puna gjatë vikendit, që fare asnjë nuk merret për bazë.

Pra, nëse shohim dhe flasim për paga, ju po e shihni çfarë hendeku dhe çfarë pabarazie të theksuar ka në mes të sektorit privat dhe atij publik. Që dje kur ishim në një debat me gratë ndërmarrëse të suksesshme, u tha nga një kolege që fatkeqësisht puna në sektorin privat nuk po shihet e pëlqyeshme, sepse aty nuk ka ato favore që i kanë punëtorët në sektorin publik e që në fakt, u takojnë të gjithë punëtorëve: ditët e pushimit, ditët e pushimit gjatë festave, t'i përlllogaritet pushimi vjetor e të tjera.

Prandaj, sektori privat, fatkeqësisht, kompanitë, bizneset e vogla familjare ato vazhdojnë të diskriminojnë, nuk ndihmohen nga shteti, ndërsa kompanitë e mëdha të fuqishme, të afërta me politikanë dhe me njerëz të fuqishëm me ndikim në shtetin tonë, vazhdojnë t'i diskriminojnë punëtorë pa një mbikëqyrje efektive.

Në fakt, paga minimale paraqet kompensimin më të vogël që sipas ligjit mund t'u bëhet punëtorëve për punën e kryer.

Mund të vendoset si e unifikuar në nivel nacional, pra mund të jetë si një lloj dysheme në nivel nacional, por normal që mund të lejohet e vendosin edhe normave më të larta.

Mund të jetë e njëjtë për të gjithë sektorët ose të variojë nga sektori në sektor, duke pasur parasysh, siç e thashë, atë minimumin që vendoset në nivel nacional.

Dihet që në bazë të ligjit mund të variojë edhe sipas moshës, siç është lënë edhe në ligjin e ri, që vendoset një normë më e ulët për personat nën moshën 18-vjeçare, e më e lartë për ata që janë mbi këtë moshë, kjo është aktualisht në legjislacionin tonë.

Si rregull, paga minimale duhet të caktohet si pagesë minimale për një orë pune, siç e ceka dhe atë si bruto pagesë.

Nëse caktohet si pagesë mujore, atëherë është e domosdoshme që të specifikohet edhe numri maksimal i orëve që mund të kërkohet nga i punësuar për pagën minimale.

Pra, e cekëm që këtu në një farë forme në legjislacionin tonë kontrabandohen orët shtesë, të cilat, siç e thashë, punëtori punon 48 orë minimum në javë dhe ato tetë orë shtesë fare nuk i përlllogariten asnjë ditë pushimi, po as si orë pune dhe këtu vazhdon pabarazia.

Në fakt, paga minimale si rregull synon mbrojtjen e një grupi të të punësuarve, të cilët qoftë për shkak të moshës së tyre të re apo situatës familjare, gratë e reja që pauzojnë për pushim lehonie kanë produktivitet më të ulët.

Në kushte normale do të duhej të përfshinte afërsisht gjysmën e punëmarrësve nga 10% i fuqisë punëtore me pagat më të ulëta në shoqëri që nënkupton diku 5% të të gjithë të punësuarve.

Paga minimale nuk nënkupton shumën e domosdoshme për përmbushjen e nevojave të caktuara, ashtu siç edhe prezantohet jo rrallë në publik, që nënkupton se jodomosdoshmërisht paga minimale do të duhej të përdorej dhe interpretohej si instrument i luftimit të varfërisë. Paga minimale është koncept në rrafshin individual, përderisa varfëria është koncept familjar.

Shtetet që përdorin pagën minimale zakonisht obligohen me ligj që në baza ditore të përshtatin atë qoftë me normën vjetore të inflacionit, qoftë edhe me lëvizjet e produktivitetit në përgjithësi.

Kjo e dyta vlen sidomos nëse synohet të mbahet një proporcion i caktuar mes pagës minimale dhe asaj mesatare në shoqëri.

Në Kosovë paga minimale është e caktuar në mënyrë arbitrare dhe është klasifikuar në bazë të moshës së punëmarrësve, ku për personat nën moshën 35 vjeç shuma minimale është 130 euro, kurse për ata mbi 35 vjeç është caktuar të jetë mbi 170 euro.

Meqë paga minimale ka të bëjë me produktivitetin e ulët në punë dhe nuk ka ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë në luftimin e varfërisë, atëherë del i palogjikshëm çfarëdo përdorimi i kësaj vlere për instrumente të tjera të shtetit social, si për shembull, lidhja e pensioneve të veteranëve me pagën minimale.

Dua të ritheksoj se Lëvizja Vetëvendosje një vit më herët pati ftuar kryeministrin në interpelancë për të njëjtën temë dhe ne sot nuk do të duhej të diskutonim, një vit më vonë, sa a duhej të rritej paga minimale, atëherë ishte edhe kërkesë e Këshillit Ekonomik Social që fatkeqësisht sot edhe është jofunksional dhe nuk ka interes që vërtet të funksionalizohet ky këshill dhe aty të marrë rolin e vet edhe sindikata, që në fakt, duhet të jetë në mbrojtje të interesave të punëtorëve.

Caktimi i pagës minimale edhe për personat mbi moshën 35 vjeç tregon që në Kosovë ka deficit në kuptimin dhe interpretimin e konceptit të pagës minimale. Kjo meqë personat mbi moshën 35 vjeç, si rregull, nuk do të duhej të prekeshin fare nga ky problem, sepse mosha e tyre nuk lejon të kenë produktivitet aq të ulët sa të paguhen nën pagën minimale.

Problem tjetër me pagën minimale në Kosovë është që ajo nuk është përcaktuar asnjëherë me lëvizjet në inflacion apo në produktivitet.

Në fillim të vendosjes të saj shuma prej 170 euro ka qenë dukshëm mbi gjysmën e pagës mesatare, kurse duke mos e përshtatur atë fare vit pas viti, sot ajo paraqet vetëm 1/3 e pagës mesatare, si e tillë e ka humbur kuptimin.

Paramendoni nga viti 2011 nuk ka lëvizur paga minimale, paramendoni qeveritarët të cilët në vazhdimësi janë brengosur dhe me vendimet qeveritare i kanë rritur si kanë ardhur në pushtet pagat e veta dhe nuk e kanë kthyer kokën asnjëherë nga ata që nuk dihet si po mbijetojnë me paga në Kosovë, e të mos flasim për pagat minimale, edhe pse thamë që ndoshta nuk është gjithnjë burimi i vetëm i njerëzve që marrin këto paga minimale, por megjithatë edhe kjo rritje që po propagandohet në sektorin publik, ende nuk ka ndodhur e ju lutem që të mos i referohemi rritjes më të re të pagave në sektorin publik derisa ajo nuk të ndodhë vërtet.

Zakonisht në teori flitet për tri fushat, ku paga minimale mund të ketë ndikim dhe ka mundësi që ky ndikim të ngrihet sa më lart të jetë paga minimale në raport me atë mesatare. Pra, po flas për atë si është në teori.

Paga minimale mund të ndikojë në punësim, në shpërndarjen e të ardhurave dhe në varfëri.

Ndikimi i pagës minimale në punësim observohet me vështirësi, meqë në statistika nuk vërehet ndonjë rritje e papunësisë pas rritjes së pagës minimale, por kjo vjen si rezultat i faktit që personat që humbin vendin e punës kur rritet paga minimale zakonisht nuk paraqiten si të papunë, por dalin krejtësisht nga tregu i punës, pasi që i vlerësojnë të ulëta shanset e tyre për t'u punësuar.

Pra, ne nuk kemi fare statistika të sakta nga Enti për Punësim, sepse nuk e shohin interes qytetarët që të regjistrohen pranë këtyre enteve, sepse është numri, të mos them minimal që kanë arritur që përmes këtyre enteve të gjejnë një vend pune.

Dhe, si rregull, vendosin pra këta punëtorë që nuk lajmërohen në këto ente që të kryejnë trajnime shtesë apo të vazhdojnë edukimin e tyre si domosdoshmëri për rritjen e shanseve për punësim.

Situata mund të ndryshojë nëse paga minimale rritet shumë si proporcion i pagës mesatare. Për shembull, nëse shkon mbi 55% e pagës mesatare.

Ndikimi në varfëri nuk mund të dokumentohet, meqë varfëria është vërtet koncept i amvisërisë, e jo i individit. Por, mund të ketë ndikim në shpërndarjen e të ardhurave, meqë rriten pak të ardhurat e atyre që arrijnë të ruajnë vendin e punës dhe pas rritjes së pagës minimale dhe, në të njëjtën kohë, ul të ardhurat e atyre që humbin vendin e punës.

Në rastin e Kosovës, nëse duam, mund ta argumentojmë që paga minimale mundet, mbase, të ketë ndikim edhe në uljen e varfërisë, edhe atë për disa arsye:

1. Papunësia është shumë e madhe që nënkupton se me probabilitet më të lartë personat e prekur nga paga minimale mund të jetojnë në familje pa burime të tjera të ardhurash.
2. Niveli i lartë i varfërisë dhe varfërisë ekstreme që çon në argumentimin e ngjashëm si më lart.
3. Niveli i ulët i sigurisë në punë dhe mbrojtjes ligjore që, në fakt, e rrit pafundësisht fuqinë negociuese të punëdhënësve, kjo me siguri shumë të madhe përkthehen në eksploatim të punëmarrësve që nënkupton pagesa që janë më të ulët se produktiviteti i punëmarrësve.

Si rezultat, mundësitë janë më të mëdha që numri i atyre që atakojnë nga paga minimale të jetë dukshëm më i lartë se 5% që do të ishte normale dhe po ashtu që në këtë kategori të ketë edhe persona më të moshuar se 25 vjet.

4. Karakteri i papunësisë në Kosovë që dominohet nga papunësia afatgjate, pra nuk bëhet fjalë vetëm për papunësi, por në fakt, bëhet për një fjalë për një papunësi afatgjate dhe tema që e folëm në këto ditë, ikja e madhe nga Kosova, jo vetëm e njerëzve, truri që vërtet po ik, që është fatkeqësi dhe kanë një pagë, po nuk e kanë sigurinë tjetër, që është siguria në shëndet, mbrojtja dhe siguria në punë, ikin edhe njerëzit pra që jetojnë në varfëri ekstreme, mirëpo e kanë pothuajse të pamundur që të gjejnë një vend pune me vite dhe e kanë humbur shpresën që kjo mund të ndodhë.

Pra, karakteri i papunësisë në Kosovë që dominohet nga papunësia afatgjate, ku individët mbesin me vite të papunësuar dhe si rezultat humbin shkathtësitë e tyre. Kjo pastaj nënkupton që edhe nëse gjejnë punë, produktiviteti i tyre është më i ulët dhe po ashtu edhe fuqia negociuese për pagën.

Pra, ne e dimë që në një treg ku ka aq shumë kërkesë dhe oferta pak, fuqia negociuese është shumë e dobët e punëmarrësit dhe shumë të fuqishëm në anën tjetër e paraqet punëdhënësin, i cili në momentin kur punëtori mendon t'i kërkojë të drejtat e veta, në veçanti në sektorin privat, ai mendon dy herë, sepse punëdhënësi duke e ditur siç e thashë, kompanitë e mëdha i mbron ligji i të fortit, pra ligji joformal që është dominues në Republikën e Kosovës dhe ata fare nuk negociojnë me punëtorin, do të thotë ia jep një ofertë, merr ose le, sepse radha për punë është shumë e madhe dhe njerëzit ose i pranojnë kushtet tejet diskriminuese, ku në kontratë i figuron që punon 40 orë, punon 48 orë, nuk i paguan orët, nuk e llogaritin asnjë orë shtesë, as si orë e rregullt e punës, nuk i llogaritet puna e natës, nuk i ofrohet siguria në punë, nuk i japin ditët e festës në pushim.

Ne e dimë nëpër supermarkete, në Kosovë nuk ka ditë të lirë pune për punëtorë. Nëse ka një ditë pune, e ka aq stresuese dhe e kalon duke fjetur, sepse orët e punës janë të pafundshme, edhe vetë ligji ia mundëson punëdhënësit edhe me 48 orë t'i japë punë punëtorit, i cili mund t'i ankohet Inspektoratit.

Dhe, ju lutem, a e njihni një rast në Kosovë që ka shkuar dhe është ankuar për punëdhënësin, sepse ai e di çka e pret, të nesërmen e pret një zarf, nëse ka mëshirë punëdhënësi t'ia japë me një shumë të caktuar dhe ditën e mirë! Nuk e mbron askush.

Prandaj, të mos flasim këtu për një siguri dhe të mos flasim për barazi, punëtorëve në sektorin privat nuk u lejohej të ulet në arka, punëtorët që punojnë në hipermarkete, sepse aty zotëria, punëdhënësi, i duket normale që një punëtorë tetë orë pune të qëndrojnë në një vend. Ne mund të lëvizim tetë orë, po të qëndrojmë në një vend, si mjeke po e them me përgjegjësi të plotë, kjo është diskriminimi kulminant i punëtorit.

Pra, meqë paga minimale në një mënyrë nënkupton subvencionim të pagës përtej produktivitetit të punëmarrësve, detyron punëdhënësi t'i paguajë këtë subvencionim, kjo vlen edhe rastet kur paga është vetëm rezultat i produktivitetit, e jo i ekspluatimit, është me interes që gjatë vendosjes së saj të kenë parasysh dëmet që mund të shkaktohen normalisht edhe ekonomisë private.

Ne e dimë që shteti këtë rast duhet të ketë parasysh, gjithmonë edhe gjatë vendosjes së pagës minimale, edhe mbrojtjen e interesit, por bizneseve të vogla dhe atyre familjare dhe aty duhet të ketë subvencionim dhe përkrahja e shtetit duhet të jetë e madhe.

Ndërsa sa u përket kompanive të mëdha, mbikëqyrje rigoroze, sepse të mos flas për shkeljet dhe pasigurinë në punë, vdekjet në punë dhe moskompensimin e jetës dhe invaliditetit në këto raste.

Prandaj, deputetë të nderuar,

Siç e ceka, më vjen mirë që gjatë fjalimeve në Kuvend opozita dhe pozita dakordohen për shkelje të ligjeve në fuqi dhe mendoj që edhe në përfundim duhet të dakordohemi që çfarë duhet të ndërmerret për përmirësimin e situatës dhe korrigjimin e padrejtësive, e në veçanti për korrigjimin e padrejtësisë tashmë mbi 8-9 vjeçare për mosrritjen e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Që në ditën kur ka kaluar Ligji për paga, rrjedhimisht në ditën kur janë rritur pagat në sektorin publik, ne kemi premtuar se do të angazhohemi për rritjen e pagave edhe në sektorin privat dhe shumë mirë që po ndodh kjo.

Siç dihet, pagat më të ulëta në vend i kanë punëtorët e tekstilit, të këpucëtarisë, i kanë kamerierët, punëtorët e pastrimit dhe të tjerë. Më në fund, pas shumë vjetëve, për herë të parë këta punëtorë dhe shumë të tjerë do të kenë paga më të dinjitetshme.

Paga minimale, u tha këtu disa herë, siç është aktualisht 170 euro për personat mbi 35 vjet dhe 130 euro për personat nën këtë moshë, përveç se është diskriminuese, nuk mbulon as nevojat elementare të një punëtori në vend. Kjo po, duhet të ndryshojë.

Para dy ditëve gjersa diskutonim për Projektligjin e punës, përmenda disa hapa konkretë që duhet të ndërmerren menjëherë, në mënyrë që punëtorët të dalin në gjendje tjetër.

Për këtë i ftoj në bashkëpunim të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës.

Siç theksova edhe atë ditë, hap fillestar sa i përket pagës minimale duhet të jetë ndryshimi i modalitetit. Paga minimale nuk duhet të njihet si e tillë, por si pagesë minimale për orë pune, pra kufiri minimal i pagesës për këtë njësi të ketë orën e punës.

Ndryshimi i modalitetit të pagës minimale, pra kur kufiri minimal i pagesës të zhvendoset në orën e punës, do të minimizojë manipulimet me kontratat e punës, do të nxitej respektimi i pagave shtesë, ndërsa punëtorëve do t'u mundësohej puna fleksibile për gjatë ditës.

Organi që ka për detyrë të dalë me propozime konkrete çdo vit në lidhje me pagën minimale, pra Këshilli Ekonomiko Social i Kosovës duhet të rrisë përgjegjësinë dhe të ndryshojë metodologjinë e përcaktimit të pagesës për orë pune. Ky organ duhet të dalë së paku dy herë në vit me propozime për pragun e pagesës për orë pune, ndërsa si kritere kryesore duhet të merren parasysch çmimet e kostos së jetesës, nevojat e qytetarëve dhe të familjeve të tyre, si dhe niveli i përgjithshëm i zhvillimit ekonomik.

E fundit, por jo nga rëndësia, patjetër se duhet të ndryshohet baza që përcakton pagën minimale për orë pune sipas moshës, pra duhet të ndryshohet rregullimi diskriminues që dallon pagesën minimale për orë pune për punëtorët nën moshën 35 vjeç. Kjo kategori duhet të ketë të njëjtin kufi minimal të pagesës për orë pune, sepse aktualisht shohim se janë përjashtuar shumica e fuqisë punëtore në vend, e cila i kalon 35 vjet.

Pra, pagesa minimale për orë pune duhet të aplikohet edhe për praktikantët, edhe për ata që ndjekin ndonjë program trajnues, si dhe për studentët. Këshilli Ekonomiko Social duhet të rrisë përgjegjësinë dhe të plotësojë e të ndryshojë kriteret e përcaktimit të pagës minimale për orë pune, po e theksoj edhe një herë dhe vendimi i kryeministrit i datës 15 mars 2019 është një qëndrim, i cili besoj që do të fillojë të zbatohet së shpejti, meqë parasheh që ky këshill të funksionalizohet më në fund, prandaj presim që edhe Ministria e Punës të ndër marrë veprimet e duhura dhe adekuate. Shqetësimi është legjitim për gjithçka që u tha nga kolegët më herët.

E mira është që edhe para kësaj interpelance, pra edhe më 15 mars të gjithë jemi dakorduar që të gjithë jemi pro rritjes së pagave në sektorin privat dhe se duhet të gjejmë modalitetet e duhura që këtë ta zbatojmë sa më shpejt. Pra, e mira është se këtu nuk kemi palë të ndryshme, jemi një palë, jemi të gjithë bashkë dhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ju thërret që, meqë jemi në fazën e plotësim-ndryshimit të Ligjit të punës, të angazhohemi që sa më mirë t'i plotësojmë ato nene, të cilat deri në këtë fazë, qoftë nuk janë implementuar mjaftueshëm ose kanë krijuar hapësira për keqpërdorim të punëtorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra të pranishëm,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në vendin tonë, përveç që është shumë e vështirë të gjesh punë, po aq e vështirë për një numër të madh të punësuarve është të mbijetosh me pagën që merr. Sektori privat që konsiderohet promotori i zhvillimit ekonomik dhe që është një mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës, nuk po arrin të ndjekë trendin e rritjes së pagave në sektorin publik. Derisa në sektorin publik paga mesatare neto për gjashtë vjet është rritur për 116 euro, në sektorin privat për gjashtë

vjet paga mesatare është rritur vetëm 15 euro, e çka është më e keqja, paga minimale që është 130 deri 170, nuk është rritur fare prej vitit 2011.

Numri i të punësuarve në sektorin privat dihet që është pothuajse trefishi i atyre në sektorin publik dhe përqindje e madhe e tyre paguhen për punën që bëjnë me pagën minimale 130-170 euro. Këtu hyjnë kryesisht punëtorët që punojnë në kompanitë e mirëmbajtjes, sigurimit, në butikë, në restorante, në markete të ndryshme dhe që punojnë 12 orë në ditë, me vetëm dy të diela pushim në muaj. Është e rëndësishme po ashtu të kthejmë vëmendjen te struktura e të punësuarve në Kosovë që gjithashtu është në shpërputhje të plotë me bilancin gjinor. 80.7% të grave nuk kërkojnë punë fare për shkak të gjasës së vogël për punësim dhe për shkak të pagës shumë të ulët që ua pamundëson t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe, që më pastaj të punojnë. Duke qenë në pozitë të vështirë ekonomike me pagë të ulët minimale, me kontratë të përkohshme gratë nuk janë të pavarura dhe në këtë mënyrë u cenohen të drejtat elementare të njeriut. 40% të grave të punësuarra marrin pagën më të vogël se sa paga minimale që është 130 euro. Dispozitat ligjore të shprehura në ligjet, të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, e kanë bërë pagën minimale të detyrueshme për Republikën e Kosovës, përkundër faktit që Ligji i punës e obligon qeverinë të përcaktojë pagën minimale në fund të çdo viti, në Kosovë kemi një stagnim të kësaj page siç e thashë prej vitit 2011.

Edhe pse Udhëzimi administrativ për caktimin e pagës minimale do të duhej të përcaktonte formulën për këtë pagë, nuk ka dokument mbështetës, i cili tregon se cila është formula që është përdorur për caktimin e pagës minimale në vend. Stagnimi i pagës minimale, përkundër kërkesave të partnerëve socialë ndaj Qeverisë për të rritur atë, tregon që në Kosovë obligimet ligjore të dala nga dialogu social dhe marrëveshja kolektive nuk po implementohen fare. Ne besojmë se përcaktimi i pagës minimale duhet të burojë nga një proces gjithëpërfshirës, demokratik në mes të partnerëve socialë. Metodologjia për llogaritjen e pagës minimale në vend është gjëja më e rëndësishme që për këtë nivel mund të flasim, të pagës minimale, duke mos pasur mundësi ta analizojmë shkencëtarisht rolin e saj në shoqëri.

Procesit të përcaktimit të metodologjisë për caktimin e pagës minimale duhet t'i paraprijë një punë e domosdoshme për sigurimin e të dhënave të besueshme për përlogaritjen e indikatorëve ekonomikë dhe shoqërorë. Procesi i përcaktimit të metodologjisë për caktimin e pagës minimale duhet nisur nga parimi që punëtorit dhe familjes së tij t'i sigurohet niveli i të ardhurave që i garanton ushqim të bollshëm dhe të shëndetshëm, hapësirë të mjaftueshme banimi, qasje të lehtë në shërbimet shëndetësore, arsim cilësor dhe përfshirje në jetën kulturore. Paga minimale nuk mund të jetë kurrsesi një politikë e vetmuar, politikat e punësimit duhet të shkojnë krah për krah me përmirësimin e gjendjes së punëtorëve. Korniza ligjore që e rregullon marrëdhënien e punës duhet të dizajnohet për të reflektuar kompleksitetin e problemeve sistematike që mirëmbajnë pabarazinë shoqërore dhe marrëdhënien shfrytëzuese punëtorë dhe punëdhënës.

Siç po e dëshmon edhe rasti i Kosovës, paga minimale si politikë e vetme pa zhvillimin e mekanizmave implementues nuk funksionon. Ne mendojmë që shoqërinë duhet ta organizojmë në atë mënyrë që negocimi për të drejta rrjedhimisht me shumë fuqi për ta duhet ta bëjnë vetë punëtorët, ndërsa institucionet e Republikës t'i krijojnë mekanizmat efikas për respektimin e të drejtave të tyre. Ky parim duhet të mbështetet edhe me ligjet për marrëdhënien e punës. Ne kemi në shqyrtim Projektligjin për punë, nga të cilat dalin detyrimet ligjore për pagën minimale dhe komponentët e tjerë të rregullimit të marrëdhënies së punës. Për ndryshimet e nevojshme në këtë paketë ligjore ne do t'i marrim për bazë praktikën e punës së Organizatës Ndërkombëtare të Punëtorëve, në mënyrë që dispozitat ligjore të punës të garantojmë më shumë të drejta dhe mirëqenie për secilin qytetar të punësuar të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bilall Sherifi e ka fjalën në emër të Nismës.

BILALL SHERIFI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot e kemi në rend dite një temë, të cilën e patëm edhe para dy ditësh përmes Ligjit të punës, pra në kuadër të debatit për Ligjin e punës e patëm edhe çështjen e pagës minimale, por mirë që edhe sot po e vazhdojmë debatin rreth kësaj çështjeje, sepse sot jemi edhe pak më shumë, atë ditë ishim diku 10-12 deputetë krejt në sallë, 15 a sa ishim kur debatohej për Ligjin e punës.

Unë do të përpiqem, meqë është interpelancë, jo debat parlamentar dhe krejt grupi në tërësi i kemi 9 minuta, një pjesë ia lëmë ministrit për t'u sqaruar, t'i them shkurtimisht pikëpamjet e Nismës rreth kësaj. Mendoj që kjo çështje është vonuar shumë, rritja e pagës minimale është dashur gjithsesi të bëhet së paku që nga janari i këtij viti, kërkoj nga ministri të japë sqarime këtu pse nuk ka ndodhur kjo deri tash. Unë e di që Këshilli Ekonomik Social ka qenë funksional vitin e kaluar, pse nuk është marrë ky vendim dhe të jepen këto sqarime, publiku ta dijë, punëtorët ta dinë, ata, të cilët janë prekur nga ky ligj ta dinë.

Sidoqoftë do të jap disa sugjerime për të ardhmen se si duhet të rregullohet kjo çështje. Së pari, të hiqen, siç u tha këtu, edhe kufizimet e moshës, sepse asnjë logjikë nuk ka për të njëjtën punë dikush që i ka 29 -30 vjet të paguhet 135 euro, e dikush që i ka 35, ta zëmë, në kushte të njëjta, e bëjnë të njëjtën punë, kanë dy fëmijë, kanë bashkëshorte dhe njëri për shkak që i paska 30 e tjetri 35 vjet të paguhet më pak, edhe pse nevojat janë të njëjta. Domethënë, kufizimet, sepse në fund të fundit kjo është edhe normë kushtetuese, të gjithë të barabartë para ligjit dhe, nën një nuk ke të drejtë përmes dispozitave të tilla të diskriminosh, është antikushtetuese edhe diskriminimi. Por, mbi të gjitha ajo që desha unë të vë theksin mbi atë çështje është që paga minimale çdo vit, në fillim të vitit siç bëhet në çdo vend të botës, ku ne synojmë të bëhemi pjesë e saj, në janar të vitit vijues duhet të rritet. Në Gjermani, për shembull, që nga janari i këtij viti për 35 centë është rritur paga minimale për orë pune, jo për pagë mujore, por për orë pune dhe ne duhet ta rregullojmë

njësinë ta kenë për orë punë, pastaj a punon 5 orë apo 10 orë, varet nga punëmarrësi dhe punëdhënësi.

Pra, gjithsesi kjo çështje me orë duhet të rregullohet dhe në ligj duhet të futet një automatizëm, të rregullohet me një automatizëm dhe të mos u lihet mundësive abuzive, siç janë bojkotimi i Këshillit Ekonomik Social, sepse po, e dimë që një kohë është bojkotuar nga aktorë të ndryshëm, të cilët kanë konsideruar se mund t'u preken interesat e tyre, por duhet me automatizëm, të vendoset klauzolë një nen ku me automatizëm rritet paga minimale që do të thotë me rritjen ta zëmë të shpenzimeve, të kostos së jetesës, me inflacion apo të përdoret një çelës, ekonomistët e dinë më mirë, kolegu Avdullah Hoti sigurisht do ta dijë më mirë, Safetja, të gjithë e dinë më mirë këtë se si mund të gjendet një metodë përmes së cilës rregullohet kjo çështje me automatizëm.

Ne e dimë që çështja e pagës i nënshtrohet edhe raportit të kërkesës dhe të ofertës, por shtetet janë për të rregulluar sadopak kur raporti, çështja ofertë-kërkesë nuk arrin të rregullojë gjërat mjaftueshëm. Pra, insistojmë që kjo çështje të rregullohet shpejt, më erdhi mirë që edhe kryeministri këtu deklaroi se tani ka ardhur koha që kjo çështje të përfundimisht të rregullohet, por jo vetëm të ngrihet si vjet, por përmes Ligjit të punës ajo çështje të rregullohet, në mënyrë që kjo çështje të mos mbetet në vullnet të strukturave, siç është Këshilli Ekonomik-Social, por të ketë një automatizëm. Unë nuk arrij të kuptoj se si, ta zëmë, një punëdhënës në Zvicër, në të cilin unë kam punuar një kohë, kam jetuar një kohë, për 1 km asfalt rrugë pothuajse çmimi është i njëjtë si në Zvicër, si në Kosovë, madje ka raste kur është më i shtrenjtë dhe unë nuk e kuptoj pse punëdhënësi i Zvicrës ka llogari të paguajë 4 mijë franga, ndërsa ky në Kosovë nuk paska llogari as 200 franga ta paguajë, edhe pse çmimi për kilometër është pothuajse i njëjtë.

Në ndërmarrjet tregtare nuk arrij të kuptoj pse Migrosi i Zvicrës një litër vaj e shet 1 euro, në Zvicër 1 litër vaj 90 centë, punëtori në Migros paguhet 3.5 deri në 4 mijë franga dhe këtu nuk arrin të paguhet as 135 euro apo 175 euro. Nuk arrij ta kuptoj këtë, shpresoj që ekonomistët në debat do të na shpjegojnë pse ky punëdhënësi këtu nuk ka llogari të paguajë më shumë për të njëjtën punë, për të njëjtin çmim, kemi këtu edhe punëdhënës që mund të na shpjegojnë. Unë nuk arrij ta kuptoj këtë, kam dëshirë që përmes këtij debati të më ndihmohet ta kuptoj një gjë. Por, megjithatë shteti ka për detyrë të kujdeset edhe për këtë kategori, sidomos ne të cilët pagat i marrim nga prodhimi që ata e bëjnë dhe nga të hyrat që në buxhet bëhen përmes punës edhe përmes kontributit të tyre. Pra, jo vetëm që ka ardhur koha për sivjet të rregullohet kjo çështje, por përmes Ligjit të punës të rregullohet një herë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Sherifi! Fjalën e ka zoti Kinolli në emër të grupit.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Ministër,

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk do mend që sot jemi duke diskutuar dhe duke debatuar për një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme, të rëndësishme dhe sensitive, e cila ka të bëjë me pagën minimale, mirëpo pa dashur të përsëris edhe atë që e thanë tashmë kolegët e mi të nderuar, unë do të jem i shkurtër në këtë paraqitjen time në emër të grupit.

Është shqetësuese të flasësh për një temë, siç është paga minimale, ku duhet të diskutojmë për një grup njerëzish apo për një shtresë, e cila e ndjen veten si të pabarabartë në shoqëri dhe e ndjen veten si e diskriminuar në shoqërinë tonë kosovare sa i përket pagës minimale. Unë dje dhe pardje kam pasur një takim me disa të rinj, të cilët vijnë nga komuniteti rom, të cilët gjatë bisedës dhe gjatë takimit i shprehën shqetësimet e veta, ku ata në sektorin privat janë duke punuar nga 10 deri në 12 orë në ditë, edhe gjatë festave, edhe të shtunave dhe të dielave.

Unë e pashë shqetësimin e tyre dhe i njoftova që ata mund t'i përdorin mekanizmat institucionalë për të kërkuar të drejtat e tyre, mirëpo ata edhe pse punojnë, shumica prej tyre në kushte të rënda dhe për një pagë prej 170-180 eurosh, nga frika se nëse e ngritin zërin, do të mbesin edhe pa këtë pagë minimale për të ushqyer fëmijët e tyre dhe për të siguruar kafshatën e gojës, ata janë të detyruar të heshtin dhe hezitojnë t'i paraqesin brengat dhe problemet e tyre. Shumica e tyre sot i kanë të drejtuar sytë e tyre nga ekranet televizive dhe janë duke na përcjellë dhe duke na pritur se çfarë vendimi do të marrë ky Kuvend për fatin e tyre.

Ne, apo më mirë të themi ky Kuvend kohë më parë ka miratuar Ligjin për pagat për sektorin publik dhe me miratimin e këtij ligji tashmë është krijuar një boshllëk apo një hendek goxha i madh mes këtyre dy sektorëve. Ne mendojmë se këtyre njerëzve apo kësaj kategorie apo shtrese është duke iu bërë një padrejtësi dhe është në dorën tonë që ne këtë padrejtësi ta evitojmë apo ta rregullojmë.

Unë si deputet, po edhe grupi im parlamentar e përkrahim këtë iniciativë të sotme dhe jemi të mendimit që të mos ketë dy paga minimale, por të ketë vetëm një që të mos bëhet ndasi dhe konform mundësive tona buxhetore si shtet, nuk është patjetër që paga minimale të jetë 250 euro, mund të jetë edhe 239, mirëpo mendoj se me këtë vendim të cilin do ta marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe me vullnetin e mirë të kryeministrit dhe Qeverisë, mendoj se këtë padrejtësi do ta vëmë në rrugë të drejtë dhe këtyre njerëzve që kohë e vite me radhë po u bëhet padrejtësi do t'u dalim hakut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramiz Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Paga minimale 130 dhe 170 euro, më duhet të citoj: “Paga minimale 170 euro në Fondin Pensional shkojnë 8.5 euro, tatim janë 3.26 euro dhe paga neto është 158 euro”. Pra, po flasim për një pagë, të cilin i punësuarit e merr me 158 euro. Sa merr ai me 130 euro, domethënë i bie diku 110 euro.

Pra, me këtë rast, paga minimale ishte dhe është momentalisht shumë diskriminuese për të punësuarin, dëshpëruese për të punësuarin dhe pa të ardhme për punëtorin që të punësohet në Republikën e Kosovës, informalizëm për konkurrencën dhe pa fond pensional dinjitoz, joatraktive edhe për investitorët e jashtëm, sepse një pagë minimale shpeshherë mund ta përcaktojë kualitetin e të punësuarit dhe profesionalizmin e tij, prandaj investitori edhe këtë e shikon si bazë për investimet e veta.

Paga e ardhshme, duke e parë këtë, ishte dashur të jetë së paku 300 euro bruto, në mënyrë që të përmirësohet tatimi në Fondin pensional, si do të jetojë një pensionist me 100 apo 150 euro pas 40 vjetëve punë. Normalizon pra bazën materiale të të punësuarit, bëhet shpresëdhënëse, përmirëson Fondin pensional, mobilizon aktorët ekonomikë, pra edhe kjo duhet të shërbejë se duhet të mobilizohen aktorët ekonomikë, rrit konkurrueshmërinë ekonomike, shton efikasitetin e të punësuarit dhe normalisht që duhet edhe qytetarët të përgatiten se do të ketë një kosto të ndryshimit të tij që duhet të përballohet, e që përafërsisht e arrin vlerën diku rreth 80 milionë euro në vit.

Duhet të shtohet për të rritur pagën minimale bruto në 300 euro, duhet të shtohet shumë seriozisht lufta kundër informalitetit, sepse kjo mund të dëmtojë seriozisht prodhuesit e vegjël apo prodhuesit, të cilët sapo kanë filluar investimin apo punën. Prandaj, kolegë deputetë, qytetarë të nderuar, unë personalisht e mbështes çdo iniciativë që ka të bëjë me rritjen e pagave të të punësuarve, gjithmonë duke kërkuar që edhe të shtohet efikasiteti, por edhe të shtohet arsimimi që ata të jenë sa më profesionalë, në mënyrë që mos të ndalen në pagën minimale, po të shkohet në paga edhe më të larta, edhe më të larta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Reçica.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale sapo ka marrë mandatin e saj prioritet ka pasur fuqizimin e dialogut social si një mekanizëm për të ndërtuar paqen sociale ndërmjet partneritet trepalësh, në mes të punëdhënësve, punëmarrësve dhe Qeverisë.

Gjatë viteve 2017 dhe 2018, së bashku me partnerët ekonomiko-socialë kemi filluar takime më shumë se mujore dhe janë trajtuar temat, të cilat kanë ndikuar në promovimin e dialogut social

dhe është arritur një paqe e qëndrueshme me propozimet e marra me shumicën e votave nga anëtarët e KES-it. Janë funksionalizuar komisionet profesionale, të cilat një kohë të gjatë nuk kanë qenë funksionale. Funksionimi i komisioneve profesionale është që të bëjë analiza socio-ekonomike në vend dhe t'ua paraqesë propozimet konkrete anëtarëve të KES-it. Një ndër çështjet për të cilat është diskutuar në mbledhjet e para në Këshillin Ekonomik Social ka qenë paga minimale në vend, e cila rregullohet në bazë të Ligjit nr. 03/L-211, neni 57 ku thuhet: “Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko Social”.

Gjithashtu, që të kemi një analizë më të mirë për pagën minimale kemi nxjerrë Udhëzimin administrativ, i cili rregullon formulën për përcaktimin e pagës minimale në vend. Kjo formulë është propozuar nga ekspertë më të mirë profesionalë pranë Këshillit Ekonomik-Social. Në bazë të analizës së bërë duke marrë parasysh faktorët e përcaktuar me ligj dhe me Udhëzim administrativ komisioni profesional ka nxjerrë propozimin për pagën minimale në shumën prej 250 euro, e cila shumë është gjithashtu e përafërt me pagën minimale në vendet e rajonit. Ky propozim është diskutuar në disa mbledhje të Këshillit Ekonomik Social dhe me një unanimitet votash në fund të vitit 2017 është miratuar dhe të njëjtin e kemi proceduar për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Cilat kritere janë marrë për bazë për përcaktimin e pagës minimale? Kostoja e shpenzimeve jetësore, përqindja e shkallës së papunësisë, gjendja e përgjithshme në tregun e punës, shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend. Paga minimale përcaktohet në bazë të orëve të punës për periudhën 1-vjeçare, e cila publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ky propozim është bërë për të gjithë punonjësit e Republikës së Kosovës, pa dallim dhe pa shqallëzim në bazë të moshës, siç është deri më tani. Rritja e pagës minimale në vend është e domosdoshme, për shkak të rritjes së kostos jetësore që ka ndodhur në vend. Kjo rritje do të ketë ndikim në mbulimin e kësaj kostoje, e cila do të ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies së qytetarëve në vendin tonë.

Të nderuar deputetë,

Për të qenë krejt i hapur, pas miratimit të propozimit nga ana e Këshillit Ekonomik Social në fund të vitit 2017, pak ditë pas kompletimit të krejt materialeve, të njëjtin material e kam përcjellë, të njëjtin rekomandim e kam përcjellë në Qeveri. Dua të jem shumë i hapur, ka pasur hezitime se propozimi i KES-it për pagën minimale mund të ketë implikime ligjore dhe buxhetore. Të njëjtat jam përpjekur maksimalisht me përkushtim shumë të lartë të sqaroj që nuk ka implikime ligjore, bazuar në opinionin ligjor në Departamentin Ligjor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Sido që të jetë ato hezitime kanë vazhduar dhe kjo është arsyeja që ende ai propozim i KES-it, i marrë në fund të vitit 2017, të mos renditet për miratim në mbledhje të Qeverisë.

Dhe, tani jemi në një situatë krejt të re, në fund të vitit 2018 Këshillit Ekonomik Social i ka mbaruar mandati dhe në bazë të proceduarve ne kemi filluar shpalljen për kompletimin me anëtarë të rinj të KES-it. Tani kanë përfunduar këto procedura dhe dua t' ju informoj se nesër bëhet konstituimi me përbërjen e re të KES-it dhe qysh nesër, menjëherë pas konstituimit, ne do të fillojmë negociatat, do të fillojmë diskutimet për të nxjerrë një propozim apo një rekomandim të ri për pagën minimale, të cilën do t'ia propozojmë Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica! Fjalën e ka zoti Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit për fjalën e dhënë, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Kjo është një ndër temat kryesore që do të duhej ta kishim ne si shoqëri dhe është një temë që merr parasysh vetëm një pjesë të realitetit tonë të hidhur. Ne sot po flasim vetëm për njerëz që kanë vend pune dhe marrin pagë dhe nuk po flasim për njerëz që s'kanë punë dhe nuk marrin pagë. Kjo me gjasë është diku rreth 30%, nëse u besojmë statistikave zyrtare, rreth 30 % të popullsisë. Kjo është çështja e parë.

Çështja e dytë është se ne po flasim, në të vërtet nuk po e përmendim ndoshta shprehimisht, por po flasim për pagën minimale në sektorin privat, jo në sektorin publik. Kjo ka arsyet e veta. Sigurisht arsyet janë të shumëllojshme, mirëpo dallimi shumë i madh ndërmjet pagave nuk arsyetohet në asnjë mënyrë. Sistemi i krijuar ekonomik në të vërtet nuk e lejon një dallim të qartë dhe një arsyetim të qartë. Pse? Sepse sistemi i krijuar ekonomik në Republikën e Kosovës në këto vitet e fundit, 20 vitet e fundit, në të vërtet nuk është transparent. Nuk është e mundur të flasim për sektorin privat që është shumë më pak i paguar, me mesatare po them, se sa sektori publik. Ky është një fenomen i ri, me gjasë, në Evropë. Nuk po guxoj të flas për krejt botën, sepse duhet ta njohim, mirëpo kjo është e çuditshme.

Pse ngjan kjo? Kjo ngjan për një arsye politikisht, sepse nuk tregohet burimi i të ardhurave për sektorin publik. Në sektorin publik rritja është shumë më e madhe, sidomos në ndërmarrjet publike, nëse bëjmë krahasimin e drejtpërdrejtë ndërmarrjet publike mendohet të jenë ndërmarrje ku ka prodhim të drejtpërdrejtë dhe krijim të vlerës. Ashtu është edhe sektori privat. Këto janë dy burimet kryesore ku krijohet vlerë e drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe nuk është e shpjegueshme se si është e mundur që në sektorin privat pagat të jenë 40%, 42-3%, më të ulëta se në ndërmarrjet publike, kurse diku rreth 30% më të ulëta se në sektorin publik, do të thotë në administratën shtetërore. Këtë nuk e shpjegon askush. Ky është problemi ynë. Burimi i Buxhetit të Republikës së Kosovës dihet prej nga është, së paku në shifra të mëdha, doganat dhe mbledhja e tatimeve. Tatimet mbledhen nga sektori privat. Ne këtu nuk prodhojmë, nuk prodhon administrata shtetërore, domethënë prodhon sektori privat. Prodhon ai sektori që është i diskriminuar, i zhvatur e i plaçkitur për të na paguar neve paga jashtëzakonisht të larta, duke

filluar nga kreu që ulet shpesh aty edhe mandej flasim për pagën minimale në sektorin privat. Ky është problemi.

Këtu dëgjojmë fjalime se si duhet me e bë, sa duhet me e caktua minimumin, andej e këndej... Problemi nuk është aty, problemi është te veprimet. Ne e kemi një veprim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të të gjitha qeverive, duke përfshi deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për rritjen e pagave të tyre në sektorin publik pa asnjë arsytim ekonomik, asnjë arsytim ekonomik. Ne nuk kemi treguar prej nga ajo rritje, prej nga këto burime, që ne të mund t'i rrisim pagat në sektorin publik, kurse në sektorin privat flasim për paga që jo se nuk janë të mjaftueshme, por nuk mjaftojnë as për një jetë elementare të një njeriu, jo të një familjeje.

Natyrisht, paga minimale mund të rritet, por duhet të rritet me ndryshimin e sistemit ekonomik këtu e ai sistem është me lehtësimin. Më së pari të ndalet haraçi dhe zhvatja e sektorit privat edhe të ndalen ngarkesat e shumta që ia bën burokracia, ku futemi edhe ne, të marrjes së parave dhe shtrëngimi, ose shtrydhja e sektorit privat nga sektori publik dhe mandej të shohim se si është e mundur që ato konkretisht të rriten. Natyrisht, se paga minimale ka disa karakteristika, një është se paga minimale nuk e zvogëlon varfërinë, por vetëm e bën rindarjen e varfërisë midis familjeve të varfra. Domethënë, me këtë ne nuk bëjmë asgjë, vetëm e bëjmë një shoqëri dyklasëshe, ose treklasëshe, dhe të varfrit vetëm i ndajmë në një anë dhe u themi “hajde, ndajeni ju varfërinë, se ne të pasurit e ndajmë pasurinë”. Kjo është zhvatje e drejtpërdrejtë. Pra, nuk ka ndryshime strukturore ekonomike.

Çështja tjetër është karakteristikë se paga minimale e zvogëlon vetëm mundësinë e punësimit, sepse sektori privat i shtrydhur nuk merr më shumë punëtorë. Efikasiteti në sektorin privat dhe në sektorin publik ka një dallim shumë të madh. Në sektorin publik mesatarja e punës efektive brenda tetë orëve nuk arrin një orë e gjysmë, kurse në sektorin privat mesatarja shkon mbi gjashtë orë efektive, gjashtë orë e gjysmë në efektive, sepse edhe ata ndonjëherë duhet të ulen prej lodhjes fizike. Këtë ne nuk e marrim parasysh. Edhe ora e tij është diku rreth 80 centë a 70. Ky problem! Çështja tjetër, paga minimale e redukton dukshëm pagën për njësi të orës, sepse ai punon në vend të tetë orëve dhjetë orë e ato nuk i llogariten kështu, kështu që edhe e rritë natyrisht punësimin formal.

Lëvizja Vetëvendosja ka paraqitur një rezolutë qysh vitin e kaluar, në 2018-ën, për anulimin e vendimit të rritjes së pagave të Qeverisë e mandej edhe rritjes vargore, që është bërë më vonë, e që ka rezultuar me një ligj të pagave që është totalisht diskriminues në Republikën e Kosovës, sidomos ndaj sektorit publik. Kjo nuk është ndërmarrë, tash po shesim fjalë ne, qysh t'ia bëjmë pagën, qysh ta rritim minimumin... Jo, duhet të shihet prej nga është burimi i rritjes së pagave në sektorin publik. Nëse kjo arsyetohet në aspektin ekonomik, atëherë duhet ta shohim se si është e mundur që të përmirësohet në sektorin privat. Pa një transparencë të plotë të burimeve të pagave në sektorin publik dhe të rritjes së pagave në sektorin publik, nuk ka përmirësim të pagës në

sektorin privat e as asaj minimale. Ne mund të shtyhem këtu sa të duam, a po e rritim për orë a për muaj, po përfundimisht nuk ka me pas asnjë përmirësim derisa sektori publik është kaq diskriminues, sidomos në ndërmarrjet publike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot Kuvendi i Kosovës po debaton për një temë të rëndësishme, që është sfidë për sektorin privat por edhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Duhet pranuar se jemi të vonuar në rritjen e pagës minimale në sektorin privat, sepse shumica e punëtorëve janë të diskriminuar, jo vetëm me paga por edhe me kushte të punës dhe të drejtat e tyre. Thash se është sfidë, sepse një pjesë e bizneseve edhe mund të mos e përballojnë rritjen e pagës minimale, pra për sektorin publik, por Qeveria e Kosovës duhet t'i bëjë të gjitha veprimet apo lehtësirat për bizneset private në mënyrë që ndërmarrësit, siç i quajti me të drejtë kryeministri Haradinaj, heronjtë ekonomikë, të mund ta përballojnë rritjen e pagës minimale në sektorin privat.

Gjendja e punëtorëve në sektorin privat është e keqe, mbase mund të themi edhe diskriminuese, jo vetëm në pagën minimale por edhe në kushtet e punës dhe të drejtat e tyre siç i kanë punëtorët në sektorin publik. Kjo temë duhet trajtuar si emergjente, sepse është e padrejtë dhe e papranueshme që të kemi një dallim kaq të madh ndërmjet punëtorëve të sektorit privat dhe atyre në sektorin publik. Qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, siç ka arritur ta shtyjë përpara Ligjin e pagave në sektorin publik do ta ketë guximin që ta rrisë pagën minimale në sektorin privat, duke u kujdesur në të njëjtën kohë që t'i përkrahë bizneset private që ato të mund ta përballojnë këtë rritje. Këtë vullnet dhe gatishmëri e ka shprehur kryeministri Ramush Haradinaj më 10 mars të këtij viti në mbledhjen e Qeverisë. Prandaj, unë jam i bindur se sikur që e kemi shtyrë përpara Ligjin për pagat në sektorin publik do të ndodhë edhe rritja e pagave të punëtorëve në sektorin privat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka. Keni disa sekonda në dispozicion, gjithsej 38.

MILAIM ZEKA: Mjaftojnë, kryesues, se të të falënderoj dhe të përshëndes që ma dhe fjalën.

KRYESUESI: Fjalën e ka zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Çështja e pagës minimale është çështje jetësore dhe është çështje esenciale. Duke qenë e tillë është çështje tepër populiste për ta diskutuar në Kuvend dhe normalisht, se secili deputet që do me dalë dhe me kërkua vota ka me e mbështet një gjë të tillë. Ajo çfarë sot mungoi, qoftë prej përfaqësuesve të Kuvendit, deputetëve kolegë, qoftë prej Qeverisë, ministri më herët tha që “duke qenë shumë i hapur...” edhe nuk tha asgjë, nuk ishte fare i sinqertë. Mungoi guximi për ta trajtuar një çështje të tillë. Mungoi guximi, sepse Ligji i veteranëve dhe pensioni i veteranëve e ka referencë pagën minimale, andaj kur të rritet paga minimale rriten pensionet dhe ka kosto buxhetore. Duhet dalë këtu e me u deklarua të gjitha grupet parlamentare, por edhe kryeministri dhe Qeveria edhe me thënë se a duan me e ngritë pagën minimale apo nuk duan me e ngritë pagën minimale.

Është e vërtetë se gjendja në sektorin privat është tepër e keqe. Më herët kolegu Kurteshi e tha se ne duhet me e pa gjendjen në sektorin privat prej perspektivës së pagave në sektorin publik. Qe sa vite Qeveritë e kaluar dhe në këtë Kuvend janë rritur pagat në sektorin publik, sepse ka qenë çështje populiste, sepse janë fituar votat e partive politike të caktuara, sa herë që i kanë rritur pagat. Dhe, nga vijnë të hyrat buxhetore? Të hyrat buxhetore vijnë komplet nga sektori privat. Ne i kemi bërë presion, e kemi shtypur qeveri pas qeverie sektorin privat, e kemi përkeqësuar gjendjen e tyre duke rritur privilegjet tona dhe të familjarëve që i kemi nëpër institucione publike. Nuk duhet me i trajtua çështjet vetëm me popullizëm, por duhet me pa se ku është prejardhja e problemit.

Janë dy elemente të cilat sot kanë shtyrë që në sektorin privat të kemi një gjendje të tillë. E para është moszbatimi i ligjit dhe e dyta është niveli i lartë i korrupsionit dhe që të dyja janë tepër të ndërlidhura. Ne sot nuk kemi zbatim të ligjeve nga ana e ndërmarrjeve private për shkak se kemi nivel të lartë të korrupsionit, për shkak se një numër i madh i kompanive mbajnë monopole në treg, si rezultat i lidhjeve që i kanë me vendimmarrësit në qeveri të ndryshme të Republikës së Kosovës dhe ne e dimë krejt kush janë oligarkë dhe me kënd i kanë lidhjet ata dhe se si e dëmtojnë tregun, se si asnjë kompani private nuk mund të hyjë në konkurrencë me ta.

Qeveria e Republikës së Kosovës para se të flasë për përmirësimin e ambientit të biznesit duhet të heq dorë prej kërkimit të 10%-shit të pothuajse secilit tender dhe kështu përmirësohet ambienti i biznesit, kështu ata nuk kanë nevojë të përdorin metodat më konvencionale për të mbijetuar në treg por kanë me qenë profitabil dhe duke qenë profitabil kanë me i rritë pagat, sepse ata e dinë shumë mirë që motivimi i punëtorëve është një ndër elementet kryesore për të pasur sukses në treg. Andaj, mos t'i trajtojmë çështjet me popullizëm. Të kërkojmë edhe prej ministrit të Mirëqenies Sociale që të na tregojë se sa është kostoja e propozimit të Këshillit Ekonomik-Social, i cili po u diskutuaka në Qeveri, sa është kostoja jonë buxhetore edhe çfarë duhet Qeveria dhe Parlamenti të bëjë, në mënyrë që sektori privat të mund të përballojë, si dhe çfarë mund të bëjmë ne në mënyrë që me e luftua korrupsionin dhe me ua sigurua ndërmarrësve tanë një konkurrencë fer, sepse vetëm konkurrenca fer i mbanë ata të gjallë.

Edhe efekti i taksës po shihet. I kemi humbur 17 000 vende të punës në bazë të Bankës Botërore, e cila është bazuar në statistikat zyrtare të shtetit. Me e luftua korrupsionin, kështu u ndihmojmë ndërmarrësve. Mos me i rritë pagat tona pa pasur rritje ekonomike, sepse kështu ne po ua vjelim atyre fitimin për ta shfrytëzuar për privilegje tona. Stop këtyre dukurive! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e pata ndërmend fare të flas. Më nxiti kolegja e Lidhjes Demokratike.

Po ky farë 10%-shi që po e kërkuaka Qeveria për çdo tender, kush, kujt dhe kur ia paska kërkuar? Meqenëse paskeni informata, kolege deputete, dilni në foltoren e Kuvendit dhe zbulojeni që ta dimë edhe ne edhe të mos vdesim injorantë.

Realisht, nuk e kam kuptuar asnjëherë pse Këshilli Ekonomik-Social nuk ka qenë funksional. Pse është dashur, për shembull, që të lehet për disa muaj, ose një kohë më të gjatë, në mënyrë që të funksionalizohet? Nuk i kuptoj ata që thonë se rritja e pagës minimale prej 130 në 250 euro qenka vetëm shpërndarje e varfërisë. Tani, nuk po e di a janë për rritjen e pagës minimale, apo janë për uljen e saj.

Unë e mbështes këtë rritje, kështu që besoj se është mirë që secili prej nesh ta bëjmë realitet. Të japim kontributin tonë e të mos flasim shumë, sepse njerëzit vërtet janë në hall të madh. Thash, arsyeja kryesore është pohimi i foltores në foltoren e Kuvendit për 10%-shin që po e kërkuakan qeveritarët, ministrat, Qeveria... Do të doja të di kush, kujt dhe kur ia ka kërkuar dhe nëse i keni këto informacione, pse kolege deputete nuk i keni dorëzuar në Prokurori? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Unë i them kolegut Nitaj se këtu kam mundur të gaboja vetëm në përqindje, ndoshta nuk është 10%, e është pak më e lartë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Republika e Kosovës është republikë demokratike parlamentare, pra qëllimi ynë duhet të jetë përkrahja e sektorit privat pa ndërhyrjen e rregullimit të tregut të lirë. Po, ne e kemi obligim që të merremi me qytetarët tanë që punojnë në tregun privat, jo vetëm të diskutojmë për pagën

minimale apo për pagën në përgjithësi, por koha është që sektori privat të respektojë Ligjin e punës për trajtimin e punëtorëve.

Punëtorët në sektorin privat paguhen shumë më pak se në sektorin publik. Punëtorët në sektorin privat punojnë deri në 12 a 13 orë, nuk kanë ditë vikendi, nuk kanë pushim vjetor, nuk respektohet as pushimi mjekësor, nuk paguhen për festa, nuk kanë sigurim shëndetësor, nuk kanë siguri në punë, e të tjera...

Pra, nuk çështja vetëm se të ardhurat janë minimale, por dinjiteti i këtyre punëtorëve është i përdhosur, i shfrytëzuar dhe i shantazhuar, për shkak se në Kosovë është vështirë ta gjeësh një vend pune, andaj klasa punëtore në sektorin privat është e diskriminuar në raport me sektorin publik. Kësaj duhet t'i vijë fundi. Nuk qëndron ajo se me rritjen e pagës minimale shkurtohen vendet e punës, sepse me respektimin e ligjit luftohet informaliteti dhe shtohet punësimi. Ne tani kemi kompani të konsoliduara në Kosovë dhe është e papranueshme që këto kompani nuk janë të gatshme që të jenë korrekte me klasën punëtore në Republikën e Kosovës.

Ne duhet që nga ky debat, siç u tha edhe nga kolegët, si zakonisht, që mund të shndërrohet në debat popullist, ta analizojmë mirë çështjen sepse vërtet ekonomia e tregut të lirë rregullohet me ligj e sidomos, këtu kemi parti politike të profilit të djathtë e që duhet të kemi kujdes. Megjithatë unë insisto se, përveçse duhet të rritet paga minimale për arsye se sektori publik ka bërë një hap i cili vërtet e ka dëmtuar shumë sektorin privat.

Ne duhet të pajtohemi të gjithë që përveç ngritjes së pagës minimale duhet të kërkojmë nga institucionet e vendit, që të respektohet Ligji i punës, që punëtorëve në këtë sektor t'u kthehet dinjiteti, sepse është e ndërlikur edhe vet biznesi me punëtorët në Republikën e Kosovës dhe në qoftë se, vërtet do të vazhdojë kështu një trend i tillë do të vijë dita që bizneset në Kosovë do të kenë mungesë të punëtorëve dhe unë frikohem se pastaj do të jenë të gatshëm të ofrojnë shumë më shumë, por do të jetë vonë me gjendjen çfarë e kemi sot.

Andaj, sidomos bizneset që janë sot të konsoliduara që kanë fitim me milionë, mos të them me qindra, ata duhet t'i prijnë këtij procesi, mos të lejojnë, ose mos të na imponojnë që ne të ndërmarrim, ose të mbajmë edhe seanca të tilla e të vendosim që vërtet në bazë të ligjit ose të farë vendimesh të Kuvendit, të ndërhyjmë edhe në tregun e sektorit privat. Unë pres që vërtet së bashku edhe sektori privat të pajtohet dhe të jetë më gjeneroz, sidomos me sjellje ndaj punëtorëve dhe natyrisht Qeveria e Kosovës të ketë kujdes në respektimin e politikave të saj fiskale. Vetëm kështu mund ta zhvillojmë Kosovën, pra duke e përkrahur sektorin privat dhe sektori privat duke qenë korrekt me klasën punëtore në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Blerim Kuçi e ka fjalën.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

U tha shumë, por ajo që më pëlqeu sot është fjalimi i zonjës Besa Baftiu, sepse e pati një fjalim vërtet konform debati që u shtrua edhe sot.

Ajo që më bëri përshtypje është ish-ministrja e cila shërbehet me të dhëna jo të sakta dhe çdoherë shkon në këtë formë. Ka qenë ish-ministre dhe të dhënat e Bankës Botërore i përmendi, por nuk e tha deklaratën e fundit të Bankës Botërore, që nuk qëndron çështja e humbjes së vendeve të punës. Ne edhe me Ligjin për Buxhet, të cilin e kemi votuar sot para shumë kohësh në Kuvend, thuhet se sipas trustit, të dhënat e trustit dhe të ATK-së, që janë të dhënat më zyrtare të këtij vendi, vendet e punës për vitin 2018 janë rritur diku rreth 18 000 vende të reja të punës.

Mënyra e të folurit, mënyra e dhënies së të dhënave jo të sakta nga ish-ministrja tregon edhe për pasaktësinë që e tha edhe në fjalimin lidhur me Qeverinë. Nuk kemi nevojë ta shtrojmë, sikurse tha zoti Nitaj, a duhet t'i besojmë apo do të shkojmë në hetuesi, po kjo qëndron e pasaktë, sepse kjo tha të dhëna të pasakta për çështjen e papunësisë. Po ashtu, unë e kuptoj këtë rivalitetin në mes LDK-së dhe PSD-së, mirëpo ju e keni ngritur një çështje, një debat për çështjen e ndaljes së të rinjve apo migrimit të të rinjve. Ky vendim, ky përcaktim i yni për rritje të pagës minimale i kontribuon migrimit, ndaljen e migrimit të të rinjve. Tash po bie LDK-ja në kundërshtim me konceptet e veta, me një anë kërkojnë të ndalen të rinjtë që të mos e lëshojnë Kosovën, ta ndalë migrimin e të rinjve, në anën tjetër kërkojnë që të mos ketë rritje të pagës minimale. Këtë nuk e kuptoj. Mund ta kuptoj rivalitetin për këto debate në mes PSD-së dhe LDK-së, por assesi zonjën ish-ministre, e cila bazohet dhe thotë të dhëna të pasakta.

Edhe njëherë, Banka Botërore e ka dhënë një deklaratë, ku e kundërshton opinionin që LDK-ja tash e sa kohë e jep lidhur me zvogëlimin e numrit të të papunësuarve. Sipas ATK-së dhe Trustit, që janë dy institucionet më zyrtare, kemi rritje për 18 000 vende të reja të punës për vitin 2018. Po ashtu, edhe treguesit ekonomikë janë gjithashtu konform kësaj çështjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, replikë, ose fjalën se keni minutazhë të mjaftueshme.

HYKMETE BAJRAMI: E para, nuk jemi kundër rritjes së pagës minimale, askush nuk e tha këtë. Asnjëherë nuk kemi qenë. Jemi kundër korrupsionit, i cili mundëson ndërmarrjeve që të kenë progres dhe të rrisin pagën minimale.

E dyta, unë shërbehem me statistika zyrtare. Tash, si ju nuk jemi Qeveri t'i thërrasim prej prokurorëve, e kryeshefave të agjencive për t'u raportuar nëpër zyra. Për besë, ne as nuk e kemi praktikuar kur kemi qenë në Qeveri, as tash. I lexojmë të dhënat që publikohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Kuçi.

BLERIM KUÇI: E para, po i ikën çështjes kryesore, që po jep një të dhënë të pasaktë, lidhur me çështjen e punësimit. D.m.th. edhe një herë po konfirmoj se në vitin 2018 nuk është e vërtetë që ka pasur ulje të çështjes së ulje të të punësuarve, po ka pasur rritje, edhe atë shifra është 18 mijë të punësuar rishtas. Këto janë të dhëna të sakta nga institucionet tona, të cilat janë ATK edhe Trusti. Në qoftë se do të thirresh në të dhëna të sakta, atëherë i ke institucionet tona, të cilat edhe ju dikur i keni përfaqësuar, edhe jeni thirrur në ato mekanizma. Për këtë, mos i ikni temës kryesore.

Edhe në debatin për të rinjtë. Ju e thatë në njëfarë forme, që po bëhet me nguti. Më me nguti se të ndalet trendi i largimit të të rinjve nuk ka. Edhe kjo është formë përmes rritjes së pagës minimale, normalisht në procedurë që është e rregullt. Nuk ka formë tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Unë i nxora edhe shifrat zyrtare prej Agjencisë së Statistikave dhe Trustit Pensional. Po filloj me këtë të fundit. Statistikat nga Trusti Pensional tregojnë që në 2018-tën ka shtatë mijë veta më pak kontribuues në Trustin Pensional sesa në vitin 2017. Këto janë të dhëna zyrtare.

Të dhënat zyrtare gjithashtu janë që paga mesatare në sektorin publik është 35 për qind më e lartë sesa në sektorin privat. Kjo është anomalia më e madhe që mund të ekzistojë në një ekonomi tregu. Ne presim që në ekonomi të tregut, pagat në sektorin publik të jenë të njëjta, ose ndoshta më të ulëta sesa në sektorin privat. A ka qenë kjo diferencë edhe në të kaluarën, sigurisht se ka qenë. Po ka ardhur duke u përkeqësuar me kalimin e viteve, në veçanti në vitet e fundit. Përpara kjo diferencë ka qenë vetëm 17 për qind. Pra, pagat në sektorin publik kanë qenë 17 për qind më të larta sesa në sektorin privat, tash kanë mbërritur në 25 për qind.

Paga minimale në sektorin publik është rreth 100 për qind më e lartë sesa në sektorin privat. Prapë është përkeqësuar me kalimin e viteve.

Po pse po e diskutojmë këtë çështje ne sot? Më se e qartë edhe nga deklaratimet edhe të Kryeministrit, edhe të ministrit të Punës, sepse Qeveria nuk ka fare emergjencë në sektorin privat. Kjo çështje qenka diskutuar në Qeveri vitin e kaluar, në propozim të ministrit të Punës, po që ka ekzistuar siç tha ministri i Punës hezitim në Qeveri për të marrë vendim për rritjen e pagës minimale. Por, që Qeveria s'ka hezituuar fare në fillim të mandatit që pagën për vete ta rrisë 100 për qind dhe të sjellë në Kuvend, Ligjin për pagën në sektorin privat, që i rregullon pagat vetëm për një të tretën e të punësuarve totalë në nivel vendi, ku pagat përgjithësisht janë rritur krahasuar me sektorin privat.

Për krahasim, në Qeverinë paraprake ne e patëm rregulluar rritjen e pagave në sektorin publik, duke vendosur nenet specifike në Ligjin për menaxhimin e financave publike, ku thoshim që rritja vjetore e pagave në sektorin publik do të jetë në përputhje me rritjen ekonomike, bazuar në rritjen vjetore të bruto-produkttit vendor, por kjo u bë mishmash me Ligjin e pagave që u aprovua në këtë Kuvend nën presionin e jashtëzakonshëm të PSD-së ndaj Qeverisë.

Logjikë të zhvillimit të sektorit privat në këtë Qeveri nuk kemi parë, se ndryshe nuk diskutohet si diskutoi Kryeministri, ministri i Punës dhe plot deputetë të koalicionit qeverisës.

Si rriten pagat në një vend? Rriten në përputhje me rritjen e produktivitetit të punës. Nëse shihni sesi janë rritur pagat me kalimin e viteve në sektorin privat, ju do të shihni se ajo rritje është gati e njëjtë me rritjen ekonomike që ka pasur Kosova. Pra, aq sa është rritur produktiviteti. Po, si ka ndodhur rritja e pagave në sektorin publik, 10, 20, 30, 35 për qind tash ka arritur kjo diferencë.

Prapë, për krahasim edhe të deputetit të AAK-së, që është gjithashtu edhe njeri i biznesit. Le t'i krahasoj ai vetë kushtet si i ka në Kosovë për të bërë biznes sot dhe si i ka pasur para tri vitesh? Statistikat zyrtare të cilat ai ka dëshirë t'i citojë, tregojnë që në Qeverinë Mustafa është përmirësuar ambienti për biznes për mbi 40 vende në rangime ndërkombëtare. Në Qeverinë Haradinaj është përkeqësuar për disa vende. Në Qeverinë Mustafa janë krijuar 40 mijë vende të reja të punës, bazuar në statistikat zyrtare. Prapë, bazuar në statistika zyrtare për një vit e sa të qeverisjes, ka shtatë mijë vende të punës formale më pak sesa në vitin paraprak. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gani Dreshaj e ka fjalën.

GANI DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Unë po kam qejf të jesh kryetar, edhe po ma merr mendja do të bëhesh.

Kur është çështja te paga minimale, gjithmonë po e lëmë fajin jetim. As nuk ka mund ministri ta bëjë për një vit, as ne nuk mund ta bëjmë për gjashtë muaj ose për katër vjet. Gradualisht mendoj se duhet të rritet paga minimale dhe duhet të bëhet krahasim me shportën e blerjes së qytetarëve. Unë mendoj se një punëtor që punon pesë ditë në javë, po ta ketë pagën nën 350 euro, më duket që edhe nuk ka në Kosovë. Problemi është që disa ndërmarrës që ua japin në zarf edhe 100 euro, e 200 ua japin kështu, për t'i ikur tatimit në rrogë.

Me qetësi po më thotë kolegu.

Paga minimale, miku im i Partisë Socialiste, të cilët i çmoj shumë e kanë dhënë të vogël. Ta merr Glauku një pagë minimale 300 euro, të shohim qysh po jeton me të. Unë mendoj që paga minimale për hir të nderit e të respektit të qytetarëve, ishte dashur të jetë diku 450 euro bruto.

Nuk e kam atë pse s'i marrin qytetarët, por po i ikin tatimit në rroga. A e dini pse po ju them këtë? Se e kam provuar vetë.

Ana tjetër është, ne po flasim për paga minimale dhe po mundohemi të bëjmë ligje për 17 muaj të Qeverisë Haradinaj. Unë mendoj që diku në 1800-tën ka pasur sigurim shëndetësor në shtetet e zhvilluara. Ne po ikim aty ku po na prek. Po le që s'kemi pagë minimale, po s'kemi as sigurim shëndetësor.

Ndonjëherë, po e shoh veten pasi po dal te shtëpia në media, që dorën në zemër, këtë çka po e foli nuk e kam mësuar në gjuhën shqipe, po unë di ta krahasoj si kontrollohet sigurimi social dhe sigurimi shëndetësor dhe deri ku i ka duart shteti. Një shtet euroatlantik demokratik, siç është Kosova. Të bëj 'lazëm' njerëzit që i ka gjashtë hektarë tokë, i ka dy traktorë, të marrë social, e ai që ka me të vërtetë nevojë nuk e merr, është keq. Besa edhe diaspora ka disa që e marrin edhe këtu pension, e shfrytëzojnë pra, po është e keqe.

Për rritjen e papunësisë, po i them dy-tri fjalë. Papunësia nuk është rritur në Kosovë. Papunësinë e kemi bërë ne ish-qeveritë e kaluara, se i kemi lënë njerëzit, ua kemi dhënë nga një ndihmë sociale veteranëve, për mua janë të gjithë të vërtetë, po nëse s'janë vendos gjykata, e ata veteranë që kanë dhënë gjymtyrët e veta, ata s'kanë të drejtë të punojnë në firma private. D.m.th. i kemi bërë të varur prej socialit, se nuk është ajo një ndihmë e madhe, po dorën në zemër është një social, edhe është një rrogë që e kanë merituar me djersë, me luftë e me plumba. Atë që ka bërë shteti me ta, po shteti kurrsesi s'ka të drejtë t'ua ndërpresë të drejtën e tyre për ta përmirësuar jetën, edhe të marrë edhe te Gania, ose te z. Kelmendi edhe 300 euro. Se na mungon fuqia punëtore e vetëdijshme.

E sa për ikje dhe emigrim, unë po ju kallëzoh kur kam shkuar për Gjermani, ka qenë Akropolis.

KRYESUESI: Faleminderit zoti Dreshaj! Ka përfunduar minutazhi grupit të juaj parlamentar. Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Ramush Haradinaj në qoftë se e dëshiron. Z. Haradinaj e ke fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Xhavit Haliti!

Të nderuar deputetë,

Edhe një herë i nderuar Visar,

Kolegë ministra,

Më herët ishin disa. Ju dëgjova me vëmendje në diskutimet tuaja. Qeveria që udhëheq nuk është e përkryer. Ka vonesa, ka ngecje. Unë kam gjetur në tavolinë të punës si kryetar qeverie plot tema. Ndër to edhe kërkesat e vazhdueshme për rritje të pagave veç e veç nëpër sektorë qysh e dini. Edhe përkundër faktit që vendimet e para të rritjes së pagave, kanë qenë vendime të kritikuara, fatmirësisht pra, fatmirësisht po them kemi ardhur deri te një moment vërtet i

vlefshëm. Për herë të parë, pagat janë rritur në sektorin publik, me përjashtim të Kryetarit të Qeverisë që i është zvogëluar, po janë rritur me ligj. Është hera e parë në historinë e qeverisjes tonë që kemi ligj për pagat në sektorin publik. Ky nuk është një ligj që i atribuohet vetëm kësaj qeverie, është rezultat i Kosovës, e do ta kenë në të ardhmen të gjithë. Pra, çdo qeveri e ka këtë ligj dhe fatmirësisht, edhe pse nuk është një ligj i përkryer, se ka ndonjë lëshim, megjithatë e ka vendosur një rregull në respektimin e të gjithë atyre që shërbejnë në sektor publik.

Sa i përket pagave në sektor privat, pa dashur të them çka kemi bërë ne për ekonominë, ne flasim për gjendje të vitit 2011. Sikur të ishte përdorë një matematikë e thjeshtë për një rritje 5 për qind për çdo vit të pagës minimale, në tetë vjet do të ishte 40 për qind. Po qeveritë e mëhershme nuk kanë lëvizur hiç, e kanë lënë fjetur, arsyet i dinë vetë. Edhe është e pashpjegueshme të thuhet se rritja e pagave të Qeverisë, a të gjyqtarëve, a të sektorit publik, e ka shkaktuar këtë. I ka ardhur koha pas tetë vitesh të trajtohet edhe kjo temë. Nuk e kam ndalë ndokënd ta trajtojë para meje. Pra, të paktën të kompensohet, sikur kjo në '16-tën kjo të kishte ndodhur, d.m.th. do ta kemi një situatë të 16-tës. Në fakt, nga viti 2011 kjo temë nuk është prekur.

Sot Parlamenti e ka mundësinë t'i kërkojë, ose t'i rekomandojë, ose të insistojë në marrje të një vendimi në përputhje me atë çka ka ndodhur. Janë rritur pagat në sektorin publik, pra janë rritur, në vazhdimësi në vite nga '11-ta, 2011. Merreni pagën e atëhershme në sektor publik. Kur ka qenë paga minimale 130 dhe 170, ju shumica jeni ekonomisë, edhe fatmirësisht që jeni, merreni edhe shiheni si ka qenë paga në sektorin publik atëherë. Paga në sektor publik është rritur në vazhdimësi, jo vetëm me ardhjen time, por nuk është prekur kurrë nga asnjë Qeveri paga në sektor privat.

Edhe ju lus ta ruajmë njëfarë kredibiliteti të diskutimit. Unë mund të jem fajtor për plot sende, po s'jam fajtor prej të '11-tës deri në fund të '17-tës, kur e kam marrë detyrën që s'është prekur paga në sektor privat, a në të njëjtën kohë i keni rritur pagat në sektorin publik. Fatmirësisht, shyqyr, të gjithë ne tash pasi e kemi stabilizuar sektorin publik, po mund të kthehemi edhe të reflektojmë edhe çka ka ndodhur edhe në sektor privat. Edhe këtë prapë po them nuk po e bëj unë, këtë po e bën Kosova, se ato janë para të njerëzve të Kosovës, vendime të Kosovës, të institucioneve të Kosovës.

Nesër, nuk e di pas tetë vitesh kush do të jetë në Qeveri, po nëse asnjë vendim s'merret deri atëherë, me siguri një qeveri pas tetë vitesh do të detyrohet të merret me vendimin tonë të sotshëm, ose të kësaj periudhe kohore. Pse po e flas këtë? Shikoni, unë kam provuar t'i marrë kontributet e juaja, në mënyrë që t'i kryejmë disa punë të Kosovës. Para një kohe, Parlamenti më ka obliguar t'i mbyllë lojërat e fatit. E ka marrë një vendim, më ka obliguar, kemi marrë vendimin. Parlamenti ka peshë përkundër faktit që është Këshilli Ekonomik-Social, përkundër faktit, edhe sugjerimet tuaja kanë peshë.

Unë e përmenda më herë, 239 euro dhe e përmenda koeficientin 1, a e dini pse, nëse ne e marrim një vendim sot, pa e marrë koeficientin bazë, pas disa vitesh, ky mund të stagnojë, ndërsa pagat në sektorin publik rriten çdo vit me koeficient të njëjtë, ose katër ose pesë për qind, çdo qeveri duhet t'i rrisë realisht. Edhe unë mendoj që prapë edhe vitin që vjen, çdo vit, pa i pritur zgjedhjet duhet të rriten. Pra, rriten çmimet, rritet inflacioni, rritet kostoja e shportës ose e jetesës, edhe është e logjikshme. Atëherë, nëse e merrni ju koeficientin 1, nëse rastësisht e marrim si pikënisje, atëherë çdo vit obligohet të ecën me koeficient. Pra nuk është 239, nëse vendosim sivjet 239. Nëse ky koeficient, kur i rrisim pagat p.sh. ne, e arrin 239 ta zëmë 245 a 250, atëherë ne ia mundësojmë sektorin privat të ecën me një dinamikë të njëjtë krahasuese me sektorin publik. Nuk duhet të jesh shkencëtar për ta kuptuar pse është me rëndësi kjo. Sikur të kishte pasur një ligj në 2011-ën, atëherë edhe sikur të kishte pasur një shifre krahasuese në bazë të ligjit me një koeficient, nuk kishte mbetur paga minimale 130 euro ajo e 2011-ës, po sot do ta kishim pagën minimale diku të krahasuar me koeficientin ta zëmë që mund të ishte një tjetër.

Unë e thash më herët dhe vërtet mendoj që sektori privat po ashtu duhet ta kuptojë këtë. Pse them duhet ta kuptojë. Nuk është kjo qëllim i yni t'ia bëjmë ligjin atyre sipërmarrësve që mezi i japin rrogat. Ka plot prej tyre që nuk fitojnë shumë, zor e kanë t'i japin rrogat, kur vjen i pari a i dyti, unë e di që ata janë në siklet të madh. Për këtë, jemi ofruar prej fillimit për një dialog të përhershëm me sipërmarrësit tonë, me odat me krejt organizimet ekonomike, edhe i falënderoj për një partneritet me ta. Të gjitha ato politika fiskale, të dakorduara më herët janë zbatuar menjëherë që t'ua lehtësojë të bërit biznes edhe punën.

E pranoj që ne kemi sfida me korrupsion, kemi sfida të tjera me rend dhe ligj, nuk janë të sotme besoj, të gjithë e dimë që ato kanë ekzistuar edhe në kohën e qeverisjes paraprake. Kjo nuk është një amnisti për këtë Qeveri. Ne duhet të përballemi me korrupsionin. Por, nëse dikush do të më bind mua, ose zonja ministre, ose një ministër që në Qeverinë Mustafa nuk ka pasur korrupsion, nuk mendoj që është mirë të flitet ashtu. Jo, s'e ka pasur, nuk e di a ka pasur, se po të ketë, shkoj në prokurori, po kur të ka korrupsion, janë prokuroria, janë gjykatësit. Vetë prokuror s'jam, edhe s'jam bërë ndonjëherë. Po, po dua t'ju them, ju lutem merreni këtë temë ta kryejmë së bashku. Pra, unë jam i interesuar ta kryejë, i kemi kryer edhe do tema të tjera edhe besoj shumë, besoj shumë që sipërmarrësit do të na kuptojnë.

Ajo që po ashtu është tepër me rëndësi, pos pagës, zbatimi i Ligjit të punës, i të drejtave në punë, të drejtave të punëtorëve. Inspektimi duhet të rritet. Pra, jo veç informaliteti, po edhe kushtet e punës, të drejtat e punëtorëve në punë duhet të rriten që janë bërë 20 vjet. Nuk jemi më në atë kohën e emergjencave bash që ka qenë dikur që të vlejë kaosi. Duhet të shkohet nga një normalitet më i madh, nga një normalitet më ligjor. E falënderoj pra grupin parlamentar PSD për thirrjen e kësaj interpelance. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Fjalën e ka propozuesi i interpelancës. Zoti Visar Ymeri si propozues, e keni fjalën. I keni pesë minuta.

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues!

Falënderoj të gjithë deputetët që morën pjesë në këtë diskutim. Falënderoj po ashtu edhe Kryeministrin, edhe me faktin që u pajtua me temën në përgjithësi, edhe me fjalën e tij në të dyja rastet.

Konsideroj që është jashtëzakonisht e rëndësishme që ta prodhojmë një rezolutë bashkë ne si Kuvend, me të cilën do të duhej të trajtoheshin disa prej çështjeve të cilat u diskutuan këtu. Pra, edhe masat konkrete që i kemi kërkuar dhe po i kërkojmë si deputetë, po pastaj edhe masa të cilat efektin e zbatimit do ta kishin pak më afatgjatë. Sepse, natyrisht që po flasim për një çështje, ose rreth një çështjeje e cila nuk është as problemi i vetëm, për sa i përket mënyrës sesi trajtohen punëtorët në Republikën e Kosovës, e as që do zgjidhte këtë problem me një masë të caktuar.

Mirëpo, paga minimale megjithatë është shumë e rëndësishme. Është e rëndësishme për shkak se përmes pagës minimale dhe pagës mesatare në sektorin privat, atë që e përmendi edhe kryetari i GP të LDK-së, më së miri mund të kuptohet për mendimin tim, atë që quhet marzha e eksploatimit ose e shfrytëzimit të punëtorëve në Republikën e Kosovës. Pra, sa krijon punëtori vlerë me punën e vet, dhe sa merr si kundërvlerë në formë të pagës. Kjo për mendimin tim është çështja kryesore që duhet ta diskutojmë me po e diskutojmë. Mirëpo, në mungesë të të dhënave statistikore, për ta pasur një pasqyrë pak më të saktë për këtë çështje, ne mund vetëm ta shtrojmë si hipotezë. Po që është e lartë, është e lartë. Këtë e dimë të gjithë besoj dhe këtë e nisi si diskutim veçanërisht mendoj deputeti Bilall Sherifi në fjalën e tij.

Sidoqoftë, duhet ta qartësojmë një gjë që e dëgjova këtu prej deputetëve. Është e vërtetë që paga minimale ka qenë me Ligjin për veteranët e lidhur me kompensimin mujor për veteranët e luftës, mirëpo kjo lidhje është hequr në amendamentimin e këtij ligji në vitin 2016, në të cilin, neni 18 atij ligji është fshirë komplet nga teksti i ligjit, që ka qenë drejtpërdrejt lidhur me këtë. Pra, tash me ligjet në fuqi, nuk është më kjo e lidhur dhe këtë besoj që nuk duhet ta përdorim si argument kundër pagës minimale. Veç nuk qëndron, nuk është e vërtetë, po ta them qartë.

Rezoluta që e kemi propozuar ne duhet ta ndryshojmë. Pra, duhet ta ndryshojmë edhe si reflektim i debatit që e zhvilluam sot dhe duhet ta ndryshojmë edhe si reflektim i ndryshimit të rrethanave. Pra e përmenda unë që ajo tekst-rezolutë ka qenë e propozuar në fillim të këtij viti dhe prej atëherë për çështjen kanë ndodhur disa gjëra të cilat duhet t'i marrim parasysh. Mirëpo, një prej çështjeve që mendoj unë që është jashtëzakonisht e rëndësishme, është që ne si Kuvend duhet ta miratojmë një kërkesë obligative për Qeverinë që në një afat normal, p.sh. brenda 30 ditësh, gjithsesi ta marrë vendimin për rritjen e pagës minimale.

E dyta, pastaj, ne mund të sugjerojmë shuma dhe shifra, po natyrisht që ky është vendim i Këshillit Ekonomik-Social dhe i diskutimit aty në mes të tri palëve, pra përfaqësuesve të Sindikatave, përfaqësuesve të shoqatave e odave të biznesit si dhe përfaqësuesve të Qeverisë. Ata duhet ta nxjerrin shifrën përfundimtare, të propozuar për Ligjin për paga dhe pastaj Qeveria ta zbatojë të njëjtin.

Çështja e tretë që mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme është që domosdoshmërisht duhet të hiqet niveli i dyfishtë i pagave minimale, pra sipas moshës. Nuk mendoj që duhet të ketë diskriminim në paga as sipas moshës, as sipas gjinisë. Ata që e bëjnë punën e njëjtë, duhet të paguhen në mënyrë të njëjtë, pavarësisht çfarë moshe kanë, pavarësisht çfarë gjinie kanë, pavarësisht se çfarë emri kanë. Në këtë drejtim, konsideroj që kjo është një prej aspekteve shumë shqetësuese, diskriminuese që ndodh në Republikën e Kosovës.

Çështja e katërt, e cila për afatgjatë është më e rëndësishmja, është që po, duhet ta kemi një lloj indeksimi objektiv të asaj që quajmë pagë minimale të nivelit të saj, siç duhet ta kemi një vlerësim objektiv të koeficientit për sektorin publik. Pra, cilët janë faktorët, parametrat që merren parasysh kur llogaritet 239, 250-shi, 270-shi në të ardhmen e kështu me radhë. Kjo duhet ta ketë të them kështu një formulë objektive të trajtimit, përndryshe bëhet vendim arbitrar. Pra, si mund të themi sot pse është koeficienti 239 euro? Duhet ta ketë një shpjegim. Pse do të jetë nesër paga minimale 239 euro ose 250? Po ashtu duhet ta kemi një shpjegim.

Kështu që ka mbetur edhe pak kohë. Edhe një herë.

Deputetë të nderuar,

Ju falënderoj shumë. Po shihet qartë që aktualisht në sallë nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për të marrë çfarëdo vendimi. Grupet parlamentare të cilat janë të interesuara që të propozojnë çështje për rezolutë, janë të mirëseardhur natyrisht që të më kontaktojnë edhe ta bëjmë një rezolutë të cilën do ta votojmë shprehimisht sot. Faleminderit.

KRYESUESI: Faleminderit z. Visar. Faleminderit Kryeministër! Faleminderit të gjithë deputetëve për angazhimin e vazhdueshëm për këtë pikë të rendit të ditës.

Mendoj që ka përfunduar si pikë e rendit të ditës. Koha është për të marrë pauzën dhe për të vazhduar pastaj pas pauzës interpelancën me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zoti Valdrin Lluka. Në orën 14:15 do ta vazhdojmë seancën. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë,

Zoti ministër,

Po vazhdojmë me seancën e filluar në mëngjes:

37. Interpelanca e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z. Valdrin Lluka, sipas kërkesës së kryetarit të GP Partia Socialdemokrate, z. Dardan Sejdiu, i mbështetur edhe nga 11 deputetë, në lidhje me themelimin e Ndërmarrjes së Re Energjetike të Kosovës sh. a./NKEC

Kryetari Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, zoti Sejdiu i mbështetur nga 11 deputetë kanë bërë kërkesën. Ju njoftoj se në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. I dini rregullat.

Tani, unë ftoj përfaqësuesin e nënshkruesve për interpelancë, zotin Visar Ymeri që në emër të kërkuësve të interpelancës ta marrë fjalën dhe ta arsyetojë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër, zoti Lluka,

Të nderuar deputetë të paktë, do të thosha që jeni në këtë sallë,

Tash jemi në një interpelancë tjetër e cila po ashtu është thirrur për një kohë të gjatë nga Partia Socialdemokrate, më saktësisht më 26 nëntor të vitit të kaluar është dorëzuar kërkesa për ta diskutuar këtë çështje.

Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, zoti Lluka në mbledhjen e mbajtur më 15 maj të viti 2018, ka marrë vendim për themelimin e ndërmarrjes së re energjetike të Kosovës, SHANKEC me 100% aksione nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sipas kontratës së nënshkruar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka më 20 tetor të vitit 2017, Qeveria e Republikës është e detyruar që të themelojë këtë ndërmarrje për të ndërmjetësuar mes kompanisë ‘Counter Global’ dhe të gjithë tregut energjetik të Republikës së Kosovës.

Sërish, sipas kontratës, ndërmarrja e re ka obligim kontraktual që tërë prodhimin e termocentralit të ri, pra ‘Kosova e Re’ ta blejë nga ‘Counter Global’ edhe nëse kjo nuk është e nevojshme për konsumin në Republikën e Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës, sërish me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik ka emëruar bordin e përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes së re energjetike NKEC. Në këtë kuptim Qeveria bëri edhe hapi e dytë, pa e diskutuar me Kuvendin, sikurse bëri edhe me nënshkrimin e marrëveshjes në dhjetor të vitit 2017.

Ashtu siç u veprua me privatizimin e rrjetit të shpërndarjes, i cili ishte i dëmshëm dhe shkatërrues për Republikën e Kosovës, njësoj ky konsiderohet si hapi i dytë, pra themeli i kësaj ndërmarrje të re në kuadër të projektit më të madh të dëmshëm, marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë ‘Counter Global’ dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërtimin, menaxhimin dhe funksionalizimin e termocentralit ‘Kosova e Re’ e cila është nënshkruar në dhjetor të vitit 2017.

Janë së paku shtatë dëme madhore që kjo ndërmarrje e re dhe tërë logjika që e përcjell këtë lloj të privatizimi, të gjenerimit në Republikën e Kosovës të energjisë elektrike, e të cilat do t’i përmendi tash.

E para, është që ndërmarrja e re energjetike e Kosovës në bazë të kontratës për ndërtimin e termocentralit ‘Kosova e Re’ ka vetëm një mision. Pra, blerjen e të gjithë energjisë në dispozicion nga termocentrali ‘Kosova e Re’ meqë në bazë të kontratës, termocentrali do të fillojë së operuari në vitin 2023, ndërmarrja e re energjetike e Kosovës e krijuar tani nuk do të ketë kurrfarë funksioni në tregun e energjisë.

Për vite të tëra ne do të paguajmë prej rrogave të anëtarëve të bordit e të punonjësve e shpenzime tjera krejtësisht pa nevojë. Të vetmin funksion që e ka kjo ndërmarrje, do të mund të fillojë ta zbatojë në vitin 2023.

Ndërmarrja e re energjetike e Kosovës është e paprecedent në tregun e energjisë. Ajo do të blejë të gjithë energjinë nga vetëm njëri operator në tregun e prodhimit të energjisë. Në kohën kur tregu do të duhej të ishte i lirë e të gjithë të konkurronin si të barabartë.

Për më tepër, nuk mund të ketë as bashkim të tregut me Shqipërinë dhe as treg të integruar rajonal nëse në Kosovë shteti favorizon njërin nga prodhuesit, në këtë rast termocentralin ‘Kosova e Re’.

NKEC, çrregullon çmimet e prodhimit. E çrregullon rrjetin pasi që energjia që blihet nga ‘Kosova e Re’ ka përparësi në futjen në rrjet dhe rrit çmimin e energjisë në masë të papërbalueshme për qytetarët.

Ekonomia e tregut si vlerë e kategori kushtetuese në Kushtetutën e Republikën e Kosovës, ka kuptim vetëm kur aktorët në treg zhvillojnë konkurrencë të lirë të papenguar dhe të pandikuar, dhe ku oferta dhe kërkesa përcaktojnë çmimet e produkteve.

Nuk mund të ketë konkurrencë të lirë në treg nëse njërit nga operatorët i është garantuar çmimi.

NKEC do të blejë energjinë vetëm nga njëri aktor në treg duke ia mbuluar kostot dhe fitimin e garantuar termocentralit 'Kosova e Re'.

Komuniteti i energjisë pjesë e të cilit është edhe Kosova, tashmë ka alarmuar se kjo kontratë dhe roli i NKEC përbëjnë ndihmë shtetërore. Ndihma shtetërore është e ndaluar edhe me ligjet vendore, por edhe me legjislacionin evropian.

Duke qenë se NKEC garanton blerjen e produktit, bashkë me një normë fitimi të garantuar, kjo përbën ndihmë shtetërore, sepse një ndërmarrje publike në mënyrë të hapur krijon privilegje për një kompani që do të duhej të konkurronte me çmimet e veta në treg.

Ky është një avantazh selektiv që ndalohet me Kushtetutën e vendit. Me traktatin e komunitetit të energjisë, me Ligjin nr. 05/L-100 për Ndihmë Shtetërore dhe me strategjitë e përkushtimet e Republikës së Kosovës në integrimet evropiane.

Me punën e saj, ndërmarrja publike NKEC do të shkaktojë monopol faktik në tregun e energjisë në Kosovë. Me garantimin e lëndës së parë, qymyrit dhe ujit, shitjes së të gjithë produktit, pra energjisë, futjes së tij në rrejt sepse është në përparësi të dispeçimit, termocentrali 'Kosova e R', dhe garantimin e çmimit bashkë me fitimin, 'Kosova e Re' praktikisht do të jetë pas asnjë riskë në tregun e energjisë.

Kjo pothuajse me automatizëm krijon kushte ideale për monopol në treg në dëm të konkurrencës së lirë nga e cila do të përfitonin qytetarët. Përkundrazi, monopoli do të imponojë çmime të larta dhe do të pengojë investitorët e tjerë që janë të interesuar të investojnë në kushte të tregut.

NKEC do të jetë kryesisht në shërbim të implementimit të kontratës për ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re'. Duke qenë se do të funksionojë si blerës i garantuar i energjisë së termocentralit të ri, ndërmarrja e parë në treg e cila do të goditet, do të jetë ndërmarrja nën pronësi publike, pra Korporata Energjetike e Kosovës, përkatësisht 'Kosova B'.

Kjo ndërmarrje me gjithë kushtet e vështirësuar, për dallim nga ndërmarrjet tjera publike vazhdon të operojë me fitim.

NKEC do ta falimentojë 'Kosovën B', sepse ndonëse do të ketë çmime më të lira nuk mund ta konkurrojë 'Kosovën e Re' që do të ketë çmime të garantuara. Rrjedhimisht 'Kosova B' do të detyrohet ta ulë prodhimin ose ta shes energjinë nën koston e prodhimit.

Tash së fundi, Zyra e Rregullatorit për Energji është duke e shqyrtuar vënien e një takse për siguri të furnizimit për të gjithë operatorët furnizues të energjisë në Kosovë. Paratë nga kjo takse do të përdoren për të paguar të gjitha kostot që NKEC do të ketë për blerje të energjisë së shtrenjtë të 'Kosovës së Re'.

Çka nënkupton kjo? Të gjithë furnizuesit do të bartin këtë kosto tek konsumatorët e Kosovës që nënkupton se ne do të paguajmë pafund, pa nevojë dhe me çmime të larta në emër të sigurisë së furnizimit. Përkundrazi, siguria e furnizimit në një produkt bazë siç është energjia është e drejtë e konsumatorëve dhe jo produkt që duhet blerë.

Praktikisht, deputetë të nderuar të Kuvendit të Republikës, ideja e themelimit të kësaj ndërmarrje publike është që të ndërmjetësohet, dhe ky ndërmjetësim në tregun e energjisë të shfrytëzohet ose të përdoret si një lloj balancimi i çmimit të lartë të blerjes së Mgw të energjisë elektrike nga termocentrali 'Kosova e Re' dhe një çmimi më të ulët të shitjes të distributorit dhe aktualisht furnizuesi ose operatori i vetëm që ka licencë furnizimi në Republikën e Kosovës, pra te KEDS-i.

Në këtë drejtim, do të jenë paratë publike, të ndërmarrjes publike ato të cilat do t'i kompensojnë dy lloj fitimesh në sektorin ose segmentet e privatizuara të sistemit të tërësishëm energjetik. Pra, fitimin e termocentralit 'Kosova e Re' një njëerën anë dhe pastaj fitim që do ta realizojë KEDS-i në tarifata e veta.

E kemi parë që në Republikën e Kosovës deri tash ka dy mundësi ose dy mënyrë sesi qytetarët e Republikës janë obliguar që të paguajnë fitimet enorme të kompanive që furnizojnë me energji elektrike. Pra, njëra është e drejtpërdrejt nëpërmjet rritjes së tarifave, e cila ndodh vit pas viti, jo për çdo vit, dhe tjetra është indirekte nëpërmjet parave të buxhetit ose parasë publike.

Para këtë që orientohen dhe kanalizohen në mënyra jo të drejtpërdrejta prapë në përfitimet e kompanive private të cilat operojnë në Republikën e Kosovës në sektorin e energjisë në të.

Ne, në këtë interpelancë e kemi edhe një rekomandim në formë rezolute të cilën natyrisht që jemi të gatshëm ta plotësojmë dhe ta miratojmë në fund me propozimin edhe të deputetëve tjerë.

Ajo rezolutë i ka dy pika. Po i lexoj shpejt meqë nuk janë të gjata.

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik:

a) Të ndërpresë të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në lidhje me regjistrimin e ndërmarrjes së re energjetike të Kosovës, derisa Kuvendi të vendos për miratim të garancionit të marrëveshjes komerciale mes kompanisë ‘Contour Global’ dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për termocentralin ‘Kosova e Re’.

b) Të mos lidhë asnjë marrëveshje kontraktuale derisa Kuvendi të vendos për miratimin e garancisë dhe në këtë mënyrë pra të vendos nëse është dakord me këtë kontratë të nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës apo kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta anulojë këtë kontratë, ta kthej prapa dhe të gjejnë mënyrë të tjera shumë më të përshtatshme për Republikën e Kosovës, për investimet në energji dhe për furnizimin të duhur dhe të bollshëm të qytetarëve dhe ekonomisë sonë me energji elektrike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar... Më falni se u dashka ta marrë fjalën ministri. Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, ministri i Zhvillimit Ekonomik, zoti Valdrin Lluka e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështjet e ngritura në interpelancë me kohëzgjatje prej 15 minutash.

Zoti Lluka e ka fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Siç edhe jeni të informuar Qeveria e Kosovës më 20 dhjetor të viti 2017, pas një procesi më shumë se 10-vjeçar studimi e negociimi, ka nënshkruar marrëveshjen për ndërtimin e termocentralit ‘Kosova e Re’.

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike është problematikë në vete në Kosovë që nga paslufta, e cila patjetër kërkon një zgjidhje urgjente të bazuar ekskluzivisht mbi resurset natyrore që posedon vendi ynë.

Në këtë drejtim, më lejoni të nënvizojë faktin se qëllimi parësor i ndërtimit të termocentralit ‘Kosova e Re’, është që t’i plotësojë nevojat për energji elektrike në vend. Të rrisë sigurinë e furnizimit duke krijuar burim të qëndrueshëm të energjisë bazë, të mbështetur ekskluzivisht në resurse natyrore të vendit, me qëllim të mënjanimin të vartësisë nga importi dhe nga para përshkueshmëria e çmimit në tregun rajonal.

Pra, ndërtimi i termocentralit ‘Kosova e Re’, përveçse jetik për vendin dhe i domosdoshëm për furnizim të besueshëm me energji elektrike është parakusht i domosdoshëm për nxitje dhe zhvillim ekonomik në vend.

Problemi i furnizimi me energji elektrike në Kosovës është i hershëm dhe kryekëput lidhet me mungesën e investimeve. Viti 1984 është viti i cili shënon fundin e investimeve në ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues në këtë sektor.

Sot, që po flasim, kapacitet ekzistuese janë në fund të ciklit të tyre dhe jashtë çdo standardi të operimit. Aktualisht gjenerimi i energjisë elektrike përballet me probleme serioze në pikëpamje të sigurisë teknike të sistemit si pasojë e vjetërsimit, rrjedhimisht duke operuar me kapacitet e vjetërsuara e të pa rehabilituara.

Besueshmëria e sistemit ekzistues është e pasigurt, shtu faktin e ndikimit negativ në mjedis dhe në shëndetin publik.

Si rezultat i mungesës së investimeve dhe planifikimit të duhur, qytetarët e Kosovës që nga paslufta janë përballur me reduktime. Prej vitit 2000 e deri në vitin 2018, Kosova ka importuar rreth 650 milionë euro energji elektrike.

Pra, 650 milionë euro të qytetarëve të Republikës së Kosovës kanë përfunduar jashtë vendit me qëllim të sigurimit të energjisë elektrike. Pra, kjo do të thotë, ne kemi gjeneruar vende pune për vendet tjera. Vendet fqinje. Ne kemi gjeneruar aktivitet ekonomik për vendet tjera dhe duke importuar energjinë elektrike ne kemi zvogëluar bruto produktin vendor të vendit tonë.

Pra, efekte të shumëfishta negative ekonomike.

Po ashtu, 330 milionë euro janë humbjet vjetore të biznesit në Kosovë si pasojë e furnizimit jo të rregullt me energji elektrike, që nënkupton se mungesa e furnizimit të rregullt është pengesa kryesore në zhvillimin e biznesit, rrjedhimisht të rritjes së gjithmbarshme ekonomike të këtyre bizneseve.

Pra, edhe bizneset janë jo konkurrues në krahasim me vendet tjera të rajonit që kanë stabilitet energjetik.

Ndërtimi i termocentralit 'Kosova e Re', përveç se do të mbulojë pothuajse gjysmën e kërkesës për energji elektrike në Kosovë, po ashtu do të jetë burim afatgjatë i energjisë termike për ngrohje qendrore, si dhe do të përmirësojë substancialisht aspektet sociale dhe mjedisore, marrë në konsideratë që 'Kosova e Re' do të ndërtohet në harmoni me direktivën e Bashkimit Evropian për emetimet industriale me eficientë mbi 40%.

Për më tepër, ndërtimi i një termocentrali do të shënojë investimin më të madh privat në historinë e vendit tonë.

Gjithashtu, shumë me rëndësi është që në përputhje me vlerësimet reale dhe trendët socio-ekonomike, kërkesa për energji elektrike deri në vitin 2026 do të shënojë një rritje deri në 19% në krahasim me kërkesat aktuale.

Është e qartë se ekziston një nevojë urgjente për kapacitetet të reja gjenerues të cilat kapacitete do të kenë ndikim shumëdimensional. Përveç të sigurimit të furnizimit me energji elektrike, po ashtu edhe me impakt ekonomik dhe mjedisor.

Në përputhje me kërkesat në rritje të energjisë elektrike, më lejoni të theksoj se vetëm gjenerimi i energjisë nga kapacitet e besueshme mund të sigurojë plotësim të këtyre kërkesave në rritje për këtë energji.

Në këtë drejtim, jemi të bindur se ndërtimi i kapaciteteve të reja siç është ‘Kosova e Re’ me qëllim të zëvendësimit të atyre ekzistuese është e vetmja zgjidhje e pranueshme dhe e përballueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të potencoj që ndërtimi i kapaciteteve të reja gjeneruese dhe adresimi i furnizimit me energji, përveç domosdoshmërisë praktike është në përputhje me objektivat strategjike të politikës së Republikës së Kosovës.

Kjo, në përputhje me objektivin e parë të strategjisë për energji të Republikës së Kosovës që i kemi kaluar për 10 vitet e ardhshme. Për sigurim të furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil.

Gjithashtu, me strategjinë kombëtare për zhvillim 2016-2021, e cila ndër të tjera parasheh dhe inkurajon ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe energji të qëndrueshme.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të nënvizoj faktin se para fillimit të gjenerimit të energjisë elektrike nga termocentrali ‘Kosova e Re’, do të merren të gjitha masat e duhura për ta arritur gjenerimin e energjisë elektrike, respektivisht mbulueshmërinë e kërkesave gjatë kohës pikut të rezervave të fuqisë rregulluese të sistemit të pajtueshmërisë me kërkesat e tregut.

Për më tepër, do të sigurohet që i gjithë kapaciteti i prodhuar nga të gjitha njësitë prodhuese energjetike në vend do të plasohet në treg. Për këtë qëllim Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ajo Shqipërisë tashmë kanë filluar me integrimin e tregut energjetik e cila do të ndikojë ndjeshëm në përmirësimin e kushteve të operimit të dy sistemeve elektrike respektive.

Rrjedhimisht, në përputhje me obligimet që derivojnë nga marrëveshjet komerciale për ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re, gjegjësisht siç parashihet me marrëveshje për blerje të energjisë, Qeveria e Republikë së Kosovës më 15 maj 2018, ka themeluar ndërmarrjen e re energjetike të Kosovës N-KEDS, shoqëri aksionare.

Kjo ndërmarrje është organizuar të jetë trupë profesionale e cila do të shërbejë si filtër i parë karshi këtyre obligimeve dhe e cila gjatë fazës së ndërtimit të termocentralit do të operojë me kapacitete minimale dhe e mbështetur me ekspertizë të jashtme profesionale deri në përfundimin e ndërtimit dhe fillim e operimit të termocentralit.

Më lejoni t'ju sqaroj se në përputhje me mandatin e komitetit drejtues të projektit, ndërmarrja e posa themeluar N-KEDS, së bashku me komitetin do të ushtrojë kompetenca të bashkëdyzuara profesionale dhe teknike me qëllim të mbikëqyrjes strikte dhe përmbushjes së obligimeve nga ana e kontraktuesit sipas marrëveshjes apo marrëveshjeve komerciale gjatë gjithë procesit tenderues dhe procesit të ndërtimit të termocentralit me qëllim të sigurimit të ndërtimit brenda afateve dhe me çmim sa më të favorshëm.

Për më tepër, ju konfirmoj se ndërmarrja N-KEDS do të jetë entitet jofitimprurës e cila do të plasojë të gjithë kapacitetin e prodhuar energjetik në funksion të sigurisë së furnizimit në vend, si objektiv parësor i këtij projekti.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës dhe palët tjera nënshkruese të marrëveshjes komerciale për ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re' kanë marrë përsipër përmbushjen e disa obligimeve në përputhje me mandatin dhe funksionin e tyre, përfshirë edhe themelimin e kësaj ndërmarrje.

Obligime këto që duhet të përmbushen në funksion të përmbylljes financiare. E për të cilat gjatë gjithë vitit 2018 është punuar intensivisht.

Në këtë drejtim, më lejoni të nënvizoj se përmbushja e secilit obligim ka për qëllim përfundimtar implementimin e projektit dhe sigurimin e çmimit sa më konkurrues të gjenerimit.

Më lejoni ta përmbyll këtë diskutim duke ritheksuar se ndërtimi i termocentralit 'Kosova e Re' do të ketë ndikim shumëdimensional. Duke siguruar pavarësi energjetike për vendin. Dyfishim të kapaciteteve për ngrohje qendrore. Shfrytëzim të resurseve natyrore të vendit. Përmirësim të ambientit dhe shëndetit publik. Rritje ekonomike si dhe krijim të parakushteve të zhvillim të qëndrueshëm.

Po ashtu, ndërtimi i këtij termocentrali do të përmbushë nevojat në rritje të konsumit të energjisë, si dhe do të sigurojë integrimin e tregut energjetik rajonal. Përmbushjes së obligimeve sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, strategjisë për zhvillim të qëndrueshëm të Republikës së Kosovës si dhe strategjisë së energjisë 2017-2026.

Termocentrali 'Kosova e Re' mbetet e vetmja zgjidhja për sigurimin e furnizimit stabil me energji elektrike, mbi të gjitha financiarisht opsioni më i mirë dhe më i përballueshëm për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Radhën e kanë grupet parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur zonja Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Falënderoj Partinë Socialdemokrate e cila ka ftuar një seancë me një tematikë të tillë. Në fakt, ajo çfarë mund të themi për Qeverinë rreth këtij projekti është që ka dështuar komplet që të jetë transparente, të prezantojë projektin ashtu siç duhet, dhe kjo u pa tani nga prezantimi i ministrit.

Ministër, deputeti Visar Ymeri ju bëri shumë pyetje dhe ju në asnjërën prej tyre nuk u përgjigjet. Bash në asnjërën prej tyre.

Kështu që, unë po ju bëj thirrje që në këtë seancë meqenëse pas tërheqjes së Bankës Botërore është krijuar komplet një situatë tjetër. Ju keni marrë obligime që të garantoni për kredinë e investitorit dhe ju duhen 80 vota të deputetëve të këtij Kuvendi, të jeni transparent se jo të gjithë kemi ndarë mendjen për të votuar.

Andaj, unë sot fjalimin tim do e bëj në formë të pyetjeve. Sinqerisht, pyetja që u parashtrua edhe më herët ishte se përderisa edhe nëse bëhet funksionale 'Kosova e Re', ajo do të fillojë me prodhim në vitin 2023. Çka u dashtë që të themelohet kompania publike e cila do e blejë energjinë elektrike në vitin 2019, në fakt 2018, ju thatë që e keni themeluar qysh më 15 maj të viti 2018.

Ministër, sa herë ju kemi pyetur edhe në komision, po ju kemi parë edhe në debate televizive, keni thënë që shifrat nuk janë ende përfundimtare.

Ne, sot si deputetë të Kuvendit e lerë më qytetarët e Kosovës, nuk e dimë se cila është kostoja e këtij projekti.

Ne, ju kemi dëgjuar juve që diku 300-400 milionë do të jenë investim privat për të cilët norma e kthimit të brendshëm do të jetë 18,3%. Unë ju kisha lutur juve në këtë seancë që të na e tregoni një projekt tjetër i cili po zhvillohet në rajon e që e ka normën e kthimit 18,3%.

Tjetra, pjesën tjetër, projekti do të financohet me kredi, prapë ju kemi dëgjuar nëpër debatet televizive që garantimin e kësaj kredie do e bëjë Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne, nuk e dimë, pas tërheqjes së Bankës Botërore se cilat janë kushtet.

Gjithashtu, është argumentuar që normat e interesit të kësaj kredie do të reflektohen në tarifën e energjisë elektrike që do t'i paguajnë konsumatorët, qytetarët e Republikës së Kosovës.

Sipas të dhënave që i kemi sot, energjia elektrike nga KEDS-i blihet me 30 euro KW, ndërsa importohet me 50 euro. Në bazë të kontratës që ju keni bërë, thuhet që është 80 euro për 20 vitet e ardhshme.

Tani, ministër e dimë edhe gjendjen e termocentralit ekzistues dhe të gjitha tjerat, po ajo çka po kërkojmë prej jush është, që ta dëshmosh këtë çmimin prej 80 eurosh. Do të thotë energjia elektrike dhe sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë do të rritet përreth 60%.

Kostot të cilat fare nuk janë të përfshira në projekt, është kostoja e hapjes së minierës së re. Sepse, në kushtet e kontratës, gjithashtu të dëgjuara, prapë nëpër debate televizive, thuhet që ju keni premtuar që do të furnizoni cilësi të limitit, domethënë cilësinë a të garantuar dhe ne kemi pasur gjithashtu disa ekspertë në komision, të cilët na kanë thënë se hapja e minierës së re dhe sigurimi i linjitet të cilësisë sipas kontratës do t'i kushtojë Qeverisë së Kosovës me qindra miliona euro.

Tani, ministër, unë kam qenë në komitetin ndërministror në qeverinë e kaluar me disa kolegë të mi.

Ne kemi negociuar përplot tri vite, po nuk kemi pajtuar të më besoni me asnjërin prej kushteve. Është shumë e vërtetë që norma e kthimit të brendshëm atëherë ka qenë edhe më e lartë, po e vërteta tjetër është që ne nuk e kemi pranuar atë normë të kthimit.

Andaj, unë ju bëj thirrje juve që kur doni që ta shisni si investim privat, po thoni që është arritje e jona, ndërsa kur flitet për anët jo shumë pozitive, thoni që është projekt që e ka punuar dikush tjetër.

Ne nuk mund të marrim përgjegjësi për kontratat që ju i nënshkruani, po gjithashtu edhe nuk mund të votojmë pa qenë të sigurt se çka po votojmë. Pa dalë ju edhe ta argumentoni secilën kosto, dhe pa u treguar qytetarëve të Republikës së Kosovës se sa do t'ju shtrenjtohet energjia elektrike.

Me disa kalkulime të thjeshta që ne i kemi bërë. Bizneset që i përmende dhe që the që humbin 300 milionë euro në vit nga ndërprerjet e energjisë elektrike, atyre do t'ju shtrenjtohet rryma qind për qind.

Tani, më thuaj do ju bëhet rryma më shtrenjtë sesa në të gjitha e rajonit. Na thoni atëherë sesi do të jenë konkurrese. Edhe tash me planin e Qeverisë për ta ndërtuar edhe një autostradë prej 1 miliardëve, ne duhet ta dimë se ku jemi.

Unë vetëm po ju them edhe diçka. Neve na duhen informata të sakta. Na duhet një prezantim i kontratës i detajuar në këtë Kuvend, sepse ju e dini shumë mirë që ne sot tregun e energjisë elektrike e kemi të deformuar me kontratën paraprake për privatizimin e distribucionit.

Sot, zoti ministër, shtatë kompani furnizuese të energjisë elektrike janë të licencuara në Kosovë dhe veç njëra është funksionale, për shkak të kontratës së dëmshme të privatizimit të distribucionit, sepse me kontratë e gjithë energjia elektrike duhet t'i jepet fillimisht KEDS-it, KESCO-s që është e njëjta gjë, dhe nëse ka teprica pastaj mund t'ju jepet të tjerëve.

Operatorët që janë të licencuar sot nuk mund të importojnë rrymë, sepse në atë mënyrë nuk do të jenë konkurrent.

Atëherë, me themelimin e ndërmarrjes tjetër N-KEDS, na thoni sesi do e sigurojmë ne tregun e lirë? Si do të bëhet funksional? Dhe gjithashtu, na tregoni sesi po mendoni që t'i adresoni çështjet që i ka ngritur komuniteti i energjisë dhe që po e konsideron këtë ndihmë shtetërore, që me të vërtetë është ndihmë shtetërore, sepse t'ia garantosh dikujt kredinë dhe t'ia paguash normat e kamatës, edhe t'i garantojnë gjithashtu që ke treg të sigurt për 20 vjet me çmim të caktuar, por edhe normën e kthimit 18,3%, kjo nuk ka se si të konsiderohet ndryshe vetëm 100% ndihmë shtetërore.

Edhe një gjë po ju them, zoti ministër, në Qeverinë e kaluar e dini, ka qenë negociim e sipër projekti i "Brezovicës". Kemi pritur në atë kohë që të bëhet një projekt qindra milionësh, ka dështuar për shkak se investitori nuk ka arritur t'i mobilizojë mjetet. Më besoni, unë ju garantoj, që jo ai projekt, po edhe me qindra projekte, në qoftë se Qeveria do të siguronte treg, do të garantonte për kredinë e tyre, do t'ua paguante normat e interesit, ne ishim bërë vendi me investimet më të mëdha, po ekonomia e tregut nuk funksionon kështu.

Na tregoni se cilat rreziqe po i merrni ju si Qeveri, e po i marrim na si shoqëri për 20 vjetët e ardhshme, sepse kjo është çështje serioze, e besoj shumë serioze e bën fakti se të duhen 80 vota të deputetëve në këtë Kuvend, e prapë po e them, pa qenë të bindur, unë nuk e besoj që i bën 80 vota. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, në fund e keni fjalën, zoti ministër. Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi në emër të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para se të flas konkretisht për temën e ngritur nga deputetët që e kanë ftuar këtë interpelancë, dua t'i përmend apo t'i rikujtoj disa prej objektivave kryesore sektoriale të vendit tonë, të cilat priten të përmbushen përmes projektit Kosova e Re, mbi të cilat premisa edhe është zhvilluar struktura e këtij projekti.

Në një, qëllimi kryesor është siguria e furnizimit, pastaj stabiliteti dhe parashikueshmëria në gjenerim, gjenerimi bazuar në resurset ekonomike në vend, si dhe përmirësimi i bilancit tregtar dhe evitimi i ekspozimit ndaj riskut të importit.

Pra, këto janë disa nga objektivat kryesore në dokumentet strategjike të energjisë të miratuara nga Qeveria dhe nga ky Kuvend, por edhe kur bëhet fjalë për sektorin në përgjithësi e për projektin Kosova e Re në veçanti.

Prandaj, është mirë të sqarohet sa herë që flasim për këtë projekt që ajo është dizajnuar në atë mënyrë që të përmbushë qëllimin e inicimit të këtij projekti, duke i adresuar kërkesat, por edhe obligimet e Qeverisë ndaj investitorit dhe të investitorit ndaj kontratës.

Thënë më thjesht, ne kemi kërkuar që investitori të bartë nën a) riskun e financimit, pastaj të marrë përsipër riskun e ndërtimit, por edhe riskun e operimit të këtij termocentrali të ri.

Në anën tjetër, institucionet e vendit tonë duhet të kujdesen që energjia e gjeneruar me prioritet të plasohet në tregun vendor, në funksion të sigurimit të furnizimit me energji, të sigurohen që të gjitha entitetet, të cilat janë pronësi publike dhe që janë jashtë ndikimit apo kontrollit të investitorit të kryejnë obligimet e marra, siç është furnizimi me thëngjill, furnizimi me ujë, kycja në rrjetin e transmisionit, e kështu me radhë, në atë mënyrë që investitori të operojë dhe të përmbushë objektivat e lartpërmendura.

Tani kur jemi para përmbylljes financiare dhe në projekt janë të involvuara një numër i konsiderueshëm i institucioneve kredibile ndërkombëtare financiare, siç është OPIK-u amerikan apo JBIC-ja japoneze, pra Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, mendoj që është shumë e rëndësishme që edhe ne si institucione, duke përfshirë Kuvendin në radhë të parë, të dëshmojmë që mbi të gjitha si shtet jemi në gjendje që të përmbushim obligimet e parapara në kontrata dhe siç parashihen në strukturën e përgjithshme të këtij projekti.

Në këtë kontekst, edhe themelimi i ndërmarrjes së re energjetike të Kosovës që është temë e kësaj interpelance, është një nga obligimet kontraktuale dhe i shërben argumentit para institucioneve financiare ndërkombëtare që Kosova është duke i përmbushur detyrat e veta dhe obligimet siç i ka marrë përmes kontratës së projektit.

Ndërmarrja e re energjetike në Kosovë në fazën e implementimit të projektit do të jetë kundërpala kryesore e investitorit, ashtu siç parashihet në marrëveshjen për shitblerjen e energjisë dhe pala që do të kujdeset që investitori është duke ndërmarrë veprimet e parapara kontraktuale edhe në kuptimin kohor, edhe në kuptimin e kostos.

Bazuar nga kjo, ne inkurajojmë, por edhe kërkojmë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që të shtojë dinamikën e zbatimit, por edhe që të kërkojë nga investitori që do t'u përmbahet kushteve edhe afateve të parapara në kontratë. Edhe ashtu ka kaluar një kohë jashtëzakonisht e gjatë prej kur është iniciuar ky projekt, e veçanërisht prej kur ka filluar edhe faza e konkretizimit përmes nënshkrimit të marrëveshjes.

Në të njëjtën kohë pa dyshim që është e nevojshme që edhe Qeveria të përmbushë obligimet që i ka marrë edhe në kuadër të kontratës me investitorin, por mbi të gjitha që të përmbyllë marrëveshjen financiare edhe që të silllet pakoja e garancive financiare për votim në Parlament.

Unë pajtohem që kjo pako duhet të ketë mbështetjen e deputetëve dhe si e tillë duhet të jetë e favorshme për Republikën e Kosovës, por deri më tash ne nuk kemi detaje konkrete se si mund të duket ajo dhe për këtë arsye kërkojmë që sa më parë, pa humbur kohë të ndërmerren veprimet konkrete nga Qeveria për të ardhur deri në këtë pikë, ashtu që me të vërtetë të fillojë edhe konkretisht ndërtimi i këtij termocentrali, i cili vazhdon të jetë në diskursin tonë publik për dekada tashmë me radhë, realisht një dekadë e gjysmë pothuajse, por që konkretisht ende nuk ka filluar ndërtimi i tij.

Andaj, unë në këtë fazë të parë po e përmbyll duke uruar që ky vit vërtet të jetë edhe simbolikisht viti i fillimit të ndryshimit të gjendjes energjetike në Kosovë, me fillimin e ndërtimit të termocentralit Kosova e Re, që do të jetë me të vërtetë jo vetëm projekti më i madh energjetik që mbi katër dekada, por me siguri projekti më i madh investim në Republikën e Kosovës së paku në këto 20 vjetët e pasluftës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, këtu secili parafolës ia dha një epitete të caktuar projektit Kosova e Re, edhe unë po ia jap një timin.

Mendoj që Kosova e Re do të hyjë në historinë e kontratave të Kosovës së pasluftës si projekti ekonomik më i kriminalizuar që është nënshkruar ndonjëherë në Kosovë.

Mendoj që për nga konsekuencat penale që do të rrjedhin prej kësaj kontrate, zoti ministër, ia kalon shumë herë dëmi të kontratës së Qeverisë Thaçi me Bechtel-in atëherë. Pse po them kështu? Sepse edhe kushtet e nënshkrimit të kontratës dhe pasojat afatgjata që do t'i ketë kjo kontratë në shoqërinë tonë, në popullin e Kosovës, nuk do të përfundojnë në një moment, qysh kanë përfunduar me autostradën për Shqipëri, se aty ka pasur shkelje të ndryshme, ka pasur jotransparencë, edhe vetë kontrata bile nuk ishte publikuar, mirëpo me gjithë atë vjedhje që kanë mundur të ndodhin, vjedhja është kryer aty. A konsekuenca që do t'i ketë ky projekti juaj, me llogaritjen e njohësve më të mirë të kësaj fushe që e kemi në 20 vjetët e ardhshme, nëse llogaritet krejt kostoja e projektit, më së paku do të ketë kosto 5 miliardë euro drejtpërdrejt prej xhepit të qytetarëve të Kosovës.

Nëse llogaritet çka mbulon shpenzime Kosova, shtoja kësaj rritjen progresive të çmimit të energjisë elektrike, në fund në vitin 2043 qytetarët e Kosovës do t'u dalë kostoja 5 deri në 6 miliardë euro, më së paku, të paguara drejtpërdrejt prej xhepit të tyre.

Le të fillojmë me racionalitetin e kontratës, nuk ka nevojë të jesh kurrfarë eksperti, doktor i shkencave të ekonomisë për t'i lexuar nja 7 a 8 tiparet kryesore, elementet kryesore të kontratës, të cilën e keni publikuar për të parë çfarë marrëveshjeje keni nënshkruar në kushtet ekonomike, të një racionaliteti të përfitimit të dyanshëm. Ne e dimë që prej kur ekziston njerëzimi dhe kur janë zbuluar kontratat, ajo racionalitetin e ka te përfitimi i dyanshëm, përfiton investitori diçka, po përfitojmë edhe ne.

Tani ta shqyrtojmë një nga një secilin element të kontratës. Ju i mbuloni të gjitha shpenzimet, ju e mbuloni kredinë mbi 900 milionë euro, ju i paguani këstet e kredisë, ju e paguani kamatën, ju e paguani fitimin dhe ju e paguani tatimin në fitim. Edhe përveç kësaj, i siguroni investitorit linjatin, ujin, deponinë e mbetjeve, të gjitha, pa asnjë risk.

Ku kësi kontrate me 18.5% të kthimit në investime, me kësi lloj kushtesh. Ku ai nuk ka rrezik asgjë, krejt rrezikun edhe koston e paguan Qeveria e Kosovës, me kombinime: qytetarët prej xhepit, Qeveria drejtpërdrejt prej buxhetit.

Kështu që vetëm dy elemente po të merren sa na kushton kjo kontratë, dhe është e mjaftueshme para se të fillojmë ne të harxhojmë energjinë elektrike, qe hiç s'po harxhojmë energji elektrike, ende nuk ia kemi nisur ta konsumojmë energjinë elektrike, ty veç dy elemente të kushtojnë 150 milionë euro, pa asgjë hiç.

Interesi i kontratës, për shkak se që po bëhesh garantues i kredisë, së paku 70 deri 80 milionë euro, plus kthimi, ky kthimi në investim kapital, që është po ashtu 70 deri 80 milionë euro.

Ty vetëm këto dy elemente, para se të fillojmë ne të konsumojmë energji elektrike po të kushtojnë 150 milionë euro, prej xhepave të drejtpërdrejtë të qytetarëve të Kosovës.

E kur t'ia nisim të konsumojmë energjinë elektrike, të dalim tash pak edhe aty.

Kontratën e blerjes që e ke bërë, për sigurt sa t'ia blesh energjinë elektrike gjeneruesit, që është praktikisht investitori, ti e ke bërë minimum në çmimin, qysh e thanë edhe të tjerët, 80 euro për megavat, por në kushte kur kjo e kapërcen atë limit, deri në 96 euro.

Së pari, nëse e përkthejnë këtë në rritje të çmimit të energjisë elektrike, ekspertët thonë që faturat, të cilën do ta paguajë qytetari në Kosovë, çmimi i energjisë elektrike që do të reflektojë në faturë, minimumin e ka 45% rritje, me këtë kontratë. Pragu shkon deri 80-90% do të rritet fatura.

Domethënë, nëse gjatë një shpenzimi, le të themi, mesatar, jo kur është dimri më i ftoftë familjet kosovare paguajnë, po e marrim me një mesatare 50 euro për faturë, ato do të paguajnë 75 euro, e maksimumi deri 100 euro, gati. Ajo faturë automatikisht, veç pse ti e ke nënshkruar këtë kontratë.

Tash, unë s'po e kuptoj një arsytim të Qeverisë, kur po thotë, kjo është insentivë e hatashme e zhvillimit ekonomik, a unë mendoj që kur preket xhepi i qytetarëve, e para dhe kur rritet kostoja për të investuar investitorët e jashtëm në Kosovë, qysh ti mund të kesh, nuk po e kuptoj këtë arsytim të ministrit dhe të Qeverisë, qysh qenka kjo njëfarë lloj shtyse e hatashme e zhvillimit ekonomik, xhepi i qytetarëve po zbrazet dhe, e dyta, po të vijë një investitor në Kosovë në vitin 2030, kur po parashihet që rritja e energjisë elektrike po bëhet së paku prej 45% në vend 85%, unë nuk e di me çfarë racionaliteti ju thoni që kjo është njëfarë lloj çelje e dyerve për investitorët në Kosovë.

Ne e dimë që energjia elektrike, aq më tepër kur ju po doni të kaloni prej shkallës së tregtisë si element kryesor i ekonomisë, në zhvillim industrial, industria ta lypë energjinë elektrike. Nëse energjinë elektrike ta lypë industria, qysh mund ta shtrenjtosh energjinë elektrike 80% e të thuash që kjo është lehtësim i hatashëm edhe hapje e dyerve për investitorë të jashtëm.

Tjetra që është shumë shqetësuese, ju keni fshehur edhe pjesë të kontratës aty. Ti mund të gjesh pjesë ku janë me një Reserve, për shembull, e ke çmimin e blerjes, e ke çmimi e garantimit të deponive, e ke çmimin e shitjes së tokës, ajo bartja e tokës, nuk e ke çmimin e shitjes së linjtit, aty mungon çmimi i shitjes së linjtit.

Dy shkelje janë të mëdha dhe, ministër, mos ma merr si për kërcënim këtë që po ta them, merre si këshillë dhe si sugjerim. Po është rrezik me këtë kontratë dikush të përfundojë në burg. Përnjëmend e kam. Kështu që kujdes, edhe pyeti ata dy ministra e tu para teje, pse nuk e kanë nënshkruar këtë kontratë. Kjo kontratë ka ekzistuar, dy ministra para teje. Veç takohu me ta, miqësisht takohu dhe pyeti me sinqeritet, pashë besën pse nuk e keni pasur guximin ta nënshkruani në një kësi kontrate. Veç pyeti për kureshtje, asgjë më shumë, është vetëm këshillë imja. Dhe të tregojnë ata pse.

Sepse dy shkelje të mëdha janë, ministër, dhe më fal, zoti nënkryetar, po të kërkoj falje që e zgjata, për 40 sekonda po e përfundoj dhe ju kërkoj falje që e zgjata kaq shumë.

Mirëpo dy shkelje po dua t'i përmend, sepse këto janë përtej asaj çka unë e përmenda si krim ekonomik, se ke hyrë me një kontratë të keqe, këto janë shkelje të ligjit të Kosovës. E para është shkelja e Ligjit për prokurimin publik, nuk u përmend këtu, e keni shkelur Ligjin e prokurimit publik, Ligji i prokurimit publik ka rregulla, ju po fshiheni pas Bankës Botërore, nuk mund të fshihesh pas Bankës Botërore me shkelje për prokurimin publik, zoti ministër.

Banka Botërore kurrë nuk e ka ratifikuar një kredi për ndërtimin e Kosovës së Re, ju do të hyni vetë në kredi personale si Qeveri, si entitet juridik dhe do të garantoni këtë kredi vetë. Sa ka qenë Banka Botërore keni mundur t'u referoheni ligjeve të tjera, zoti ministër.

Kur e keni bërë kontratën, nëse Banka Botërore ka thënë se nuk e financoj Kosovën e Re, ti e ke pasur vetëm një ligj në fuqi, përmes të cilit je detyruar të bësh kontratën, ky është Ligji i prokurimit publik dhe e ke shkelur, zoti ministër, Ligjin e prokurimit publik.

Dhe, e dyta, e ke shkelur përmes shitjes së tokës, a e dini që në Kosovë nuk shitet toka.

Të përdoret në kontratë termi “shitje e tokës”, është përdorur termi ‘shitje e tokës’. Këqyrni me kujdes se mund të jetë shkelje e madhe me konsekuenca penale. Unë veç e kam për ty, se disa ministra shumë më të fortë se ti nuk kanë pasur guximin ta nënshkruajnë, e unë po frikohem mos je viktimë e mund të përfundosh shumë keq.

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën, zoti Lluka.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, nënkryetar!

U bënë disa tema, po e marr pak fjalën që t'i diskutojmë e të mos mblidhen shumë.

Po shkoj një nga një, disa tema që i ngriti edhe deputetja Bajrami.

Pika e parë ishte transparenca. Besoj që jam i pari ministër që një kontratë madhore e kam bërë të hapur publikisht, në momentin që është nënshkruar.

Ajo çka është me rëndësi, transparenca do të promovohet tërë kohën. Sot kur po flasim, po flasim për kostot e projektit, ende nuk e dimë.

Pra, është një projekt nën vlerësim e sipër, pra sot po flasim, janë ekspertët duke i vlerësuar ofertat janë pranuar, dy oferta nga “Mitsubishi&Tachi dhe “General electric” dhe shumë shpejt do ta kemi një raportim që kërkon edhe aprovimin e Komitetit drejtues. Do t’ju mbajmë të informuar çdo gjë që ndodh lidhur me këtë projekt. Sa i përket pjesës të hijezuar në marrëveshje, deputeti Konjufca që e përmendi, pjesa e rezervës nuk është hequr nga kontrata, ato janë pjesë të lëna pa ndonjë shumë specifike, për arsye se nuk është përcaktuar shuma, sepse vendoset sipas studimeve të radhës, sipas pajtueshmërive të tjera. Për shembull, çmimi i thëngjillit mund të ndryshohet, ajo reflekton në çmim, por mund të ndryshohet. Prandaj, nuk kemi vendosur çmim fiks dhe nuk i dihet sa do të jetë çmimi i thëngjillit.

Sa u përket pyetjeve që nuk iu përgjigja, arsyetimi i ndërmarrjes të re energjetike në Kosovë. Qëllimi parimor i asaj ndërmarrjeje është mbikëqyrja e ndërtimit të projektit, pra do t’i bëjë aprovimin e të gjitha raporteve që vijnë nga një inxhinier i pavarur që do të punësohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku do të hapet shumë shpejt tenderi, një inxhinier ndërkombëtar që do t’i bëjë raportimet dhe ky entitet, sipas marrëveshjes do t’i aprovojë ato raporte. Pra, do të jetë një entitet, një organizatë me staf minimal. Gjithashtu, ka qenë kërkesë e institucioneve financiare që të dihet kush është blerësi i energjisë dhe për atë është themeluar, prapë po them nuk është ndonjë barrë e madhe, nuk është ndonjë kosto e madhe, sepse do të operojë me staf minimal, përveç bordit e kryeshefit, do t’i ketë edhe 3 deri 4 pozita të tjera.

Sa i përket garantimit të kredisë, deputetë të nderuar, është mirë të kuptohet një herë e përgjithmonë, edhe deputetja Bajrami, edhe deputeti Konjufca. Qeveria e Kosovës apo Parlamenti nuk e garanton kredinë për termocentralin “Kosova e Re”, ne nuk garantojmë kredi. Të vetmen garanci shtetërore që e marrim ne është obligimi i ndërmarrjeve publike karshi kompanisë Contour Global. Performansa e ndërmarrjeve publike, për shembull, blerja e energjisë, furnizimi me thëngjill, furnizimi me ujë, tri garanci, për shkak që ndërmarrjet publike janë të vogla dhe nuk kanë kapacitet financiar për t’i garantuar, këtu ndërhyt shteti për garanci. Garancinë e kredive nuk e japim ne, ato i garanton vetë projekti. Duhet kuptuar, kredinë e merr Contour Global, nuk e merr Qeveria e Kosovës.

(Ndërhyrje nga salla)

Jo, jo, absolutisht, për të garantuar një kredi, duhet aprovuar në Parlament, për atë arsye nuk ka garanci të kredisë. E vetmja gjë që vjen në Parlament është garancia e performansës së

ndërmarrjeve publike që duhet të jetë diku në rastin më të keq rreth 330 milionë euro dhe kjo është shuma maksimale që garantohej nga ky Parlament ku jemi sot.

Kosto financiare, veç pak, është me rëndësi të kuptohet, kosto financiare e projektit nuk e dimë, pra çdo gjë që flasim për çmimin e energjisë, të gjitha janë spekulime. Kur përmendet çmimi 80 euro, është spekulim, kur përmendet çfarëdo kosto financiare, është spekulim, asgjë nuk dihet. Për ta kuptuar çmimin e energjisë elektrike duhet ta dimë çmimin e ndërtimit të termocentralit, koston financiare të projektit dhe asnjëra nuk është e ditur, sepse kostoja financiare vendoset kur aprovohet, pra te financuesi i projektit, që në këtë rast jemi duke diskutuar me dy apo tre financues potencialë. Njëjtë është sa do të shtrenjtohet rryma? Nuk e dimë! Më fal, deputet, nuk e dini çmimin e energjisë elektrike, jo ajo është çmim tavan që nuk guxon të tejkalohet, nëse tejkalohet çmimi 80 euro, ne mund të tërhiqemi nga projekti, përndryshe çmimi do të jetë më i mirë dhe si të tillë ne nuk mund të paragjykojmë me çmimin, rritjen dhe impaktin e tarifave të energjisë elektrike.

Këto janë të gjitha pikat, normalisht që linjiti apo thëngjillin ne duhet ta garantojmë si shtet furnizimi, sepse asnjë investitor nuk vjen nëse s'e garanton furnizimin. Por ai thëngjill do të shitet, pra do të ketë të hyra edhe nga tantiema, por edhe KEK-u nga shitja e thëngjillit, sepse duhet të garantohej në një formë. Është me rëndësi të mos ketë spekulime jashtë asaj çka jemi duke folur këtu. Të gjitha këto që i thashë janë pjesë e marrëveshjes, çdo gjë është transparente dhe do të sigurohem që çdo lëvizje që do ta bëjmë, ju do të jeni të informuar me kohë, siç ju kam informuar përmes buletineve që i kam shpërndarë në baza mujore te të gjithë ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse do replikë, ju e keni minutazhën tuaj. Replikë e pa replikë, minutazhën tuaj e shpenzoni. AAK-ja s'është paraqitur, PSD-ja, zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Këtu kaluam shumë shpejt prej temës së interpelancës, në diskutimin e kontratës me Contour Global, e nisi ministri, pastaj edhe u vazhdua nga deputetët. Një interpelancë të tillë ne e patëm zhvilluar edhe më herët për kontratën në përgjithësi, dëmet që ajo i shkakton sektorit energjetik dhe ekonomisë së Kosovës në përgjithësi, mirëpo sidoqoftë, e kuptoj që nuk kemi se si t'ia bëjmë ndryshe përveç se t'i diskutojmë të dyja, meqë janë të lidhura njëra me tjetrën, meqë kjo kompania e re NKEC është rrjedhojë e asaj kontrate.

Pra, siç e përmendi edhe ministri dhe të tjerët që e mbrojtën këtë kompani, thanë që ky është obligim kontraktues, asnjëherë nuk e kemi vënë këtë në mëdyshje. Problemi është që edhe përmes këtij obligimi kontraktues dëshmohej se sa e dëmshme është kontrata dhe sa e pakuptimtë është ajo. Pra, NKEC është një prej shembujve të kësaj kontrate se çka do t'i bëjë ajo Kosovës në të ardhmen. U përmend këtu disa herë që kontrata qëllimin kryesor e ka sigurimin

me furnizim, apo jo? Termocentrali Kosova e Re. Termocentrali Kosova e Re maksimalisht megavat që do të prodhojë do t'i ketë diku prej 450 deri 480 megavatë dhe në këtë drejtim natyrisht që kjo mund të përdoret si furnizim bazë për nevojat energjetike të Republikës së Kosovës, por asnjëherë t'i përmbushë ato. Pra, domosdoshmërisht termocentrali Kosova e Re duhet të përcillet edhe nga së paku Kosova B, në mënyrë që sado pak ta kemi një pavarësi energjetike në Republikën e Kosovës, gjithnjë duke e llogaritur edhe potencialet e ripërtëritshme, të cilat do të duhej të instaloheshin në Republikën e Kosovës.

Mirëpo, këtu është edhe njëri prej problemeve, atë që e përmenda në fjalimin në fillim. Filloi selektiviteti karshi termocentralit Kosova e Re përmes ndërmarrjes NKEC, do ta dëmtojë deri në mbyllje termocentralin Kosova B, që i bie praktikisht që jo që do të kemi energji elektrike më shumë, ta zëmë, nëse mbyllet B-ja, por do të kemi një zhvendosje nga monopoli aktual në gjenerim, që e kemi monopol në pronësi publike, në monopolin e së nesërme, të cilit do të jetë monopol me pronësi private. Është e njëjta gjë që ka ndodhur me rrjetin e distribuimit, nga monopoli publik, meqë distribuimi është monopol natyror, kemi kaluar në monopol privat, në të cilin jo sot, po as nesër nuk kemi mundësi që të paktën si kompani publike të vendoset në funksion dhe në shërbim të konsumatorëve, sepse e kemi ndërmjetësimin e profitit të kompanisë private, të investitorit privat që është kërkesë e natyreshme e investitorit privat, e cila ua pamundëson sot qytetarëve të Republikës së Kosovës të kenë energji elektrike me çmim më të lirë, edhe duke i pasur resurset e thëngjillit që përgjithësisht na mundësojnë një energji elektrike me çmim më të lirë.

E dyta, është pastaj që, e përmendi edhe deputetja Bajrami, edhe deputeti Konjufca, aktualisht ne i paguajmë në Kosovën B, deri vonë ka qenë 27 euro për megavat, tash është diku te 30 euro për megavat, e cila blihet nga KEDS-i dhe pastaj u shpërndahet qytetarëve të Republikës së Kosovës. Nesër çmimi me termocentralin Kosova e Re, të cilin ju po e quani që nuk është ende i ditur, do të jetë deri në 80 euro, apo jo? Qe ta zëmë që është ashtu siç po thoni ju, pra maksimalisht do të jetë 80 euro, çka nëse na del çmimi me maksimalen e parashikuar në kontratë me 80 euro.

Atëherë, çka do të ndodhë këtu? NKEC-i do ta blejë nga termocentrali Kosova e Re çmimin për 80 euro dhe do t'ia shesë pastaj KEDS-it në mënyrë që KEDS-i t'ua shpërndajë atë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kush e mbulon këtë dallim në çmim prej 80 deri në 50 që është çmimi i importit, e 30 është çmimi i prodhimit aktual në Republikën e Kosovës. Ju kujtohet që në vitin 2014, KEDS-i pati bërë kërkesë që të rriten tarifat e energjisë elektrike, në mënyrë që të mbulohet nevoja e shtuar për import të energjisë elektrike për shkak të avarisë në termocentralin Kosova A. Dhe, kjo rritje e çmimit të energjisë elektrike atë botë ka qenë për 11%, në shtator të vitit 2014 është marrë ky vendim. Pra, kur e shohim tash në terma financiarë, energjia e importuar atëherë krahasuar me këtë të prodhuar ka qenë për 20 euro më shtrenjtë në megavat, pra prej 30 në 50. Dhe, tash prej 30 në 80 kur rritet, sa do të jetë kërkesa për rritje të çmimit të energjisë ose tarifave për qytetarët e Republikës së Kosovës?

Dhe, prapë po them, nuk ka shumë rëndësi a paguhet nga qytetarët përmes mënyrës direkte, pra me rritje të tarifave, apo paguhet përmes ndërmjetësimit nga KEDS, i cili po ashtu, funksionon me paranë publike përmes buxhetit. Por, kjo nuk ka rëndësi, tarifat edhe mund të jenë më të ulët, po do të paguhet nga paratë e buxhetit, që prapë nuk janë para të Qeverisë, janë para të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, barra në fund do t'i bie ekonomisë dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Cilido të jetë varianti i zgjedhur i pagesës për këtë rritje të çmimit të prodhimit të energjisë elektrike, dhe kur rritet çmimi i energjisë elektrike, në një vend të varfër si Kosova, duhet ta kuptojmë reduktohet qasja e qytetarëve në energji elektrike që i bie zvogëlohet furnizimi ose, më mirë thënë, do të rritet furnizimi dhe do të jetë stabil për ata që kanë para për ta paguar atë, ndërkohë që do të jetë i ndërprerë për ata që nuk kanë para për ta paguar atë. Praktikisht siç është nga pak edhe sot, pra kryeqyteti, Prishtina, shumë më pak ka reduktime të energjisë elektrike se ç' kanë komunat e tjera, e veçanërisht zonat rurale në kohën kur prodhimi i energjisë nuk është i bollshëm.

Kështu që në këtë drejtim edhe një herë, kërkesë e kësaj seance, e kësaj interpelance, siç e kemi paraparë ne dhe besoj që e dëgjova edhe nga deputetët e tjerë, të cilët u pajtuan këtu, është absolutisht e papranueshme, mendoj unë, që Qeveria e Republikës së Kosovës, cilado prej qeverive të Republikës së Kosovës, të nënshkruajë kontratë, të marrë obligime dhe të fillojë së zbatuari ato obligime pa e marrë edhe mendimin e instancës përfundimtare vendimmarrëse për këtë çështje, e që në këtë rast është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Pra, ju keni nënshkruar kontratë, keni filluar së zbatuari kontratën pa e pyetur Kuvendin nëse është dakord në këtë gjë, edhe pse është dashur të pyetët Kuvendi siç u tha edhe këtu, domosdoshmërisht Kuvendi do t'ia japë vendimin përfundimtar kësaj, sepse Kuvendi duhet të votojë me 80 vota, pra me 2/3, nëse është dakord me këtë kontratë dhe me garancitë, të cilat Republika e Kosovës obligohet t'i japë "Contour Global"-it përmes kësaj kontrate.

Dhe, mendoj që në këtë drejtim e keni bërë një gabim jashtëzakonisht të madh, i cili mund të na kushtojë shumë si Republikë e Kosovës, meqë nuk e keni marrë pëlqimin paraprak të Kuvendit për kontratën, formën e saj dhe veçanërisht obligimet që do t'i kemi si Republikë e Kosovës, në mënyrë që pastaj ta keni të qartë, nëse Kuvendi do të thoshte "po", atëherë, ju do të nënshkruanit këtë kontratë sepse do ta keni pëlqimin nga Kuvendi, nëse Kuvendi do të thoshte "jo", atëherë nuk bën të nënshkruhet një kontratë të tillë. Na ka ndodhur me privatizimin e PTK-së, kemi rrezikuar të humbim qindra miliona në arbitrazh, mund të na ndodhë me projektin "Brezovica", pra pse po hyni në obligime, të cilat pastaj mund të na kushtojnë shumë shtrenjtë për një votë, të cilën ju nuk mund ta garantoni, e 80 vota të këtij Kuvendi nuk mund t'i garantoni për "Contour Global" dhe, siç u pa nga deklaratimet e tri grupeve parlamentare: PSD-së, LDK-së dhe Vetëvendosjes, jeni shumë larg 80 votave në këtë Kuvend. Prandaj, ndërpritni çfarëdo pjese të zbatimit të kësaj kontrate dhe po, po shihet që është shumë e rëndësishme që sa më shpejt ta

diskutojmë këtu në Kuvend dhe ta marrim vendimin përfundimtar për këtë kontratë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Kosovës, zoti Haradinaj.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Tema që po e diskutojmë sot është diskutuar edhe në një seancë para kësaj, pra është investimi më i madh i pasluftës në historinë e re të Kosovës, investim privat që kalon 1 miliard dollarë. Pra, ky investim është më i madhi në historinë tonë, investim privat mbi 1 miliard dollarë, që është një e vërtetë që duhet ta ndajmë, nuk është privatizim, pra është vetëm investim privat, paraja nuk është e Qeverisë, nuk e garanton Qeveria. Qeveria merr penallti në rast të dështimit të obligimeve të veta, por nuk garanton kredinë dhe Kosova me këtë investim menjëherë fillon të sjellë në buxhet të hyra për publikun. Pra, shet lëndë të parë, ato që i tha ministri më herët, edhe ujin, edhe qymyrin ne e shesim, janë lëndë e parë, i shesim.

Merrini çmimet dhe i shihni sa e si, çdo detaj e keni. Tjetra, mos harroni, ky projekt, tash po më vjen keq kryeministri Mustafa nuk është sot në këtë sallë, ky projekt mos harroni është avancuar në masë të madhe nga Qeveria para meje, edhe ministrat e LDK-së e dinë si ka ndodhur kjo dhe janë të konsultuar, me leje, që të jem i sinqertë për korrektësi, janë të konsultuar edhe ditën e nënshkrimit dhe është marrë aprovim për nënshkrim, për përkrahje të këtij projekti nga LDK-ja. Pse? Kanë qenë pjesë e përgatitjes së këtij projekti, nëse dëshirojmë të ndërrohet qëndrimi, është një e drejtë, nuk ka gjë të keqe. Do të flasim, po ashtu për thelbin e këtij projekti, unë e shoh që në Kosovë ka plot njerëz që janë të bindur, edhe unë nuk dyshoj që ju këtu jeni të bindur dhe i thoni në bazë të bindjes tuaj anët negative të këtij projekti. Ndër të tjera, është rritja e çmimit të energjisë, mund të ketë edhe të tjera, unë i shoh që i besoni këto, vetëm ju lutem, a mund t'i bëni disa krahasime. A është e vërtetë, pyetja për ju, që ne kemi blerë për këto vjet që shkuan mbi 650 milionë euro energji jashtë vendit? Edhe a bën t'ju pyes, ku e kemi blerë atë energji?

Jo, më falni, veç një sekondë, në kohën e çdo qeverie prej Bajram Rexhepit që s'është gjallë më, e deri në këtë timen sot, ende sot e kësaj dite Kosova blen energji, çdo muaj blen, veç ndonjëherë kur kemi ndonjë periudhë si të verës, po nëse i kemi blerë veç shtrojeni këtë pyetje një herë, a i ka blerë Kosova 650 milionë euro energji dhe a bën t'ju pyes ku i kemi blerë? Shikoni, energjia është rrjet ndërkombëtar, po ta japin prej atij që e ke më së afërmi, e kemi marrë energjinë prej Kollobares në Serbi. Përderisa nuk ke prodhim të qëndrueshëm, mbajeni mend këtë, të flasim sinqerisht njëri me tjetrin, nuk është ky projekti i përkryer, se nuk je duke e bërë me paratë tua e në kushtet tua, me një investitor, nuk i bie kurrkush 1 miliard e 300 milionë dollarë veç për hatër tëndin, po i ka sjellë po ashtu të fitojë investitori. Vetëm pse s'po i bëjmë këto pyetje, nëse

vazhdojmë ne të blejmë energji, edhe pas tre vjetëve ku kemi do ta blejmë? Na e dhënë prej atij që është më së afërmi, e ai më së afërmi, ju e dini kush është.

Shiko, ne kemi afërsisht 900 megavatë konsum në kohë dimrit, bie në kohë të verës. Ne i kemi dy termocentrale, mund të flasim për termat e kontratës, se kontrata i ka do terme, ato prapë do t'i diskutojmë, kur të precizohen kostoja, shkalla e koston krejt, asaj që do të ndodhë në investim, se ende s'e ke atë dhe s'mund ta japë kurrkush përpara, se është pjesë e ofertës së tregut, një ditë do të ndodhë. Ne kemi rënë dakord në termat e përgjithshëm të kontratës, po ende s'ka ndodhur kontrata e mirëfilltë e investimit në bazë të krejt atyre që i shtinë paratë e veta. Po ata janë duke i futur paratë e veta në Kosovë, është investim i tyre, e vetmja arsye që Kosovës i bie barrë është se ata po kanë qejf t'u kthehen paratë më shpejtë. Po thonë a bë për shtatë vjet t'i kthejmë paratë, nuk po duan prej 25, për 30 dikush, po e lyp më shpejt kthimin e investimit të vet, nuk po na merr para neve si Kosovë, ai po e lyp kthimin e parasë që po e harxhon te ne, se ai po investon. Çka është dallimi? Shikoni, nëse ne lëshojmë në treg 450 megavatë në Kosovë, nënkupton ne e ndalim nevojën të blejmë më prej tjetërkujt, nuk jemi ne të blejmë nga 100 milionë në vit energji diku.

A e keni analizuar këtë ndonjëherë? A është interes i Kosovës të vazhdojë të jetë veç konsumatorë, pse edhe ne të mos jemi njëfarë adrese e energjisë në rajon. Unë jam i vetëdijshëm që investitori nuk ka ardhur për bamirësi, por çka është duke ndodhur me ne, unë e di po ashtu që ekziston një mafi e energjisë, e cila ka blerë energji për Kosovën që 20 vjet, dhe ndoshta nuk është veç kombëtare, ndoshta është edhe ndërkombëtare, e cila kishte pasur qejf edhe këto të dyja t'i mbyllim, se ndotin shumë, ende pa pasur ne prodhim, veç të rritet blerja. Po ne çka duhet të bëjmë si Kosovë. Ne po zgjedhim mes disa të këqijave, cila është një e keqe, bile, që na lë të qëndrueshëm, të mos të bëjë veç konsumatorë, çezmën Rusia ua ndal shpesh të gazit disave, edhe energjinë, nëse s'e ke të prodhuar në vend, çfarë sigurie energjetike ose tjetër ke, nëse krejt je i varur prej energjisë që ta japë dikush. Është e ditur ende sot e kësaj dite, energjia alternative e ripërtëritshme, ajo solare, ajo me erë, i kanë do pengesa. Nuk mund të llogaritësh në stabilitetin e tyre në vazhdimësi, për shkak se ende akumulimi i asaj solare është i shtrenjtë, është proces i komplikuar.

Po ashtu, për erë e dimë si shkon rrjedhja e saj. Ne duhet të jemi të hapur për energjinë alternative, sa më shumë të bëjmë në treg, por nuk guxojmë të mbetemi pa prodhuar energji që është e përhershme, e qëndrueshme dhe që garanton stabilitet të energjisë. Nëse kostoja e prodhimit të kësaj energjie vërtet është jashtë normales dhe i bën dëme shumë çdo procesi të brendshëm, duhet ta trajtojmë të gjithë me seriozitet dhe kurrkush s'duhet të ikë prej përgjegjësisë, por jo apriori t'i kërkohet Qeverisë ose Parlamentit vendim që të ndalet investimi më i madh privat që ka ndodhur ndonjëherë në energji, energji që prodhohet në Kosovë, dhe nga dita që lëshohet në prodhim, nuk je më blerës. Ka edhe diçka, nëse flasim për ndotjen, shikoni ne e kemi A dhe B-në të vjetra, sado që ua zgjatim jetën atyre, prapë duhet shtirë para në to, këto

prapë do të ndodhin, e pamundshme është A-ja e B-ja të kalojnë në koeficiente që është teknologjia e sotshme e re. Nëse eventualisht Kosova, kur e ka Kosovën e Re, kur e ka investimin e ri, e vendos, e vlerëson që s'ka nevojë të vazhdojë ta mirëmbajë B-në, se për A-në të mos flasim, atëherë është vendim që sigurisht e merr Parlamenti, a do të vazhdojmë të shtimë para në B-në më tutje, a do renovim, a do riinvestim a çka do?

Por, ju lutem, kolegë, përkundër faktit që unë besoj që shumë prej juve besoni që ka defekte, apo ka të meta, ose ka elemente që nuk e bëjnë këtë kontratë më të mirën, ngadalë, mos e gjykoni çdo gjë pa i pasur edhe këto elemente parasysh, pa e pasur edhe faktin që ne jemi sot blerës të energjisë dhe kemi blerë 650 milionë, po ashtu ne kemi shtirë qindra milionë euro duke i rinovuar këto A, B dhe duhet të vazhdojmë të investojmë edhe vitin tjetër, se janë të vjetra. Trendi i energjisë alternative në Kosovë është i hapur, por nuk është garant i një furnizimit të qëndrueshëm, pa i shtuar këto që supozohet që ka humbje vjetore ekonomia jonë për shkak se furnizimin me energji nuk e kemi të qëndrueshëm. Të gjitha këto elemente, unë nuk jam i sigurt që është studiuar mirë për çka jemi duke folur.

Nuk ka investim privat që s'lufton për kushte më të mira të nxjerrjes së investimit dhe të fitimit, këtu as nuk ka dilema, as nuk e mohoj këtë, por po ashtu Kosova të thuhet se duhet të ndalë investimin në energji prej investitorit privat, prej parasë së huaj, me të cilin ka ndikim shumëdimensional pastaj në zhvillimin e vendit, se së pari ajo është promotor i zhvillimit ekonomik nga dita e nisjes së investimit, pastaj lënda e parë hyn në funksion, nuk blejmë më, nuk qesim para jashtë, se operimi ndodh brenda vendit, paguhet tatimi këtu, nuk është para që ka shkuar në skaj të dynjasë ose te komshiu ynë, ju lutem analizoni edhe këto para se të gjykoni kaq negativisht, po them edhe një herë, këtë projekt.

Arsyeja pse erdha, unë e di që në interpelancë është i thirrur ministri, nuk erdha as për hatër të ministrit, as për ndonjë arsye tjetër, por erdha t'ju lus, mos lejoni t'ju mund ndoshta ndonjë element që ju shqetëson, t'jua mund përmbajtjen. Unë nuk dua ta shoh Kosovën vetëm blerëse të energjisë, nuk dua të vazhdojmë të nxjerrim qindra milionë të këtij vendi në Kollobare, të zgjerohet Kollobara. Pse Kollobara përballon me qymyr, pse u rrit, pse kanë bërë investim, a e dini që investimin e fundit e kanë bërë për ne, veç të na shesin neve rrymë. Ua kam thënë edhe një herë në këtë sallë, kur e kemi biseduar për këtë, në rregull, ambienti, në rregull, plot probleme të tjera, në rregull rritja e çmimit, se do të ndodhë rritja e çmimit, garant, por nuk ka ndodhur që dy vjet, e kemi mbajtur me shumë kujdes çmimin stabil, por si duam të dalim prej gjendjes, unë mund të mos jem nesër kryetar Qeverie, ose pasnesër dhe mund të mos jemi, se në demokraci jemi, por mos harroni sot Kosova është e rrezikuar, se nuk prodhon energji, se blen, se i ka të vjetra A-në dhe B-në dhe s'do të mund të zërë rendin me energji të ripërtëritshme, nuk mundet kaq shpejt ta zërë rendin, se i ka defektet e veta furnizimi me këtë. Ju lutem!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Glauk Konjufca, dy minuta, edhe Visar Ymeri dy minuta replikë. Për diskutim pasi ta kryejë Bilalli, e t'i kthemi për së dyti, replikë ke dy minuta.

GLAUK KONJUFCA: Ne po e kuptojmë të gjithë këtë strategji të kryeministrit, kur po na thotë: “Ju qenkeni kundër energjisë elektrike, kundër që Kosova të ketë kapacitete të qëndrueshme të energjisë elektrike”. Unë po i them kryeministrit këtu, që ka trokitur në derë të hapur. Nuk është ky debati që sot po e bëjmë.

Kryeministër, ne pajtohemi plotësisht, të gjithë që jemi në këtë sallë, që Kosova ka nevojë për prodhimin e energjisë elektrike. Ky debat nuk mund të bëhet në këtë Parlament, sepse askush nuk tha “Kosova nuk ka nevojë për prodhimin e energjisë elektrike”. Debati që po e bëjmë ne është ky: Si ta gjejmë mënyrën më të mirë qysh ta prodhojmë energjinë elektrike? Plani yt, që ti e ke zgjedhur, qysh të prodhojë Kosova energjinë elektrike, e ke zgjedhur një plan, i cili në xhepin e qytetarëve të Kosovës ndikon drejtpërdrejt, kjo është kritika jonë për ty. E di shumë mirë ti, që në tregun e ndërimit të termocentraleve në botë, edhe në Evropë, një MW kushton përafërsisht 1 milion euro. Po duam të ndërtojmë kapacitete të termocentralit, të përkthehen në terma ekonomikë dhe të kostos, gjithkush e di, çdo ekspert elementar, që 1 milion euro kushton një MW. Atëherë, sa po kushtuakan këto 450? Me para tona na kushtojnë 450 milionë euro, aq sa ti po thua se na shkojnë për çdo vit.

E pse Kosova, pra, paska për asfalt, e nuk paska për të investuar në prioritetin më të rëndësishëm, që qenka energjia elektrike? Veç këtë ma shpjego!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, mandej kur të vijë radha, ta japin minutazhin ata. Zoti Haradinaj, përgjigjen do t'ia japë. Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E thashë në fillim, ashtu qysh nuk dyshoj se plot deputetë shqetësimet i kanë të bazuara e besojnë, po ashtu nuk besoj dhe nuk dyshoj që edhe ju, Glauk, edhe Vetëvendosje edhe PSD, edhe të gjithë në këtë sallë, kanë dëshirë që Kosova të prodhojë energji. Nuk e kam këtë dyshim. Nuk mendoj që ka njeri normal i vendit tonë që s'do ta shohë vendin e vet duke prodhuar.

Megjithatë, unë i përmenda konsekuencat që ne kemi blerë energji e po vazhdojmë të blejmë, derisa s'e kemi një investim. Kur po thoni ju, Glauk, sa kushton një MW në miliona, shikoni, kostoja e prodhimit është krahasuese. Krahasoma, të lutem mua, me cilin krahasim je duke llogaritur. Ne nuk kemi investitor tjetër në tavolinë, përveç Contour Global, të vetmin e kemi pasur. Shiko, operatori është “Behtel&Enka”, ti paratë tua je duke i shtirë, nëse do ti, po i shtimë edhe tonat në energji. E, cili do të ishte dallimi atëherë? Kamata...

(Ndërhyrje nga salla)

Shikoni, jo, jo, me leje, mos e ke merak, unë nuk kam dilemë se po e di çka jeni duke thënë, mirë që po e thoni ashtu si po e thoni. Shiko, dallojnë këtu disa koncepte. Pse po them dallojnë? Për shembull, unë e di që çmimi të mbesim në treg ne të prodhojmë energji, e ka një çmim edhe kjo, por unë e di që nëse vendi im, Kosova, këta që po të dhimbsen se do t'u rritet çmimi qytetarëve tanë, unë e di po ashtu që këta humbin kur blejnë rrymë në Serbi. Kjo është një zinxhir... Jo, me leje, duam të jemi të sinqertë. Është një zinxhir i proceseve që ndodhin kur prodhohet këtu dhe, ju e dini, në çdo hallkë të atij zinxhiri paguhet tatim. "Behtel&Enka" sot që e kryen autorrugën është tatimpaguesi më i madh në Kosovë.

Çka jam duke thënë me këtë? Nëse fillojmë ta shohim vetëm një efekt të asaj që do të ndodhë në këtë vend, me siguri do ta shohim atë. Por ju lutem, me kujdesin më të madh, kjo marrëveshje për investim, kjo kontratë për investim me Contour Global së pari është investim që vjen prej adresave të garantuara. Ti mund të bësh ndonjë kontratë me Kinë, a me ndonjë operator tjetër që ta sjellë një... por ndoshta nuk qëndron shtatë vjet. Teknologjia që është duke ardhur te ne, nuk është teknologji që do të na zhgënjejë pas pesë, shtatë a dhjetë vjetësh. Edhe këtu bëni një dallim, ju lutem. Pse? Ndoshta, në zorin e fukaranë e në kushtet tona na duhet të blejmë edhe mallin e lirë, por ky nuk ka garanci. Ju e dini, ky aset i kalon në përdorim vendit pas një periudhe të caktuar kohore, është pronë e Kosovës. Nëse ti e merr të lirë, nuk do të mbërrijë as deri te ajo ditë, nëse e merr një teknologji tjetër, e ke më gjatë dhe kjo është një kosto që duhet kalkuluar Kosova, se cilin interes e ka. Mirëpo, të thuhet se kjo është formula e gabuar qysh Kosova të prodhojë energji, për çka e ke fjalën atëherë?

Më së pari, nëse investojmë ne, edhe këtë, investoi Kosova, kush është zbatues i investimit, sipas teje? Duhet marrë një kompani të huaj të ta zbatojë investimin, se ne nuk kemi ekspertizë e nivel që e bëjmë një termocentral, ta mbarojmë, ta ndërtojmë prej fillimit deri në menaxhim e deri atje, nuk kemi aty ende, fatkeqësisht. Kemi pasur ndoshta ndonjëherë në '70-at e '80-at, po s'e kemi më atë ekspertizë. Prapë ti duhet paguar një kompani të huaj me paratë tua për ta ndërtuar. E këto janë do farë elementesh që kur t'i diskutoni, i keni parasysh, ju lutem.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju kisha lutur që më shkurt t'i bini. Zoti Visar Ymeri i ka dy minuta, pastaj vazhdojmë me diskutime të rregullta. Ju kisha lutur që në diskutime s'ka nevojë të replikoni, janë diskutime e sqarime sqaruese. Unë s'di pse duhet replikuar në diskutime. Zoti Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Kryesues, faleminderit!

M'u desh ta bëj një ndërhyrje, se prapë mendoj se duhet kthyer debatin në atë siç e kemi kërkuar. Natyrisht, që ka shumë tema për energjetikën dhe natyrisht që do t'i diskutojmë ato dhe natyrisht se secili grup parlamentar dhe deputet e ka të drejtën për këso kërkesash dhe të diskutojë për çështje të cilat janë interesante dhe të rëndësishme.

Tash, duhet pasur parasysh një gjë. Po e shoh që edhe nga diskutimi i kryeministrit po na përvidhet prapë njëfarë situatë që është e zakonshme në debatin publik në Republikën e Kosovës, se situata gjithnjë është përmes një dikotomie, zi e bardh, keq e mirë, ja Contour Global, ja Serbia, mendoj se kjo më shumë, e s'po them që është qëllimi i kryeministrit ta ndalë debatin, por më shumë funksionon me ndalje të debatit se sa me nxitje të debatit, diskutimet, tek e fundit, për të mirat dhe të këqijat e kësaj kontrate. Pra, unë mendoj që, po, ka alternativë, as Contour Global, as Serbia. Dhe, do të kisha shtruar pyetje edhe për ministrin, edhe për kryeministrin: çka nëse do të ndërtoheshin kapacitete të reja gjeneruese në kuadër të korporatës energjetike të Kosovës, gjithnjë me kredi, që do t'i merrte me emër të korporatës energjetike të Kosovës, e që do t'i garantonte Republika e Kosovës? A do të bëhej kjo e mundshme dhe, nëse po, atëherë a do të ishte më lirë? Unë mendoj që do të ishte më lirë. Së paku, Internal Right of Return, së paku këtë 18,5%-sh nuk do të detyroheshim ta paguanim në kësi versionin.

E dyta, a është bërë ndonjë analizë se sa kemi kapacitete të energjisë së ripërtërishme dhe, nëse, ta zëmë, e marrim megavatit 80 euro, që rrezikojmë ta paguajmë "Contour Global", a na kushton energjia e ripërtërishme më lirë? Gjithsesi, na kushton më lirë, jo vetëm në shumën që e paguajmë për megavat, po pastaj edhe në efektet anësore, të cilat energjia e ripërtërishme i ka shumë të vogla, s'po them se i ka inekzistente, por i ka shumë të vogla krahasuar me investimet në thëngjill, sepse duhet ta kuptojmë edhe një gjë, investimet në thëngjill...

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Bilall Sherifi, ministri në fund, i ke 5 minuta.

BILALL SHERIFI: Mirë është, të nderuar kolegë, i nderuar kryesues, që njëherë ta bëjmë njëfarë rendi të gjitha grupet, e pastaj të hyjmë kështu në këto përplasje tek a tek ju që dini shumë.

Seriozisht po ju them, është mirë një herë të respektohet rendi në grupet parlamentare, pastaj ministri, kryeministri e deputetët, kryetarët e grupeve e të mos përllahemi ndër vete. Nuk është në rregull kjo. I humb kuptimi edhe debatit, edhe interpelancës, edhe krejt... shndërrohet në një debat në mes dy-tre personave këtu.

Tash po hyj në temë. Ju e dini që nuk besoj se këtu në Kosovë dikush është kundër ndërtimit të kapaciteteve të reja për prodhim të energjisë elektrike. Pra, këtë sintagmë e kemi dëgjuar që njëzet vjet, por askush nuk është angazhuar që të ndërtohen ato kapacitete. Pra, gjithkush ka thënë "nuk jemi kundër, po kemi nevojë dhe e dimë, por..." si duket ajo farë mafia kombëtare dhe ndërkombëtare ka ndikuar që të mos ndërtohen ato kapacitete, përkundër nevojave, madje edhe vullnetit, siç po thuhet këtu.

Unë nuk shoh vullnet, nuk kam parë vullnet, përkundrazi, kam parë vullnet që të pengohen këto procese, sepse që njëzet vjet kurrkush s'na ka ndalë, së paku që pesëmbëdhjetë vjet nga 100 milionë në vit t'i ndajmë e 100 milionë ka mundur t'i përballojë ekonomia e këtij vendi, buxheti i

këtij vendi apo edhe nga 50 e të ndërtoheshin 350 megavatë, hiç më shumë, kapacitete autoktone, tonat, kjo pjesa e parë.

Pjesa e dytë, nuk kemi nevojë të bëjmë lojë fjalësh. Investim është edhe kur investon publiku. Pra, investim është edhe kur investon privati, veçse dallojnë për nga investimi, investim privat dhe investim publik. Kur kemi investim publik në një fushë të caktuar të ekonomisë, të gjitha të mirat, përfitimet i merr publiku, kur kemi investim privat, ndahet fitimi në publik dhe në privat. Cili është përfitimi që e merr publiku, vendet e punës dhe energjia elektrike që e konsumon. Fitimi shkon te investitori, që është krejt e natyrshme. Ky është sistemi kapitalist, nuk kemi çka befasonemi këtu. E tash, a është kjo kontrata më e mirë? Sipas asaj që po dëgjojmë këtu, nuk është më e mira, madje sipas asaj që po dëgjojmë këtu, se unë nuk jam ekspert, sipas asaj që po dëgjojmë këtu na del se kjo kontratë është edhe e dëmshme.

Tash unë kam një pyetje për ministrin, madje edhe kryeministri e elaboroi, tha investitori po do t'i nxjerrë për shtatë vjet paratë e veta, pra nëse qenka e mundur t'i nxjerrë për shtatë vjet paratë e investimet, që të jenë 1 300 000 000, pse të mos hyjmë ne vetë ta bëjmë edhe t'i nxjerrim për shtatë vjet ato para? Tregu po garanton shtatë vjet kthimin e investimit. Atëherë, shtatë vjet, nëse 1 miliard e 300 milionë e ndajmë për shtatë vjet, po na mbetet diku gati ka 200 milionë në vit t'i inkasojmë, kështu u tha, ministër. Shpjegoja publikut, se çka desh të thuhet me atë që për shtatë vjet do t'i nxjerrë investimet. Çka duhet të bëjmë, a duhet munduar kalin aq fort që t'i nxjerrë ato investime, a çka është?

Pra, nëse dikush do me çdo kusht t'i nxjerrë investimet për shtatë vjet, na shpjego se çka do të ndodhë, si do t'i nxjerrë ai? Dhe, nëse është e mundur, pse s'po mundkemi more vetë ta bëjmë? Pra, ne nuk mundemi vetë ta bëjmë nëse investimi del për 40 vjet, vërtet shumë, gjatë kohë, qysh të presim, po shtatë qysh s'presim? Kemi pritur pesëmbëdhjetë vjet, e s'po mundeshim të presim shtatë vjet, edhe tre që do të ndërtohet, për dhjetë vjet ne i kemi 1 miliard e 300 milionë që i kemi investuar, na u kanë kthyer dhe nëse, ministër, për shtatë vjet kthehen paratë, kjo i bie që pas shtatë vjetëve, çdo vit nga 200 milionë euro fitim, përpos pagave dhe përpos energjisë elektrike. Pra, të mos e ngatërrojmë, askush nuk është kundër investimit në fushën e energjisë elektrike. Dallimet i kemi: a duam ta bëjmë përmes investimeve publike apo investimeve private? Dhe, mbi të gjitha, u shtrua këtu një pyetje, qysh duam ta ndërtojmë këtë kur s'kemi ekspertë! Shumë thjesht është, e shpall interesin publik, të vijmë kompanitë, të tregojnë a ta mbarojnë "fiqë", a "fiat", a ta mbarojnë "mercedes", çfarë të duash ti, pastaj e porosit.

Pra, nuk është çështja që ne na nevojiten ekspertë që ta mbarojmë, se këta ekspertë nuk i ka asnjë vend në rajon, po kanë vendet industriale, me atë industrinë e rëndë të tyre të zhvilluar, vjen kinezi nesër të konkurron, po të vjen edhe japonezi, të vjen edhe gjermani e edhe amerikani, ti vendos në bazë të kapacitetit tënd ekonomik, financiar, vendos kujt po do t'ia japësh ta ndërtojë. Edhe fillon brenda tre-katër vjetësh a pesë, sa shkon ndërtimi, e hap more një degë të fakultetit

atje në universitet dhe u thua që disa inxhinierë tash duhet shkolluar që të mund të punojnë në at termocentral. I merr edhe do profesorë prej atyre vendeve industriale, ta përgatisin edhe kuadrin. Pra, nga momenti kur ne fillojmë ndërtimin, duhet filluar edhe përgatitjen e kuadrove.

Çështja është: a duam investim publik apo duam investim privat. Me sa unë dëgjova këtu, paratë po u kthye kan shpejt, prandaj unë jam për investim publik. Faleminderit! Po u lë pak kohë kolegëve deputetë të Nismës, por them edhe një orë të flas, unë nuk kam çka them më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Qytetarë të dashur,

Po bëhet fjalë për një projekt, se këtu pak dolëm prej temës, po më duket, se tema është shumë më e ngushtë se ato që u diskutuan paraprakisht që nga fillimi, por po bëhet fjalë për një projekt që është i ndërtuar si financim i strukturuar dhe arsyeja pse përdoret ky term është sepse financimi i projektit, në fakt, bazohet në një strukturë, e cila në vete ngërthen një mori subjektesh dhe kontratash në mes tyre, të cilat janë të ndërtuara me qëllimin e realizimit të një qëllimi të caktuar, që është projekti.

Natyrisht, se çdo palë dhe çdo raport juridik në mes këtyre palëve mundohet të sigurohet për të eliminuar rrezikun eventual të dështimit të njërit nga linçet, ose nga këto raportet juridike, sepse rrezikohet i tërë projekti të mos realizohet, nëse njëri nga këto linçe dështon. Rrjedhimisht, këtë e kemi parë edhe në këtë rast, sepse pikërisht kjo është tentuar të bëhet, si të themi, për të mos u përsëritur gjërat, qysh i ka ndodhur me sa më kujtohet edhe Contour Global-it në Argjentinë, ku i ka dështuar plotësisht projekti i ndërtimit të një projekti të tillë, siç po ndërtohet ose synohet të ndërtohet në Kosovë.

Po kjo nuk është tema e sotme të diskutohet a e ka Kosova strategjinë e energjisë për të investuar në thëngjill të mirë apo jo, ose a është ky projekt. Temën, sa e kuptova sot, ka të bëjë me atë se a është e nevojshme të themelohet kjo STV, ose kjo ndërmarrje publike, e cila është themeluar me vendim të Qeverisë. Edhe këtu u dëgjuan dy gjëra që u thanë edhe prej kryeministrit dhe prej ministrit, nën një, që projekti si projekt, financimi i tij nuk po garantohet prej Kosovës. Po, natyrisht që nuk garantohet prej Kosovës, sepse nëse ti një subjekti ia garanton lëndën e parë, me një sasi të caktuar, cilësi të caktuar dhe çmim të caktuar, dhe ia garanton blerjen, natyrisht se s'ke nevojë t'ia garantosh financimin, sepse financimi, kthimi i financimit është i sigurt, sepse e ke një subjekt që lëndë të parë ka sa të duash, me çmim të caktuar dhe cilësi të caktuar, edhe po e shet sasinë dhe çmimin e ka të garantuar, që domethënë s'ka aty rrezik komercial. Kështu që nuk është problemi aty.

Tash unë po dua të fokusohem vetëm në këtë punën e themelimit dhe t'i bëj disa pyetje, s'qenka këtu ministri, ndoshta doli në pauzë a diçka, po a ka pasur nevojë të themelohet kjo ndërmarrje në këtë stad kohor? Gjithmonë po flasim duke pasur parasysh që garancinë që duhet t'ia japë ky Kuvend nëse e voton, nuk është ende para këtij Kuvendi, do të thotë ende nuk dihet a do të dështojë ky projekt apo do të shkojë përpara.

Çështja e dytë ka të bëjë me a kemi pasur ndonjë obligim ligjor, ose kontraktual që ta realizojmë themelimin e kësaj ndërmarrjeje në këtë moment kohor. Tash, sot u fol që u themelua për t'i bindur financierët për të mbështetur financimin e projektit, po ata nuk binden pse na e themelojmë a nuk e themelojmë një ndërmarrje publike, ata binden sa ka qenë "Contour"- i mjaftueshëm i suksesshëm në ndërtimin e këtij financimi të strukturuar që thashë, këtyre raporteve juridike dhe subjekteve të caktuara në letër. Edhe ajo është çka u shitet financierëve potencialë për ta financuar këtë projekt, jo domosdoshmërisht a e ka themeluar Kosova një ndërmarrje publike apo jo. Kështu që, unë dua të di a ka qenë obligim ligjor edhe kontraktual që të themelohej ndërmarrja në fjalë në këtë moment kohor.

Natyrisht, është pyetja tjetër, a kishim mundur të pritët që të themelohet pas momentit kur synohet që garancia që pritët ky Kuvend ta kalojë, të kalojë në Kuvend, me qëllim që të mos ndërmarrim hapa para se të ketë nevojë dhe të krijojmë shpenzime shtesë. Tash shtrohet pyetja, çka nëse vijmë në një situatë ku nuk mund të gjeni mbështetjen e mjaftueshme në këtë Kuvend dhe rrjedhimisht çka bëni ju me këtë kompani, ndërmarrje publike, nëse pra nuk kalon garancia në Kuvend? Çka bëni me ta, i shkarkoni, i shuani apo çka... domethënë keni krijuar diçka që potencialisht mund të kërkohet prej juve të shuhet. Pra, unë thjesht po kërkoj që Qeveria në këtë rast të ketë një qasje normale, që të mos bëjë hop pa e kaluar, si të themi, pengesën, por vendimet dhe hapat t'i ndërmarrë sipas radhës dhe sipas arsyes.

Pra, të mos shkojmë ne te financierët e të themi që kemi ndërtuar diçka, kur në fakt ende nuk jemi në atë stad ku është e nevojshme të themelohen këto gjëra, se veç po i krijojmë vetes shpenzime të panevojshme, me një buxhet që ashtu-kështu, do ta kemi problem ta konsolidojmë vitet e ardhshme, duke pasur parasysh krejt shpenzimet, edhe krejt skemat të cilat po i ndërtojmë këto vitet e fundit. Kështu që, të jemi pak më konservativë, t'i qasemi edhe këtij projekti pak në mënyrë më konservative, që t'i kursejmë edhe buxhetit, edhe vetes, edhe mund, edhe shpenzime të panevojshme. Kështu që, nëse mundeni veç të më përgjigjeni në këtë pyetje, a ka pasur nevojë thjesht të realizohet në këtë moment apo kemi mund edhe më vonë ta realizojmë, pasi që të siguroheni që projekti kalon në Kuvend? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radha, Gani Dreshaj s'është. Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për dallim prej parafolësit, unë mendoj se tema e nënshkrimit të kontratës dhe krejt projektit Contour Global me temën e themelimit të ndërmarrjes publike janë drejtpërdrejt të ndërlidhura. E dëgjova me vëmendje edhe ministrin kur i dha arsyetimet e veta pse Kosova përfiton nga projekti i Contour Global, ose projekti i Kosovës së re.

Megjithatë, një rikujtim për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Projekti i Kosovës së Re është i filluar prej vitit 2004, jemi në vitin 2019. Në vitin e kaluar është nënshkruar kontrata. Do të thotë midis kohës së inicimit dhe diskutimit në kohën e nënshkrimit në mes janë afërsisht 15 vjet. Tash, nëse një projekt i kategorisë së tillë diskutohet, trajtohet, edhe kalon nëpër shumë filtra, qoftë të organizatave vendore e qeverive të ndryshme, por edhe të atyre ndërkombëtare, të paktën duhet t'i ketë tri vlerësime të arsyeshme të cilat gjithë në opinion publik duhet t'i kuptojnë, e në veçanti politikbërësit apo deputetët e këtij Kuvendi, që në masë nuk e mbështesin sot siç po dëgjohet këtë projekt.

E para, vlerësimin ekonomik-social. E dyta, duhet të jetë në përputhshmëri me të gjitha synimet zhvillimore dhe politika zhvillimore të vendit dhe e treta duhet të jetë në përputhshmëri me standardet mjedisore të cilat në Kosovë janë larg të tejkaluara dhe të shkelura.

E dëgjova ministrin duke i dhënë arsyetimet e veta. Ministri është, në fakt, unë i kisha bërë një pyetje kur ta marrë fjalën të adresohet. A e ka lexuar ministri komplet kontratën 1 000 faqe që e ka nënshkruar, si e para, dhe a e di obligimet të cilat i ka marrë përsipër Qeveria e Republikës së Kosovës dhe shteti i Kosovës në raport me këtë kontratë? E njëjta pyetje vlen edhe për Kryeministrin, për arsye se si Qeveri e vendimeve të mëdha, konsideroj se është goxha një vendim ta mbajë dhe ta shtyjë një përpara një projekt të kësaj madhësie dhe të shkohet me inercion ose t'i referohet qeverisë paraprake. Nëse do të ndërrosh drejtim dhe tregon që je më e aftë, atëherë duhet të tregosh arsyeshëm argumente pse e ke bërë këtë.

Tha më herët ministri se me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe kryerjen e këtij projekti, garantohet çmimi, ose është çmimi i siguar. Çmimi i cili është i paraparë të jetë për qytetarët e Republikës së Kosovës, është mbi mesataren e çfarëdo çmimi rajonal. D.m.th. përderisa ne flasim për një stabilitet ekonomik-social, ne po tregojmë që me çmimin për megavat ose kilovat që u faturohet qytetarëve të Republikës, ne kemi pasur çmimin më të shtrenjtë të energjisë elektrike.

Ndërsa sa i përket asaj se duhet të ketë siguri të energjisë, ne kur ia garantojmë blerjen, edhe kur ia garanton tregun një kompanie, natyrisht se ia ke garantuar krejt. Ajo tjetra sa i përket kredisë e këto janë jorelevante.

E tha ministri gjithashtu se ka për të siguar një shëndet më të pastër se kemi nevojë për nivel më të mirë të mjedisit. Unë po ia bëj ministrit pyetje direkt, shumë statistikore: a e di ministër

nivelin ose përqindjen e sëmundjeve që vijnë në burim? D.m.th. a e di ministri çka shkakton ndotje në Kosovë? Sa është përqindja e ndotjes së shkaktuar prej burimeve energjetike, sa është prej automjeteve, sa është prej faktorëve të tjerë ose prej amvisërisë? Nëse mundet dikush në Kosovë t'i japë një përgjigje të saktë për këtë, mund edhe të vijë të argumentojë që ka për të ofruar një mjedis më të pastër. Fatkeqësisht, sot në vitin 2019, Kosova nuk e ka një listë të qartë të ndotësve të saj. Ka po parashikime të ndryshme, vlerësime. Po nuk e dinë a është KEK-u, apo janë automjetet dhe cili rajon është më i ndoturi. Rajoni i Prishtinës me Obiliq dhe Fushë Kosovë është më i ndoturi në Kosovë, me 500 mijë banorë apo afërsisht një të tretën e qytetarëve të Republikës së Kosovës që jetojnë në këtë rajon.

Shkojmë te furnizimi dhe strategjia e mirëfilltë ose strategjitë zhvillimore. A mund të na tregojë Kryeministri ose ministri në këtë rast, si mund ta shpjegojnë që amvisëria është 59 për qind konsumuese e energjisë elektrike? Për qëllimi komerciale dhe industriale është 29 për qind, ndërsa për të tjerat i ke dy-tre për qind. Tash, nëse ne e kemi amvisërinë në 59 për qind konsum të energjisë elektrike, nuk është ndërtimi i kapaciteteve të reja të bazuara në thëngjill masa, po është ngritja e masave eficientë. Kjo Qeveri ka marrë obligime me një rezolutë të Kuvendit të vitit 2018, në janar të vitit të kaluar, për të parandaluar ndotjen që do të shtojë fond të eficientë. Asgjë kjo Qeveri nuk ka shtuar sesa që ka qenë e paraparë me buxhet më herët. D.m.th. 59 për qind e energjisë elektrike neve na shkon në konsum të amvisërisë, ndërsa nuk i kemi rritur masat e energjisë eficientë, nuk e kemi bërë asnjë masë tjetër e cila mund të ndihmojë ose të zëvendësojë energjinë elektrike si mjet për ngrohje edhe për zierje në amvisëri.

Shkojmë te tjetra. Sa i përket ndikimeve mjedisore. A mundet dikush nga Qeveria Haradinaj të na japë një pyetje të thjeshtë: A ka projekti Contour Global vlerësim të ndikimit në mjedis dhe a kanë leje mjedisore? Sa i përket projekteve të mëdha strategjike, secili projekt duhet t'i ketë, e para vlerësimin e ndikimit në mjedis, e dyta lejen mjedisore. Dhe jo vetëm projektet e energjisë, projektet e autostradave, projektet tjera zhvillimore. Ne fatkeqësisht jemi shtet, i cili shteti bëhet kontraktues dhe jashtëligjshëm vazhdon me zhvillim të projekteve, qoftë me mungesë të lejeve të ndërtimit, qoftë me leje mjedisore. Le të vjen këtu, sot është dashur të jetë edhe ministri i Punës dhe Mirëqenies, edhe ministri i Mjedisit. Edhe secili prej aspektit të vetë, të na tregojë dhe të na japë një përgjigje të saktë neve. Cili është vlerësimi i ndikimit në mjedis për Contour Global? Mos na tregoni që do të ketë teknologji të avancuar. Asnjëri nuk mund të hyjmë në ato specifika. Le të na tregojë saktë dhe qartë, cilët janë ata që kanë punuar në vlerësim të ndikimit në mjedis, sa është i qëndrueshëm ai vlerësim i ndikimit në mjedis dhe a do të kalojë lejen mjedisore?

Te aspekti i shfrytëzimit të burimeve energjetike. Në rast se ne duam ta shfrytëzojmë dhe sigurojmë një furnizim të mirëfilltë të energjisë elektrike, a t'u tregojmë qytetarëve që menjëherë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! E ke shfrytëzuar kohën e katër kolegëve të tjerë, kështu që në qoftë se dikush ta jep minutazhin. Fjalën e ka z. Glauk Konjufca, s'është. Gani Dreshaj është paraqitur, s'është. Ahmet Isufi. Me radhë.

AHMET ISUFI: Faleminderit kryesues!

Sot është një temë jashtëzakonisht e rëndësishme sa i përket termocentralit Kosova e Re. Kjo tregon që vërtet ka një interesim për të ditur sesi mund të implementohet një projekt i tillë. Nuk është sot siç u tha kjo temë, por është nga viti 2004, në Qeverinë e Bajram Rexhepit të ndjerit. Prej atëherë, unë e di që ka pasur si një angazhim në këtë drejtim, ka pasur edhe konsulencë, e di që është paguar dhe për vite të tëra është biseduar nga Kosova C që ka qenë atëherë si projekt i parë në Kosovën e Re që ka vazhduar madje në qeveritë e kaluara, deri në këtë qeveri.

Tash, është interesant që të shpjegohet se ku ka investime Contour Global që t'i dimë në njëfarë mënyre efektet e mundshme në të ardhmen.

Po ashtu, nëse kemi një teknologji të avancuar që vjen përmes kësaj kompanie, normalisht që edhe çështja e ambientit mund të jetë çështje shumë më e mirë, në kuptimin e ndotjes, që do të jetë normalisht me një teknologji shumë më të avancuar sesa që e kemi sot dhe që ndotësi më i madh dihet që është Kosova A, Kosova B, po ashtu edhe termocentralet përcjellëse.

Duhet një studim më i thellë mendoj, nuk duhet apriori të kundërshtohet pa pasur një bazë të të dhënave mbi të cilat duhet të bazohemi. Dhe ajo që është më kryesorja, nëse ne mund t'i ndalim importin e energjisë që po i kushton miliarda Kosovës, atëherë duhet vërtet një studim, një angazhim shumë më i madh edhe i deputetëve, përmes ekspertëve, e jo të flasim paushall në këtë seancë, por përkundrazi të marrim ekspertizën e duhur nga Qeveria, po ashtu edhe nga ekspertë të tjerë, të cilët e njohin këtë lëmi dhe të mos kundërshtohet apriori, përkundrazi duhet të kemi një bazë të mirë të të dhënave, në mënyrë që nëse është ky projekt i dobishëm për Kosovën, i nevojshëm po ashtu, gjithsesi atëherë të përkrahet edhe të ecim më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Miliam Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë me të vërtet të gjithë çka kanë diskutuar, një pas një i kam dëgjuar me vëmendje, edhe në mënyrë absolute pajtoj me ta. Unë trishtohem kur dëgjoj që është hapur një kompani, akoma pa u nënshkruar kontrata me Contour Global. E kam mbështetur kontratën, edhe jam që të ndërtohet një termocentral modern e të gjitha ato, po si ka mundësi që në kontratë të thuhet minimum pesë vjet do të marrë kohë ndërtimi i këtij termocentrali dhe pse nuk është pritur deri në atë kohë. E para.

E dyta, kisha pasur dëshirë të kërkoj nga Qeveria e Kosovës, meqenëse kemi mbingarkim të këshilltarëve, mbingarkim të zëvendësministrave, është një armatë e tërë që veç rrinë gjithë ditën me telefona në dorë, të bëjnë një hetim ku kanë shkuar paratë e UNMIK-ut dhe të EULEX-it, të dedikuar për energji elektrike në Kosovë. Punën e parë që na e gjuajnë, na e përplasnin në fytyrë çdo ndërkombëtar kur rrinë me neve është kjo. Ne i kemi dhënë, thonë ata, diku 800 milionë euro për termoelektranë dhe ju nuk keni energji elektrike. Në kohën e UNMIK-ut, i nderuar ministër, e ke të faktuar, t'i sjell edhe dëshmitarët, UNMIK-u ka ngarkuar në Selanik trenat me gjoja naftë, mazut dhe i kanë mbushur me ujë dhe i kanë derdhur në KEK, në termoelektranë, d.m.th. aso hajnish gjigante kanë bërë ndërkombëtarët.

E dyta, shumë e kam një brengë që jeni duke e bërë të njëjtën gjë që e ka bërë Qeveria e kaluar me Ferronikelin. Kanë bërë një kontratë fikse, ku një kilovat rrymë p.sh. për pesë vjet, shtatë vjet, ia kanë zgjatur kontratën, është paguar, Ferronikeli e ka paguar vetëm 33 euro. Ndërkohë që Kosova e ka blerë 120 euro nga importi. Jeni duke bërë kontratë fikse dhe mbi bazën e kësaj, duke përjashtuar Contour Global-in që unë do e mbështesë si deputet, këtë kontratë, këtë kompani të re që e keni bërë, pavarësisht se ti nuk e ke bërë, jam shumë i garantuar, po ai që e ka dhënë idenë të bëhet, e ka bërë me sherr, edhe me dallavere.

Unë dyshoj që këtu është duke u bërë një lojë e madhe me paranë publike. Prandaj, mbi bazën e kësaj, po them edhe një herë të keni kujdes, sepse e tha Glauku që mund të biesh në burg. Ti me ra në burg, s'ka lidhje se je djalë i ri e përballon, por është mirë që të kenë kujdes, edhe ata në të kaluarën që kanë bërë kontrata të dëmshme si me Ferronikelin për shembull, edhe me shumë kompani të tjera, edhe në proces të privatizimit, me pas kujdes ndoshta vjen një ditë, një forcë politike në këtë vend, ku e vendos një prokuror i cili merret me hetimin e çdo kontrate prej pasluftës e deri sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani dua t'ju them që LDK-ja i ka edhe 24 minuta, PDK-ja i ka 23 minuta, Vetëvendosja i ka 14 minuta, AAK-ja i ka 0.7 sekonda, PSD-ja i ka 7 minuta e 53 sekonda, Nisma i ka 1 minutë e 27 sekonda, 6+ i ka 7 minuta e 30 sekonda, pa grup e ka 1 sekondë.

Fjalën nga Vetëvendosje, Glauk a do ta marrësh fjalën, a e ke kërkuar apo dikush tjetër që është paraqitur? Kështu që, ju keni të drejtë t'i shpenzoni minutat si ta doni, ose leni.

GLAUK KONJUFCA: Tash, sa i përket në fakt kontratës edhe një herë, e pastaj kësaj kompanisë së krijuar enkas për të blerë energjinë elektrike prej prodhuesit, prej gjeneruesit, në këtë rast investitorit, i cili po i qet paratë.

Sa i përket kësaj që e tha Kryeministri më herët lidhur me faktin se po është problem të gjenden paratë dhe investitori është i mirësearchur kur i grumbullon paratë dhe hyn me një projekt, se

paratë po hynë në Kosovë, pastaj kjo mund të gjenerojë zhvillim. Vetëm dy elemente t'i marrim. Sa kamatë të kredisë ke për të paguar, e para. Edhe e dyta, sa kthim ke për të paguar në investim kapital.

Unë e thash në fillim, kjo pa asgjë hiç neve na kushton 150 milionë euro. A po pajtohemi që na kushton 150 milionë euro, kjo është shumë me rëndësi. Ti d.m.th. veç pse s'po i investon paratë tua, po paguan për asgjë 150 milionë euro. A e di sa janë 150 milionë euro? Nuk është hajgare kjo punë a e di, po ne po kemi për asfalt, po s'po kemi për energji elektrike, kështu që ne i nxjerrim prej xhepit tonë pa lidhje 150 milionë euro. Më fal bre, po ky debat është, nuk është në nivel të racionalitetit ekonomik ky debat. Duhet pranuar.

Neve na kanë shkuar 700 apo 800 milionë euro për një autostradë drejt Shqipërisë, po na shkon një miliard euro autostrada e Dukagjinit. Për çdo vit kësti që paguan Qeveria prej buxhetit drejtpërdrejt për asfaltin është ndërmjet 100 dhe 130 milionë euro për çdo vit. Deri në vitin 2023 për ta ndërtuar këtë termocentral, ti po thua që Kosova duhet të marrë kredi, a për ta ndërtuar 450 megavatë, unë po të them që tregu e thotë që është 450 milionë. 450 milionë euro, ti i ndërton kapacitetin me 450 megavatë.

Ama ajo që po e kursen ti është njëzet vitet e ardhshme, mos të krijosh një situatë politike qysh i ka ndodhur një vendi për të cilin ka studim. Ministër, një kontratë të tillë e ka nënshkruar Afrika e Jugut para do vitesh, bash kështu siç e ke nënshkruar ti. Është interesant rasti të studiohet se është e njëjta kontratë është. Sikur të thuash, ajo është të thuash kështu: në vitin 2030 do të krijohet një aso situatë energjetike në Kosovë, aq shtrenjtë do të jetë energjia elektrike me këtë kontratë, më shumë se gjyma e familjeve në Kosovë po të garantoj nuk do të kenë hesap t'i lajnë teshat me lavatriçe. Kanë me i la teshat në dorë o ministër. Këso situatë energjetike do të krijosh në Kosovë. Të mos guxosh ta fusësh makinën e larjes në rrymë. Kështu ka shtete të cilat u ka ndodhur. Unë po ta jap ty rastin ta studiosh, e ka nënshkruar Afrika e Jugut, atyre u ka ndodhur kështu. I ka ndodhur Argjentinës e njëjta.

Edhe si manifestohet në fund kriza, dalin qytetarët të protestojnë o ministër. Dalin qytetarët të protestojnë se nuk ua rrok kurrqysh me këto ngritje të çmimeve, tash veç edhe i energjisë elektrike të mbetet të rritet. Kur të ngritet energjia elektrike, nuk po të ngrihet veç fatura, krejt çmimet kur të hysh në vetëshërbim do të ngrihen. Se kur ngrihet çmimi i energjisë elektrike, kjo i rrit edhe një milion çmime të tjera. Kështu që, ti s'po e llogarit këtë kosto afatgjate, me të cilën do të përballen qytetarët e Kosovës. Pse? Sepse ti e ke qit atje çmimin me të cilin ti do t'ia blesh Contour Global-t, ke për t'ia blerë gjeneruesit që po e prodhon. A e ke caktuar çmimin me të cilin ti ke për t'ia blerë gjeneruesit energjinë elektrike? Në momentin që e ke caktuar ti, edhe manipulove pak më herët se the pragu më i lartë, target nuk është pragu më i lartë. Në marrëveshje e ke nënshkruar, me nënshkrim tëndin target. Target është i arritshëm, i synueshëm,

krejtësisht normal është. Target është normaliteti, nuk është pragu më i lartë, nuk është tavani target.

Kështu që, ti duhet të kesh kujdes edhe qysh interpretohet kontrata, kush ta interpreton, qysh ta interpreton, është ajo që shkruan në tekst dhe ti e ke nënshkruar. Edhe po të ndodh të përfundojmë në nëpër arbitrazhe qysh ka përfunduar qëllimisht mafia e Telekomit, Z-Mobile me Telekomin tonë, ajo është interpretim preciz i termave të marrëveshjes. Edhe ti për këtë marrëveshje, s'ke çka na flet, prej mënyrë asimetrike, qysh janë kushtet e kontratës, ju duhet të paguani 20 milionë euro thuajse, vetëm nëse e prish kontratën.

Vetëm mos harro që nëse e analizon kontratën edhe pasojat e saj, kjo do të jetë kostoja jonë më e mirë e mundshme sikur ta prishnim këtë kontratë dhe të paguheshin veç 20 milionë euro. Dëmi më i madh do të ishte nëse zbatohet kjo kontratë dhe jo nëse priset dhe nëse ndalet në gjysmë.

Kështu që, e gjithë kjo që po e themi dhe në mënyrë që t'i rikthehem edhe me më precizitet temës së interpelancës, kjo kompani e re të cilën e ke krijuar nuk është larg logjikës së Z-Mobile. Çfarë keni bërë ju është ekuivalenti i Z-Mobile, me këtë kompani të re që e ke krijuar.

Çka i bie kjo? Qeveria po hyn garant që diferencën e çmimit mes blerjes që do t'ia bësh Contour Global edhe asaj që do t'ia shesësh, kompanisë së Kosovës, kompanisë elektroenergjetike të Kosovës, atë diferencë do të mbulosh vet, ministër. Vet do ta mbulosh me paratë e tua.

E tash a po paguan prej këtij xhepi apo prej atij xhepi, është pak me rëndësi prej cilit xhep. Xhepi është i qytetarëve të Kosovës. Nuk është i yti privatisht dhe as i kryeministrit dhe as i yti po as i Contour Global. Xhepat tonë me një mesatare do të hyjnë dhe do ta paguajnë atë diferencë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Fjala është për ministrin. Zoti ministër e keni fjalën për t'i dhënë sqarimet e duhura. Keni kohë të mjaftueshme, ua ka dhënë Grupi Parlamentar i PDK-së.

Kështu që mos diskutoni në presion të kohës. Pastaj vetëm edhe zoti Visar Ymeri do ta ketë fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem t'ju përgjigjem pyetjeve pak më teknikisht për hir të qytetarëve që të kuptohen disa pjesë.

E para, është me rëndësi të kuptohet që çmimi aktual i energjisë elektrike që po e marrim këtu si shembull që blihet nga KEK-u nuk është çmim real. Pse nuk është real?

Çmimi prej 30 eurove është një çmim nën kosto të prodhimit. Është një çmim që nuk ka amortizim. Nuk ka kosto të financimit. Pra, janë asete të tërësisht të amortizuara.

KRYESUESI: Gane, ju lutem qetësi! Uluni në vend!

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Nuk mund të merren si modele për një projekt të ri që mund të ndodhë në të ardhmen.

KRYESUESI: Ju lus për qetësi! Zonja Hadërgjonaj. Safete Hadërgjonaj, ju lutem uluni! Edhe pak kemi dhe në qoftë se ju flisni, atëherë s'ka nevojë të diskutojë ky hiç. Ose dëgjojeni, ose... Zoti ministër, vazhdoni!

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit!

E dyta, çdo investim që bëhet në tregun energjetik, çfarëdo qoftë, qoftë në ndonjë transmision të ri, qoftë në kapacitetet gjeneruese, qoftë energjia e ripërtëritshme që e garanton blerjen e energjisë për 12 vite apo 15 vite, të gjitha futen në tarifat e energjisë.

Sot, nëse termocentrali ndërtohet nga Kosova, prapë Kosova do të marrë kredi. Ka kosto të financimit. Prapë Kosova e bënë investimin, ka kosto. Prapë ne duhet të bëjmë një tender, që do të ketë kosto, mbase më të madhe.

Dhe, normalisht nëse vjen puna tek efienca e menaxhimit të atij termocentrali këtu do të çalojmë në krahasim me një privat që e menaxhon më mirë dhe në formë më eficiente për arsye të interesit personal.

Si të tillë, dallimi mes ndërtimit publik dhe privat nuk është aq i madh, kur të krahasohet rëndësia e nevojave të investimeve në infrastrukturë që e kemi në vend.

Sot, konsiderohet që Kosova ka nevojë për rreth 10 miliardë euro investime në infrastrukturë, për përmirësimin e infrastrukturës në nivel të barabartë me vendet e Bashkimit Evropian.

Kurse arsyeja kryesore pse me sektor privat të ndërtohet termocentrali, është se sektori energjetik ka mundësi që të thithë investime private, kurse sektori i infrastrukturës, rrugë e këto, nuk kanë mundësi, është problem. Prandaj, duhet të bëhet me financim të buxhetit.

Është me rëndësi gjithashtu të ceket e tha deputeti Konjufca, që ne 150 milionë euro i kemi kosto me automatizëm, 70 nga financimi i kredisë, kurse 70 nga fitimi i garantuar.

Një gjë duhet të kuptohet, 18,5% fitimi i garantuar, apo kthimi në ekuitet i kompanisë Contour Global. Çfarë do të thotë ajo? Ajo është vetëm për pjesën e ekuitetit që është 30% e investimit.

Pjesë tjetër është e gjitha pjesë e kostos së projektit që është rikthim të investimit të bëhet për shumë vite.

Nëse e shikojmë nga kthimi në ekuitet në kthimin e investimit ajo zbret diku në rreth 12 % për afërisht. Që është brenda normave normale të kthimit në investim të një investimi të madh.

Kthimi në ekuitet do të thotë që nëse neve nesër na del çmimi, pasi që t'i marrim të gjitha kostot dhe inkorporojmë në modelin financiar dhe del çmimi që është diku rreth 65 euro për MGW, 18.5% të këtij 65% është fitimi që e inkason kompania Countour Global.

Pra, jo projekti si tërësi që u mor rreth 1.3 miliard X 18.3%. Pra, shkojnë vetëm sa i përket pjesës së ekuitetit.

Këto janë gjëra bazë që duhet të kuptohen, sepse po ka keqkuptime.

U përmend që ky projekt do t'i kushtojë Kosovës 5 deri në 6 miliardë euro. Absolutisht nuk është e vërtetë, sepse një kosto e pagesës së rrymë dhe jo vetëm rrymës po të asnjë produkti nuk mund të llogaritet si kosto totale e projektit. Njëjtë është sikurse për shembull, unë sot të prodhoj ujë edhe të them se i gjithë qarkullimi i shitjes është kosto e projektit.

Kosto e projektit është 1.3 miliard maksimalja që është vlerësuar dhe kjo varet tash nga ofertat që pranohen dhe aty futet kosto financiare edhe mbaron ajo punë.

Kosto operative për shkak që ky termocentral është teknologjia e fundit, është më eficientë, kosto operative do të jetë shumëfish më e mirë sesa që e ka sot KEK-u. Rreth 18 cen për KW apo për 18 euro për MGW. Janë pastaj ato kostot tjera që është amortizimi, është financimi dhe të gjitha ato dhe plus fitimi i garantuar që e rrisin normalisht çmimin për MGW.

Sot, kur flasim për, e përmendi deputetja Kusari-Lila. E para, ndikimi në mjedis. Deputete e dimë saktësisht, sipas studimit të Bankës Botërore në ndikimin në ambient dhe shoqëri se çfarë burimesh dhe sa ndikojnë në ndotje të ambientit.

Sipas të njëjtit studim të përfunduar në vitin 2016 e të rishikuar në vitin 2018, termocentrali 'Kosova A' kontribuon në ndotje vetëm 2% të të gjithë ndotjes. Termocentrali 'Kosova B' ndikon me 8%, pra shumë më shumë se 'Kosova A', sepse 'Kosovës A' i janë ndërruar filtrat më 2011.

Makinat rreth 30%, kurse djegia e thëngjillit në mënyrë të pakontrolluar nëpër shtëpi rreth 60%.

Këto janë të dhëna zyrtare sipas studimit të financuar nga Banka Botërore.

Pra, saktësisht e dimë se cili është burimi kryesor i ndotjes në Kosovë dhe dihet saktë ku mund të merren masat për atë punë.

Gjithashtu, sa i përket efektivitetit. Normalisht që projekti vet 'Kosova e Re' e dyfishon kapacitetin e ngrohjes që qendrore në Prishtinë. Kjo tregon që kjo është masë efektive, ku shtëpitë do të ngrohet shumë më tepër nëpërmjet kogjenerimit që është forma më e lirë dhe më efektive për ngrohjen e shtëpive në Prishtinë.

Gjithashtu, kemi pasur një buxhet rreth 30 milionë euro nëpërmjet një kredie të Bankës Botërore që i bënë të gjitha ndërtesat publike efektive, duke përfshirë spitalet, universitet, shkollat fillore dhe të mesme, objektet tjera institucionale.

Pra, është punuar dhe po punohet edhe sot e kësaj dite në efektivitet, ku edhe kemi krijuar fondin për efektivitet të energjisë që ishte para një muaji.

Pjesa tjetër që nuk është përmendur. Në fund dua të them që kur po flitet për marrëveshje për blerjen e energjisë që është e nënshkruar me Contour... qenka kundër rregullave të tregut të lirë, kurse kur po flasim që nënshkruhen me qindra MGW në energji të ripërtëritshme garantohej për shumë e shumë vite, nuk qenka kundër rregullave të tregut të lirë.

Ndihma shtetërore klasifikohet në raste të caktuara. Në rastin e Kosovës jemi duke folur për energji bazë për siguri nacionale me furnizimin të energjisë. E në raste të tilla kemi shumë shtete duke e përfshirë edhe Anglinë, ku ka nënshkruar marrëveshje për blerje të energjisë për 20 vite me një kompani që ka ndërtuar një termocentral nuklear dhe kjo ka ndodhur tash vonë, më duket në 2016-ën.

Pra, kemi raste në vende të Bashkimit Evropian, ku i është lejuar dhe nuk është numëruar si ndihmë shtetërore. Quket ndihmë shtetërore e lejueshme sipas rregullave të Bashkimit Evropian dhe këtë edhe ne po e synojmë që ta bëjmë për 'Kosovën e Re'.

Unë mendoj që 'Kosova e Re' është një projekt që duhet të ndodhë në Kosovë, për arsye se kemi shumë prioritet tjera në shumë infrastruktura në projekte që nga uji i pijshëm, rezervat ujore e deri në infrastruktura rrugore që duhet të fokusohemi me para të buxhetit, kurse projekti i energjisë që ka mundësi të thithë investime private le të jetë i tillë, dhe kjo normalisht se e ka një kosto.

Kosto mund të jetë financimi, po nga ana tjetër do të ketë benefite, menaxhimi më i mirë, menaxhimi më efikas, jo mbi punësime e mbipopullime në ndërmarrje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! E ka fjalën vetëm Visar Ymeri. Faleminderit! S'ke qenë këtu, ka përfunduar debati. Visar, vazhdo.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Faleminderit të gjithë deputetëve që morën pjesë në këtë diskutim, po edhe ministrit që qëndroi deri në fund. Kryeministrit i cili ishte një kohë dhe shkoi.

Duhet ta them që, natyrisht u ngritën shumë çështje e unë disa prej tyre tentova t'i adresojë edhe gjatë diskutimit, veçanërisht në replikën që e pata me kryeministrin, po disa edhe mbeten për shkak të kohës së shkurtër të atëhershme.

Pra, edhe njëherë. Duhet ta kemi parasysh që për sektorin e energjisë nuk është vetëm një zgjidhje, dhe në fund të themi që ose do ta ndërtojmë këtë termocentral me Contour Global ose do të mbesim kështu siç jemi, sepse alternativa të tjera nuk e ka, ose siç e tha për shembull ministri, që është alternativa e vetme që e kemi në sektorin e energjisë.

Mendoj që kjo po bëhet qëllimisht nga Qeveria për ta mbrojtur një kontratë e cila natyrisht që nuk është e vetmja mundësi. Është njëra prej mundësive. Dorën në zërmë, mundësia më e keqe, siç e diskutuan këtu, por sidoqoftë është njëra prej mundësive.

Për shembull, një prej mundësive do të ishte që ta analizojmë pas një vlerësimi të nevojave tona energjetike për të ardhmen, dhe po flas për të ardhmen afatgjatë, t'i analizojmë pastaj se sa kapacitet, sa MGW në orë na duhen të ndërtoara që prodhohen nga thëngjilli.

Pastaj në kuadër të kësaj analize, të vendosim sesi do t'i ndërtojmë ato. Për shembull, si kemi ardhur deri te kjo shifra 500MG, 450MGW, sepse më herët që u përmend këtu, te termocentrali 'Kosova C', atëherë është planifikuar të jenë 2100 MWG.

Pastaj është bërë një ndryshim dhe janë bërë 1000MGW, ndërkaq pastaj prej 1000MGW kemi rënë në 500MGW, asnjëherë pa përditësuar edhe strategjinë energjetike që e kemi. Po si kemi ardhur deri te ky arbitrariteti prej 450MGW?

E dyta, a nuk ka qenë ideja që me ndërtimet e reja, pra me instalimin e kapaciteteve të reja gjenerues ta rrisim edhe fleksibilitetin e sistemit tonë. Dhe, në 450 MGW nuk po e rrisim fleksibilitetin, përkundrazi po e bëjmë edhe më jofleksibil sistemin tonë energjetik.

Çka nënkupton fleksibiliteti? Një termoelektranë të caktuar, një bllok të caktuar ta ndalim kur nuk kemi nevojë për prodhimin që e marrim nga aty.

Dhe, tash e kemi në 'Kosovën B', dy nga 300. Tash po ndërtojnë 500, i cili i prodhon 450 Mgw energji elektrike.

Në kuadër të kësaj pastaj të vendosim, pse të mos ia rrisim kapacitet termocentralit të Korporatës Energjetike të Kosovës. Infrastruktura është e gatshme, ndërtesa është e gatshme, të gjitha parametrat dhe kapacitet janë të gatshme aty të ndërtuara, pse të mos i shtojmë edhe dy blloqe ta zëmë me nga 300MGW aty.

Kjo të bëhej me paratë publike. Do të kushtonin më lirë. Do të kishim energji shtesë të gjeneruar shumë më shpejt sesa me Contour Global.

Tjetra, pastaj. A kemi përlllogaritje të mundësive tona të energjisë së ripërtëritshme dhe deri në çmasë do ta mbulonin këto nevojën tonë energjetike në të ardhmen.

Pastaj, çka do t'i sillte sistemit energjetik të Kosovës, bashkimi ose unifikimi i tij me Republikën e Shqipërisë? Pra, a do ta ndihmonte kjo furnizimin me energji elektrike? Dhe nëse po, a ka nevojë që ta kemi edhe Contour Global, kur e kemi këtë mundësi me energji nga uji.

Pastaj e katërta, rritja e efijencës, investimet në rritje efijencës. A do ta reduktonin nevojën tonë për energji? Sigurisht që po, sepse përndryshe nuk do të kishte kuptim. Pra, të gjitha këto parametra, nuk i dëgjova t'i përmendin as kryeministri dhe as ministri në planifikimin e tyre për energji. Thanë, Contour Global dhe pikë.

Mendoj që kjo është absolutisht e papranueshme. Edhe nëse është kontrata më mirë, mënyra sesi po diskutohet në Republikën e Kosovës.

Ministri këtu e tha tash së fundi që, kthimi në ekuitet, pra që i jepet Contour Global për ato 300 milionë euro nëse nuk gabohem, që do t'i investojë si para të tyre, është normale. Jo nuk është normale ministër. Për shembull, nëse e shikon çka po ndodh sot me investimet e huaja direkte, globalisht në vitin 2017, kthimi në investime ka qenë mesatarisht globalisht 6.7%, mesatarisht.

Ndërkohë, që në vitin 2012 ka qenë 8,1%. Pra, kthimi në investim është duke rënë globalisht.

Nëse globalisht mesatarja është 6,7%, e hajde ta zëmë që tek vendet bë zhvillim, pra siç jemi ne do duhej të ishte pak më e lartë, ta zëmë që është edhe 2 pikë të përqindjes, normale do të ishte 9% ose 8.9%. Jo 18%. Pra, nuk është normale. Është absolutisht në kundërshtim me atë që po ndodh sot nëpër botë.

Pastaj, edhe kjo që u përmend, blerja e energjisë nga ripërtëritshmes. Unë jam dakord më atë që e thanë deputetët këtu që, problemi më i madh më këtë kontratë është që ne po i garantojmë treg. Ne po ia garantojmë blerjen e krejt energjisë elektrike, na u duhet apo nuk na duhet, e prodhoj apo nuk e prodhoj. Ky është problemi më i madh në këtë kontratë.

Për këtë po e bëjmë edhe për energjinë e ripërtërishme. Po natyrisht që e bëjmë për energjinë e ripërtërishme. Por, jo te një kompani. E bëjmë te të gjitha kompanitë, ta zëmë, që prodhojnë energji solare. Kjo është që të nxiten investimet në energji solare. Pse? Sepse janë më të mira për mjedisin. Që nuk është rasti...

KRYESUESI: Edhe një minutë dhe përmbylle.

VISAR YMERI: Po! Vetëm rekomandimin që e kemi, që e propozojmë ne dhe pastaj natyrisht e diskutojmë edhe me grupet para se të votojmë.

Pra, ne rekomandojmë kështu:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës të kërkojë nga Qeveria e Republikës dhe nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që;

a) Të ndërpresë të gjitha veprimet e ndërmarra deri më tani në lidhje me regjistrimin e ndërmarrjes së re energjetike të Kosovës NKEC, deri sa Kuvendi të vendos për miratim të garancisë së marrëveshjes komerciale ndërmjet kompanisë Contour Global dhe Qeverisë së Kosovës për projektin e termocentralit ‘Kosova e Re’.

b) Të mos lidhë asnjë marrëveshje kontraktuale derisa Kuvendi të vendos për miratimin e garancionit të marrëveshjes komerciale ndërmjet Countour Global dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Pra, praktikisht qa po themi ne është që, çfarëdo veprimi në zbatimin e kësaj marrëveshjeje të suspendohet derisa Kuvendi ta japë fjalën e vet përfundimtare. Nëse Kuvendi i thotë po garancisë, atëherë natyrisht që Qeveria ka të drejtë që të vazhdojë me zbatimin e kontratës. Nëse i thotë, jo, kontrata duhet anuluar dhe Kosova duhet të dalë nga kjo kontratë, sepse Kuvendi i ka thënë jo një kontrate të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Liburn, grupi juaj e ka shpenzuar gjithë kohën. Keni pasur në dispozicion vetëm 44 sekonda. Seanca ka përfunduar, nuk ke të drejtë të diskutosh pas ministrit dhe pas atij që e prezanton. Nuk ke të drejtë. Ke qenë këtu, ke mundur që të paraqitesh. Ka përfunduar seanca.

Atëherë, konstatoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës është shterur. Kemi disa pika të tjera që kemi menduar t'i votojmë. Nuk ka kuorum për votim. Mirupafshim në seancën e ardhshme! Faleminderit për bashkëpunim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë